UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

ÇËSHTJE TË ANTONIMISË NË MBIEMRAT DHE FOLJET E GJUHËS ANGLEZE DHE SHQIPE

Punim për gradën "Doktor"

Specialiteti: Gjuhësi

Mbrohet më, ___.___ 2014 para komisionit:

1.	**Prof.Dr. Viktor RISTANI**	**Kryetar**
2.	**Prof.As.Dr. Shpresa SHAMBLLI**	**Anëtar (oponent)**
3.	**Prof.Dr. Nonda VARFI**	**Anëtar (oponent)**
4.	**Prof.Dr. Raul LILO**	**Anëtar**
5.	**Prof.As.Dr. Shpresa DELIJA**	**Anëtar**

Disertante: Udhëheqës shkencor:

M.A Ekaterina STRATI **Prof.Dr. Ilo STEFANLLARI**

Tiranë, 2014

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE

0.1 Përligjja e studimit.....v

0.2 Objekti i punimit dhe hipotezat.....v

0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit.....vi

KREU I

1. ÇËSHTJE TEORIKE DHE SHKENCAT GJUHËSORE THEMELORE TË STUDIMIT TË ANTONIMISË

1.1 Leksikologjia.....1

1.1.1 Njohuri të përgjithëshme mbi leksikologjinë.....2

1.1.2 Metodat në leksikologji……....3

1.1.3 Leksikografia dhe roli i antonimeve në fjalor …….…….....3

1.1.4 Fjala dhe nocioni ……...……..……..…..…….……..5

1.1.4.1 Çfarë kuptojmë me termin "fjalë" në leksikologji?.....5

1.2 Semantika.....9

1.2.1 Historiku dhe terminologjia e semantikës.....9

1.2.2 Përkufizimi i semantikës ……..…..……...10

1.2.3 Qasjet e ndryshme ndaj semantikës…….....….11

1.2.4 Përcaktimi i njësisë themelore të semantikës …….……...…..11

1.2.5 Semantika, antonimet dhe strukturalizmi …….……13

1.2.6 Gjuha e folur dhe e shkruar si objekt i semantikës ……..…….....17

1.2.7 Semantika historike ……..…….……...…...17

1.3 Kuptimi dhe llojet e kuptimit në gjuhë.....…….....18

1.3.1 Ç'është kuptimi i fjalës?.....…….....18

1.3.2 Llojet e kuptimit……..…..…….....……20

1.3.3 Kuptimi konotativ dhe denotativ.....24

1.3.4 Tipet e marrëdhënieve kuptimore…….……. 26

1.3.5 Fusha konceptore, leksikore dhe semantike ……..…….27

1.3.6 Analiza e përbërësve kuptimorë…….…….….....28

1.3.7 Kuptimi gramatikor.....30

1.4 Lidhjet paradigmatike dhe sintagmatike 31

KREU II

2. ANTONIMET NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

2.1 Rreth historikut, terminologjisë, përkufizimit dhe burimeve të antonimisë në gjuhën shqipe dhe angleze.....……...35

2.1.1 Historiku.....35

2.2. Përkufizimi sipas kritereve të ndryshme.....38

2.2.1. Kriteri semantik…….……....38

2.2.2 Përkufizimi sipas kriterit leksikor…….……..39

2.2.3 Kategorizimi sipas kriterit të konfigurimit…….……....40

2.2.4. Burimet e antonimisë ……..…….....40

2.3 Antonimet dhe problematikat rreth natyrës së kundërvënies …….……42

2.3.1 Papajtueshmëria dhe antonimia……...……....42

2.3.2 Antonimia dhe mohimi……..42

2.3.3 Antonimia dhe shkallëzimi……..……..…49

2.4 Marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë dhe poliseminë si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe…….52

2.4.1 Marrëdhënia e antonimisë me poliseminë si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe…….....52

2.4.2 Marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe…….……54

2.5 Tipare të përgjithshme të antonimeve mbiemërore dhe foljore……....59

KREU III

3. TIPOLOGJIA E PËRGJITHSHME E ANTONIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

3.1 Antonimet tradicionale përballë kategorive të reja …….....66

3.1.1 Tipologjia tradicionale semantike në gjuhën angleze……..……...66

3.1.2 Tipologjia tradicionale strukturore në gjuhën angleze…….....74

3.1.3 Klasifikimi i përgjithshëm tradicional i antonimeve në gjuhën shqipe ……74

3.1.4 Klasifikimi i antonimeve shqipe sipas kriterit strukturor …….....78

3.1.5 Klasifikimi gramatikor shqip dhe anglisht ……...……..79

3.2 Kategoritë e reja të antonimeve……82

3.2.1 Kategorizmi në bazë të funksionit në bashkërenditje …….…….....82

3.2.2 Kategorizimi sipas interpretimit të konfigurimit dhe përmbajtjes së kuptimit...83

3.3 Kategorizime të tjera …….....84

3.3.1 Antonimet ndërkulturore……..……85

3.3.2 Antonimet stilistike……...……..86

3.3.3 Antonimet kontekstuale …….....87

KREU IV

4. TIPOLOGJIA E ANTONIMEVE TË SHPREHURA ME MBIEMËR DHE FOLJE NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE

4.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe, parë semantikisht…….……..…89

4.1.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën shqipe, parë semantikisht……..…….….88

4.1.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze, parë semantikisht……..…….…....96

4.1.2.1 Antonimet mbiemërore të shkallëzuara……..…….....97

4.1.2.2 Antonimet mbiemërore plotësuese…….....101

4.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën angleze dhe shqipe, parë semantikisht…….……...…….104

4.2.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën angleze, parë semantikisht……...…….....…...104

4.2.2 Shkallëzimi dhe foljet ……...…….…..109

4.2.3 Problematikat në klasifikimin e foljeve antonime ……....112

4.3 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe, parë semantikisht……..…….……...115

4.3.1 Analiza e përbërësve kuptimorë dhe kundërvënia tek foljet……...116

4.4 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe, parë strukturalisht……..…….116

4.4.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze, parë strukturalisht …….....120

4.4.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën shqipe, parë strukturalisht…….……..……..……..120

4.5 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe dhe angleze, parë strukturalisht……...…….……..130

4.5.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe, parë strukturalisht……..……..……..…..130

4.5.2 Antonimet e shprehura me folje dhe togfjalësh……...……..133

4.6 Klasifikimi i antonimeve të shprehura me togfjalësh……...134

KREU V

5. KORPUSI I ANTONIMEVE DHE STUDIMET EKSPERIMENTALE

5.1 Studime të rëndësishme të antonimeve, përmes korpusit dhe eksperimenteve gjuhësore.....141

5.2 Studimet tona të antonimeve përmes korpusit dhe eksperimenteve gjuhësore..157

5.2.1 Parashtesat e gjuhës angleze dhe shqipe në fjalorët një dhe dygjuhësh ...…….157

5.2.2 Studimi eksperimental përmes vjeljes së informacionit.....175

5.3 Përvetësimi i gjuhës dhe antonimet 183

5.3.1 Strategjitë kyçe për përvetësimin e fjalorit……....186

5.3.2 Roli i mësuesit në përvetësimin e fjalorit ……..190

PËRFUNDIME……....……192

BIBLIOGRAFI…….…….…….…….…….208

Ky punim i dedikohet profesionit tim si mësimdhënëse në fushën e gjuhësisë pasi ky është edhe frymëzimi dhe motivimi parësor në këtë puim. Por, gjithashtu, i‘a dedikoj edhe profesorëve, kolegëve dhe familjes që më mbështetën pafundësisht në këtë rrugëtim të gjatë, të lodhshëm por të vlefshëm e të rëndësishëm.

FALËNDERIME

Si ish-studente e Departamentit të gjuhës angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës dhe si pedagoge prej disa vitesh pranë departamentit të gjuhëve të huaja në Universitetin e Durrësit, i jam shumë mirënjohëse departamentit të gjuhës angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, ish-profesorëve të mi, si edhe kolegëve me të cilët jam "rritur" profesionalisht.

Kryesisht, dua të falenderoj udhëheqësin shkencor Prof.Dr. Ilo Stefanllari, për një udhëheqje shkencore, kritikë të mprehtë dhe mbështetje të vazhdueshme. Më duhet të cilësoj se pa ndihmën e tij, kjo punë shkencore nuk do të ishte arritur.

Me një notë të veçantë, dëshiroj të shpreh mirënjohje edhe për të gjithë të njohurit e të dashurit, të cilët duke patur besim më kanë ndihmuar moralisht që ky studim të përfundonte me sukses. Këtu, nuk mund të lë pa përmendur familjen time, e cila është gjithmonë inkurajuese dhe mbështetëse.

Dhe së fundi, kërkoj ndjesë për ata që nuk i kam përmendur, por që janë të shumtë, për mbështetjen e tyre gjatë kohës së punimit.

Ju Falënderoj!

0. HYRJE

0.1 Përligjja e studimit

Në këtë punim do të studiohen çështje të antonimisë në mbiemrat dhe foljet në gjuhën shqipe dhe angleze. Do të përfshihen çështje që lidhen me fushën e semantikës, leksikologjisë dhe morfologjisë. Gjatë hulumtimeve të shumta kemi gjetur se çështja e antonimisë në mbiemrat dhe foljet në gjuhën shqipe dhe angleze përbën interes të veçantë kryesisht në aspektet që lidhen me kategorizimin semantik dhe strukturor, si edhe me problemaika të natyrës së antonimisë parë në këndvështrime të ndryshme. Punimi shoqërohet edhe me studime praktike, rezultatet e të cilëve janë me vlera të konsiderueshme. Në këta kushte, mendojmë, se janë jo të pakëta vështirësitë e studimit në korpusin e antonimeve mbiemërore dhe foljore në gjuhën shqipe. Ato do të shqyrtohen në aspektin e dallimit të karakteristikave në të dyja gjuhët. Ky studim do të trajtojë, përpos dukurisë së antonimisë tek mbiemrat dhe foljet në të dyja gjuhët, edhe tipologjinë semantike dhe strukturore, si edhe trajtimin e antonimisë në lidhje me dukuri të tjera leksiko-semantike, si polisemia dhe sinonimia, i cili përbën dhe kontributin teorik të këtij studimi Nga ana tjetër, studimi do të shtrihet edhe në anën praktike kërkimore me bazë korpusi gjuhësor fjalorët një dhe dygjuhësh, nga ku do të dalin rezultate me interes në lidhje me antonimet mbiemërore dhe foljore në gjuhën shqipe dhe angleze. Përpos vlerave leksikore dhe leksikografike, ky punim ka vlera të lidhura ngushtë me përvetësimin e gjuhës së huaj dhe mësimdhënien e gjuhës angleze. Këtu, vlen për tu theksuar, kontributi praktik i këtij studimi, duke ofruar baza dhe strukturë për rëndësia e këtij studimi edhe për mësuesit e gjuhës angleze.

Duke konsideruar rëndësinë e leksikologjisë në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze, e shohim të udhës thellimin e njohurive tona në fushën e leksikologjisë dhe semantikës. Leksikologjia ka rëndësi në mësimin e gjuhës dhe përvetësimin e saj, duke qenë se ajo ka si objekt studimi, fjalën. Është me rëndësi që nxënësit dhe studentët të kenë njohuri rreth leksikologjisë së gjuhës, që ata studiojnë, pasi edhe komunikimi në atë gjuhë realizohet kryesisht përmes fjalëve. Çdo gjuhë ka veçoritë e saj leksikore. Studimet përqasëse dhe krahasuese ndërmjet gjuhëve paraqesin interes per ne. Gjuha angleze dhe ajo shqipe edhe pse i përkasin familjeve të ndryshme në pemën e gjuhëve indoevropiane, ngërthejnë elemente leksikore dhe semantike të përbashkëta a të ngjashme njëra me tjetrën. Pikërisht, këta dallime e të përbashkëta na shtyjnë drejt studimit të antonimisë në mbiemrat dhe foljet e gjuhës angleze dhe shqipe.

0.2 Objekti i punimit dhe hipotezat

Pse e studiojmë antoniminë? Përgjigjja më e thjeshtë do të ishte, se ajo ekzistonnë gjuhë. Sipas Cruse, "antonimia është një nga marrëdhëniet kuptimore më të perceptueshme".[1] Shumë shembuj antonimie rrënjosen thellësisht në mendjen tonë, që nga fëmijëria. Të kundërtat mësohen shpejt dhe harrohen rrallë.

[1] Alan Cruse (1986) Lexical Semantics.Cambridge:Cambridge University Press, f.197

Sikurse Cruse vë në dukje, "të kundërtat kanë një magjepsje të veçantë dhe kanë cilësi të cilat mund të duken paradoksale".[2] *Për shembull, po të konsiderojmë afërsinë dhe distancën nga njëra-tjetra të fjalëve të kundërta, vëmë re se kuptimet e fjalëve në një çift të kundërt ndihen në mënyrë intuitive se janë maksimalisht të ndara.*

Prandaj ka një ide të përgjithshme se fuqia e bashkimit të të kundërtave është një fuqi magjike, një tipar hyjnor apo një tipar i gjendjes mendore si rezultat i një meditimi të thellë…".[3]

Studimi i çështjes së antonimisë tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe atë shqipe ka ngjallur interesin tonë, pasi mendohet që ky problem është i rëndësishëm nga pikëpamja gjuhësore, leksikografike dhe leksiko-semantike. Po ashtu, propozimi i temës vjen si nevojë e studimeve më të thelluara në fushën e gjuhësisë. Gjatë këtij procesi, është konstatuar, se krahas çështjeve që lidhen me antoniminë në një aspekt të përgjithshëm, klasa e mbiemrave dhe e foljeve paraqesin interes të veçantë studimi në korpusin e antonimeve në gjuhën shqipe dhe angleze.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë antoniminë si dukuri leksiko-semantike dhe gramatikore në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe problemet që lidhen me afritë dhe dallimet e antonimeve në këto dy gjuhë.

***Kurpusi** me të cilin ne do të punojmë paraqitet si më poshtë:*

- *Fjalori "Shqip-Shqip" (2006)*
- *Fjlori "Anglisht- Anglisht" (Oxford English Dictionary)*
- *Fjalori "Anglisht-Shqip" (Ilo Stefanllari)*
- *Fjalori "Shqip – Anglisht" (Pavli Qesku)*

Hipotezat e këtij studimi:

- *A ekziston antonimia në të gjitha gjuhët natyrale?*
- *A është antonimia si lidhje ndërmjet fjalëve aq edhe lidhje ndërmjet koncepteve?*
- *A është antonimia njësi semantike aq sa edhe leksikore?*
- *A janë mohimi, papajtueshmëria dhe kunërvënia dukuri të ngjashme por të dallueshme në të dyja gjuhët?*
- *A mund të studiohet antonimia si lidhje sintagmatike, e jo vetëm paradigmatike?*
- *A është raporti i antonimisë me sinoniminë një tregues i lidhjes së të kundërtave dhe të ngjashmeve në gjuhë?*
- *A ekziston një lidhje midis antonimisë dhe polisemisë në gjuhë?*
- *A shërben antonimia si mjet i dobishëm në komunikim?*
- *A paraqet antonimia mbiemërore dhe foljore tipare të ngjashme si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze?*

[2] Alan Cruse (1986) Lexical Semantics.Cambridge:Cambridge University Press, f.197
[3] Alan Cruse (1986) Lexical Semantics.Cambridge:Cambridge University Press, f.197

- *A është parashtesimi forma më prodhimtare e formimit të antonimeve në të dyja gjuhët?*
- *A janë disa parashtesa më shumë prodhimtare sesa disa të tjera?*
- *A është raporti i parashtesave antonim-formuese në fjalor një dhe dygjuhësh i njëjtë apo i ndryshëm në gjuhën shqipe dhe angleze?*
- *Cilat janë strategjitë e përdorimit të antonimisë për përvetësimin e gjuhës angleze?*

0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit

Një gërshetim metodash të ndryshme siç janë ato përshkruese, përqasëse krahasuese, statistikore, etj., do të përdoren në këtë studim. Për të realizuar këtë punim do të përdoret metoda sasiore e kërkimit dhe e mbledhjes së informacionit, ndërsa vëzhgimi, interpretimi dhe krahasimi do të jenë baza e të dhënave. Punimi do të realizohet duke përdorur një literaturë të pasur të autorëve të huaj dhe shqiptarë, e cila përbën bazën teorike të tij. Shfrytëzimi i fjalorëve një dhe dygjuhësh, për sa u përket antonimeve të shprehura në klasën e mbiemrave dhe foljeve, analiza e shpeshtësisë së përdorimit të antonimeve në klasat mbiemërore dhe foljore, si dhe klasifikimi i tyre në qasje të ndryshme ndërgjuhësore.

Për sa i përket studimit praktik, u jemi referuar modeleve të studimeve amerikane përmes studimit të çifteve antonimike në përdorim, brenda një konteksti të caktuar. Kjo metodë e vëzhgimit të shpërndarjes dhe e përdorimit të antonimeve në gjuhë realizohet duke vjelur modelet më të shpeshta të bashkërenditjes së antonimeve dhe dallimit të funksionit që gjymtyrët, kanë në këto çifte të bashkërenditura. Rezultatet e mbledhura nga ky studim shërbejnë si të dhëna krahasuese për gjuhën angleze dhe atë shqipe.

Struktura e punimit

Struktura e këtij punimi do përbëhet nga pesë kapituj:

Kapitulli i parë: *do të shërbejë si hyrje për të paraqitur çështje teorike dhe shkencat gjuhësore themelore të studimit të antonimisë, siç janë leksikologjia, leksikografia dh sematika, etj. Do të përqendrohemi tek njohuritë e përgjithëshme për këto fusha studimi, si edhe në lidhjen e antonimisë me to. Fjala dhe nocioni zënë një vend të rëndësishëm në këtë kapitull. Për më shumë, do të ndalemi edhe në tipologjinë e kuptimeve në gjuhë, kuptimin e fjalës, duke u përqendruar tek kuptimi denotativ dhe konotativ, tipet e marrëdhënieve kuptimore, fushat leksikore dhe semantike, etj.*

Kapitulli i dytë: *do të përqendrohemi tek antonimet në gjuhën shqipe dhe angleze. Kështu, do të ndalemi tek historiku, terminologjia, përkufizimi, burimet, e antonimeve në të dyja gjuhët. Do të trajtojmë përkufizimin në mënyrë më të detajuar duke u përqendruar tek kriteret semantike, leksikore, të konfigurimit, etj. Më tej do të ndalemi tek antonimet dhe problematikat e tyre të cilat lidhen me natyrën e kundërvënies, papajtueshmërinë, mohimin, shkallëzimin, etj. Një vënd të rëndësishëm në këtë kapitull, zë edhe marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë dhe poliseminë.*

Kapitulli i tretë: *do të pareqesë tipologjinë e përgjithëshme të antonimeve në gjuhën shqipe dhe angleze. Kështu, do të trajtojmë antonimet tradicionale përballë kategorive të reja. Tipologjia do të shihet në dy këndvështrime, në atë strukturor dhe semantik. Klasifikimi*

gramatikor do të ceket gjithashtu si edhe kategoritë e tjera siç janë ato ndërkulturore, stilistike, kontekstuale, etj.

Kapitulli i katërt: *do të përqendrohet kryesisht në analizën e tipologjisë së antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe, vëzhguar e analizuar dhe analizuar semantikisht dhe strukturalisht. Ky kapitull do të karakterizohet nga këndvështrimi sematik dhe strukturor i antonimeve i shprehuar me mbiemër në gjuhën angleze. Në lidhje me mbiemrat do të ndalemi pak më shumë tek mbiemrat e shkallëzuar dhe ata plotësues, duke i parë në përqasje me njëra tjetrën. Çështjet problematike të kategorizimit të foljeve dhe natyra e shkallëzimit tek ato, do zënë një pjesë të rëndësishme të kapitullit.*

Kapitulli i pestë: *do të analizojë afritë dhe dallimet në gjuhën angleze dhe shqipe, përmes shfrytëzimit të fjalorëve një dhe dygjuhës, duke iu referuar studimit praktik të vjeljes së parashtesave nga fjalorë të ndryshëm. Fillimisht, do të shohim disa nga studimet me bazë korpusin më të njohur në fushën e antonimivenë gjuhën angleze dhe shqipe. Më pas, do të trajtojmë rezultatet e studimeve tona. I pari studim është pikërisht ai i lidhur me vjeljen e parashtesave në fjalorët shqip-shqip, shqip-anglisht, anglisht-anglisht, shqip-shqip. Krahasimi i rezultateve dhe të dhënat e mbledhura do të analizohen në mënyrë të detajuar. Në studimin e dytë, do të krahasojmë rezultatet e vjela nga pyetësorët drejtuar studentëve të masterit shkencor të gjuhës angleze.*

Përfundimet: *do të shërbejnë si përmbledhje e çështjeve të anatomisë së mbiemrave dhe foljeve ne gjuhën shqipe dhe angleze. Ky kapitull do të përqendrohet në risitë që sjell ky punim, dhe në rezultatet e analizës teorike dhe praktike duke e organizuar edhe një herë në mënyrë të përmbledhur informacionin e lartëpërmendur. Sugjerime dhe rekomandime do të jepen në përfundim të punimit.*

KREU I

1. ÇËSHTJE TEORIKE DHE SHKENCAT GJUHËSORE THEMELORE TË STUDIMIT TË ANTONIMISË

1.1 Leksikologjia

1.1.1 Njohuri të përgjithëshme mbi leksikologjinë

Termi leksikologji përbëhet nga dy morfema greke, kuptimi i të cilave është "leksis-" (fjalë) dhe "logos-" (njohuri). Ajo nuk është e vetmja shkencë që studion fjalën, pasi të gjitha fushat e gjuhësisë e studiojnë atë, në këndvështrime të ndryshme. Kështu, fonetika studion strukturën fonetike të fjalës, ndërkohë që gramatika, e cila është e lidhur ngushtë me leksikologjinë, studion strukturën, dukuritë gramatikore të fjalës. Leksikologjia është një degë e gjuhësisë, e cila studion leksikun e gjuhës. Fjala, kuptimi leksikor i saj dhe leksiku përbëjnë objektin kryesor të studimit të leksikologjisë. Studimi i fjalës dhe nocioni i saj përbëjnë thelbin e studimit të leksikologjisë. Të gjitha termat e përdorura "fjalor", "leksik" apo "leksikon" tregojnë se të tre këto terma mund të përdoren në mënyrë pak a shumë sinonimike[1], duke sqaruar se termi i parë është më shumë i zakonshëm, ndërsa të tjerët janë më teknikë. Dallim duhet bërë edhe midis këtyre termave dhe termit fjalor (*dictionary*). Duhet theksuar, se tre termat e parë i referohen grupit të tërë të fjalëve të një gjuhe, ndërkohë që fjalori është vetëm një përzgjedhje e këtij grupi fjalësh në një kohë të caktuar.

Leksiku i gjuhës përbën dhe objektin kryesor të studimit të leksikologjisë. Memushaj përcakton, se "*tërësia e fjalëve të një gjuhe përbën leksikun ... dhe fjala është njësia bazë e rrafshit leksikor…"*.[2] Brenda leksikut formohen nënsisteme, si p.sh, leksiku i gjuhës shqipe, leksiku i gurrës së huaj (i huazuar), leksiku i përgjithshëm, leksiku terminologjik, neologjizmat, arkaizmat, homonimet, antonimet, sinonimet, etj., të cilat së bashku përbëjnë sistemin leksikor.[3]

Leksikologjia si degë e gjuhësisë ka objektin e saj të studimit dhe metodat e saj të kërkimit shkencor. Leksikologjia merret, jo vetëm me fjalët e thjeshta në të gjitha aspektet e tyre, por edhe me te gjithë fjalët e përbëra dhe njësitë e kuptimshme të gjuhës.[4] Për shkak se këto njësi analizohen si nga forma dhe nga kuptimi, leksikologjia mbështetet në informacionin që merret nga morfologjia (studimi i formave të fjalëve dhe i përbërësve të tyre) dhe semantika (studimi i kuptimeve të tyre). Nuk mund të anashkalohet një fushë e tretë për studimet leksikologjike, siç është ajo e *etimologjisë* (studimi i origjinës së fjalëvë).[5]Nuk duhet ngatërruar termi leksikografi dhe leksikologji, ku i pari përbën thjesht një teknikë të veçantë të përpilimit të fjalorëve, dhe jo një fushë studimi.

Një nga detyrat kryesore të leksikologjisë është studimi dhe përshkrimi sistematik i leksikut të gjuhës, duke parë atë në origjinën, zhvillimin si edhe përdorimin aktual. Pra, leksikologjia përdor qasjen diakronike dhe atë sinkronike. Në qasjen sikronike, dallojmë

[1]H. Jackson , E. Zeamvela (2007) Words, Meaning And Vocabulary, An Introduction To Modern English Lexicology, Cromwell Press, f.18.
[2]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.129.
[3]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.129.
[4]H. Jackson , E. Zeamvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern English Lexicology, Cromwell Press, f.19.
[5]H. Jackson , E. Zeamvela (2007)Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern English Lexicology, Cromwell Press, f.20.

leksikologjinë specifike përshkruese, e cila ka të bëjë me një gjuhë në një kohë të caktuar, p.sh., të tashmen. Metoda diakronike studion zhvillimin e fjalorit në kohë dhe është pikërisht leksikologjia historike, e cila merret me origjinën e fjalorit, ndryshimet e tij, zhvillimin në kohë, faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, të cilët ndikojnë në strukturën e tij, si dhe kuptimin dhe përdorimin e fjalëve gjatë historisë së gjuhës.[6] Objekt i saj janë fjalët, togfjalëshat, njësitë frazeologjike, si edhe morfemat fjalëformuese. Sipas Memushajt, "*antonimia brenda sistemit gjuhësor është studiuar në rrafshin sinkronik, pra në gjendjen e tanishme të gjuhës dhe kuptimet e kundërta të së njëjtës fjalë, të cilat u takojnë periudhave të ndryshme të gjuhës, nuk përbëjnë antonimi* ".[7]

Nga ana etimologjike, leksiku i gjuhës angleze nuk është homogjen. Ai përbëhet nga dy shtresa kryesore: *leksiku vendas* dhe *leksiku i huaj*.[8] Në raporte numerike, sasia e fjalëve të huazuara në gjuhën angleze është më i madh se atyre vendase, në raportin 70% me 30 %.[9] Vetë përbërja e gurrës vendase e gjuhës angleze ka një karakter polisemik dhe prodhimtar në formimin e fjalëve apo shprehjeve të reja.

Për sa i përket zhvillimit të kohëve të sotme në leksikologji, mund të themi, se në fund të shekullit të 20-të, u vunë re ndryshime të dukshme në praktikën dhe teorinë e leksikologjisë si rezultat i teknologjisë së re për procesimin e të dhënave dhe kërkimeve shkencore të bazuara te teksti. Dy burimet kryesore ishin kompjuteri dhe korpusi.

1.1.2 Metodat në leksikologji

Ka dy metoda kryesore për përshkrimin e fjalëve: fjalori dhe enciklopedia (thesaurus). Dallimi midis një fjalori të thjeshtë dhe një enciklopedie është fakti se në të dytën fjalët që kanë kuptim të ngjashëm grupohen së bashku, p.sh. sipas modelit të gjithë fjalët që kanë lidhje me speciet e peshkut, fjalët që kanë lidhje me emocionet etj[10]. Nga ana tjetër, në një fjalor fjalët organizohen sipas një rendi alfabetik, dhe rendi ku fjalët ndodhen nuk ka të bëjë me kuptimin e vetë fjalës. Në fjalor, çdo fjalë qendron më vete si një njësi e pavarur. Një nga renditjet tipike të organizimit të fjalëve paraqitet si më poshtë:

Fjala kryesore, ose leksema që zakonisht është e theksuar me të zezë apo në fjalor të caktuar me shkronja të veçanta.[11]

1. *shqiptimi*
2. *pjesa e ligjëratës*
3. *etimologjia*
4. *përkufizimi*
5. *citime (shembuj të përdorimit)*

Sipas A.Kostallarit, [12] struktura e artikullit për çdo fjalë përbëhet nga këto elemente:

[6]A.C. Baygh , T.A. Camble (1978) The History of English Language , Londër, f.12.
[7] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.129
[8]A.C. Baygh , T.A. Camble (1978) The History of English Language, Londër, f.12.
[9]A.C. Baygh , T.A. Camble (1978) The History of English Language, Londër, f.13.
[10] A.C. Baygh , T.A. Camble (1978) The History of English Language, Londër, f.12.
[11]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f.202.
[12]A. Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike

a) fjala si njësi e mëvetësishme e fjalës
b) lidhjet e fjalëve (ku hyn fjala që analizohet)
c) informacioni i mundshëm etimologjik.

Ashtu siç thekson A.Kostallari[13], menjëherë pas fjalës në trajtën perfaqësuese jepen trajtat e saj gramatikore, duke shënuar pjesën e ndryshueshme të tyre në lidhje me pjesën e pandryshueshme.Pas karaktestikës gramatikore jepet karakteristika stilistikore, kur fjala nuk është stilistikisht neutrale, si dhe karakteristika të tjera, (sfera e përdorimit etj.) si në shembujt: mjek.-mjekësi, kim.-kimi, drejt.-drejtësi. Pas shënimeve gramatikore e stilistikore, jepet shpjegimi i kuptimit a i kuptimeve të fjalës. Përngjitjet dhe njësitë frazeologjike, të cilat në shqipen e sotme nuk kanë më një lidhje të qartë me njërin nga kuptimet e fjalës , renditen pas shenjës konvencionale, në pjesën e dytë të artikullit për çdo fjalë, d.m.th vendosen gjithnjë pas shpjegimit e ilustrimit të kuptimit ose të kuptimeve të fjalës. Në fund të artikullit, duke filluar në krye të rreshtit, do jepet informacioni etimologjik i mundshëm për fjalët me prejardhje të huaj. Ky është një rend tipik në shumicëne fjalorëve, por mund të ketë raste, kur informacioni etimologjik vendoset në fund të fjalës.

1.1.3 Leksikografia dhe roli i antonimeve në fjalor

Zhvillimi i fjalorëve në Europën moderne lidhet me përhapjen e arsimit. Që nga 1450-ta e në vazhdim, fjalorët dygjuhësh u prodhuan për përdorim shkollor, fillimisht për mësimin e latinishtes, e më pas edhe për atë të gjuhëve të tjera europiane.[14] Për sa i përket zhvillimit të fjalorëve të gjuhës angleze, duhet të përmendim faktin se termi "fjalor" u përdor në shekullin e 13-të, kur dhe përmbledhja e fjalëve po bëhej gjithmonë e më e madhe, e kur filluan të hartoheshin përmbledhje të fjalëve anglisht–latinisht.[15] Në vitin 1450, Geoffrey nga Norfolk hartoi "The Promptorium Parvulorum" si dhe "Clericorum" (*Repository for children and Clerics*). Më 1538, Sir Thomas Elyot hartoi "Latin English-Dictionary", më pas në 1552, R. Howlet hartoi Abecedarium Anglico-Latinium. Fjalorët dygjuhësh të gjuhëve moderne filluan me fjalorin anglisht-frëngjisht (*1530*) dhe më tej pasuan ato anglisht-italisht dhe anglisht-spanjisht.

Fjalori i parë njëgjuhësh i gjuhës angleze u publikua nga Robert Cawdrey, më 1604, me 2500 terma. Më pas, pasuan ato të 1616 (John Bullokar), 1623 (Henry Cockream), 1720 (Nathan Bailey), 1755 (Samuel Joneson).[16]

Në leksikologjinë e shekullit e 13-të, në Angli pati katër arritje kryesore:

1. *Fjalori i Piter Mark Roget (Thesaurus)*
2. *Fjalori i ri i gjuhës angleze mbi parimet historike, James Murray në 12 volume*
3. *Fjalori i dialektit të gjuhës angleze nga Joseph Wright në 6 volume 1898 - 1905*
4. *Fjalori i shekullit të 19-të i gjuhëve klasike nga Lewis dhe Short "Fjalori Latinisht-Anglisht" dhe Liddell dhe Scott " Fjalori Anglisht-Greqisht"*[17]

[13]A.Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike

[14] M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction , University of Oslo, Norway, f.202.

[15]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction, University of Oslo, Norway, f.202.

[16]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f.204.

Për sa u përket fillimeve të leksikografisë së *gjuhës shqipe,* ato datojnë që në vitin 1695 me F. Bardhin, fjalori "Latinisht-Shqip". Në vitin 1904, u botua fjalori i Kristoforidhit, fjalori dygjuhësh "Greqisht-Shqip". Më pas doli fjalori i Bashkimit, 1908, fjalori i gjuhës shqipe, 1954, i cili ishte edhe fjalori i parë shpjegues. Antonimet datojnë që prej fjalorit të Kristoforidhit. Aty gjenden gjithsej 351 çifte antonimesh, dyfish më shumë se në fjalorin e gjuhës shqipe me 146 çifte[18]. Antonimet shënohen shkurtimisht *ant*. në fjalorin e Kristoforidhit, ku gjenden 82 emërore dhe 147 foljore. Fjalori 1954, ka rreth 28 çifte foljore dhe 40 mbiemërore.[19] Vlen për t'u theksur fakti, se deri përpara Rilindjes Kombëtare, në fjalor gjendeshin vetëm antonime të rrënjëve të ndryshme.[20] Në fjalorin e Kristoforidhit ka vetëm 54 çifte antonimesh parashtesore dhe 297 çifte të tjera, pra, ndajshtesimi ka luajtur rol në pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe në një periudhë më të vonshme. Gjithashtu, duket se raporti midis foljeve dhe mbiemrave është i ndryshëm, por ky raport nuk është aq domethënës për vendin që zënë në gjuhën shqipe antonimet foljore dhe mbiemërore, pasi për shkak të studimeve jo me baza të shëndosha shkencore të asaj kohe, nuk janë përfshirë në grupin e antonimeve shumë fjalë, kryesisht ato me formim prej rrënjësh të njëjta përmes fjalëformimit. Si përmirësim në këtë drejtim vjen paraqitja e mëvonshme në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, të vitit 1954. Në një periudhë të mëtejshme u bë pasqyrimi i tipareve, analizave studimore, tipologjisë, shkallëzimi, si dhe karakteristika të tjera të antonimeve në gjuhën shqipe.

Nga studimet e kryera nga Paradis dhe Willners[21] rezulton, se fjalorët në përgjithësi, si edhe fjalorët e nxënësve në mënyrë të veçantë, përbëjnë një mjet të rëndësishëm në procesin e përvetësimit të gjuhës së huaj. Qëllimi kryesor i një fjalori për nxënësit e gjuhës me një korpus të gjerë, siç është ai i Collins[22], është t'u paraqesë nxënësve informacion të dobishëm, i cili do t'i ndihmojë ata të ndërtojnë lidhjet midis fjalëve dhe kuptimeve në mënyrë të ngjashme me folësit vendas. Në studim u vu re, se jo të gjitha fjalët kyçe kanë një antonim dhe raporti në pjesët e ligjeratës ishte: mbiemra 59 % të ndjekur nga emrat me 19%, më pas foljet me 13% dhe së fundmi ndajfoljet me parafjalët 9% .

D. Hoxhaj thekson rëndësinë e rigrupimit të fjalëve në fjalor mbi bazën e antonimisë dhe sinonimisë. Makrostrukturë quhet "*tërësia e njësive leksikografike të renditura, që i nënshtrohen gjithmonë një leximi vertikal të pjesshëm për gjetjen e objektit të mesazhit*"[23]. Ndërkohë, mikrostrukturë quhet "*tërësia e informacioneve të renditur të çdo artikulli, që zbatojnë një program informacioni të qendrueshëm për të gjithë artikujt dhe që lexohen horizontalisht pas njësisë leksikografike*". [24] Brenda mikrostrukturës gjendet informacion në lidhje me kategorinë gramatikore, përkufizimin, shembujt, njësinë leksikografike, shqiptimin, theksin, sinoniminë, antoniminë.

---

[17]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f.204.

[18]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanogjik i Prishtinës, f.106.

[19]Shënim: të dhënat shifrore të mbledhura nga I.Goçi (1985) Antonimet e gjuhës së sotme shqipe , Instituti Albanogjik i Prishtinës f.106.

[20]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway f.205.

[21] C. Paradis, C.Willners (2007) Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects.Studia Linguistica, f.261–277.

[22] Collins English Dictionary (2004)

[23]D. Hoxhaj (1994) Makrostruktura dhe Mikrostruktura e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, f.49.

[24]D. Hoxhaj (1994) Makrostruktura dhe Mikrostruktura e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, f.49.

Androkli Kostallari, gjithashtu, thekson rëndësinë e antonimeve si mjet plotësues në përkufizimin e fjalëve, por, siç thekson ai "antonimet nuk mund të përdoren asnjëherë si mjet kryesor, siç mund të ndodhë me sinonimet"[25] (pra nuk lejohet që "*i hidhur"* të shpjegohet vetëm me "jo i ëmbël", *i shkurtër* me "jo i gjatë", etj.). Antonimet do të përdoren vetëm në raste kur janë fjalë të leksikut të përgjithshëm, të njohura gjerësisht dhe kur ato me të vertetë lehtësojnë kuptimin më të mirë të shpjegimit[26]. Antonime të reja të formuara me parashtesa (bëj/çbëj, mësohem/çmësohem, i përshtatshëm/i papërshtatshëm, i arsyeshëm/i paarsyeshëm, mirënjohës/mosmirënjohës, dije/padije, etj.) zakonisht nuk do të përdoren në përkufizimin e fjalëve[27]. Kështu, p.sh., "*i ëmbël"* mb. që ka shije të këndshme, të tillë siç e ka sheqeri ose mjalti, e kundërta: *i hidhur* etj.

Antonimet e mirëfillta përdoren si mjete plotësuese të shpjegimit dhe vendosen në fund të shpjegimeve me shënimin "*kund*.". D. Hoxhaj thekson, se "në përberje të mikrostrukturës është e udhës të përfshihen edhe antonimet situative, që varen nga rrethanat jashtëgjuhësore, siç janë ato midis ngjyrave të semaforit, p.sh ngjyra e kuqe në kundërvënie me ngjyrën jeshile". [28]

1.1.4 Fjala dhe nocioni

1.1.4.1 Çfarë kuptojmë me termin *"fjalë"* në leksikologji?

Një nga karakteristikat themelore të gjuhës është fakti se ajo përbëhet nga fjalët. Në procesin e përvetësimit të gjuhës, kur e vendosim atë në formë të shkruar, i dallojmë fjalët duke i ndarë në hapësira nga të dyja anët, mësojmë se si t'i gërmëzojmë ato, përdorim fjalorin për t'i përkufizuar, organizojmë lojëra dhe ushtrime për të përvetësuar gjuhën, por ky është vetëm një këndvështrim i thjeshtë në lidhje me atë çka fjala është.

Për sa i përket përbërjes së fjalës, vërejmë se analiza e përbërësve të saj merr nuanca të ndryshme në studime të gjuhëve të ndryshme. p.sh., gjuha kineze përdor morfemat si njësi më të vogla leksikore, pra mund të themi se "shkronjat" në gjuhën kineze përfaqësojnë morfemën; psh., nëse fjala "*freedom*" do të shkruhej në gjuhën kineze, do të përbëhej nga dy "shkronja" (morfema) respektivisht "*free*" dhe "*dom*". Çdo morfemë në gjuhën kineze shqiptohet si një rrokje e vetme. Pra, në procesin e përvetësimit të gjuhës kineze, intuita e nxënësit përqendrohet te morfema, ndërsa në përvetësimin e gjuhës angleze nxënësi ndalet te fjala. Për më shumë, nëse do të shikojmë greqishten e lashtë, studimet dëshmojnë, se fjalët ishin të bashkuara pa ndonjë hapësirë, dhe jo shumë shekuj më parë vërejmë, se fjala u shfaq si një njësi e mëvetësishme[29]. Pra, sistemi shkrimor jo gjithmonë na ndihmon të dallojmë fjalët për shkak të llojeve të ndryshme të sistemeve shkrimore (japonez, tajlandez, hindu, kinez, arab etj.). Vetë shumëllojshmëria gjuhësore e bën të vështirë dallimin e fjalës përmes sistemit shkrimor[30].

---

[25]A. Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike

[26]A.Kostallari, Parimet Themelore për Hartimine "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike

[27] A. Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike

[28] D. Hoxhaj (1994) Makrostruktura dhe Mikrostruktura e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, f.49.

[29] M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f. 205.

[30]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f. 206.

Njësitë themelore të gjuhës janë fonema, morfema, fjala, togfjalëshi dhe fjalia. Siç shihet, *në këtë varg, që shkon nga njësia më e ulët te më e lartë, nga më e thjeshta temë e ndërlikuara, fjala gjendet midis morfemës dhe togfjalëshit*[31]. Termi "fjalë" përdoret për të emërtuar një strukturë të ndërmjetme më të vogël se një frazë, por më të madhe se një segment tingujsh[32]. Përkufizimi i fjalës mund të ndryshojë sipas synimit të studimit: duke iu referuar paraqitjes apo formës së saj, mendimit që ajo shpreh, apo kriterit formal. Përkufizimi i dytë, ka të bëjë me njësinë e pandashme të mendimit, si kriterin më të rëndësishëm. Fjala, siç paraqitet në formë të shkruar, paraqet një njësi mendimi apo një njësi psikologjike. Këndvështrimi i tretë, bazohet te kriteri i pastër formal, ku Bloomfieldi[33], si hulumtuesi kryesor i kësaj teorie, sugjeron një përkufizim të termit "fjalë" bazuar te kriteri formal. Ai e dallon fjalën nga njësitë e tjera të kuptimshme, siç janë: morfema, njësia minimale e kuptimshme, sintagma, apo struktura të cilat përbëhen nga më shumë se një fjalë. Në këtë mënyrë, Bloomfield e përkufizon fjalën si "formë e lirë minimale".[34]

Edhe I. Goçi, i njeh fjalës tiparin e një njësie minimale në gjuhë, duke theksuar, se "*Raporti i vendosur midis realitetit objektiv dhe subjektiv, i kundruar nga qasjet logjike, psikolinguistike, në kontekste gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, na jep një pasqyrë të qartë të dinamikës së fjalës si njësi gjuhësore minimale në komunikim*" [35]. Lidhur me përkufizimet me karakter logjik, ontologjik, I. Goçi thekson, se*: "fjalët janë thjesht shprehje e realitetit objektiv në bazë të nocioneve të sendeve dhe të fenomeneve që kushtëzohen nga ndërhyrja gramatikisht".*[36]Nga ana fonetike "*fjala është një kompleks tingullor*", nga ana semantike "*ajo është një njësi emërtuese"* dhe nga ana gramatikore "*kryen një funksion të caktuar në fjali*".[37] F.Agalliu e ka përkufizuar fjalën si "*një njësi me kuptim të gjuhës, që ka një trajtë të përhershme, fonetike e gramatikore dhe riprodhohet në të folur si strukturë e gatshme*".[38]

J. Thomai [39] përcakton njësitë themelore të gjuhës: *fonema, morfema, fjala, togëfjalëshi dhe fjalia*. Fjalën ai e sheh si njësi leksikore, e cila gjendet midis morfemës dhe togfjalëshit. Si tiparin themelor të fjalës, ai dallon kuptimin leksikor tërësor dhe të mëvetësishëm. Fjala shihet, si një strukturë në gjuhën shqipe, e cila përbëhet nga përmbajtja dhe forma. Përmbajtja e saj është leksiko-gramatikore (përbëhet nga kuptimet leksikore dhe kuptimi gramatikor).

R. Memushaj gjithashtu shton, se "*fjala është element përbërës i një sistemi, si nga ana formale dhe nga ana kuptimore*".[40] Fjala shihet jo vetem si njësia bazë e leksikut, por edhe si njësia themelore e gjuhës. Përkufizimi i fjalës dhe përcaktimi i kufijve nga njësitë e tjera gjuhësore paraqet një objekt debati gjuhësor, pasi nuk është e lehtë të japësh një përkufizim të saktë. Fjalët ndahen në[41]:

---

[31] J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.27.
[32]H. Jackson, E. Zeamvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern English Lexicology, Cromwell Press, f.57.
[33]L. Bloomfield (1936) Language or Ideas? Language, f.89-95.
[34]L. Bloomfield (1936) Language or Ideas? Language, f.89-95.
[35]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.31.
[36]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.31.
[37]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.31.
[38] F. Agalliu, R. Memushaj, M. Reso (1986) Hyrje në Gjuhësi, Tiranë. f. 46
[39]J. Thomai (1974), Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.86.
[40]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.132.
[41]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.132.

1. të *mëvetësishm*e ose *leksikore*, siç janë *emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet* (*fjalë emërtuese*).

2. të *pamëvetësishme ose shërbyese,* siç janë *lidhëzat, nyjet, parafjalët, foljet ndihmëse* dhe *pjesëzat*.

Objekti i studimit tonë do të jenë pikërisht mbiemrat dhe foljet antonime në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Leksema do të jetë në qendër të studimit tonë, pasi ajo përben një emërues të përbashkët në inventarin e formave të paradigmës, e cila e dallon fjalën nga sintagma dhe fjalia.

Ne do ta konsiderojmë fjalën si një njësi strukturore të pandërprerë, e cila përbëhet nga një ose më shumë morfema dhe që zakonisht gjendet në strukturën e frazës. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis "*fjalës leksikore*" dhe "*fjalës gramatikore*". Fjalët leksikore janë emrat, foljet, mbiemrat dhe ndajfoljet, të cilat kanë një kuptim të pavarur dhe mbeten të kuptimshme edhe nëse janë të izoluara apo në një varg fjalësh[42]. Nga ana tjetër, *fjalët gramatikore* janë elemente të tilla si, parafjalët, nyjet, lidhëzat, format e numrit shumës, të kohës, etj[43]. Këto përbëjnë një klasë të mbyllur fjalësh. Edhe pse nuk ka një ndarje të mprehtë midis këtyre dy lloje fjalësh, ne mund të flasim për fjalë me përmbajtje semantike, si p.sh. fjala "*student*", dhe fjalë pa përmbajtje semantike, si: fjala "it", "that"(*se*) në kontekstin si në shembullin më poshtë[44]:

"***It** is obvious **that** some **students** will pass this exam*".

(*Është e qartë **se** disa **studentë** do ta kalojnë këtë provim*)

Në këtë këndvështrim, M. A. K. Halliday, Teubert, Yallop, Cermakova theksojnë, se "ka rëndësi të dallojmë një njësi sintaksore, siç është fjalia, fjalët me përmbajtje dhe fjalët funksionale".[45] Për shembull, në fjalinë " *It always snows on the top of the mountain.*" fjalët përmbajtësore janë "*snow*" dhe "*mountain*", ndërkohë që fjalët funksionale janë fjalët të tipit "*it*", "*on*", "*the*". Për sa më sipër, vija ndarëse midis fjalëve me përmbajtje dhe fjalëve funksionale nuk është shumë e dallueshme dhe mund të themi se të dyja përbëjnë një "*continuum*" (madhësi të vazhduar).[46]

Kështu, mund të themi se nuk ka një pikë fikse, ku leksikologu dhe gramatikani ndajnë detyrat e tyre në analizën e fjalës, pasi secili prej tyre mund të hyjë në territorin e tjetrit. Kjo dëshmohet nga vëzhgimi i përmbajtes së fjalorëve, ku fjalë të tipit "the" dhe "end" përfshihen në fjalor, paçka se nuk ka shumë për të thënë nga ana leksikologjike. Nga ana tjetër, gramatikat klasifikojnë fjalët në klasa gjithmonë dhe më të vogla. Këtu ndeshemi me një kuptim tjetër të termit "fjalë", pikërisht atë që njihet si klasë fjalësh (pjesë e ligjëratës nga pikëpamja gramatikore).

[42]H. Jackson (1988) Words and their Meaning, What is a word?, Pearson Education , f.1-18.
[43]H. Jackson (1988) Words and their Meaning, What is a word?, Pearson Education , f.1-18.
[44] Shembuj të shkëputur nga M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f.207.
[45]M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f.207.
[46]Shënim: M. A. K. Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) e quajnë *continuum*

Për sa i përket dykuptimsisë së fjalës, vërejmë, se nuk ka kufij të prerë në botën jogjuhësore, dhe mungesa e familjarizimit me referentin e fjalëve bashkë me karakterin e përgjithshëm të vetë fjalës përmbajnë burimin kryesor të kësaj dykuptimësie.[47]

Russell propozon dallimin midis *fjalës objektive* dhe *fjalës në fjalor* në mënyrë të tillë që "*të dallohen ato fjalë të cilat shënojnë objekte që fëmija i mëson përmes emërtimit, dhe fjalëve të cilat përdoren në mënyrë të prejardhur nga përdorimi i tyre bazë*".[48]

Siç u theksua më lart, Bloomfield[49] e përkufizon fjalën si "*forma minimale e lirë*", pra, forma më e vogël, e cila mund të qendrojë më vete. Ai, gjithashtu, dalloi dhe një njësi më të vogël se fjala, pikërisht *morfemën*. Për shkak të paqartësisë që kjo ndarje krijon në raste të tilla, ku është e vështirë të dallohen morfemat brenda fjalës, si në shembullin "*took"* si e përbërë nga folja "*take"*dhe koha e saj e shkuar "*past simple"*. Palmer[50] sugjeron, që të mos përqendrohemi tek morfema në studimin semantik, por tek njësitë kuptimore përbërëse të fjalës*"took"*. Pra, dallojmë forma të ndryshme të së njëjtës fjalë. Kështu, "*took"* është një formë e foljes "*take"* dhe kjo e fundit njihet si forma përfaqësuese në fjalor, apo *leksemë*. Kështu dallohen *treguesit gramatikorë* (numri shumës, veta e tretë, etj) nga leksema.

Një tjetër problem, lidhet me ato që Ullman[51] i quan fjalë *transparente* dhe fjalë *opake*. *Fjalët transparente* janë ato fjalë, kuptimi i të cilave mund të përcaktohet nga kuptimi i pjesëve përbërëse të tyre, ndërsa *fjalët opake* janë ato fjalë, kuptimi i të cilave nuk mund të përcaktohet nga pjesët përbërëse të tyre. Disa fjalë mund të dalin si transparente në një gjuhë të caktuar, por si opake në një tjetër gjuhë. Kështu, për shembull, në gjuhën shqipe fjala "*mendjelehtë"*është transparente, ndërsa në gjuhën angleze ajo del si opake,"*frivolous"*. Kjo dëshmon se fjala mund të përbëhet nga disa pjesë të kuptimit dhe se këto ndarje në "copëza kuptimore" kanë natyrë arbitrare. Gjithsesi, nuk është e lehtë të përcaktohen këto elemente semantike brenda fjalës.

Në vazhdim të problematikave të përcaktimit të elementeve semantike brenda fjalës, do të theksojmë edhe karakteristikat e fjalëve, që në gjuhën angleze njihen si fjalë *fonaestetike, karakteristikat fonologjike të të cilave paraqesin kuptime të caktuara*[52], si për shembull fjalët që në gjuhën angleze fillojnë me "*sl-*" përdoren me kuptim *rrëshqitës* në një mënyrë të caktuar. Të tilla fjalë janë *slide (rrëshqas), slip (rrëshqas, shkas), slither (rrëshqas, shkas)*, etj. Nga ana tjetër, fjalë të cilat fillojnë me "*sl-"* mund të përdoren për kuptime *keqësuese*, si në shembujt:"*slattern" (femër pisanjose), "slut" (zuskë), "slang" (zhargon, sleng), "sly" (tinëzar)*, etj. Gjithsesi, *këto karakteristika fonologjike nuk mund të jenë gjithëpërfshirëse, pra ka edhe përjashtime që tregojnë se sl- para një fjalë nuk ka asnjë nga kuptimet e mësipërme*[53].

Më tej, qendron edhe problematika e përcaktimit gjinor brenda së njëjtës njësi leksikore. Pra, ka disa fjalë të cilat mbartin në semantikën e tyre edhe dallimin gjinor, si p.sh. emrat "*stallion/mare" (hamshor/pelë)* tregojnë dy gjini të ndryshme të së njëjtës kafshë (*kalit)*. Ndërkohë që jo gjithmonë një emër i cili emërton një kafshë mund ta

[47]S. Ullman (1962) Semantics: An Introduction to the Science of Meaning, f.118.
[48]B. Russell (2007) Inquiry into Meaning and TR., Routlege, f.11.
[49]L. Bloomfield (1914) Introduction to the Study of Laguage: The Sentence and the Word, f.69.
[50] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.27.
[51]S. Ullman (1962) Semantics: An Introduction to the Science of Meaning, f.119.
[52] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.27.
[53] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 27.

paraqesë këtë dallim gjinor si në shembulin "*elephant" (elefanti)* ku nuk mund të gjejmë ndonjë emër për elefantin femër dhe mashkull. Si rezultat, Palmer ndan mendimin, se "*disa fjalë arrijnë të mbërthejnë brenda tyre më shumë elemente kuptimore, sesa disa fjalë të tjera".*[54]

Palmer shton, se interes dhe problematikë njëkohësisht paraqet edhe "*përcaktimi i idiomave apo frazeologjizmave*" (*kick the bucket*, në kuptimin *vdes, ndërroj jetë*). Sematikisht ato përcaktohen si njësi të mëvetësishme, por gramatikisht ato nuk janë të tilla, pasi nuk pësojnë ndryshime gramatikore. Pra, idiomat përbëhen nga disa fjalë, por funksionojnë si një e vetme semantikisht.[55]

Nga sa më sipër, nocioni i termit "fjalë" përbën një çështje komplekse në studimin e gjuhës në rrafshin semantik, një studim i cili kërkon të njihen parimet e mësipërme për të dalluar tiparet e veçanta të termit "*fjalë"*. Pra, fjala nuk është thjesht një njësi semantike natyrale (si njësi e izoluar brenda hapësirave veçuese nga fjalët e tjera) pasi do të ishte shumë e thjeshtë ta ngushtojmë nocionin *fjalë* deri në këto kufizime. Palmer thekson, se "*në semantikë nuk duhet të anashkalohet përcaktimi i fjalës si njësi më vete dhe të kërkohet të studiohen vetëm kuptimet individuale brenda saj, pasi diçka e tillë do të jetë e nevojshme vetëm në analizat semantike*"[56]. Gjithashtu, "*përcaktimi i kuptimit përmes krahasimit të formave gjuhësore, fjalëve dhe mbi të gjitha përmes kundërvënies", thekson ai, "është edhe më e lehtë të dalin tiparet semantike të një fjale*".[57]

Si përfundim, mund të përmbledhim karakteristikat e fjalëve. Nga shqyrtimi i literaturës përmblidhen katër karakteristika të rëndësishme në përkufizimin e termit "*fjalë*":

1. *Fjala është një njësi e pandashme.*

2. Fjala mund të përbëhet nga një ose më shumë morfema (kur përbëhën nga një ose më shumë morfema quhen fjalë të thjeshta). Ndërsa kur fjalët përbëhen nga më shumë se një morfemë ato mund të jenë të përbëra dhe komplekse.

3. Fjala gjendet në strukturën e frazës, dhe nëse do t'i qasemi hierarkisë strukturore, do të thoshim se morfemat përdoren për të ndërtuar fjalë, fjalët për të ndërtuar fraza, frazat për të ndërtuar "sifjali"[58] *(clauses) dhe sifjalitë për të ndërtuar periudhë.*

4. Fjala i përket një klase të caktuar apo një pjese të ligjëratës.

1.2 Semantika

Duke qenë se në qendër të studimit tonë qendron antonimia si dukuri leksiko-semantike, ne do të përqendrohemi shkurtimisht tek disa njohuri dhe përkufizime bazë të semantikës.

1.2.1 Historiku dhe terminologjia e semantikës

[54] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.27.
[55] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.27.
[56] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.75.
[57] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.76.
[58]Shënim: terminologji e re e përdorur nga M. Çeliku (2012) Sintaksë e Gjuhës Shqipe, Tiranë

Semantika ose *semasiologjia* kanë lindur të fundit si shkencë e gjuhësisë (fundi i shekullit të XIX). Semantika u përdor për herë të parë si term në vitin 1948 nga Read[59] në fjalorin e gjuhës angleze dhe ka prejardhje nga greqishtja e lashtë. Ajo përkufizohet si studimi i kuptimit, pasi edhe qëllimi i saj është që të shpjegojë dhe të përshkruajë kuptimin në gjuhë të ndryshme. Semantika nuk lidhet vetëm me kuptimin, por edhe me zhvillimin e tij, i cili studiohet nga *semantika historike*. Punimi parashkencor i mirëfilltë në këtë fushë është pikërisht ai i vitit 1900, "Semantika: Studime mbi shkencën e kuptimit", nga francezi Breal[60]. Në gjuhën angleze, një nga punimet e para në semantikë, që përbën dhe bazën e studimeve të mëtejshme, është: "The meaning of meaning"[61] nga Ogden dhe Richards, në vitin 1923.

Të tjera terma që janë përdorur përveç termit *semantikë* janë edhe termat "*significs*" i përdorur nga Wells[62], s*emasiologji, semologji,semiotikë, semikë*, etj ., të cilat janë përdorur herë në kuptim më të zgjeruar e herë më të ngushtuar se termi *semantikë*. Për më shumë, njësitë e saj themelore janë akoma të papërcaktuara qartë, prandaj ato dalin në forma të ndryshme, si: sema, semema, semiema, noema, semantema, tipari semantik, përbërësi kuptimor, etj.[63]

1.2.2 Përkufizimi i semantikës

Semantika përkufizohet si "*studimi i kuptimit, pasi edhe qëllimi i saj është që të shpjegojë dhe të përshkruajë kuptimin në gjuhë të ndryshme*".[64] Ne do t'i referohemi termit "kuptim", duke u bazuar në terminologjinë e Jackson.[65] Sipas tij, duhet të identifikohen llojet e ndryshme të semantikës:

- *semantika pragmatike (studion kuptimin e shprehjeve në kontekst)*
- *semantika e fjalisë (merret me kuptimin e fjalive, ashtu sikurse edhe me kuptimin e marrëdhënieve midis fjalive)*
- *semantika leksikore (merret me kuptimin e fjalëve dhe me marrëdhëniet kuptimore të fjalorit të një gjuhe).*

Sipas R. Memushajt, "*semantika është ajo shkencë gjuhësore që merret me studimin e planit të përmbajtjes së gjuhës, përbëhet nga disa degë siç janë semantika leksikore, morfologjike apo sintaksore"*.[66] Semantika leksikore është indentifikuar si *semasiologji (*nga greqishtja e vjetër - kuptimi i fjalës). Leksikologjia studion çështje të leksikut, që lidhen me shënuesin e fjalës, ndërsa semantika leksikore studion kuptimin e fjalës. Lind pyetja: *ç'është kuptimi i fjalës?* Këtë pyetje dhe përgjigjen e saj do ta trajtojmë pak më poshtë, në një nënçështje të mëvetësishme. J. Thomai e përkufizon semasiologjinë si **"***një degë e leksikologjisë, e cila merret me studimin e kuptimeve*

[59]A. W.Read (1948) An Account of the Word Semantics: World Volume 4, f.78.
[60] M. Breal (1900) Semantics, Studies on the Science of Meaning, f.63.
[61] C. K. Ogden, I. A. Richards (1923) The Meaning of Meaning University of Cambridge, f.147.
[62]H. G.Wells (1975) Early Writings in Science and Fiction University: California Press, f.69.
[63]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, f. 16.
[64] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 27.
[65]H. Jackson (1988) Words and their Meaning, Routlege, f. 244.
[66]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi , Botimet Toena, f.129.

leksikore të fjalëve dhe përmbajtjen leksikore të tyre".[67] Fillimet e saj në gjuhën shqipe identifikohen me emrin e profesor E. Çabejt.

Palmer thekson, se*"semantika ka të bëjë me mënyrën se si e lidhim gjuhën me eksperiencën tonë dhe si e tillë referenca është një aspekt i rëndësishëm i semantikës. Nga ana tjetër, edhe marrëdhëniet e nuancave kuptimore kanë një rol të rëndësishëm në studimin e gjuhës".*[68] Fjalët në një gjuhë të caktuar lidhen në mënyra të ndryshme, të cilat kanë natyrë jo vetëm gramatikore, por kryesisht natyrë semantike, siç janë edhe sinonimet, antonimet, etj. Edhe fjalorët i trajtojnë këto marrëdhënie mes fjalësh, pasi qëllimi kryesor i një fjalori është që t'i mundësojë përdoruesit kuptimin referencial, dhe e realizon këtë duke e lidhur një fjalë me kuptim të panjohur me një fjalë tjetër, referenca e të cilit është e njohur. Si rezultat kemi dy lloje semantikash:[69]

1. semantika strukturore e cila merret me strukturën semantike (sematika)

2. semantika e cila merret me kuptimin e lidhur me përvojën tonë me botën e jashtme (semiologjia)*[70]*

Pra, njëra anë e semantikës lidhet me njësitë jogjuhësore, dhe tjetra me ato brendagjuhësore. Ka përpjekje për ta kufizuar atë vetëm në këndvështrimin e marrëdhënieve kuptimore/nuancave kuptimore, siç bëjnë gjuhëtarë të tillë, si Katz dhe Fodor.[71] Gjithsesi, ne nuk do të ndalemi gjatë në këtë drejtim pasi semantika këtu trajtohet në aspektin e përgjithshëm teorik në funksion të qartësimit të koncepteve bazë për të na ndihmuar të kuptojmë lidhjet semantike siç është edhe antonimia.

1.2.3 Qasjet e ndryshme ndaj semantikës

Vërejmë se semantika zakonisht ka dy qasje të ndryshme, ku dallojmë kryesisht atë filozofike dhe atë gjuhësore. Ajo filozofike merret me "*tiparet logjike të gjuhës, natyrën e teorive formale dhe gjuhën e logjikës"*.[72] Ndërkohë, semantika gjuhësore "*përfshin të gjitha aspektet e kuptimit në gjuhë të ndryshme, që nga kuptimi i shprehjeve komplekse apo të ndërlikuara në kontekste të caktuara deri te kuptimi i tingujve të mëvetësishëm te rrokjet*".[73]Semantika lidhet ngushtë edhe me fusha të tjera studimore, si fonologjia, sintaksa, gjuhësia e tekstit, pragmatika, etj. Por, ne do t'i përmbahemi lidhjes së saj me leksikologjinë për arsye të studimit në fjalë.

1.2.4 Përcaktimi i njësisë themelore të semantikës

Për sa i përket përcaktimit të *njësisë themelore* të semantikës diskutimet janë midis fjalës dhe fjalisë. Kratz dhe Fodor shprehen, se: "*një teori semantike përshkruan dhe vë në dukje aftësinë interpretuese të folësve, duke marrë parasysh performancën e tyre në përcaktimin e numrit të leximeve të një fjalie, duke evidentuar anomalitë*

[67]J. Thomai, (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.36.
[68] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 27.
[69] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 28.
[70] Shënim: Kjo ndarje është e ngjashme me dallimin midis fonetikës (merret me tingujt e gjuhës, duke i përshkruar në lidhje me karakteristikat e tyre akustike si edhe me organet e të folurit dhe artikulimin e tingujve) dhe fonologjisë (marrëdhëniet e brendshme të tingujve)
[71] J. Katz, Jerry A. Fodor (1964) The Structure of Semantic Theory, North Holland Publishing Co. Smith, MD, f.479.
[72]H. Jackson (1988) Words and their Meaning, What is a word?, Pearson Education, f.1-18.
[73]H. Jackson (1988) Words and their Meaning, What is a word?, Pearson Education, f.1-18.

semantike, duke vendosur për marrëdhëniet e perifrazimit mes *fjalive dhe duke evidentuar çdo tipar apo marrëdhënie tjetër semantike, e cila luan një rol në këtë aftësi*".[74] Pra, ata theksojnë se teoria semantike duhet të merret me *dykuptimsinë, anomalitë* dhe *perifrazimin*. Janë pikërisht këto *marrëdhëniet kuptimore* mes fjalive apo fjalëve, që bëjnë të mundur përcaktimin e njësisë themelore të semantikës.

Palmer thekson, se "*… të tilla marrëdhënie nuk janë parë në kontekstin e përdorimit të fjalive. Semantika nuk merret me mënyrën se si fjalët dhe fjalitë përdoren në lidhje me botën përreth nesh*".[75] Bierwisch[76] është ai që thekson rëndësinë e interpretimit të fjalive nga folësit e gjuhës, duke argumentuar interpretimin e fjalive, dhe se si këto interpretime lidhen me atë për çka flitet.

Sipas Palmer, "*çështja e semantikës nuk është kërkimi për një iluzion të quajtur kuptim, por është një përpjekje për të kuptuar se si fjalët dhe fjalitë mund të përcjellin një kuptim apo të jenë të kuptimshme*".[77] Kështu, kuptimi nuk është diçka të cilën fjalët apo njësitë e tjera gjuhësore e mbajnë në kuptimin e parë të fjalës "*kam"* apo "*posedoj"*. Palmer[78] thekson gjithashtu edhe rëndësinë që ka përdorimi i fjalëve duke u mbështetur në thënien e Wittgenstein: "*mos kërkoni kuptimin e një fjale, kërkoni përdorimin e saj"*.[79] Duke studiuar përdorimin, ne vërejmë se e perceptojme atë, jo si diçka që fjalët e kanë në vetvete në kuptimin e parë.

Në gjuhën shqipe, J. Thomai[80] dallon tri njësi të semantikës:

a. *njësia semantike minimale* (përbërësi kuptimor sipërfaqësues gjuhësor i një treguesi të reales)

b. *njësia semantike themelore* (kuptimi leksikor në të tri rrafshet, që përbëhet nga disa njësi semantike minimale)

c. *njësia semantike maksimale* (tërësia e kuptimeve leksikore të një fjale me shumë kuptime, ndryshe quhet "*përmbajtja leksikore e fjalës*", ose "*struktura leksikore e fjalës*").

Disa gjuhëtarë të tjerë, kanë shkuar më tej, duke e përkufizuar semantikën në lidhje me marrëdhëniet e së vërtetës midis fjalive, duke dalluar ato që kanë të bëjnë me të vërtetën logjike apo analitike, etj. Palmer,gjithashtu, shton, se "*vetëm një pjesë e caktuar e marrëdhënieve kuptimore janë të lidhura ngushtë me semantikën, pasi pjesa tjetër është e lidhur me pragmatikën*".[81]

[74]H. Jackson, (1988) Words and their Meaning, What is a word?, Pearson Education , f.1-18.
[75] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.39 .
[76] M. Bierwisch (1971) Modern Linguistics: its Development, Methods, and Problems, f.26.
[77] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.98.
[78] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.98.
[79]L. Wittgenstein (2009) G E M Anscombe; P M S Hacker; Joachim Schulte,Chichester, West Sussex, U.K., f.145.
[80]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.52.
[81] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.41.



Figura 1

Marrëdhënia dhe dallimi midis *referencës* dhe *kuptimit* (*sense*) nuk është e thjeshtë të përcaktohet, pasi edhe kategoritë e gjuhës korrespondojnë me ato të botës reale. Kjo ka të bëjë me ndikimin e botës reale te gjuha apo anasjelltas, gjë që përbën një çështje mjaft komplekse. Fakti që ekzistojnë dallime gjinore tek kafshët në botën reale mund të ketë rezultuar në dallimet gjuhësore me terma të caktuar për gjini të ndryshme, si p.sh "*lopë/dem"*, etj. Megjithatë, jo të gjitha gjuhët kanë dallime gjuhësiht të njëja për të tilla raste, dhe për më shumë disa fjalë bëjnë pjesë në kategoritë natyrale dhe disa jo. Në këtë këndvështrim bëhet edhe dallimi midis *kuptimit* (sense) dhe *referencës* edhe pse nuk mund të themi se ekziston një dallim i qartë mes tyre. Por, studiuesit në përgjithësi e kanë neglizhuar *referencën*, duke e përqendruar tek marrëdhëniet kuptimore (*sense relations*). Gjithsesi, kjo qasje është e paplotë, pasi nuk mund të anashkalohet *referenca* në të tilla analiza gjuhësore.

Si përfundim, mund të themi se një teori e kuptimit (*meaning*) është e plotë atëherë kur përfshin si *nuancën kuptimore* (*sense*), pra aspektin brendagjuhësor, ashtu edhe *referencën,* apo marrëdhënien e gjuhës me botën.

1.2.5 Semantika, antonimet dhe strukturalizmi

Teoritë e bazuara tek logjika e lidhin fjalën me sendet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por, gjuhësia dhe gjuhëtarët kanë ecur me hapa galopantë me qasjet e tyre ndaj fjalës dhe kuptimit. Si rezultat, lindi nevoja e një qasjeje tjetër, e cila do të përfshinte edhe konceptin mendor. Një tjetër këndvështrim, ishte ai që lidh fjalët dhe sendet përmes ndërmjetësimit të koncepteve mendore. Ky këndvështrim daton që prej kohëve antike në studimet e filozofëve dhe gjuhëtarëve, por dy nga versionet më të njohura janë teoria e shenjës së De Saussure dhe trekëndeshi i Ogden dhe Richards.

Trekendëshi i kësaj marrëdhënie, i krijuar nga Ogden dhe Richards[82], përmban *simbolin,* i cili është elementi gjuhësor (fjala, fjalia, etj), *referentin*, apo objektin në botën reale dhe së fundi *referencën* apo mendimin, pra konceptin. Sipas kësaj teorie, nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë mdis simbolit dhe referentit, pra gjuhës dhe botës reale. Kjo lidhje formohet përmes mendimit apo *referencës*, konceptit në mendjen tonë.

Për dhjetëvjeçar me radhë, studimet e marrëdhënieve leksiko-semantike ishin të lidhura ngushtë me qasjen strukturaliste ndaj kuptimit. Sipas kësaj qasjeje, "*gjuha perceptohet si një sistem autonom i marrëdhënieve paradigmatike dhe sintagmatike*

[82] C.K Odgen, I.A. Richards (1946) The Meaning of Meaning, New York, Harcourt, Brace &Co., f. 186.

ndërmjet fjalëve". Në këtë qasje, dallojmë kontributin e themeluesit të strukturalizmit, De Saussure[83], të pasuar nga Firth[84], Lyons[85], Cruse[86], Lehrer[87], Sinclair[88], Halliday[89], etj.

Semantika, është pjesë e gjuhësisë, ashtu sikurse janë dhe fonetika dhe gramatika. Gjuha është një sistem komunikimi, e cila lidh diçka që duhet komunikuar me atë që e komunikon atë, pra një mesazh nga njëra anë dhe një grup shenjash apo simbolesh nga ana tjetër. Gjuhëtari zviceran Ferdinad De Saussure[90] iu referua këtyre elementeve me termat "*signifier*" (shënuesi) dhe "*signified*" (i shënuar). Ai përdori termin "sign" (shenjë) për t'iu referuar lidhjes së shënuesit dhe të shënuarit, por pasuesit e tij të strukturalizmit e kanë përdorur këtë term për t'iu referuar vetëm shënuesit, pra Saussure ka mundësuar një përshkrim të sistemit të komunikimit. Sistemet e komunikimit mund të jenë edhe jashtëgjuhësore, si p.sh, ajo e ngjyrave në rregullat e qarkullimit rrugor, sistemi i komunikimit të zhurmave të kafshëve, etj.

Për të parë se si funksionon gjuha si një sistem shenjash, nevojitet të kuptojmë konceptin *sistem*. Fjala *sistem* vjen nga greqishtja e vjetër *systema* – që do të thotë bashkësi ose tërësi. Sipas R.Memushajt, "*me sistem kuptohet një bashkësi elementesh të lidhura, të ndërvarura në mënyrë të ndërsjellë midis tyre, që funksionojnë si një e tërë e vetme* ". [91] Njësitë e gjuhës shërbejnë për komunikim vetëm në lidhjet sistemore midis tyre, tërësia e këtyre lidhjeve midis njësive të sistemit përbën *strukturën e gjuhës"*.[92] Struktura e gjuhës është mënyra e organizimit të elementeve të sistemit gjuhësor."*Sitemi i gjuhës përbëhet nga njësitë dhe nga struktura … dhe përkufizohet si një unitet i njësive me strukturën … pra gjuha cilësohet si sistem strukturor*".[93]

Brenda këtij sistemi dallohen dhe nënsisteme, siç është fonetika, leksiku dhe gramatika. Që të kemi një sistem "*duhet të jenë jo më pak se një element të një fare, dhe këto elemente të kenë lidhje paradigmatike midis tyre*".[94] Në ligjërim, sistemi funksionon përmes mekanizmave të caktuara, të cilat janë tashmë objekt i analizave të gjuhëtarëve. Këto analiza mundësohen përmes korpusit apo një teksti specifik, objekt i analizës prej të cilit rezultojnë të dhëna për njësitë e sistemit. Njësitë e sistemit formojnë rrafshe të ndryshme dhe ne do të kemi si objekt studimin e rrafshit të fjalëve, pra nënsistemin leksikor, i cili nuk mund të shikohet i shkëputur nga sistemi gramatikor, morfologjik dhe sintaksor. Thëniet janë njësia themelore e ligjërimit dhe formojnë grupe kuptimore, të cilat janë të kapshme gjatë procesit të të folurit.

[83] F. De Saussure (1959) Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and A Sechehaye.Trans.by W. Baskin.) New York: Philosophical Society, f.189-196.
[84] J.R. Firth (1957) Modes of Meaning. Papers in Linguistics 1934–51, Oxford University Press, f. 190-215.
[85]J. Lyons (1977) Semantics. Cambridge: Cambridge University Press, f.69-87.
[86] D. A. Cruse (1986) Lexical semantics.Cambridge: Cambridge University Press, f.63.
[87] A. Lehrer. &K.Lehrer (1982) Antonymy. Linguistics and Philosophy5, Paradigmatic Relations, f. 483–501.
[88] J. Sinclair (1987) Looking up. An Account of the COBUILD Project in Lexical Computing and the Development of the Collins COBUILD English Language Dictionary. London: Harper Collins, f.38.
[89] M.A. K. Halliday (1994) An Introduction to Functional Grammar. London: Edward Arnold, f.85.
[90] F. De Saussure (1959) A Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and a Sechehaye.Trans.by W. Baskin.) New York: Philosophical Society, f.96-105.
[91]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.129.
[92]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.130.
[93]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.130.
[94]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.131.

Në këndvështriminin strukturialist është e rëndësishme të përcaktohet natyra dhe marrëdhënia e sistemit të komunikimit midis shënuesit dhe të shënuarit[95]. Palmer vëren, se që nga koha e Plato është përcaktuar, se shënuesi është një fjalë e gjuhës, dhe i shënuari është një objekt në botën reale, së cilës i referohet apo e shënon shënuesi. Ai shton, se fjalët janë emërtime për sendet. Është procesi i emërtimit, mënyra se si fëmija mëson të përdorë fjalët. Megjithatë, teoria e emërtimit u përshtatet më shumë emrave, sesa pjesëve të tjera të ligjëratës[96].

Sipas De Saussure, shenja gjuhësore përbëhet nga *shënuesi* dhe *i shënuari*, pra thënë ndryshe një *imazhi i zëshëm* dhe *një koncept*, të cilat lidhen përmes një lidhjeje psikologjike njohëse si tingulli që ne lëshojmë, ashtu edhe objektet e botës, për të cilat ne flasim, e të cilat pasqyrohen në një mënyrë të caktuar nga njësitë konceptuale. [97]

Teoria e De Saussure merret me klasifikimet konceptuale. Por, *çfarë është lidhja* njohëse*te De Saussure?* Kjo është një lidhje psikologjike, që do të thotë, se kur ne mendojmë një emër, në mendojmë edhe konceptin, apo anasjelltas. Pra, kuptimi ka të bëjë me aftësinë tonë në njohjen e njërës me tjetrën, të konceptit me emrin. Edhe ky këndvështrim ka të metat e tij, pasi nuk është e qartë ajo çka nënkuptohet "me të menduarit e një koncepti". Problemi qendron përsëri në emërtimin dhe sendet. Edhe sot, ka disa gjuhëtarë, të cilët e pranojnë tërësisht apo pjesërisht këndvështrimin konceptual për kuptimin. Një këndvështim i tillë i ka rrënjët tek Chomsky dhe tek pasuesit e tij, të cilët këmbëngulën se "*intuita dhe vetëshqyrtimi (introspektimi) luajnë një rol të rëndësishëm në studimin e gjuhës"*.[98]

Teoria e sistemit në komunikim pati edhe kritika, ndër të cilat mund të përmendim kundërargumente, si fakti se nuk duhet të ngulmohet në analogjinë e gjuhës me sistemet e tjera të komunikimit, sepse gjuha jo gjithmonë ka një "mesazh" në kuptimin gjithëpërfshirës; pjesë e funksionit të saj është edhe marrëdhënia shoqërore, e cila nuk është tipar i dukshëm i sistemeve të tjera të komunikimit, për më shumë në gjuhë shenjat dhe mesazhet (*shënuesi- i shënuari*) janë shumë komplekse dhe marrëdhënia midis tyre akoma më e ndërlikuar, prandaj themi se gjuha njerëzore dallon nga të tjera "sisteme gjuhësh"[99]. Palmer thekson, se nëpërmjet gjuhës është shumë e vështirë të përshkruash qartë çfarë është një mesazh gjuhësor, ndërsa në sistemet e tjera të komunikimit, mesazhi mund të identifikohet pavarësisht nga gjuha. Ai shton, se "*në gjuhë ne mundemi vetëm të përcaktojmë kuptimin përmes kuptimit, pra ta përshkruajmë gjuhën vetëm në terma gjuhësorë*".[100]

Palmer e kundërshton një teori të tillë, duke argumentuar se nuk është e mjaftueshme të shihet kuptimi në lidhje të ngushtë me njësitë mendore të quajtura koncepte, për tri arsye[101]:

1. Edhe po të ketë koncepte në mendjen tonë, ato janë në parim të papërdorëshme për të tjerët, por vetëm për individin, pra kemi të bëjmë me këndvështrime totalisht subjektive.

[95] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[96] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[97] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.133.
[98] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.133.
[99] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[100] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[101] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.

2. Argumentet për intuitën dhe vetëshqyrtimin janë të pavlefshme, pasi ne mund të vetëshqyrtojmë për gjuhën tonë pa pasur nevojë për të dhëna njohëse, por në këtë mënyrë ne nuk mësojmë ndonjë gjë më shumë rreth gjuhës apo strukturës së saj; ne thjesht japim disa shembuj të përdorimit të gjuhës sonë.

3. Së treti, asgjë nuk thuhet duke zhvendosur prapa kuptimin në mendjen, apo në trurin tonë.

Saussure thekson, se "*gjuhësia duhet të studiojë përmes metodave njohëse shkencore, ajo studion jo vetëm shembuj specifikë, por gjithashtu merret edhe me përgjithësime*". [102] Këtë pohim De Saussure e thekson në dallimin midis gjuhës (langue) dhe të folurit (parole).

Edhe Naom Chomsky[103] edhe pasuesit e tij u përpoqën të bëjnë këtë dallim midis kompetencës dhe performancës. Chomsky dallon shumë nga De Saussure për sa i përket sistemit të gjuhës apo kompetencës, por dallimi teorik është i njëjtë. Të dy merren kryesisht me përjashtimin e asaj që është thjesht individuale apo aksidentale (të folurit apo performanca) dhe ngulmojnë tek studimi i mirëfilltë i gjuhësisë së gjuhës apo kompetencës së saj. Si për Saussure dhe për Chomsky, gjuha apo kompetenca është një lloj sistemi i idealizuar, pa ndonjë bazë njohëse të qartë, prandaj dhe preferohet të flitet në terma të përgjithshme[104]. Pra, ashtu siç Palmer thekson, *kuptimi i një individi nuk është pjesë e semantikës, megjithatë përbën interes të studiohen dallimet individuale nga modeli i përgjithshëm, por ky është objekt i studimit të degëve të tjera të gjuhësisë, siç është sociolingustika, etj.*[105]

Bertrand Russell[106] propozon dallimin midis fjalës objektive dhe fjalës së fjalorit, në mënyrë të tillë, që të dallohen ato fjalë të cilat shënojnë objektet dhe që fëmija i mëson përmes emërtimit dhe fjalëve, të cilat përdoren në mënyrë të prejardhur nga përdorimi i tyre bazë.

Ullman[107] e shkëput mendimin nga gjuha, pra, kuptimin nga fjala. Edhe Palmer, Bloomfield, dhe Saussure, e strukturalistë të tjerë nuk e përfshijnë në gjuhë kuptimin e fjalës, pasi e konsiderojnë atë jashtëgjuhësor. Ndërkohë, funksionalistët, si Martine, e shohin shenjën gjuhësore si arbitrare, duke e anashkaluar lidhjen formë-përmbajtje.[108] Si njësi themelore ata përcaktuan *monemën*, por nuk e dallojnë atë nga fjala.

J. Thomai thekson, se "*nuk mund të ketë një prerje rrënjësore ndërmjet studimit formal të gjuhës dhe studimit të kuptimeve, pra edhe ndërmjet gjuhë, shoqërisë, historisë, e kulturës së folësve"*[109].

[102] F. De Saussure (1959) Course in General Linguistics, New York: Philosophical Society, f.96-105.
[103]N. Chomsky (1969) Topics in the Theory of Generative Grammar, Cambridge University Press, cituar nga F.R. Palmer, (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156 .
[104]N. Chomsky (1969) Topics in the Theory of Generative Grammar, Cambridge University Press, cituar nga F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[105] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[106]B. Russell (2007) Inquiry into Meaning and TR., Routlege, f.98.
[107] F. De Saussure (1959) Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and A Sechehaye.Trans.by W. Baskin.) New York: Philosophical Society, f.96-105.
[108] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[109]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.30.

Gjenerativistët, si Chomsky, nuk ishin të interesuar të dallonin kuptimin, vlerën apo përmbajtjen e fjalës, duke u përqendruar tek *fraza*, dhe jo tek *fjala*. Në këtë mënyrë ata e ndajnë shprehjen gjuhësore nga përmbajtja.[110]

De Saussure ka edhe meritën e futjes së konceptit të *vlerës* dhe fushës në leksikologjinë strukturaliste. Kjo vlerë del nga lidhjet paradigmatike dhe sintagmatike të fjalëve. Për sa i përket fushës, ajo "*tregon se si formohet një mikrosistem, ku elementet lidhen më njëri-tjetrin e përmes këtyre lidhjejeve nxjerrin vlerën e tyre*".[111] Thelbi i analizës distribucionale apo të pranëvënies është studimi i mundësisë së pranëvënies së fjalëve me njëra-tjetrën. Në këtë analizë u dallua tipari pozitiv dhe ai negativ (ose zero). I pari lidhet me ato tipare që fjala i ka, ndërsa i dyti me ato tipare të cilat fjala nuk i ka, pra i mungojnë.

1.2.6 Gjuha e folur dhe e shkruar si objekt i semantikës

Një karakteristikë e rëndësishme e qasjes gjuhësore në studimin e gjuhës është fakti, se ajo nuk merret vetëm me gjuhën e shkruar, por edhe me gjuhën e folur. Palmer[112] dallon katër arsye kryesore pse gjuha e folur qendron mbi gjuhën e shkruar:

1. *Gjuha e folur ka ekzistuar përpara gjuhës së shkruar, dhe akoma sot disa gjuhë nuk kanë formë të shkruar.*

2. Fëmija fillimisht fillon të flasë dhe më pas të shkruajë.

3. Gjuha e shkruar mund të shndërrohet në të folur pa pësuar humbje, por jo anasjelltas, pasi nëse ne shkruajmë atë çka thuhet, humbasim shumë, p.sh., tiparet paragjuhësore ose prozodike, siç janë intonacioni dhe theksi, nuk mund të pasqyrohen në formë të shkruar, gjithashtu edhe shenjat jogjuhësore, siç janë buzëqeshja, mimika, shkelja e syrit etj., japin një informacion, i cili nuk mund të përkthehet në gjuhë të shkruar.

4. Të folurit luan një rol shumë më të rëndësishëm në jetën tonë, pasi ne kalojmë shumë më tepër kohë duke folur, sesa duke shkruar.

1.2.7 Semantika historike

Semantika historike studion ndryshimim dhe zhvillimin e kuptimit në kohë. Studiuesi amerikan L.Bloomfield[113] dallon disa lloje të ndryshimit të kuptimit në kohë, ku mund të përmendim: zgjerimin e kuptimit, ngushtimin e kuptimit, metaforën, metoniminë, sinekdotën, hiperbolën, etj. Shkenca e gjuhës, e cila merret me ndryshimin historik, njihet ndryshe edhe si *filologjia krahasuese,* e cila merret me historinë e gjuhës dhe burimin e saj. Gjuha angleze ka prejardhje nga gjuhët romake dhe gjermanike, kështu p.sh çifti antonimik *guest-hostile* kanë origjinë të përbashkët.

Etimologjia është ajo shkencë e gjuhës e cila studion historikun e fjalëve dhe se si forma dhe kuptimet e tyre kanë ndryshuar me kalimin e kohës, pra merret me zbulimin e kuptimit të vërtetë.[114]Fjalorët përpiqen të paraqesin informacionin etimologjik të fjalëve,

[110] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.156.
[111] F. De Saussure (1959) Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and A Sechehaye.Trans.by W. Baskin.) New York: Philosophical Society, f.96-105.
[112] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.157.
[113]L. Bloomfield (1914) Introduction to the Study of Laguage:The sentence and the Word, f.65.
[114] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.157.

pasi kjo paraqet interes për studimin e tyre.[115]Palmer shton, se problemi më i madh me etimologjinë është fakti se nuk ekziston një kuptim i vërtetë dhe origjinal, sepse gjuha njerëzore shtrihet shumë larg në kohë,[116] p.sh., mbiemri "*nice"* (*i këndshëm)* i cili ka kuptim pozitiv për të cilësuar diçka apo dikë, në një studim historik rezulton që dikur të ketë pasur kuptimin "*silly" (budalla),* pra kuptim negativ.

De Saussure [117] është ai që bëri dallimin midis gjuhësisë diakronike dhe sinkronike, ku e para merret me gjuhën në kohë, ndërsa e dyta me gjuhën siç është tani, apo siç ajo ishte në një periudhë të caktuar të kohës. Gjuhëtarët kryesisht janë përqendruar në studimin sinkronik të gjuhës për nga vetë fakti se nuk mund të studiohet ndryshimi në gjuhë pa përcaktuar fillimisht gjendjen e gjuhës në një kohë të caktuar. Pra, në semantikë nuk mund të studiojmë ndryshimin e kuptimit pa ditur se çfarë është kuptimi.

1.3 Kuptimi dhe llojet e kuptimit në gjuhë

1.3.1 Ç'është kuptimi i fjalës?

Kuptimi i fjalës është leksiko-gramatikor, sepse përbëhet nga kuptimet leksikore dhe nga ato gramatikore. Këto të fundit së bashku me mjetet gjuhësore që i shprehin (mjetet gramatikore) janë objekt i morfologjisë. Siç shprehet dhe gjuhëtari Memushaj, "*kuptimi i fjalës nuk pasqyron vetëm lidhjen e saj me një aspekt të dhënë të botës reale. Në të vërtetë ai duhet marrë si një rezultante e tipareve semantike, që dalin nga përkatësia e fjalës, në një apo disa sisteme leksikore".*[118]

Sipas qasjes njohëse del, se "*kuptimi leksikor është marrëdhënia ndërmjet njësive leksikore dhe vlera e përdorimit të mundshëm në raste dhe kontekste të caktuara. Kuptimi leksikor del dhe kufizohet nga njohuritë enciklopedike, hartat e konvencionalizuara ndërmjet njësive leksikore dhe koncepteve, mënyra konvencionale e mendimit në kontekste të ndryshme, struktura dhe korniza situative*".[119] Bazuar në këto këndvështrime, mund të themi, se kuptimet e fjalëve dalin dhe "lexohen" në struktura dhe kontekste të veçanta, ku ato përdoren. Sipas kësaj teorie, një fjalë mund të ketë më shumë sesa një "lexim", duke u dhënë fjalëve dhe kuptimeve të tyre një dinamikë natyrale. Paradis vë në dukje përparësitë e kësaj qasjeje: "*Përparësia e modelit të studimeve njohëse ontologjike paraqet një model me dinamikë të lartë, në të cilin mund të trajtohen si çiftet e standardizuara, ashtu edhe ato rastësore (Ad Hoc) midis konfigurimit dhe përmbajtjes*".[120]

Ekzistojnë disa teori për përkufizimin e kuptimit, ndër të cilat dallojmë:

Teoria semantike, ku kuptimi përbën objektin kryesor, pasi vetë semantika merret me kuptimin e fjalëve dhe fjalive. Gjithsesi, nuk është e thjeshtë të përkufizohet ky term, pasi ashtu siç Leech thekson, fjala *'kuptim' dhe folja 'nënkupton' janë nga termat më të*

[115] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.157.
[116] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.158.
[117] F. De Saussure (1959) A Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and A Sechehaye.Trans.by W. Baskin.) New York: Philosophical Society, f.102.
[118]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f. 135.
[119] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge: Cambridge University Press. (1992) Antonymy Revisited: Some Thoughts on the Relationship Between Wordsa Concepts, f. 189.
[120] C. Paradis, C. Willners (2011) Antonymy from Convention to Meaning-Making, Lund University, Review of Cognitive Linguistics, f. 367–391.

diskutueshem në gjuhën angleze. [121] Bloomfield, gjithashtu, trajton problemin e përkufizimit të kuptimit, duke u shprehur, se: "*Që të japim një përkufizim të saktë shkencor të kuptimit për çdo formë të gjuhës, duhet të kemi njohuri të sakta shkencore të gjithçkaje në botën e folësit*".[122] Pra, njohuritë tona janë gjithmonë të kufizuara, pasi ne nuk mund të kuptojmë gjithçka që dinë personat me të cilët flasim. Bloomfield vazhdon duke thënë, se "*Ne mund të përkufizojmë qartë kuptimin e një forme të ligjërimit, kur ky kuptim ka të bëjë me një çështje, për të cilën kemi njohuri shkencore* ".[123]

Martin jep përfundime të ngjashme me atë të Bloomfieldit, duke theksuar, se: "*Të dish atë që dikush nënkupton, nuk do të thotë të dish atë që folësit kanë në mendjen e tyre, kur ata flasin – jo të dimë çfarë përafrimesh bëjnë ata midis fjalëve dhe ideve vetjake. Të dish çka dikush nënkupton, do të thotë të kesh një teori të mirë për sjelljen gjuhësore publike të një folësi*."[124]

Froomkin shkruan për tiparet përcaktuese semantike dhe shprehet, se "*fjalët kanë karakteristika unike, të cilat përcaktojnë ekzistencën e tyre*".[125] Ai jep shembullin e emrit "*horseness"*i cili përfshihet në kuptimin e fjalës "*horse"*. Froomkin del në përfundimin, se "*Kuptimi i një fjale përcaktohet pjesërisht nga një grup tiparesh semantike*."[126]

Vështirësia me përkufizimet e kuptimit lidhet edhe me faktin, se një fjalë ka shumë nuanca kuptimore. Ogden dhe Richards paraqesin disa përkufizime të ndryshme të kuptimit, duke i ndarë në tri grupe A, B dhe C. Në studimin e kuptimit të fjalës paraqesin rëndësi grupi B dhe C, ku grupi B, ka të bëjë me kuptimin e një fjale në fjalor si dhe në kuptimet e saj konotative. Ata e përcaktojnë grupin B, si "*fjalë të tjera të pranëvëna me një fjalë në fjalor,…kuptimi konotativ i një fjale, thelbi, … ".*[127]Grupi C, ka të bëjë më shumë me marrëdhëniet e një fjale, ashtu siç Ogden dhe Richards e përcaktojnë: "*Grupi C është ai grup, i cili është i lidhur me një shenjë përmes një marrëdhënieje të zgjedhur, efektet e kujtesës të një stimuli, disa raste të tjera, në të cilat efektet e kujtesës së çdolloj rasti tjetër janë të përshtatshme".*[128]

Alston paraqet një përmbledhje përkufizimesh të ndryshme për termin kuptim, duke dalluar tre tipe teorish të kuptimit: *teoria referenciale*, *teoria e sjelljes* dhe *teoria e ideimit*. Ai thekson, se: "*Teoria referenciale identifikon kuptimin e një shprehjeje me atë së cilës ajo i referohet apo me lidhjen referenciale*"[129]. Për sa i përket *teorisë së ideimit,* ai thekson, se: "*ka të bëjë me idetë me të cilat ai shoqërohet* "[130]. Për *teorinë e sjelljes*, ai shprehet, se kjo teori "*konsiston në stimujt të cilët sjellin shprehjen e tij me fjalë dhe /ose përgjigjet që ai shkakton*".[131]

Alston thekson se kur dikush thotë diçka ata kryejnë tre veprime:

1. shqiptojnë një fjali të caktuar
2. sjellin një ose disa rezultate nga kjo shprehje përmes fjalëve

[121]G. Leech (1974) Language Arts and Disciplines, f.19.
[122]L. Bloomfield (1933) Language and Linguistics, f.139.
[123]L. Bloomfield (1933) Language and Linguistics, f.139.
[124] J.R. Martin (1985) Factual Writng: Exploring and Challenging Social Reality, f. 58.
[125] J. Froomkin (1993) The Crisis in Higher Education, f .165.
[126] J. Froomkin (1993) The Crisis in Higher Education, f. 166.
[127] C.K Odgen,I.A Richards (1946) The Meaning of Meaning, New York, Harcourt, Brace &Co., f. 186.
[128] C.K Odgen, I.A Richards (1946) The Meaning of Meaning, New York, Harcourt, Brace &Co., f. 187.
[129]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 10.
[130]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 134.
[131]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 134.

3. kryejnë diçka, e cila qendron mes 1 dhe 2.[132]

Duke përdorur terminologjinë e Austin, Alston i quan këto veprime përkatësisht[133]:

1. *veprimi lokucionar*
2. *veprimi perlokucionar*
3. *veprimi ilokucionar.*

Alston përcakton, se ”*veprimet perlokucionare kryesisht sjellin prodhimin e një efekti të caktuar, ndërkohë që akti ilokucionar kërkon dhe bazohet tek një akt lokucionar”*[134]

Siç shihet, fjala *kuptim* mund të ketë përkufizime të shumta në një kuptim të përgjithshëm. Në studimin tonë, ne do të trajtojmë vetëm kuptimin e fjalës në kuptim të ngushtuar.

1.3.2 Llojet e kuptimit

Në një qasje teorike ndaj tipologjisë kuptimore kemi vënë re, se ekzistojnë mendime të ndryshme, për sa i përket llojshmërisë së kuptimeve në gjuhë. Ne do të përqendrohemi tek kuptimi leksikor, pasi ai është është në qendër të marrëdhënieve leksiko-semantike. Raporti midis sendit, konceptit, kuptimit dhe fjalës, të cilat lidhen me rrafshin e realitetit, mendimit dhe gjuhës, kanë qenë gjithmonë objekt debatesh gjuhësore. Përkufizimi i saktë i asaj që ne quajmë *kuptim leksikor*, nuk është i qartë, pasi gjuhëtarë të ndryshëm kanë këndvështrime përcaktuese të ndryshme.

Tipat e kuptimeve leksikore në gjuhën shqipe, sipas J. Thomait[135]:

A. *kuptime të parme dhe kuptime të prejardhura*

.

Kuptimet e prejardhura janë më të shumta në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhën angleze, sesa kuptimet fillestare, pasi çdo fjalë ka vetëm një kuptim fillestar.

B. kuptimet *konkrete*, kuptimet *abstrakte* dhe *të figurshme*

Ndarja bëhet sipas llojit të lidhjes me realitetin: lidhje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë[136]. Këtu, J.Thomai dallon kuptimet *konkrete* (të cilat pasqyrojnë gjuhësisht sende konkrete në kuptimet e para dhe të prejardhura të fjalëve), kuptimet *abstrakte* (kuptimet e para të fjalëve të thjeshta ose të fjalëve te prejardhura) si edhe *të figurshme* (që pasqyrojnë gjuhësisht një realje përmes një realjeje tjetër).[137] Në vargun e kuptimeve dallojmë një kuptim kryesor, ose kuptimi i parë, i cili zakonisht është kuptimi fillestar, por tek fjalët që e kanë humbur kuptimin fillestar, përkon me kuptimin e prejardhur.

J. Thomai përcakton edhe *rrafshet e kuptimit leksikor*[138]:

[132]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 134 .
[133]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 135.
[134]W. Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 136.
[135]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.34.
[136]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.34.
[137]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.34.
[138]J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.34.

1. *Kuptimi leksikor i përgjithshëm* (aftësia që ka fjala për të shënuar diçka nga realiteti). Në këtë rrafsh dallohen fjalët nga fonema, morfema dhe fjalia, por nuk dallohen fjalët nga njëra-tjetra.

2. *Kuptimi leksikor kategorial* (aftësia që ka një klasë fjalësh të shënojë diçka të përbashkët, dhe që e dallon këtë fjalë nga klasat e tjera. p.sh., emrat shënojnë sendësi, mbiemrat cilësi, foljet veprime.

3. *Kuptimi leksikor i veçantë individual* (aftësia që ka çdo fjalë të shënojë diçka të veçantë nga realiteti, një send, një tipar, një veprim, etj. Çdo fjalë ka përmbajtjen e vet leksikore.

Në përgjithësi, në sistemin e kuptimeve të fjalës në gjuhën shqipe dallohen tre rrafshet si më poshtë:

1. *rrafshi i parmë-i prejardhur,*
2. *rrafshi konkret-abstrakt,*
3. *rrafshi i drejtpërdrejtë-i figurshëm.*

Tipologjia e kuptimeve paraqitet si më poshtë, nga Rami Memushaj:[139]

- nga pikëpamja e rëndësisë, dallojmë kuptime dytësore dhe kuptime kryesore,
- nga pikëpamja e rendit kohor, dallohet kuptimi bazë dhe kuptimi i prejardhur,
- sipas lidhjes së kuptimit me objektin, dallohet kuptimi i drejtpërdrejtë dhe i figurshëm,
- sipas vlerës stilistike, dallohet kuptimi neutral dhe shprehës,
- sipas kontekstit, dallojmë kuptime të pavarura nga konteksti dhe kuptime kontekstore,
- nga informacioni që përcjellin, dallojmë kuptime denotative dhe konotative.

Në punimin tonë kundërvënia kuptimore do të jetë thelbi i analizave studimore. Sipas M.Samarës[140], në bazë të kundërvënies dallojmë:

1. kundërvënie kuptimesh parësore

2. kundërvënie kuptimesh dytësore

3. kundërvënie kuptimesh të figurshme

Kuptimi leksikor përbën anën me thelbësore të fjalës. Që të kemi fjalë, duhet të kemi një grup tingujsh të të folurit të formësuar nga ana gramatikore, dhe që shpreh diçka nga realiteti. Te fjala ndërthuren dhe gërshetohen në një njësi të vetme elementet e fonetikës, gramatikës dhe semasiologjisë.[141] Të gjitha fjalët kanë kuptim leksikor, por shkalla e qartësisë së këtij kuptimi është e ndryshme. Fjalët që shënojnë nocione, emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet, kanë kuptim më të qartë e më të pavarur. Fjalët shërbyese nuk shënojnë nocione dhe kanë kuptim leksikor më pak të qartë.

[139]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.157.
[140]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.58
[141]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, EDFA, f.103.

J.Thomai thekson, se dallimi midis nocionit dhe kuptimit leksikor ka gjithashtu rëndësi, pasi nocioni është kategori logjike, lidhet me mendimin, ndërkohë që kuptimi leksikor është kategori gjuhësore dhe lidhet me gjuhën.[142] Të gjitha fjalët kanë kuptim leksikor, por jo të gjitha shënojnë nocion, megjithatë ekziston një lidhje e ngushtë midis mendimit dhe gjuhës, nocionit dhe kuptimit leksikor.[143]

Në qasjet pragmatike dallojmë kryesisht Clark me "Parimin e Kundërshtisë", i cili thekson se "*çdo dy forma kundërvihen në kuptim*".[144] Duket qartë, se teoria pragmatike thekson nevojën për shmangien e sinonimisë, duke theksuar se çdo dy forma janë të ndryshme, por kjo nuk do të thotë se dallimi i këtyre formave është pikërisht antonimia.

Kempson përmbledh tri mënyra kryesore të shpjegimit të kuptimit: "*domethënien e fjalëve, interpretimin e fjalive, dhe atë që folësi nënkupton dhe ka qëllim të shprehë në aktin e komunikimit*"[145], nga ato rezultojnë tre lloje kuptimesh: *kuptimi i fjalës*, *kuptimi i fjalisë* dhe *kuptimi i bashkëbisedimit*.

Ngjyrimi emocional i përdorimit të gjuhës në kundërvënie me atë komunikativ (referencial) përbëjnë gjithashtu një pjesë të rëndësishme të kuptimit të shprehjeve. Kuptimi leksikor është objektiv (absolut) ndryshe nga ai emocional, i cili është subjektiv (relativ). Të gjitha gjuhët kanë një vlerë të caktuar emocionale. Ashtu sikurse Ullmann thekson: "*Nëse dikush s'ka absolutisht asgjë për të thënë, ai nuk duhet të thotë asgjë".*[146] Edhe J. Thomai e dallon dhe e trajton ngjyrimin emocional, i cili është tregues i qendrimit të folësit ndaj asaj që ai thotë, ku përfshihet edhe vlerësimi i tij subjektiv. Gjithtsesi, ai thekson se "*kuptimi emocional bën pjesë në përmbajtjen leksikore të fjalëve*".[147]Në lidhje me antoniminë, në kapitujt e mëposhtëm, do të zgjerojmë lidhjen e ngjyrimit emocional me antoniminë, duke u ndalur edhe tek katëgoria e antonimeve stilistike.

Bloomfield dallon midis *kuptimit të ngushtuar* dhe *kuptimit të zgjeruar*. Ai i përcakton kuptimet e ngushtuara si "*të vështira për t'u përcaktuar, se çdo paraqitje e një forme motivohet nga situatë praktike, të cilat nuk duhet të përmbajnë të gjitha mundësitë e kuptimit".*[148] Kështu, p.sh. kuptimi i foljes "*cut"* (*pres*) ka tjetër kuptim për një parukiere, tjetër kuptim për një kasap, etj. Pra, kjo folje ka një kuptim të ngushtuar për secilën nga situatat e mësipërme. Nga ana tjetër, kuptimet e zgjeruara janë më pak të zakonshme dhe si shembull për të kuptuar zgjerimin e kuptimit, Bloomfield jep fjalën "*cat",* por që herë pas here ne e përdorim duke përfshirë edhe luanët edhe "*tigrat*" (*lions and tigers*).

Leech dhe Lehrer kanë analizuar dhe mbledhur një inventar të *përbërësve të kuptimit*, nga ku dalin edhe kuptimet universale. Leech përshkruan shtatë lloje të ndryshme të kuptimit: konceptual, konotativ, shoqëror, afektiv, të reflektuar, bashkrënditës dhe kuptimin tematik. Ne në studimin tonë do të merremi vetëm me kuptimin konceptual, denotativ, njohës, themelor apo si bërthamë semantike, i cili, siç e përcakton Leech, "*ka një organizim të komplikuar dhe të sofistikuar të një tipi, i cili mund të krahasohet dhe të ndërlidhet me organizime të ngjashme në nivelet sintaksore dhe*

[142]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, EDFA, f.103.
[143]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, EDFA, f.103.
[144]H. H. Clark(1992) Arenas of Language Use. Chicago: University of Chicago Press, f.172.
[145]R. M.Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f.12.
[146]S. Ullmann (1962) Semantics: An introduction to the Science of Meaning, f.128.
[147]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, EDFA, f.67.
[148]L. Bloomfield (1933) Language and Linguistics, f.151.

fonologjike të një gjuhe"[149]. Për më shumë do t'i referohemi edhe kuptimit konotativ, social dhe emocional, për sa u përket antonimeve stilistikore, të figurshme apo kontekstuale.

Mathesius përdor termin *bërthamë semantike,* e cila "*përbën një pjesë të kuptimit të një njësie emërtuese, bashkë me përqfrimet e lidhura me fjalën dhe çfarë mund të quhet ngjyrim emocional*".[150] Pra, bërthama semantike përbën një pjesë të kuptimit themelor të një fjale. Për termin denotacion përdoret edhe termi *referencë.* [151]

Nuanca kuptimore nga ana tjetër përkufizohet, si: "*e lidhur me sistemin kompleks të marrëdhënieve midis elementëve gjuhësore në vetvete (kryesisht fjalët) ajo ka të bëjë me marrëdhëniet brendagjuhësore*".[152]

Hurford, Heasley dhe Smith japin një përkufizim më të thjeshtuar: "*kur flasim për reference, kemi të bëjmë me marrëdhëniet midis gjuhës dhe botës; kur flasim për nuancën kuptimore, kemi të bëjmë me marrëdhëniet brenda gjuhës* "[153].

Odgen dhe Richards propozojnë *trekëndëshin* e marrëdhënies midis një mendimi apo referencës, një simboli dhe një referenti[154].



Figura 2 Trekëndëshi e marrëdhënies midis një mendimi apo referencës, një simboli dhe një referenti

Kjo marrëdhënie gjuhësore me realitetin objektiv është ilustruar nga strukturalistët përmes një trekëndëshi semantik, këndet e të cilit janë përkatësisht: shenjuesi (shenja gjuhësore, fjala), kuptimi, dhe objekti. Shënuesi përbën përmbajtjen fonologjike të fjalës, kuptimi është ai që përçon informacionin, si edhe anën subjektive dhe qendrimin e folësit, ndërsa objekti përfaqëson realitetin objektiv, jogjuhësor, apo përvojën njerëzore. Fakti që ndërmjet shenjuesit dhe objektit nuk ekziston ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë, dëshmon edhe mënyrën arbitrare të ndërtimit dhe ekzistencës së gjuhëve të ndryshme në botë, edhe pse ato dalin të degëzuara në varësi të disa burimeve apo modeleve të përbashkëta (pema e gjuhëve indo-europiane).

Ogden dhe Richards pohojnë, se ekziston një *marrëdhënie rastësore* ndërmjet një mendimi dhe një simboli. Pra, një simbol simbolizon një mendim apo referencë.

[149]G. Leech (1974) Language Arts and Disciplines, f.11.
[150] V. Mathesius (1975) A Functional Analysis of Present Day English on a General Linguistic Basis, f. 18.
[151] Shënim: "Referenca është një aspekt i kuptimit, e cila merret me marrëdhënien ndërmjet elementeve gjuhësore , fjalëve, fjalive etj., dhe botës reale jogjuhësore", F. R.Palmer (1981) f.29.
[152] Cituar nga: F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 29.
[153]J. R.Hurford, B. Heasley, M. B.Smith (1983) Sematics: A Coursebook, f. 25.
[154] C.K Odgen I.A Richards (1946) The Meaning of Meaning, f. 11.

Marrëdhënia midis një mendimi dhe një referenti mund të jetë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë. Një mendim i referohet një referenti dhe fakti që vija lidhëse midis simbolit dhe referentit është e thyer dhe jo e plotë tregon se marrëdhënia midis tyre nuk është e drejtpërdrejtë. "*Simboli dhe referenti nuk janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, por vetëm në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në dy anët e trekëndëshit*".[155]

Sipas Palmer,"*kuptimi implicit (i nënkuptuar) ka të bëjë me informacionin faktik dhe njihet ndryshe si kuptimi njohës, denotativ, i propozuar, ideor etj".*[156] Por ky nuk është i vetmi tip i kuptimit në gjuhë, pasi një pjesë e rëndësishme e kuptimit është ndërpersonale, apo shoqërore, duke na lidhur me të tjerët. Pra, gjuha nuk përcjell vetëm informacion personal, dhe këtë e dëshmojnë argumentet që Palmer[157] radhit si më poshtë:

- ne nuk ndërtojmë vetëm thënie, por edhe pyetje apo urdhëra përmes formave gramatikore pyetësore dhe urdhërore. Veçanërisht urdhërat kanë si qëllim kryesor ndërmarrjen e veprimeve dhe jo mundësimin e një informacioni faktik.

- aktet e të folurit na mundësojnë që të ndikojmë tek të tjerët duke i bindur, paralajmëruar etj.

- një pjesë e konsiderueshme e asaj që ne themi nuk është një pohim i një fakti, por një vlerësim përmes kuptimit emotiv. Është pikërisht faktori emotiv apo vlerësues, i cili dallon fjalën "fashist" si diçka pozitive në Afrikën Jugore dhe si diçka negative në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mbiemra të tillë si "i mirë" dhe "i keq" nuk tregojnë fakte, por vlerësime.

- marrëdhëniet shoqërore me personin me të cilin flasim janë gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Ne mund të zgjedhim të jemi të sjellshëm ose jo karshi personit të cilit i drejtohemi. Një pjesë e mirë e gjuhës është me natyrë sociale, dhe nuk i përcjell informacion faktit, siç është edhe shembulli i bisedave "*small talk*", të cilat nuk transmetojnë fakte, por janë pjesë e aktivitetit shoqëror.

- përmes mjeteve paragjuhësore, apo prozodike, siç është intonacioni, ne mund të përdorim një sarkazëm, e cila nënkupton të kundërtën e asaj që themi si në shembullin: *That is very clever! (Është shumë e zgjuar!)* që në një intonacion të caktuar nënkupton *That is foolish! (Është budallallëk!)*. Pra, përmes një intonacioni në rënie, mund të nënkuptojmë të kundërtën e asaj që thuhet.

- përmes një thënieje të caktuar, ne mund të presupozojmë diçka, e cila nuk shprehet gjuhësisht me fjalë brenda asaj thënieje, si në rastin *The king of France is bald*. (*Mbreti i Francës është qeros*.), ku nënkuptohet se Franca ka një mbret.

Sipas teorisë së relativizmit gjuhësor, "*kuptimi i fjalës nuk përbën një kategori objektive dhe e pranon kuptimin e fjalës si diçka relative, që zbulohet vetëm nga konteksti ose situata e ligjerimit …"* Pra, kuptimi i fjalës varet nga lidhjet e saj me fjalët e tjera në një thënie. Kuptimi i fjalës, sipas relativizmit gjuhësor, është *"shuma e rrethimeve në të cilat përdoret fjala*".[158]

[155] C.K Odgen, I.A Richards (1946) The Meaning of Meaning, f.11.
[156] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.136.
[157] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.136.
[158]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.149.

Si përfundim, këto janë disa nga kuptimet, por ka edhe lloje të kuptimeve, që nuk janë trajtuar në këtë punim, për të mos u zgjatur në nënçështjet e trajtuara më lart, pasi qëllimi kryesor është të studiojmë natyrën e antonimeve mbiemërore dhe foljore në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke u mbështetur te kundërvënia kuptimore.

1.3.3 Kuptimi konotativ dhe denotativ

Ajo që na intereson në aspektin leksikologjik është fakti, se kuptimi i çdo fjale mund të ndryshohet nga ngjyrimi emocional, edhe pse me rëndësi dytësore. Këtu dallojmë kuptimin *denotativ* dhe *konotativ* të fjalës. Me vlerë konotative,do të kuptojmë ngjyrimet që shoqërojnë kuptimin e fjalës, të cilat gjithashtu njihen si *ngjyrime stilistike* dhe shprehin një qendrim emocional, estetik, social, etj. Sipas Memushajt, "*me kuptim denotativ do të kuptojmë kuptimin kryesor të fjalës*".[159]

Lyons e përkufizon kuptimin d*enotativ* të një lekseme, si "*marrëdhënie e cila qendron midis leksemës dhe personit, sendit, vendit, cilësisë, tipareve, proceseve, aktiviteteve të jashtme jashtë sistemit të gjuhës".* [160] Ky këndvështrim mbështetet në marrëdhënien e një njësie gjuhësore abstrakte dhe një klase të tërë objektesh jashtëgjuhësore. Në lidhje me kuptimin konotativ dallojmë qasje të ndryshme, ku vërejmë "*dallimin binar midis këryre dy termave"*[161], dhe qasjen e cila nuk e pranon dallimin binar, por e sheh "*përdorimin e konotacionit dhe denotacionit në një drejtim të veçantë*".[162] Në të dy këndvështrimet, dallohet qartë lidhja e ngushtë midis konotacionit dhe sinonimisë. Si rezultat, kuptojmë se si denotacioni dhe konotacioni janë të dyja të rëndësishmë për të përcaktuar kuptimin e fjalës në një kontekst të caktuar.

Sipas F.GJ.SH, konotacioni përkufizohet si "*kuptim i veçantë, më i hollë, që merr një fjalë a një shprehje në një përdorim ose në një fushë të caktuar, nuancë*".[163] Për më shumë, Samara, në lidhje me dallimin nga denotacioni, mendon, se "*konotacioni ka të bëjë me vlerat suplementare që merr fjala, si rezultat i qendrimit a vlerësimit shoqëror, i cili pasqyrohet e shprehet te fjala gjatë përdorimit ligjërimor në mjedise dhe me qëllime të caktuara*."[164] Ai dallon dy lloje ngjyrimesh:

1. sipas stileve të ligjërimit (libror apo bisedor)

2. sipas shkallës apo vlerave të tyre shprehëse emocionuese (qendrimi i folësit mund të jetë *keqësues, sharës, përçmues*,etj).[165]

Kuptimi dhe denotacioni përbëjnë dy marrëdhënie të ndërvarura nga njëra-tjetra. Lyons e përkufizon "*kuptimin*", si: "*vendi që zë fjala në një sistem marrëdhëniesh të krijuara me fjalët e tjera në fjalor*"[166] Më pas, Lyons e përkufizon kuptimin, si "*një marrëdhënie midis fjalëve apo shprehjeve në një gjuhë të vetme, pavarësisht nga*

[159]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.148.
[160]J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f.207.
[161]S.Ullmann (1962) Semantics: An Introduction to the Science of Meaning, f.74.
[162]G. Leech (1981) Semantics:The Study of Meaning, f.12.
[163]Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë (2006) Akademia e shkencave e shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë.
[164]M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politik e Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë f.101
[165]M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politik e Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.104-105.
[166]J. Lyons (1968) Introduction to Theoretical Linguistics,Cambridge University Press, f. 427.

marrëdhënia e atyrë fjalëve apo shprehjeve dhe referentëve të tyre".[167] Si leksemat e mëvetësishme ashtu dhe shprehjet më të zgjeruara kanë kuptim. Megjithatë, kuptimi i një shprehjeje është funksion i kuptimit të leksemave që ajo përmban dhe i gjendjes së tyre në një strukturë gramatikore të caktuar. p.sh.,.kuptimi i fjalës "*table"*[168]do të variojë në fjalitë e mëposhtme:

- *"table"*-[+ sing/pl verb] njerëz të ulur në tavolinë (*the people sitting at a table)*

There was a really noisy *table* behind us celebrating someone's birthday.

(Ndodhej një tavolinë e zhurmshme pas nesh, ku po festonin ditëlindjen e dikujt.)

- *"under the table" –nëse diçka bëhet "*under the table*", ajo është sekrete dhe e fshehur (something that is secret, hidden).*

They offered him money *under the table* to change his mind.

(Ata i ofruan atij para nën dorë për t'i ndryshuar mendjen.)

Në studimin tonë mbi antonimet,mund të themi se të dy aspektet e mësipërme luajnë një rol të rëndesishëm në përcaktimin e kuptimit të gjymtyrëve të një çifti antonimesh, si edhe në dallimin e lidhjeve radiale të kundërvënies së fjalës në kuptimin denotativ dhe konotativ.

1.3.4 Tipet e marrëdhënieve kuptimore

Marrëdhëniet semantike ekzistojnë ndërmjet kupimeve të fjalës, kuptimeve të shprehjeve dhe ndërmjet kuptimeve të fjalive, pra në tri nivele. Marrëdhëniet semantike në nivelin e fjalës përfshijnë sinoniminë, antoniminë, homoniminë, poliseminë, metoniminë.

Për të diskutuar për marrëdhëniet kuptimore, Lyons dhe Palmer, fillimisht bëjnë dallimin midis termit "*referencë*" e fjalës dhe termit "*kuptim*", *ku referenca përbën një marrëdhënie kuptimore të jashtme dhe përfshin marrëdhëniet midis fjalës dhe asaj çka ajo i referohet në botën fizike, në botën tonë mendore, apo eksperiencës sonë*[169]**.** Psh., referenca e fjalës "*pemë"* do të ishte: *një bimë e caktuar, e cila ka një trung, degë dhe gjethe*. Ndërkohë që *kuptimi* (sense) është një marrëdhënie kuptimore e brendshme, marrëdhënie e cila vendoset midis fjalëvë brenda fjalorit. Dy nga marrëdhëniet më të dukshme janë ato të "*ngjashmërisë*" dhe të "*kundërshtisë*", të cilat njihen ndryshe si *sinonimi* dhe *antonimi*.

Marrëdhënie të tjera përfshijnë *homoniminë* dhe *metoniminë,* të cilat përbëjnë marrëdhënie hierarkike midis fjalëve, ku një fjalë me një kuptim të përgjithshëm përfshin kuptimin e fjalëve të tjera me kuptim më specifik. p.sh., fjala "*pemë*" (*tree)* në një marrëdhënie hierarkike lidhet me fjalë si bimë (*plant), ah (beech), lis (oak)*. Për më shumë, Jackson dhe Amvela theksojnë, se "*të tilla marrëdhënie kuptimore kanë natyrë*

[167]J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f. 206.
[168]Shënim: përkufizim dhe shembull i marrë nga Cambridge Advanced Learner's Dictionary & Thesaurus, Cambridge University Press.
[169]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.

paradigmatike, për arsye se kanë të bëjnë me një zgjedhje midis fjalëve, apo zëvëndësimin e një fjale me një tjetër, në një kontekst të caktuar".[170] Nga ana tjetër, shtojnë ata, *fjalët gjithashtu kanë edhe marrëdhënie semantike, sintagmatike të vendosura midis fjalëve brenda të njëjtës fjali, të cilat formojnë "rende fjalësh"*(collocations).[171]

Ndërkohë, disa gjuhëtarë njohin tipologji të tjera të marrëdhënieve kuptimore. Kështu, Bolinger dhe Sears[172] paraqesin një ndarje tjetër të grupeve të fjalëve sipas lidhjeve të tyre kuptimore:

1. të anasjelltat (*come /go, buy/sell*)
2. objektet karakteristike (*eat/food*)
3. objektet e afërta (nga burimi kuptimor p.sh *ask/question, run/race*)
4. veprim karakteristik (*hurt/beat, fire/burn*)
5. subjekte, veprime, objekte të afërta (nga burimi kuptimor: *employer/employ/employee*)
6. cilësi karakteristike (*water/wet, summer/warm*)
7. gjendje (*smile /happiness*)
8. bashkëhiponime (*matter/solid/liquid/gaze*)
9. korpusi i anglishtes britanike dhe korpusi i anglishtes amerikane

1.3.5 Fusha konceptore, leksikore dhe semantike

Konceptet formojnë një sistem, pasi konceptet tona mbi gjithçka që na rrethon janë të lidhura në një mënyrë të tillë, që as nuk mund të ekzistojnë dhe as të kuptohen pa njëra-tjetrën. Sistemet dhe nënsistemet e koncepteve në botën e dukurive diskrete apo jodiskrete quhen *fusha konceptore*.[173] Tërësia e fjalëve që mbulojnë fushën konceptore formon një *fushe leksikore*. Kuptimet e një fjale që dalin nga lidhjet e saj në sintagma përbëjnë *fushën semantike* të asaj fjale. Struktura kuptimore e fjalëve studiohet sipas boshtit paradigmatik dhe sipas boshtit sintagmatik.

Kuptimet e një fjale që dalin nga lidhjet e saj në sintagma përbëjnë *fushën semantike* të asaj fjale, kështu që struktura kuptimore e fjalëve studiohet sipas boshtit paradigmatik dhe sipas boshtit sintagmatik.[174]

Fillimisht, antonimia është studiuar vetem përmes boshtit paradigmatik, duke zëvendësuar fjalët në një thënie, por më pas u zgjerua studimi edhe në boshtin sintagmatik, ku vërehen kombinimet e fjalëve antonime, pra studiuesit e ndryshëm nuk janë dakord me ndarjen sipas boshtit paradigmatik të studimit të sinonimisë, antonimisë dhe hiponimisë dhe sipas boshtit sintagmatik të studimit të polisemisë dhe homonimisë, pasi tashmë gjuhësia e ka zgjeruar studimin e antonimisë, duke përfshirë edhe boshtin sintagmatik. Më poshtë, por edhe në kapitujt në vazhdim, do të trajtojmë më gjerë lidhjet sintagmatike të antonimeve.

---

[170]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[171]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[172] Bolinger& Sears, cituar në R. George Wright,T (1990) The Future of Free Speech Law, University of Michigan, f. 128.
[173]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.150.
[174]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.

Siç dëshmohet edhe nga sa më sipër, gjuha nuk është thjesht një përmbledhje e pastrukturuar e fjalëve. Marrëdhëniet kuptimore të mësipërme janë provë e gjallë e karakterit sistematik të gjuhës.[175] Sipas Jackson, *edhe në këndvështrimin psikologjik mendohet se të tilla marrëdhënie kuptimore janë të vlefshme për mënyrën se si njeriu i ruan fjalët në "leksikun mendor*".[176] Po ashtu, edhe leksikologët përdorin eksperimente me natyrë të marrëdhënieve kuptimore, për të propozuar përshkrime të ndryshme të strukturës së fjalorit. Një nga konceptet që ata përdorin është edhe ai i *fushës semantike* ose leksikore. Fjalori gjithashtu organizohet në fusha semantike të ndryshme, të cilat ndërlidhen midis tyre[177]. Një fushë semantike përmban fjalë që i përkasin një fushe të përcaktuar të kuptimit (psh. *bimët, arsimi, ngjyrat* etj). Pikërisht kjo fushë rezulton të jetë edhe konteksti brenda të cilit përcaktohen marrëdhëniet kuptimore[178]. Për më shumë, edhe në studimet e përvetësimit të gjuhës duket qartë, se prania e të tilla fushave semantike ndihmon në mënyrën se si nxënësit arrijnë ta përvetësojnë gjuhën.[179]

1.3.6 Analiza e përbërësve kuptimor

Rreth viteve '30 të shekullit të shkuar, u hodh ideja e zbërthimit dhe analizës sipas tipareve dalluese semantike, të cilat njihen si "*njësitë më të vogla të përmbajtjes kuptimore*". Në këtë periudhë, gjuhëtarët filluan të analizojnë kuptimin, duke e ndarë në njësi më të vogla të përmbajtjes, të cilat njihen si *sema* (nga greqishtja e vjetër do të thotë *shenjë*)[180]. Memushaj shton, se *tiparet semantike realizojnë kundërvënien e kuptimeve të fjalëve, duke evidentuar tiparet dalluese brenda një çifti antonimesh*.[181]

Ishin Kratz dhe Fodor,[182] ata që hodhën idenë e analizës së përbërësve kuptimorë. Ata e realizuan këtë përmes parimeve të dykuptimsisë, perifrazimit, dhe anomalisë. Gjithashtu, ata dalluan përbërësit "*shënues*" (*markers*) dhe "*tiparet dalluese*" (*distinguishers*). Kjo teori pati vështirësi në praktikë, pasi dallimi midis "*tipareve shënuese*" dhe "*tipareve dalluese*" nuk ishte i qartë. Edhe pas përmirësimeve të kësaj analize, vështirësia qendron tek numri i "tipareve shënuese", i cili mund të jetë shumë i madh dhe e vështirëson analizën. Të analizosh përbërësit kuptimorë tek emrat antonimë është më e thjeshtë, pasi kemi të bëjmë me tipare të qarta fizike, të cilat janë edhe universale. Ndërkohë, te kategoritë e tjera nuk është aq e lehtë, pasi, për shembull, folje të tilla si "*come/go*", "*bring/take*" nuk kanë tipare fizike universale. Në përgjithësi, përbërësit kuptimorë në analizë trajtohen në formën e "*kundërvënies binare*", të ngjashme me natyrën e antonimeve plotësuese.

Palmer, në lidhje me përbërësit kuptimorë, shprehet: "*Ashtu si tiparet dalluese të fonemave realizojnë kundërvënien midis vetë fonemave, edhe tiparet semantike të fjalëve*

[175]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[176]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[177]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[178]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[179]H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.119.
[180]R. Memushaj (2006) Hyrje në gjuhësi, Botimet Toena, f.150.
[181]R. Memushaj (2006) Hyrje në gjuhësi, Botimet Toena, f.150.
[182]J. Katz, J. A. Fodor (1964) The Structure of Semantic Theory, North Holland Publishing Co. Smith, MD, f.480.

realizojnë kundërvënien e kuptimeve të tyre. Kështu, kuptimi i fjalës shihet si shumë e semave, të cilat përbëjnë inventarë të mbyllur, ato kanë natyrë binare dhe janë të njëkohshëm, ashtu si tiparet dalluese të fonemave". [183]

Analiza e strukturës kuptimore të fjalës përbën një nga objektet kryesore të semasiologjisë. Strukturalistët janë ata që kanë dhënë një kontribut të veçantë në analizat me bazë leksemën, sememën etj., përmes metodave të ndryshme, si ajo e shpërndarjes, ajo e analizës së tipareve dalluese etj. Ishte De Saussure, ai që e vuri fjalën në qendër të boshtit sintagmatik (sintaksa, morfologjia, morfosintaksa) dhe atij paradigmatik (leksikologjia).

Ka disa modele të analizave semantike përmes tipareve binare apo kolonave, të cilat tregojnë njëkohshmërinë e këtyre përbërësve sipas skemës së drurit. Gjenerativistët e përdorën analizën e përbërësve kuptimorë, por ata shtuan edhe disa tipare gramatikore apo sintaksore.[184]

Qëllimi është që të arrihet analiza e kuptimit të një numri të madh fjalësh përmes një minimumi tiparesh. Chomsky përdori skemën e pemës së përmbysur për të analizuar përbërësit kuptimorë. Në përgjithësi, analiza e përbërësve kuptimorë paraqet një përpjekje të rëndësishme për të analizuar kuptimin e fjalëve në kundërvënie binare, por praktikisht për shkak të numrit të madh të tipareve është e vështirë të zbatohet gjerësisht. Megjithatë, në lidhjet semantike të ngushta, siç është antonimia, kjo analizë është vlerësuar si e vlefshme dhe e dobishme. M.Samara thekson, se "*antonimet ndihmojnë edhe në shpjegimin semantik të përbërësve kuptimorë të fjalëve në fjalorë, pasi elementet e çiftit antonimik janë ngushtësisht të lidhur, sa edhe kuptimi i secilës prej tyre qartësohet nga kundërvënia e gjymtyrës*".[185]

Sipas J. Thomait: "*dallimet janë tipare jo të njëjta tek gjymtyrët në opozicion, kurse boshtet semantike janë tipare të njëjta për të dyja gjymtyrët, sipas të cilave ndërtohen dallimet*".[186] Jakobson i quan këto "*tipare dalluese*", ndërsa De Saussure "*elemente dalluese*". Greimas i quan "*sema*". Jakobson ishte ai që njihet si babai i binaritetit në gjuhë. Ai e zbërthen boshtin në dy sema. Në kundërvënie mund të kemi opozicion të tiparit semik me mungesën e tij, ose opozicion të dy tipareve dalluese.

Në kontekstin e përbërësve kuptimorë, antonimet ndajnë pothuajse të gjitha *tiparet semantike* përveç njërit. Tipari të cilin ato nuk e ndajnë ndodhet në njërën nga gjymtyrët e çiftit dhe mungon në gjymtyrën tjetër".[187] Për ta ilustruar na ndihmon *analiza e përbërësve* si më poshtë[188]:

$$\left\{\begin{array}{c} \text{GIRL} \\ +\text{animate} \\ +\text{human} \\ +\text{female} \\ +\text{young} \\ -\text{adult} \end{array}\right\}$$

[183] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.145.
[184] N. Chomsky (1957) Syntactic Structures the Hague/Paris: Mouton, cituar nga F. R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 145.
[185] M. Samara (1993) Rreth Sintagmatikës së Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike.
[186] J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, Botimet Toena, f.43.
[187] V. Fromkin, Richard Rodman (1998) An introduction to Language, Longman Publishers, f.83.
[188] Analiza e shkëputur nga F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f.147.



Figura 3 Analiza e përbërësve kuptimorë

Nga paraqitja skematike e mësipërme dallohet qartë se tek fjala "*girl*"(vajzë) mungon tipari "*adult*"(e rritur) tipar ky që gjendet tek "*woman*"(grua). Pra, kjo analizë është tepër praktike dhe ndihmon në evidentimin e tipareve dalluese ndërmjet gjymtyrëve të çiftit antonimik.

Por, nga ana tjetër, analiza në përbërës ka një sërë mangësish, që e bëjnë të pamundur përdorimin e saj në analizën e të gjithë leksikut të një gjuhe. Nëse njësitë leksikore zakonisht bëjnë kombinime me fjalë të caktuara, *fjalët e përbëra* jo vetëm që mund të gjenden në fjalorë, por janë edhe objekt studimi. Me gjithë rolin e analizës së përbërësve të kuptimit në gjuhë, J. Thomai thekson, se "*përbërësit kuptimorë janë njësi të thjeshta të pavetëmjaftueshme e si të tillë nuk mund të merren si njësi themelore të semantikës*".[189]

Si përfundim, mund të themi se kjo analizë ka vlerat e saj në analizën e marrëdhënieve semantike, por nuk mund të aplikohet njësoj për të gjitha dhe paraqet probleme praktike.

1.3.7 Kuptimi gramatikor

Fjala është një nga njësitë themelore të semantikës, por jo të gjitha fjalët kanë të njëjtin kuptim. Gramaticieni Henry Sweet[190] bën dallimin midis atyre që quhen *fjalë të plota* dhe *fjalë-formë*. Vetëm fjalët e plota kanë kuptim në këndvështrimin semantik. Për sa i përket fjalë-formës, ajo ka kuptim, por josemantik. Ajo ka *kuptim gramatikor*, të cilin e shprehin vetëm në lidhje me fjalët e tjera brenda frazës apo fjalisë. Pra, kuptimi i tyre bëhet i qartë vetëm në përdorim. Për më shumë, nuk është e përcaktuar qartë ajo çka ne dallojmë si fjalë, pasi në disa gjuhë ajo është e dallueshme përmes hapësirave ndarëse me fjalët e tjera, por në gjuhë të tilla, si arabishtja kjo nuk është e mundur.

Duke krahasuar kuptimin leksikor dhe atë gramatikor, mund të themi se "*kuptimi leksikor është konkret, individual dhe ndonjëherë është quajtur kuptimi material i fjalës, ndërsa kuptimi gramatikor është më shumë abstrakt dhe i përgjithësuar*".[191]

1.4 Lidhjet paradigmatike dhe sintagmatike

Natyra e lidhjeve paradigmatike dhe sintagmatike do të jetë me interes në këtë studim, pasi ato qendrojnë në themel të analizave gjuhësore për antonimet si në gjuhën

[189] V. Fromkin, R. Rodman (1998) An introduction to language, Longman Publishers, f.85.
[190] H. Sweet (1900) A new English grammar, logical and historical Oxford, Clarendon Press, f.14.
[191] I. Stefanllari (2011) A Course in English Lexicology, GEER, f.3.

shqipe edhe në atë angleze. Sipas R. Memushajt: "*marrëdhëniet midis dy a më shumë njësive që ndjekin njëra–tjetrën në rrjedhën e ligjërimit quhen lidhje sintagmatike,*"[192] kurse njësitë që hyjnë në lidhje të tilla formojnë një sintagmë. [193] Ai shton se "*marrëdhëniet midis njësish që mund t'i zënë vendin njëra-tjetrës në të njëjtën pikë të rrjedhës së të folurit quhen lidhje paragmatike"*[194], kurse njësitë që hyjnë në lidhje të tilla formojnë një *paradigëm.*[195]

Lidhjet sintagmatike dhe paradigmatike dallohen në të gjitha rrafshet e gjuhës dhe funksionojnë në formën e një tërësie rregullash, të cilat përbëjnë sintagmatikën dhe paradigmatikën e një rrafshi të caktuar.

Përbërësit e sintagmës krijojnë lidhje kundërshtie, ndërsa ato të paradigmës krijojnë lidhje kundërvënieje me njëra-tjetrën. Raportet sintagmatike janë lineare, të tipit "e*dhe …edhe*", ndërkohë që vetëm njëra nga gjymtyrët e paradigmës përdoret në ligjërim dhe kjo lidhje njihet si lidhja "*ose…ose*". [196]

Lidhjet paradigmatike në mënyrë tradicionale janë cilësuar si mënyra e vetme e studimit të antonimeve në gjuhë. Theksojmë se antonimia konsiderohet një marrëdhënie kuptimore me *natyrë paradigmatike,* për arsye se ka të bëjë me një zgjedhje midis fjalëve, apo zëvendësimin e një fjale me një tjetër në një kontekst të caktuar. Por, nga ana tjetër, edhe lidhjet në rrafshin sintagmatik janë thelbësore në analizat e raportit dhe shkallës së antonimisë së fjalëve, pasi ato mundësojnë studimin e tyre në kontekstin real, në përdorim, brenda fjalisë. Sipas J. Thomait, "*lidhjet sintagmaike të fjalëve janë pasqyrë e lidhjeve logjike dhe shprehen gjuhësisht me lidhjet ndërmjet emërtimeve përkatëse*".[197] Në gjuhën shqipe ai dallon dy lloje lidhjesh të tilla:

- *lidhje të drejtpërdrejta, të nënshtrimit;*

- *lidhje të tërthorta, të barazisë;*

Si rezultat, R.Memushaj [198] thekson, se struktura kuptimore e fjalëve duhet analizuar sipas dy rrafsheve:

- sipas boshtit paradigmatik, nëpërmjet të cilit zbulohen lidhjet e zëvendësimit midis fjalëve në një thënie.

- sipas boshtit sintagmatik, që lejon të shtrihen kombinimet e mundshme të kuptimeve të fjalës". Kuptimi i një fjale ka disa aspekte.

Në lidhje me zgjerimin e qasjes nga ana paradigmatike në atë sintagmatike në literaturën e huaj, me interes për studimin tonë krahasimor, asaj të gjuhës angleze, ku dallojmë studiues si Murphy i cili u përqendrua tek lidhjet e antonimeve brenda kontekstit. Kjo tendencë e gjuhëtarëve justifikohet me faktin se jo rrallë në ligjërimin e

[192]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.158.
[193] Nga greqishthja e vjetër *syntagma* – do të thotë bashkërenditje
[194]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi , Botimet Toena, f.159.
[195] Nga greqishtja e vjeter *paradigma* – do të thotë model, sistem
[196]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.161.
[197]J. Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, f.215.
[198]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.161.

shkruar dhe të folur ndeshim çifte antonimike brenda të njëjtës fjali.[199] Shembuj të tillë janë shprehjet e mëposhtme:[200]

The long and the short of it is that they are willing to start the work in January.
(Me një fjalë, ata kanë dëshirë të fillojnë punë në janar.)

Shprehja "the *long* and the *short* of it" në fjalinë e mësipërme përdoret kur shpjegojmë dhe përshkruajmë një situatë në mënyrë të përgjithshme, pa dhënë detaje.

Një tjetër rast kur vërejmë bashkrenditjen e çiftit antonik është shembulli për qëllime të theksimit, si në shembujt e mëposhtëm:

"It was a remark made in *private***,** not in *public*"
(*Ishte një koment i bërë në mënyrë private, jopublike*.)

Antonimet përdoren në çift brenda së njëjtës fjali, edhe kur referenca ka të bëjë me një gjendje të ndryshuar.

"The museum opens at 9 and closes at 4"
(Muzeu hapet në orën 9 dhe mbyllet në orën 4.)

Qasjen sintagmatike ndaj antonimisë e vërejmë edhe në studimet e gjuhës shqipe, konkretisht te zhvillimi dhe thellimi i punës studimore kërkimore tek i njëjti gjuhëtar, siç është rasti i M. Samarës, i cili në punimete tij të hershme e cilësonte antoniminë si një marrëdhënie krejtësisht në rrafshin paradigmatik. Ndërkohë, në vazhdimësi të studimeve të tij në këtë fushë gjejmë edhe qasje në këndvështrimin sintagmatik.

Po kështu, edhe I. Goçi, gjatë studimeve të tij të thelluara për antoniminë, shprehet se ka lindur nevoja që çifti antonimik të shihet edhe më i zgjeruar, dhe këtu ai përmend "*tufën antonimike*", e cila del e qartë jo vetëm në lidhjet paradigmatike, siç e ka treguar tradita e studimeve në këtë fushë, por "*edhe në shkallë sintagmatike apo frazeologjike, që paraqet interes të veçantë për studime nga aspekti sintaksor e sintagmatik*".[201] Ai e ilustron më tej këtë ide përmes shembujve "*i bardhë*", "*i bardhë/i zi*", "*fatbardhë/fatzi",* "*e ka fatin e bardhë/e ka fatin e zi*". Nga këta shembuj duket qartë edhe procesi i evoluimit të shkallëzimit nga fjala si gjymtyrë e vetme në izolim, në lidhjet kuptimore përmes çiftit antonimik, më pas në kompozitë e duke përfunduar në përdorime frazeologjike. I. Goçi e lidh ngushtë rrafshin sintagmatik me frazeologjinë si një nga proceset e zhvillimit të studimeve të lidhjeve kuptimore.

Xh. Lloshi në lidhje me sintagmatikën e antonimeve shton "fjalët antonime në rrafshin sintagmatik dalin sëbashku në role të ndryshme leksikore duke formuar togje të tipit "*merr e jep",* "*hyr e dil",* etj.".[202] Kjo ka efekt shprehës përmes ndërtimit sintaksor të një situate kontekstuale të kundërvënies, etj.

M. Çeliku[203] dallon gjymtyrët homogjene me raport kundërshtor, me strukturë të mbyllur dygjymtyrëshe. Gjymtyrët janë në raport kundërshtor, ku dallohen disa lloje

[199] C. Fellbaum (1995) Co-occurrence and Antonymy.International Journal of Lexicography, f.281–303.
[200] Shembuj të shkëputur nga S. Jones (2002) Antonymy: a Corpus-based Perspective. London: Routledge, f.67.
[201] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituri Albanogjik i Prishtinës, f.18.
[202] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.124.
[203] M. Çeliku (2012) Sintaksë e Gjuhës Shqipe, Tiranë , f. 232.

semantike: me raport kundërshtor, marrëdhënie përqasore, kundërvënie, mospajtim, kundërshore të mirëfillta, kundërshtore kufizuese, përmbyllëse, përjashtuese, etj. Këto gjymtyrë lidhen me lidhëzat bashkërenditëse *po, por, mirëpo, porse, kurse, ndërsa, megjithatë, veç, veçse, vetëm se, pa*. Çeliku e ilustron këtë raport mes antonimeve sipas shembujve të mëposhtëm:

Mësuesja ishte veshur ***thjesht***, *por* ***bukur***.

Në mbrëmje ***punonte***, *ndërsa* në mëngjes ***pushonte***.

Sipas M. Samarës, "*studimi në rrafshin sintagmatik ka si qëllim qartësimin e shkallës së kundërvënies dhe dallimin e tipave kryesore të antonimeve në gjuhën shqipe".*[204] Lidhjet sintagmatike, shprehet ai, kufizohen nga:

1. tipologjia dhe struktura sintaksore e një gjuhe
2. situata ligjërimore
3. nga struktura e kuptimeve leksikore
4. vlerat stilistike apo konotacioni i fjalëve.

Dallojmë dy tipe kryesore të lidhjeve sintagmatike:

1. lidhje me bashkërenditje

2. lidhje me nënrenditje.

M. Samara përqendrohet në lidhjet me bashkërenditje, të cilat përfshijnë disa nëntipe:

1. Lidhje bashkërenditëse të fjalëve antonime me lidhëza këpujë (*e, edhe*). Në frazat dygjymtyrëshe, kjo paraqitet me skemën e lidhjes "A *e /dhe* B". Në këtë rast, lidhja mund të jetë e drejtpërdrejtë, ose jo e drejtpërdrejtë (kanë ndërmjet tyre gjymtyrë të tjera. Konteksti i lidhjeve sinagmatike identifikon më mirë kundërvënien, duke i ardhur në ndihmë paradigmatikës së fjalëve antonime. Mund të mungojnë lidhëzat *e, edhe*, dhe në mënyrë asintetike mund të përdoret presja, si p.sh., në rastin "jep me dorë, merr me këmbë".

2. Lidhje me bashkërenditje me lidhëzën *as,* p.sh., "*nuk jam as optimist, as pesimist"* (F.Noli) Skema "as A as B", ku lidhëza *as,* ka rolin përforcues të kundërvënies.

3. Lidhjet bashkërenditëse me lidhëzat *ose, a, apo*, me funksion veçues (*A shkon, a vjen, është puna jote*.). Skema paraqitet si: "*ose/a/apo A ose/a/apo B*".

4. Bashkërenditje përmes lidhëzave kundërshtore *kurse, ndërsa, por*. Skema "A *kurse/ por* B". Nëntipi i katërt ka shkallën e kundërvënies më të lartë dhe nëntipi i parë më të ulët.

Në këtë mënyrë mund të krijohen edhe togfjalësha të qendrueshëm frazeologjik, sidomos me tipin 1 dhe 3, p.sh., "*çel e mbyll", "vej e vjen",* etj. Pra, në bashkërenditje sintaktike përmes lidhëzave *e, edhe, ose, as..as* etj., formohen togfjalësha frazeologjikë ashtu si dhe çifte antonimike brenda tyre të tipit "*merr e jep"*, "*fund e krye",* etj. Të tilla bashkërenditje e kanë humbur antoniminë mes tyre, duke formuar një fjalë të re me një

[204] M. Samara (1993) Rreth Sintagmatikës së Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike.

unitet kuptimor, siç ishte "*jep e merr"* në kuptimin "*lëviz"*, apo "*fund e krye"*, në kuptimin "*krejtësisht"*.

Ndonjëherë analizat semantike të çifeve antonime dhe përcaktimi i tyre brenda një kategorie apo një tjetre, është i lidhur ngushtë me qasjen ndaj analizës në rrafshin paradigmatik apo sintagmatik. Në këtë këndvështrim, nuk mund të futen në tipin e antonimeve të mirëfillta, çifti "*bir/bijë", "burrë/grua"*ose "*studenti/studentja",* të cilat megjithëse mund të përdoren si antonime në rrafsh sintagmatik, në rrafshin paradigmatik ato mund të kundërvihen vetëm nga ana e përbërësit të *seksit a gjinisë,* dhe si rezultat vështirë të quhen antonime.[205]

[205] M. Samara (1993) Rreth Sintagmatikës të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike.

KREUII

2. ANTONIMET NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

2.1 Rreth historikut, terminologjisë, përkufizimit dhe burimeve të antonimisë në gjuhën shqipe dhe angleze

2.1.1 Historiku

Problemet e lidhura me natyrën e antonimisë janë të dukshme në gjuhën angleze si dhe në gjuhën shqipe. Tipare të tilla, si ndërtimi i tyre ontologjik, simetria e antonimeve në lidhje me kufirin ndërmjet strukturave kuptimore, përdorimi kontekstual, si edhe frekuenca janë përcaktuese në formimin e çifteve tradicionale të antonimeve leksiko-semantike.

Kryesisht, përkufizimet dallohen mes tyre për nga *burimi*, pra nëse kanë natyrë e burim fushat e gjuhësisë, si: semantika, psikolinguistika, logjikën, filozofinë, etj. Kjo për shkak, se sfera të ndryshme e shohin ndryshe kundërvënien si nocion dhe, si rrjedhim, edhe konkluzionet e tyre janë të dallueshme dhe të ndryshme. Ne do të përqendrohemi pikërisht te studimet me natyrë gjuhësore mbi antoniminë dhe, siç do shihet me poshtë, edhe në problematikat që lindin në këtë fushë studimi gjatë trajtimit të antonimisë si fenomen gjuhësor. Problemi kryesor rrjedh nga kompleksiteti që ekziston në vetë natyrën e kundërvënies gjuhësore në qasje me realitetin. Nisur nga etimologjia me fjalën " *antonim*" nga greqishtja *anti-* që do të thotë *kundër-* dhe *–onoma* që do të thotë *–emër,* pra fjalë me kuptim të kundërt.

Në *gjuhën angleze*, fjala "antonimi" u përdor në vitin 1867, nga C.J.Smith, si e kundërta e fjalës "sinonimi". Në vazhdim të këtij mendimi, edhe disa gjuhëtarë të tjerë mendojnë se antonimia është e kundërta e sinonimisë. Nëse do të pranohej kjo ide, atëherë fakti se sinonimet janë fjalë me ngjashmëri, nënkupton se antonimet janë fjalë që këto ngjashmëri i kanë dallime. Kjo nuk mund të pranohet pasi "*një marrëdhënie kundërvënieje semantike qendron mes fjalësh, të cilat kanë të njëjtat tipare, përveç kuptimit/ve*".[206] Megjithatë, edhe kjo teori marrëdhëniesh kundërvënëse nuk është e saktë për përcaktimin e asaj që ne quajmë antonimi, pasi sipas këtij përkufizimi, aty përfshihen edhe homonimet. Lyons thekson, se "*kundërvëniet formohen përgjatë dimensionit të ngjashmërisë*".[207] Pra, themi se antonimet ndërtohen në bazë të ngjashmërisë semantike të gjymtyrëve të një çifti.

Në lidhje me terminologjinë në gjuhën angleze dallojmë, se ndryshe nga pjesa dërrmuese e gjuhëtarëve, të cilët përdorin termin antonimi, Murphy përdor termin "*kundërshti leksikore"* për shkak të teorisë së tij të *Marrëdhënies Përmes Kundërshtisë*. Termi "*antonim"* që Cruse përdor i referohet kuptimit të kufizuar të përcaktuar nga Lyons, i cili e dallon antonimin nga koncepti i përfshirjes i të gjitha llojeve të të kundërtave leksikore. Në këtë këndvështrim disa studiues, si Lyons, Cruse, Palmer, etj., e përdorin termin "*antonim"* në kuptim të ngushtuar vetëm për t'iu referuar antonimeve të shkallëzueshme, ndërkohë që për çiftet e tjera në raport kundërvënieje përdorin termin "*të kundërta*". Shpesh, termi "*antonimi"* mendohet, se mund të jetë i njëjti term gjuhësor me termin "*e kundërt",* ashtu sikurse dhe termi *"parentheses"* është teknikisht i njëjti emër

[206] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Cambridge University Press, f.195.
[207]J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f.286.

me*"brackets*". Lyons dhe pasuesit e tij e trajtojnë në mënyrë kritike këtë kundërvënie terminologjike, e cila, sipas tyre, mund të sjellë edhe interpretime të gabuara në grupimet e fjalëve antonimike, apo të kundërta. Këtë çështje e kanë analizuar Lyons[208] dhe Cruse[209] në vëzhgimet që u kanë bërë çifteve antonimike të tipit "*new/old*" (*e re/e vjetër*) apo "*slow/fast*" (i ngadaltë/i shpejtë) duke i krahasuar me çifte të tipit "*dead/alive*" (i gjallë/i vdekur), "*true/false*" (i vërtetë/i gabuar), "*female/male*" (femër/mashkull). Ata argumentojnë se çiftet e tipit të parë janë antonimike, për arsye se janë të shkallëzuara (gradable), ndërkohë që ata mendojnë, se çiftet e grupit të dytë nuk janë të shkallëzuara (nongradable) dhe si pasojë joantonimike. Për sa i përket grupit të dytë, ata mendojnë, se në ato shembuj kemi të bëjmë me "opposites", pra të kundërta, joantonime.

Për më shumë, në lidhje me terminologjinë, Paradis dhe Willners përdorin termin "*form-meaning pairings*" (çifte "formë-kuptim") në studimin e tyre për antonimet. Ata pohojnë se çiftet "*formë-kuptim*" janë antonime atëherë kur përdoren si kundërvënie binare"[210], duke e parë si një strukturë ku përmbajtja ndahet nga një kufi. Kjo është e rëndësishme që kuptimi të përdoret si antonim. Ata theksojnë se "*të gjitha gjymtyrët antonime kanë të njëjtin status dhe kategorizimi sipas kuptimit formon një vazhdimësi, i cili ndryshon nga çifte të lidhura ngushtë, të cilat njihen si gjymtyrët bërthamëtek çiftet e rastit në periferi*".[211]

Në mënyrë tradicionale, antonimet janë përkufizuar si "*fjalë me kuptim të kundërt*", por ky përkufizim nuk është i mjaftueshëm, prandaj lind nevoja për një përkufizim më të zgjeruar, në mënyrë të tillë që të dallohen se cilat fjalë kanë kuptim të kundërt. Në këtë qasje, ne do të japim përkufizimin e Paradis për antonimet: "*antonimet janë dy ose më shumë fjalë të së njëjtës gjuhë, të cilat i përkasin të njëjtës pjesë të ligjëratës dhe të njëjtës fushë semantike, identike në stilin e përdorimit dhe pothuajse identike në përhapje, të cilat shpesh shoqërohen apo përdoren së bashku në mënyrë të tillë, që kuptimet e tyre denotative rezultojnë në nocione kontradiktore apo të kundërta*"[212]. Me nocion kontradiktor do të kuptojmë, fjalë të cilat i kundërvihen njëra-tjetrës dhe mohojnë njëra-tjetrën, si në shembujt: "*i gjallë*" që do të thotë "*jo i vdekur*" apo "*i paduruar*" që nënkupton "*jo i duruar*". Nocionet e kundërta i kundërvihen njëra-tjetrës. Megjithatë, nocionet kontradiktore ndonjëherë mund të jenë të shkallëzuara, si p.sh.: "*hot/warm/cool/cold*"*(i nxehtë/i ngrohtë/i freskët/i ftohtë*). Për këtë arsye themi, se dallimi midis këtyre dy nocioneve nuk është absolut sikundër del në shembullin: "*One is more dead than alive"* (*Dikush është më shumë i vdekur sesa i gjallë*).

Problemi me përkufizimin qendron edhe në faktin se është e vështirë të përshkruash atë që lehtësisht ilustrohet me shembuj, si e tillë, është e vështirë të gjesh një përkufizim që vlen për çdo shembull të antonimisë. Është më se e dukshme se studimet e

[208]J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f. 189.
[209] D. A. Cruse (1986) Lexical semantics. Cambridge: Cambridge University Press. (1992) Antonymy Revisited: Some Thoughts on the Relationship Between Words and Concepts, f. 197 .
[210] C. Paradis, C. Willners, S. Löhndorf, M.L. Murphy (2006) 'Quantifying Aspects of Antonym Canonicity in English And Swedish: Textual and Experimental', prezantuar në Quantitative Investigations in Theoretical Linguistics 2, f.29.
[211] C. Paradis, C. Willners, S. Löhndorf , M.L. Murphy (2006) 'Quantifying Aspects of Antonym Canonicity in English And Swedish: Textual and Experimental', prezantuar në Quantitative Investigations in Theoretical Linguistics 2, f.31.
[212] C. Paradis, C. Willners, S. Löhndorf , M.L. Murphy (2006) 'Quantifying Aspects of Antonym Canonicity in English and Swedish: Textual and Experimental', prezantuar në Quantitative Investigations in Theoretical Linguistics 2, f.31.

hershme të antonimisë janë parë në dritën e parimeve dhe konkluzioneve logjike, shumë cekët nga ana gjuhësore. Është më i vonshëm trajtimi teorik e shkencor i antonimisë me drejtim kryesisht gjuhësor. Për sa i përket *gjuhës shqipe,* mund të themi se studimet në këtë fushë kanë filluar e po vazhojnë, duke na lehtësuar dhe bërë të mundur studimet krahasimore ndërgjuhësore.Në hulumtimet në gjuhën shqipe kemi vënë re faktin, se studiuesit e kësaj fushe janë rishprehur për problematika të ndryshme, duke korrigjuar dhe rivlerësuar disa nga karakteristikat kryesore të antonimisë në dritën e zhvillimit gjuhësor dhe nën ndikimi e studimeve në gjuhë të tjera. Disa nga studiuesit me kontribut të vyer në antoniminë e gjuhës shqipe janë: J. Thomai, M. Samara, I. Goçi etj. Me të drejtë J. Thomai thekson, "*derisa të ketë kundërthënie në natyrë, gjithnjë do të ketë antonime dhe në gjuhë*".[213] Në lidhje me përkufizimin e antonimisë e të nocioneve të lidhura ngushtë me të, vërejmë se ka debat të shtrirë në kohë në lidhje me atë çka ne quajmë *antonim, çift antonimik, kundërvënie, kundërthënie, kundërshti, opozicion, shkallëzim i kundërvënies, motivim*,etj.

M. Samara jep këtë përkufizim: "*Antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt, të cilat së pari pohojnë veten, pastaj mohojnë fjalën e kundërt*".[214] Në mënyrë të ngjashme I. Goçi, jep këtë përkufizim: "*Antonimet janë çifte fjalësh dhe kuptime të kundërvëna midis tyre, të cilat, duke plotësuar kuptimin e njëra-tjetrës, nëpërmjet kësaj kundërvënieje, ata së pari e pohojnë veten, pastaj e mohojnë njëra-tjetrën"*[215]Megjithatë, nuk analizohet rëndësia e përdorimit të fjalëve antonimike në rrethana e kontekste gjuhësore e jashtëgjuhësore. Ndërveprimi dhe lidhja e ngushtë me gjymtyrën antonimike gjegjëse është vlerësuar si tipar i rëndësishëm për antoniminë nga pasues të Samarës. Kështu, I. Goçi thekson faktin, se "*pa marrë parasysh a është fjala antonimike vetëm a përballë tjetrës që i kundërvihet, ajo është çift, sepse tjetra, edhe pse nuk është e pranishme, nënkuptohet nëpërmjet asosacionesh psikolinguistike në ndërgjegjen e folësit.*"[216] Kështu, sa herë që dëgjojmë fjalën "*hap*", na vjen në mendje fjala "*mbyll*, etj. Në këtë mënyrë theksojmë, se antonimet janë çifte fjalësh të kundërvëna.

Po kështu, I. Goçi shton, se vlen të bëhet edhe dallimi midis kuptimit dhe konceptit, pasi siç pohon ai, "*raportet e kundërvëna janë semantike e jokonceptuale. Kemi raporte kuptimesh e jo konceptesh, të cilat i studion logjika.*"[217] I. Goçi jep një përkufizim të zgjeruar të antonimeve: "*Meqenëse fjala është njësia themelore e gjuhës dhe shpreh kuptimin e sendeve dhe të fenomeneve të realitetit objektiv dhe subjektiv, antonimia shpreh kundërvënie kuptimore sendesh dhe fenomenesh, kushtëzuar nga rrethana të ndryshme të emërtimit e të veprimit, nga pozita subjektive, që shprehet me mjete leksikore e fjalëformuese*."[218] J. Thomai shprehet, se "*kundërvëniet e kuptimeve u përgjigjen kundërvënieve të nocioneve mbi sendet dhe dukuritë e realitetit*".[219] Pra, realiteti luan një rol të rëndësishëm, por jo të mjaftueshëm, e të izoluar nga qendrimi subjektiv i folësit ndaj realitetit.

[213] J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.61.
[214] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.144.
[215] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.12.
[216] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.11.
[217] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 11.
[218] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 33.
[219] J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f. 57-63.

Jones thekson: "*Kundërvënia ndikon në mënyrën e të menduarit dhe komunikimit në një masë domethënëse, dhe kjo dëshmohet nga përdorimi i gjerë i antonimisë*".[220] R. Memushaj ndan mendimin, se "*përmes antonimisë pasqyrohet realiteti përmes çifteve të koncepteve të kundërta*".[221] Gjymtyrët e një çifti antonimesh kanë një bërthamë semantike të përbashkët, prandaj e nënkuptojnë njëra-tjetrën, por nga ana tjetër kësaj bërthame i shtohen edhe tiparet semantike të kundërta.

2.2 Përkufizimi i antonimeve, sipas kritereve të ndryshme

Në një këndvështrim të përgjithshëm dallojmë dy mënyra përkufizimi të antonimisë: së pari, ai që përfshin *kriterin semantik* dhe, së dyti, ai që përfshin *kriterin leksikor*. Me zhvillimet e fundit në fushën e gjuhësisë, dallojmë edhe kriterin e *konfigurimit të përmbajtjes,* si një tjetër kriter të rëndësishëm në përcaktimin e antonimeve.

2.2.1 Kriteri semantik

Në gjuhën shqipe, M. Samara e përcakton antoniminë "*si kategori gjuhësore dhe shprehje e marrëdhënieve e raporteve të kundërvënies midis kuptimeve a varienteve leksiko-semantike të fjalëve, ose togfjalëshave të qendrueshëm* ".[222] Sipas fjalorit Longman, antonimia përkufizohet "*si një fjalë e cila është e kundërt në kuptim me një fjalë tjetër*".[223] Në mënyrë të ngjashme, fjalori i gjuhësisë dhe fonetikës, Crystal, e përcakton antoniminë: "*Antonimia në kuptimimin e saj më të gjerë pasqyron në mënyrë kolektive të gjitha llojet e kundërvënieve semantike*".[224] Këto përkufizime pasqyrojnë *kriterin semantik,*dhe si rrjedhojë antonimia përkufizohet thjesht si "*kundërvënie e kuptimit*". Por ky lloj përkufizimi nuk arrin të shpjegojë tendencën e disa fjalëve për t'u përfshirë në kundërvënie, ndërkohë që disa të tjera nuk e kanë. Antonimet janë fjalë semantikisht të kundërvëna, por jo të gjitha fjalët kanë kundërvënie. Nga këtu rrjedh dhe mendimi se "*antonimet janë fjalë me kundërvënie semantike, por, jo të gjitha fjalët që kanë kundërvënie semantike janë antonime*".[225] Cruse jep shembuj të këtij rasti me fjalët "*tubby*" (i mbushur) dhe "*emaciated*" (i dobsuar). Ai thekson se nuk ka diskutim për faktin se këto dy fjalë janë të kundërta në kuptim më njëra-tjetrën, por ai e sheh të vështirë që një folës amëtar i gjuhës angleze t'i konsiderojëato si të kundërta.

Sipas S.Jones[226] ekzistojnë tri tipe kryesore antonimesh në bazë të *kriterit semantik:*

- Antonime *plotësuese ose kontradiktor*e, të cilat janë çifte fjalësh, me të cilat një gjymtyrë ka një tipar semantik të caktuar, të cilin gjymtyra tjetër nuk e ka. Kështu që në kontekstet në të cilat njëra prej këtyre gjymtyrëve është e vërtetë gjymtyra tjetër nuk mund të jetë e vërtetë, p.sh., "*male/female"* (mashkullor/femërore), "*married/unmarried"* (i martuar/i pamartuar), "*complete/incomplete"* (i plotë/i paplotë), "*alive/dead*" (i gjallë/i vdekur), "*present/absent"* (i pranishëm/i

[220] S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f. 125.
[221] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.171.
[222] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.145.
[223] Longman Dictionary of Applied Linguistics, Richards, Platt, Weber (1985) f.14.
[224] Dictionary of Linguistics and Phonetics (1985) f.18.
[225] D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f. 262.
[226] S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f.126.

muguar), "*awake/asleep"* (i zgjuar/i përgjumur) etj. Kundërvënia e këtyre është e tipit "*ose…ose*", ku nuk ekziston një vijë e mesme apo një gjymtyrë e vetme.

- *Antonimet marrëdhëniore* janë çifte fjalësh, në të cilat prania e një tipari semantik të caktuar në një nga gjymtyrët nënkupton praninë e një tjetër tipari semantik në gjymtyrën tjetër. Thënë ndryshe, ekzistenca e një prej gjymtyrëve nënkupton ekzistencën e gjymtyrës tjetër, p.sh., "*buy/sell"* (blej/shes), "*stop/go"* (ndal/iki), etj., si edhe disa mbiemra në formë krahasore të tipit "*taller/shorter"* (më gjatë/më shkurtër),"*cheaper/more expensive"*(më e lirë/më e shtrenjtë), etj.

- *Antonimet e shkallëzuara* janë ato çifte fjalësh, të cilat kundërvihen në lidhje me masën e zotërimit të një tipari semantik të caktuar. Secila gjymtyrë përfaqëson një pikë ekstreme në një bosht, i cili përfaqëson një dimension të caktuar, si p.sh: masa, temperatura, përmasa, lartësia, etj. Ndërmjet këtyre dy skajeve ekstreme ndodhen edhe pika të tjera të ndërmjetme,[227]si p.sh: "*hot/cold*" (i nxehtë/i ftohtë), "*big/small*" (i madh/i vogël), "*tall/short*" (i gjatë/i shkurtër), "*good/bad*" (i mirë/i keq), "*strong/weak*" (i fortë/i dobët), "*beautiful/ugly*" (e bukur/e shëmtuar), "*happy/sad*" (i lumtur/i trishtuar), "*fast/slow*" (i shpejtë/i ngadaltë), etj.

2.2.2 Përkufizimi sipas kriterit leksikor

Një tjetër lloj përkufizimi në lidhje më termin *antonimi* është ai që bazohet në marrëdhëniet leksikore. Janë pikërisht gjuhëtarët Justeson dhe Katz, të cilët e përkufizojnë antoniminë si "*një lidhje leksikore që është specifike për fjalët, e jo për konceptet*".[228] Si provë ata marrin *boshtin e madhësisë* dhe argumentojnë se edhe pse mbiemri "*i vogël*" (small) dhe "*i vogël"* (little) janë sinonime ashtu si edhe "*i madh*" (big) dhe "*i madh*" (large) janë gjithashtu sinonime. Nisur nga këta shembuj, ata kanë vënë re, se çiftet më tipike antonimike midis këtyre fjalëve do të ishin "*large/small*" (i madh/i vogël) dhe "*big/little*" (i madh/i vogël). [229] Si kundërargument për ekzistencën e kundërshtisë leksikore në lidhje me mbiemrat e mësipërm është ai që jep Muehleisen. Ai argumenton, se "*edhe pse 'big' dhe 'large' ashtu si edhe 'little' e 'small' janë pothuajse sinonimike, kjo nuk do të thotë që ato janë identike në kuptim. Ato janë sinonime në këndvështrimin e të njëjtit dimension semantik, por dallohen nga fakti, se përdoren për të përcaktuar lloje të ndryshme emrash (përkatësisht të numërueshëm dhe të panumërueshëm". [230]* Më tej, ai argumenton se, "*fjalët vërtet të kundërta janë ato mbiemra, që jo vetëm përbëjnë skajet e kundërta të një dimensioni të përbashkët kuptimor, por gjithashtu përshkruajnë të njëjtin lloj emrash*".[231]

Për më shumë në lidhje me përfshirjen e kriterit semantik dhe leksikor janë Justeson dhe Katz, ata të cilët shtojnë, se "*antonimia duhet të përkufizohet sipas kritereve leksikore, ashtu edhe atyre semantike, pasi ajo është një fenoment i lidhur me fjalët dhe jo me konceptet*".

[227] J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f. 74.
[228] J. S. Justeson, S. M. Katz. (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts. Computational Linguistics, f. 138.
[229] Shënim: kjo është vënë re nga një studim të gjuhëtarëve amerikanë mbi kuartetin e fjalëve "large/small","big/little", dallim ky që në gjuhën shqipe nuk del i qartë pasi nuk dallojmë me një fomë të caktuar leksikore midis "large" dhe "big" apo" small" dhe "little".
[230] V. Muehleisen (1997) Antonymy and Semantic Range in English, f. 113.
[231] V. Muehleisen (1997) Antonymy and Semantic Range in English, f. 113.

Çka më lart, thekson edhe njëherë faktin, se antonimia duhet parë si marrëdhënie midis fjalëve, e jo si marrëdhënie midis koncepteve.

*Si përfundim***,** ne jemi të mendimit se, përkufizimi i antonimisë duhet t'u përmbahet të dyja këndvështrimeve, atij leksikor dhe atij semantik. Antonimet duhet të kenë kundërvënie kuptimore, por ato gjithashtu duhet të kenë edhe një marrëdhënie të fuqishme dhe të mire përcaktuar me njëra-tjetrën. Ato çifte fjalësh, të cilat u përmbahen të dyja këtyre kritereve, njihen si "*prototipe ose kanonike*" ndërkohë që ato tipe fjalësh të cilat, i përmbahen vetëm kriterit leksikor, njihen si "*jokanonike ose periferike*".[232]

2.2.3 Kategorizimi sipas kriterit të konfigurimit

Në studimet e fundit jotradicionale vërejmë, se kriteret e kategorizimit janë shtrirë përtej atij vetëm leksikor apo vetëm semantik. Në këtë qasje të re, antonimet përkufizohen si "*kundërvënie binare në gjuhë dhe në mendim*".[233] Bazuar në studimet e fundit, nga kategorizimi i antonimeve rezulton, se antonimia është përkufizuar sipas dy këndvështrimeve kryesore: *përmes konfigurimit apo skemës* dhe përmes *përmbajtjes*. Kundërvënia perceptohet si "*një interpretim binar krahasimi, në të cilin dimensioni i përmbajtjes përcaktohet dhe ndahet nga një skemë apo konfigurim kufizues. Konfigurimi i një kufizimi të tillë përbën një domosdoshmëri absolute për kuptimet në mënyrë të tillë që të përdoren si antonime në një segment përmbajtjeje të caktuar*".[234] Ky përkufizimi qendron në themel të këndvështrimit konfigurues apo skematik. Nga ana tjetër, sipas këndvështrimit të stukturës së kuptimit domethënës, kategorizimi i antonimeve përbën një vazhdimësi brenda së cilës disa çifte kundërvënëse binare konsiderohen "më të mirë" sesa disa të tjerë. Kategorizimi sipas segmentit të përmbajtjes përbën një prototip, i cili dallon dhe bën ndarjen e çifteve kanonike si *gjymtyrë bërthamë* dhe *çiftet e rastësishme*. Sipas Paradis, "*sa më kanonike të jenë antonimet, aq më të lidhura ngushtë janë nga ana leksikore dhe semantike, ndërkohë që ato më pak kanonike, apo aspak kanonike konsiderohen si antonime vetëm për shkak të mospërputhshmërisë së tyre semantike, kur përdoren në kundërvënie binare për të qenë të kundërta*". [235]

2.2.4 Burimet e antonimisë

Prejardhja shihet si burimi kryesor i antonimisë. Sipas M.L.Murphy, "*nevoja për të kundërta të leksikalizuara është në rënie për shkak të prodhueshmërisësë mjeteve morfologjike negative apo mohimit përmes frazave*".[236] Kjo ka të bëjë me fjalët e reja, të cilat futen në fjalor, antonimet e të cilave formohen përmes prejardhjes me mjete morfologjike. Për këtë arsye, antonimet "*e padepërtueshme*" (*opaque*) gjenden në sasi më të vogla te kategoritë semantike.

[232] Shënim: terminoligji e përdorur nga Cruse (1986) dhe nga Murphy (1994)
[233] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f. 34.
[234] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f. 35.
[235] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f. 35.
[236] M. L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and Other Paradigms, Camridge University Press, f. 197.

Antonimet e reja mund të leksikalizohen nëse kundërvënia ka rëndësi kulturore.[237] Përgjithësisht, kjo ndodh në situatat, kur një koncept i ri shtohet në një kulturë të caktuar ndaj një koncepti jo të leksikalizuar ekzistues (*mail/email/snail-mail*).

Burim tjetër antonimesh janë edhe kategoritë shoqërore, sidomos në fushën e fjalorit, që ka të bëjë me orientimin racor dhe seksual. Fillimisht ekzistonte termi "*homoseksual*" dhe më pas u shpik termi kundërvënës "*heteroseksual*". Dynes, gjithashtu, shton, se "*preferenca për termin "homosexual" përballë terminlogjisë së propozuar në shekullin XIX, justifikohet me përbërjen e saj morfologjike*".[238]

Përveç futjeve të reja si më lart, ndryshime semantike kemi edhe brenda marrëdhënieve semantike ekzistuese. Horn thekson "*tendencën në gjuhë drejt polarizimit të kuptimeve përmes fenomenit të zhvendosjes së antonimeve kundërshtuese, të cilat lejojnë terma të ndërmjetëm drejt antonimeve plotësuese, të cilat nuk lejojnë ndërmjetësime"*.[239] Për shembull, çifti antonimik kundërshtues: "*big/little" (i madh/i vogël)*, në përgjithësi, shihet nga folësit vendas si çift antonimik plotësues.Për të përmbledhur nëse fjalët X dhe Y janë në kundërvënie kanonike në bazë të dallimeve minimale në fushën semantike A dhe fjala X kanë një tjetër nuancë kuptimore, e cila aplikohet në fushën semantike B, atëherë si rezultat nëse Y zhvendoset në fushën B, mund të kuptohet si e kundërta e X.[240] Shembull: mbiemrat "*hot/cold"* (e nxehtë/e ftohtë), përveç përdorimit në një fushë semantike A në kuptimin e tyre të parë, gjymtyra *hot* futet në një fushë semantike B me kuptimin "*stolen" (e vjedhur*) më pas gjymtyra "*cold" (e ftohtë)* gjithashtu u zhvendos në fushën B në kuptimin "*legally acquired" (e siguruar ligjërisht)*. Këtu kemi të bëjmë me zgjerim kuptimi të çiftit "*hot/cold" (i nxehtë/i ftohtë).* [241] Pra, antonimet kanonike lëvizin drejt një fushe tjetër semantike përmes zhvendosjes metaforike, e cila i bën të dy gjymtyrët të përshtatshëm në fushën A dhe B.[242]

Por, jo gjithmonë mundet që gjymtyrët antonime të ndjekin njëra–tjetrën në zhvendosjen antonimike. Po t'i referohemi shprehjeve të tilla si "*tall tale" (përrallë e trilluar)* dhe "*tall order*" *(detyrë e vështirë)* vërejmë se nuk mundet që "*short*" si gjymtyra tjetër e çiftit "tall/*short*", të zhvendoset në kuptim antonimik në këto shprehje. Megjithatë, vetëm brenda një konteksti të caktuar e të mjaftueshëm, me nuancë gazmore, shprehje të tilla si*: "short tale"* dhe "*short order"* mund të përdoren në kundërvënie me idiomat "*tall tale" (përrallë e trilluar)* apo "*tall order*" *(detyrë e vështirë).*[243]

---

[237]M. L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f. 197.

[238]Dynes (1985) cituar nga M. L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f.197.

[239]A. Lehrer (1985) Markedness and Antonymy. Linguistics, f.397-429.

[240]A. Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity. In Cruse, D.A., F. Hundsnurcher, M. Job, P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology. Berlin: de Gruyter, f.498-508.

[241] Shembull i marrë ngaA. Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity. In Cruse, D.A., F. Hundsnurcher, M. Job and P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology. Berlin: de Gruyter, f.498-508.

[242]A. Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity. In Cruse, D.A., F. Hundsnurcher, M. Job and P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology. Berlin: de Gruyter, f.498-508.

[243]A. Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity in D.A. Cruse, F. Hundsnurcher, M. Job and P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology. Berlin: de Gruyter, f.498-508.

Përbën interes dhe enantiodromia, e cila njihet si "*procesi përmes të cilit diçka kthehet në të kundërtën e vetes*".[244] Në këndvështrimin semantik kuptojmë një ndryshim përmes të cilit një kuptim i fjalës zëvendësohet nga kuptimi i kundërt. Këtu duhet të bëjmë dallimin ndërmjet fjalëve që kanë njëkohësisht dy kuptime të kundërta brenda vetes (enantiosemia) dhe enantiodromisë. Përgjithësisht, këto ndryshime, motivohen nga ironia përmes zhvendosjes së koncepteve nga e keqja tek e mira dhe anasjelltas.[245] P.sh., përdorimi i mbiemrit "*bad"(i keq)* në zhargon me kuptimin "*good" (i mirë),* fjala qendron në të njëjtën fushë semantike dhe i referohet drejtimit tjetër të boshtit semantik.

2.3 Antonimet dhe problematikat rreth natyrës së kundërvënies

Në studimet e shumta të antonimisë si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, vërejmë se ka vatër debatesh gjuhësore në lidhje me atë çka përbën antonim, në dallim me papajtueshmërinë, mohimin, shkallëzimin, etj.

2.3.1 Papajtueshmëria dhe antonimia

Në përgjithësi, hulumtuesit e fushës së gjuhësisë e shohin antoniminë veçmas nga *papajtueshmëria.* Fjalë të ndryshme kanë kuptime të ndryshme, por disa prej tyre kanë kuptime të ndryshme, të cilat lidhen mes tyre përmes disa elementëve të përbashkët. Kjo përbën interes studimor për disa gjuhëtarë, të cilët analizojnë tiparet e përbashkëta dhe të kundërta që fjalët përmbajnë në strukturën e tyre semantike. De Saussure vuri theksin tek "vlera" që mbartin fjalët brenda sistemit të përbashkët.[246] Një shembull i këtij sistemi në gjuhë është edhe ai i ngjyrave, të cilat ndajnë të njëjtën fushë, por kanë vlerat e tyre, të cilat nga marrëdhënia e kundërvënies rezultojnë të jenë të papajtueshme. Një tipar tjetër i fjalëve të papajtueshme është fakti se ato nuk mund të renditen në mënyrë natyrale, ndaj për t'i renditur është përdorur kriteri i rendit alfabetik. Kështu, ai i sheh ngjyrat si një "*grup i parenditur termash të papajtueshme*". Hjelmslev u përpoq t'i shihte ngjyrat në raport intensiteti midis tyre në bazë të karakteristikave fizike të ngjyrave, por kjo nuk mund të shprehet gjuhësisht.[247]

Përpjekje janë bërë në gjuhësi për të përkufizuar antoniminë përmes testeve diagnostikuese, si për shembull: hulumtimet eksperimentale në veprat e studiuesve si: Kay, Cruse, Lyons,[248] etj., të cilët studiojnë papajtueshmërinë e strukturave minimale brenda fjalive si më poshtë:[249]

The bread is *fresh.*
(Buka është *e freskët*.)

The bread is *stale*.
(Buka është *bajate.*)

[244] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f.213.
[245] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f.213.
[246] F. R. Palmer (1972) Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.103.
[247] F. R. Palmer (1972) Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f..103.
[248] D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f.94.
[249] Shembujt e shkëputur nga D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f.95.

Nga të tilla qasje, mund të identifikohen çifte fjalësh të papajtueshme, por jo të dallohen ato fjalë që kanë vetëm referencë të papajtueshme, nga ato të cilat kundërvënien e kanë antonimike. Ato nuk arrijnë të vlerësojnë kundërvënien leksikore të antonimeve kanonike, ku disa antonime (kanonike) përbëjnë çifte "*më të mira*" krahasuar me çifte të tjera fjalësh të kundërvëna[250], si për shembull: "*alive/dead*" (i gjallë/i vdekur) përbën një çift më të gjetur sesa"*alive/expired*" (i gjallë/i vdekur).

2.3.2 Antonimia dhe mohimi

Çështje problematike paraqitet edhe përfshirja në kundërvënie antonimike e pjesëzave mohuese ose jo, bashkë me parashtesat negative si mjete fjalëformuese. M. Samara thekson, se "*në raportin midis gjymtyrëve të një çifti antonimik ekziston edhe një element mohimi i kuptimit të gjymtyrës tjetër, por këtu mohimi do të kuptohet si një dukuri gjuhësore, si karakteristikë e fjalëve në kundërvënie dhe pjesë përbërëse e gjymtyrëve të çiftit*".[251] Kështu, "*e keqe"* mohon fjalën "*e mirë"*. Por, këtu duhet bërë dallimi midis mohimit të mbartur në kundërvënie dhe mohimit përmes formave gramatikore, siç janë pjesëzat mohuese. Në shqip ekzistojnë disa mjete gjuhësore për të shprehur mohimin, ku mund të dallojmë pjesëzën mohuese "nuk" (*është i mirë/ nuk është i mirë*), pjesëzat mohuese "jo"(*i pijshëm/ jo i pijshëm*), pjesëzën mohuese *s'* (*është i martuar/s'është i martuar*).

Për sa u përket pjesëzave mohuese ("*not"* në anglisht dhe "*jo/nuk/mos/s'"* në gjuhën shqipe), vërejmë se si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe, ato nuk formojnë çifte antonimesh, pasi janë të palidhura morfologjikisht me parashtesat negative. Por ka gjuhë të tjera, si rusishtja, ku pjesëzat mohuese dhe parashtesat negative janë homonime. Ndërsa në gjuhën shqipe dhe angleze, me përdorimin e pjesëzave mohuese kemi të bëjmë me një mohim sintaksor, dhe jo me antonimi leksikore. Për më shumë mund të konstatojmë se gjatë përdorimit në fjali, si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe, mund të zëvendësojmë një mohim sintaksor përmes një pjesëze mohuese me një antonim të prejardhur me parashtesim, ku do të vemë re, se ky i fundit ka një forcë shprehëse më të lartë, duke e theksuar kundërvënien, si në shembullin e mëposhtëm:[252]

I am sorry to inform you that we are ***not*** at all ***satisfied*** with your sister. We are very much ***dissatisfied*** with her.

(Më vjen keq t'ju vë në dijeni se jemi ***jo të kënaqur*** me motrën tuaj. Ne jemi shumë ***të pakënaqur*** me të.)

Shumica e studiuesve shqiptarë, këtu pajtohen me idenë, se pjesëzat mohuese nuk janë elemente fjalëformuese dhe, si të tilla, nuk formojnë kundërvënie kuptimesh, pasi ato vetëm mohojnë fjalën tjetër pa pohuar veten. Nisur nga përkufizimi, është e rëndësishme që fjala antonimike me kuptim kundërvënës fillimisht të pohojë veten, pastaj të mohojë tjetrën. Pra, pjesëzat nuk e përmbushin këtë kriter e, si të tilla, shembujt e tipit "*i sigurt/jo i sigurt*" nuk përbëjnë një çift antonimik, por thjesht mohojnë tjetrën pa pohuar veten. M. Samara dallon pohimin dhe mohimin brenda gjymtyrëve të çiftit antonimik dhe shprehet,

[250] F. R. Palmer (1972) Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f..103.
[251] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f. 144.
[252] Shembujt e shkëputur nga Ch.Dickens, cituar D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f. 97.

se "*kuptimi pohues i njërës fjalë lidhet me kuptimin e fjalës që ajo mohon*".[253] Kështu, çdo njësi leksikore pohon diçka dhe mbart një kuptim, dhe mohimi qendron brenda këtij kuptimi si pjesë përbërëse. J.Thomai pohon, se "*nuk krijohet asnjë kundërvenie ndërmjet një fjale dhe mohimit të saj me pjesezat s', nuk, jo, mos*".[254] Tek mohimi kemi të bëjmë me mohim të fjalës së parë, po nuk pohohet e kundërta me të. J. Thomai mendon, se "*mohimi ka përmbajtje më të gjerë sesa mohimi i një fjale*".[255]

Kështu, p.sh., "*i nxehtë/ jo i nxehtë"*, ku kjo e dyta jo vetëm nënkupton që mund të jetë diçka e ftohtë, por mund të jetë edhe e ngrohtë, e vakët, e freskët etj. Gjithashtu, edhe M. Samara thekson, se pjesëza *nuk, jo,* dhe *s',* nuk shërbejnë si elemente fjalëformuese, pra nuk kemi të bëjmë me antonimi, por me *mohim logjik*.[256] Ai njeh si fjalëformuese parashtesën "pa-", e cila ndihmon në forminin e çifteve antonimike të tipit: "*i martuar/i pamartuar"*. Në këtë këndvështrim, M. Samara dallon midis dy tipesh të çiftit antonimik:

a) Antonimi ose kundërvënie të ndërtuar mbi bazën e mohimit leksikor (*i martuar/i pamartuar*)

b) Antonimia ose kundërvenia, e cila ndërtohet mbi bazën e pohimit leksikor të dy kuptimeve të kundërta midis fjalëve me rrënjë të ndryshme (*i martuar/beqar*).

Xh. Gosturani, i cili e trajton gjerësisht çështjen e mohimit në gjuhën shqipe, thekson se "*pohimi me mjete sintaksore që kanë formë mohuese, por brendi pohuese, duke mohuar antoniminë e një fjale me një pjesëz mohuese (nuk, s', jo, mos, pa) bëhet në gjuhën shqipe vetëm për nevoja të caktuara stilistikore të lidhura ngushtë me kontekstin…ose kur dëshirojmë të mos i quajmë sendet me emrin e vet*." [257] Ai dallon disa raste kur dy mohime japin një pohim. Shembull:

"Krevati ***nuk*** është ***jo i rehatshëm***."

M. Samara e kundërshton këtë mendim, pasi ai mendon, se në një këndvështrim semantik dhe strukturor të fjalës nuk mund të vihet shenja e barazimit semantik midis kuptimit pohues të shprehur me dy pjesëza mohuese dhe atij të shprehur nga mohimi i një fjale me parashtesën "pa-" dhe një pjesëz mohuese. Shembull:

"Ai ishte ***jo i papërqendruar***."

(pra, ishte "*i përqendruar*")

Ai e vazhdon arsyetimin e tij duke theksuar, se fjalët me parashtesa mohuese kanë veçori strukturore dhe semantike, të cilat i japin mohimit të këtij lloji vlera të ndryshme në krahasim me mohimin e shprehur me pjesëzën mohuese. Ai rikthekson se mohimi i shprehur me parashtesa mohuese bën pjesë në kuptimin leksikor të fjalës, pra është mohim leksikor, kurse me pjesëza mohuese është mohim sintaksor ose togfjalëshor. M. Samara mendon, se pohimi që bëhet në gjuhën shqipe nëpërmjet mohimit të kuptimit të

[253] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f. 144.
[254] J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f. 27.
[255] J. Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f. 28.
[256] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f. 144.
[257] Xh. Gosturani *cituar nga*I. Goçi (1985), Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 33-37.

kundërt të fjalës me anë të pjesëzës "*jo"*, nuk është karakteristike për gjuhën e folur popullore.

Vjet u përgatita ***jo keq****.*[258]

Në shembullin e mësipërm të Xh. Gosturanit, pohimi është bërë me anë të mohimit në kuptim të kundërt të fjalës "*keq",* por nuk mund të themi, se "*u përgatita jo keq*" do të thotë "*u përgatita mirë"*, pra kemi të bëjmë me mohim të fjalës "*keq*", por jo pohim të fjalës "*mirë*". M.Samara dallon dy tipe të mohimit, karakteristike të gjuhës shqipe:

1. Mohimi i fjalës me anë të pjesëzave mohuese *nuk, s', mos,* dhe *pa* (para foljes) dhe rrallëherë me jo (prapa mbiemrit)

2. Mohimi me anë të prapashtesave me funksion mohues, si p.sh. *pa -, mos-, jo-, s-,* (mbiemra+folje)

Nga këto dy tipe mohimi karakteristike për gjuhën shqipe vetëm tipi i dytë, pra ai përmes parashtesave me karakter mohues është i lidhur ngushtë me kuptimin antonimik të fjalëve. Ndërsa në rastin e pare, nuk kemi të bëjmë me antonimi leksikore (kundërvënie leksikore), por me kundërvënie sintaksore.

I. Goçi[259] e ilustron raportin e mohimit si edhe të parashtesimit përmes skemave mohuese e kundërvenëse, si më poshtë:

- Skema e mohimit: "A/jo A" "i bukur/jo i bukur", ku gjymtyrët përjashtojnë njëri-tjetrin. Gjithashtu, mund të ndërtohet mohim edhe me foljen jam+mbiemër", modele të cilat përmbajnë një folje këpujë pohuese të shoqëruar me një mbiemër pohues në gjymtyrën e parë, dhe me pjesëzën mohuese "jo" plus mbiemrin në pjesën e dytë sipas modelit "ai është i mire/ai është jo i mirë").

- Ndërkohë, skema e kundërvënies del e zgjeruar në raport me atë të mohimit: "A/ jo A +B", "i bukur/jo i bukur + i shëmtuar". Pra, siç shihet edhe nga skema e mësipërme, kundërvënia e përmban mohimin si pjesë përbërëse të skemës së mësipërme, por nuk kufizohet me të, pasi përfshin edhe pohimin e termit të dytë, antonimik, i cili mohon gjegjësen e tij në çift, sikurse edhe pohon veten.

I.Goçi gjatë studimit të tij të thelluar mbi antoniminë në gjuhën shqipe, analizon edhe raportin midis mohimit, kundërvënies dhe kundërthënies. Ai thekson, se "*mohimi dhe kundërvënia nuk mundet kurrsesi të jenë e njëjta gjë, pasi mohimi nuk përbën mjet fjalëformues, dhe si i tillë nuk mund të formojë çifte antonimike apo kundërvënie*".[260]

Parashtesat tipike negative në gjuhën shqipe: *pa-, jo-, mos-.* (*i fuqishëm/i pafuqishëm)*. Krahas formës antonimike me parashtesë negative, ndodh që të ekzistojë edhe një fjalë tjetër antonimike, e cila qendron përballë të njëjtit mbiemër si në rastin e

[258] Shembull i I. Gosturani i shkëputur nga M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.144.
[259] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 33-37.
[260] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 33-37.

mësipërm, ku "*i pafuqishëm*" mund të zëvendësohet me "*i dobët*", nga ku del çifti antonimik "i fuqishëm/i dobët". Për sa i përket marrëdhënies midis "*i dobët*" e "*i pafuqishëm*", vlen të theksojmë, se ato kurrsesi nuk mund të jenë sinonimike apo të njëjta në kuptim, pasi një njeri "*i pafuqishëm*" jo domosdoshmërisht është *"i dobët*", sepse ekziston edhe një gjendje e ndërmjetme mes tyre.

Për sa u përket foljeve, një parashtesë negative si fjalëformese në gjuhën shqipe është edhe "zh"-ja, si në shembullin "*bëj/zhbëj*". Vetë termi i kundërvënë "zhbëj" mund të diskutohet në raport me një formë tjetër jokundërvënëse, por thjesht mohuese, siç është "*s'bëj*". Në rastin e dytë nuk kemi kryerje të veprimit e më pas kthim në formën e parë, por moskryerje të veprimit. Në lidhje me foljet, M.Samara dallon edhe ata çifte antonimike foljore, të cilat shprehin marrëdhënie kundërvënieje reciproke, ku mohimi i kuptimit të njërës fjalë qendron brenda kuptimit të fjalës tjetër, por nuk është i mjaftueshëm për të pohuar të kundërtën. Për shembull, tek çifti "*dashuroj/urrej"* folja dashuroj e përdorur në mohim "*nuk dashuroj",* jo domosdoshmërisht na sjell në mendje foljen "*urrej"*.

Si përfundim, mund të përmbledhim mendimin tonë, se antonimet nuk janë një mohim i thjeshtë i tipareve semantike të një fjale tjetër, pasi ata e plotësojnë njëra-tjetrën duke u kundërvënë. Themi, se antonimet qendrojnë në një unitet të mohimit dhe pohimit nga këndvështrimi kundërvënës. Gjymtyrët e çiftit antonimik, si rezultat janë të dallueshme, të ngjashme ashtu sikurse kanë dhe një përbërës që i kundërvë me njëra-tjetrën.

2.3.3 Antonimia dhe shkallëzimi

Shkalla e kundërvënies është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e kundërvënies kuptimore. Shkallëzimi ka të bëjë me shkallën e marrëdhënieve të kundërshtimit ndërmjet dy a më shumë sendeve, dukurive, cilësive, apo veprimeve të kundërvëna. Kështu, për shembull, gjymtyrët "*i ftohtë*" dhe "*i nxehtë*" qendrojnë në dy skaje të kundërta të së njëjtës fushë kuptimore, që është temperatura. Duhet theksuar, se këto dy fjalë janë lehtësisht të identifikueshme si të kundërta, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për termat që qendrojnë më afër mesit të fushës së temperaturës, siç janë për shembull, "i freskët" dhe "i ngrohtë", të cilët pa dyshim që shprehin kontrast, por vështirë të kenë të njëjtën vlerë kundërvënëse, si çifti "*i ftohtë/i ngrohtë*".

Justeson dhe Katz pohojnë, se "*mbiemrat mund të jenë më pak ose më shumë antonimikë, por jo thjesht antonimikë ose joantonimikë*".[261] Këta shembuj në klasën e mbiemrave, sipas S. Jones, "*shpjegojnë qartë faktin se ajo që ne mendojmë si kundërvënie duhet të vërtetohet përmes referencës semantike*".[262] Pra, mbiemrat përbëjnë një nga pjesët e ligjëratës, të cilat nuk e kanë të thjeshtë përkufizimin e antonimisë.

Llojet e kundërvënies janë[263]:

- *kundërvënie e plotë,*
- *kundërvënie e ndërmjetme,*
- *kundërvënie e shkallëzuar.*

[261] J. S. Justeson, Slava M. Katz. (1991) Co-occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts. Computational Linguistics, f. 1-19.
[262] S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f.128.
[263] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.

Tipologjia e kundërvënies përcaktohet në varësi të qendrimit subjektiv të folësit. Antonimet janë të plota, kur u kundërvihen shumica e kuptimeve themelore. Këtu kemi të bëjmë me kundërvënie të pastër, jashtë kontekstit. Shembuj: "*jap/marr", "prish/rregulloj", "bëj mirë/bëj keq",* etj. Ato studiohen kryesisht nga korpusi i antonimeve në fjalorë, pasi konteksti nuk ka rëndësi në këtë analizë. Mund të themi se kanë burim ontologjik, pra lidhen me pasqyrimin e botës reale dhe, siç e thekson I. Goçi, "ato janë jo të shumta në numër e janë të pavarura, ndryshe nga ato kontekstuale, të cilët kushtëzohen nga kuptimi reciprok i dy antonimeve".[264] Po të mbeteshim në kufijtë e përkufizimit logjik për antoniminë, nuk do të mund të ishim në pozita për të diskutuar për shkallëzimin e kundërvënies, pasi logjika mbështetet tërësisht në realitetin objektiv, në natyrë, dhe dihet se natyra ka kufij të prerë kundërvëniesh në skaje ekstreme.[265] Kështu, themi se ka një polaritet ekstrem, dhe të tilla antonime janë krejtësisht të kundërta, si për shembull,*"i mirë/i keq", "plak/i ri", "i afërt/i largët","i ëmbël/i hidhur", "ngul këmbë/lëshoj pe", "faqebardhë/faqezi*", etj.

Nga ana tjetër**,** antonimet e pjesshme kundërvihen vetëm në disa nga kuptimet e tyre, kanë një zbutje të nocionit të polaritetit, pra jo deri në skaje ekstreme, dhe këtu flasim pikërisht për një kundërvënie të zbutur.[266] Për shembull, "*e pastër/e papastër"* përballë çiftit *e pastër/e pisët /e ndyrë*. Këtu theksojmë se fjalët "*i pappastër*" dhe "*i pisët/i ndyrë*" nuk përbëjnë sinonime mes tyre. Ato formojnë sinonime të tipit "*i papastër, i përlyer*" apo "*i pisët, i ndyrë, i fëlliqur*". Të gjitha këto hyjnë në marrëdhënie kundërvënieje të plotë apo të pjesshme me fjalën "i pastër".

Leech i referohet kundërvënies së plotë me termin "*taksonomia binare*".[267]Të tjerë gjuhëtarë, si për shembull Palmer[268], Carter[269], Jackson[270], preferojnë të përdorin termin "*complementarity"(plotësueshmëri)*. Kempson preferon termin *kundërshti e thjeshtë binare* dhe i quan ato "*antonime të vërteta*".[271]Ky këndvështrim ndeshet me mendimin e kundërt të Lyons[272] dhe Cruse[273], të cilët format komplementare nuk i njohin si antonime dhe besojnë, se antonimia duhet të kufizohet vetëm brenda çifteve të shkallëzuara.Në këtë punim ne ritheksojmë se do i përmbahemi logjikës së Leech, Palmer, Carter, etj. dhe do t'i konsiderojmë si antonimi e vërtetë edhe format komplimentare.

Logjika që përdoret për të kuptuar të tilla çifte antonimike është formula, ku X, i cili është një "*burrë"*, nuk mund të jetë një *grua,* ashtu sikurse një X, i cili është "*i martuar"* nuk mund të jetë "*i pamartuar",* etj.[274]Leech përdor metodën e analizës së përbërësve të një fjale për të zbërthyer kuptimin e saj. Kështu për shembull, fjalën "*burrë",* ai e zbërthen në tre përbërës, përkatësisht "njeri" + "i rritur" + "mashkull". Nga ana tjetër, ai zbërthen fjalën "*grua",* duke analizuar elementët përbërës të fjalës *grua* në kundërvënie me atë të fjalës "*burrë",* si: "njeri" + "rritur" + "jo mashkull".[275] Kjo lloj

[264] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[265] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[266] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[267] G. Leech (1974) Semantics. Middlesex, Penguin, f.109.
[268] F.R Palmer (1972) Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.104.
[269] R Carter (1987) Vocabulary. London, Allen & Unwin, f.98.
[270] H.Jackson (1988) Words and their Meaning. Cambridge, Cambridge University Press, f.76.
[271] R. M.Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f .84.
[272] J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f.97.
[273] D. A. Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f. 95.
[274] D. A. Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f. 95.
[275] D. A. Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f. 95.

analize e justifikon kundërvënien kuptimore të analizës së përbërësve të kuptimit të fjalës*"grua"* dhe "*burrë"*, kundërvënie e cila realizohet përmes dy elementëve kuptimorë të përbashkët dhe një elementi të kundërt. Dy elementët e përbashkët kuptimorë (*njeri* dhe *i rritur*) përjashtojnë nga kundërvënia kuptimore fjalë të tjera, si për shembull, fjalë që shënojnë jofrymorë si p.sh.,"*makinë"*. Pra, mund të themi se këto dy fjalë (*burrë* dhe *grua*) mbartin në vetvete nocionet "*njerëzor*" dhe "*i rritur*".

Gjithashtu, edhe Kempson përdor analizën e përbërësve kuptimorë në analizën e tij për antoniminë dhe vëren, se kjo strategji është e frytshme, kur kemi të bëjmë me disa çifte antonimike të caktuara, kryesisht ato që kanë të bëjnë me gjininë dhe farefisninë (kinship). Megjithatë, fuqia shpjeguese e kësaj lloj analize duket se ka limitet e saj. Edhe pse Kempson beson, se "*analiza e përbërësve është një mënyrë më e qartë për të karakterizuar marrëdhëniet…"*[276]*(*dhe ne pranojmë që është një mjet i dobishëm për të përshkruar vetëm disa çifte antonimike) nuk mund të themi se kjo analizë është gjithmonë kaq e dobishme dhe e saktë.

Në një këndvështrim tjetër, Jackson është ai që vë në dyshim ekzistencën e një koncepti të tipit kundërvënie e pashkallëzuar përmes theksimit të faktit se "*çdo antonim i pagradueshëm mund të përdoret si i shkallëzuar*".[277] Për më shumë, ai vë në diskutim edhe kundërvënien midis fjalëve "*femër*" dhe "*mashkull*", duke u bazuar në faktin se në ditët e sotme kryhen operacione për ndryshimin e seksit dhe kërkimeve në fushën e kromozoneve.

Për më shumë mund të bazohemi në disa shembuj të shkëputura nga vepra letrare, si më poshtë vijon:[278]

But I feel ***very alive*** while I am acting- the rest becomes a lot more interesting.
(Por unë ndihem *shumë më i gjallë* kur jam duke aktruar- pjesa tjetër e jetës bëhet shumë më interesante.)
Josh Logan had understood that he had everything a director could ask for: tall, a sense of humor, ***terribly male***.
(Xhosh Logan e kishte kuptuar se ai ishte gjithçka që një regjisor mund të shpresonte: i gjatë, me sens humori, *tmerrësisht mashkullor.)*
At the time, Margo was ***very pregnant*** with Hektor and we had dinner and talked until late at night.
(Margoja në atë kohë ishte *shumë shtatëzënë* me Hektorin dhe ne hëngrëm darkë dhe diskutuam vonë gjatë natës.)

Shembujt e mësipërm, mund të jenë të rrallë dhe vënë në diskutim atë që teknikisht ne e quajmë "*i gjallë*" ose "*i vdekur*". Megjithatë, nëse do të arrijmë të nxjerrim kuptimin e nënkuptuar të fjalës "*more alive*" (*më i gjallë*), "*extremely male*" (*tmerrësisht mashkullor*) dhe "*very pregnant*" (*shumë shtatëzënë*), do të arrijmë ta kuptojmë qëllimin e përdorimit të këtyre "sasiorëve" (*more, extremly* and *very*). Ashtu siç Lyons thekson, "*në shembujt e mësipërm ne shkallëzojmë kuptimet e dyta të fjalëve ose konotacionet e tyre*".[279] Ai vazhdon me argumentet e tij, ku thekson, se fakti që ekziston një mundësi

[276] R. M.Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f .86.
[277] H. Jackson (1988) Words and their Meaning. Cambridge, Cambridge University Press, f.76.
[278] Shembuj të shkëputur nga H.Jackson (1988) Words and their Meaning. Cambridge, Cambridge University Press, f.77.
[279] J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f.278.

shkallëzimi për antonimet e pashkallëzuara, nuk do të thotë se nuk ekziston një dallim i qartë midis antonimeve të shkallëzuara dhe të pashkallëzuara në sistemin gjuhësor.

Nga sa më lart, mund të themi se kundërvënia ndërmjet gjymtyrëve të çiftit antonimik nuk është e lehtë të përcaktohet, pasi kërkon që të studiohen mirë përbërësit e kuptimit të këtyre gjymtyrëve. Në varësi të qendrimit subjektiv të folësit, ndonjëherë kemi edhe kalim të një çifti antonimesh nga njëri tip i kundërvënies në një tip tjetër. Megjithatë, nuk flitet për kufij të prerë në gjuhësi. Shkallëzimi është me interes në studim, pasi ndihmon të analizojmë kuptimet dhe raportin e çifteve antonimike tek kundërvënia e pjesshme, ndërkohë që antonimia e plotë shihet te kuptimi kryesor.

2.3.4 Kundërvënia në kontekst dhe antonimia

Palmeri e sheh antoniminë si "*kundërvënie kuptimore*" dhe shprehet se: "*fjalët që janë të kundërta janë antonime"*.[280] Nga problemet më të mëdha në semantikën leksikore janë karakteri i ndryshueshëm i fjalës dhe ndjeshmëria e saj ndaj kontekstit. Me zhvillimin e metodave të studimit në gjuhësi, si dhe përmes qasjeve të reja të orientuara drejt kontekstit të përdorimit të gjuhës, vërejmë se disa studiues i janë referuar kontekstit, si kriter thelbësor në analizën dhe studimin e antonimisë. Kështu, Paradis dhe Willners, i ndajnë antonimet në: *çifte leksiko-semantike tradicionale* dhe në *çifte të motivuara kontekstualisht* të para në këndvështrimin e semantikës njohëse.[281] Kështu trajtohen edhe nga Talmy[282], Cruse[283], Kroft dhe Cruse[284], Herrmann[285], Fellbaum[286], Gross dhe Miller[287], Justenson dhe Katz[288], Willners[289], Jones[290], etj.

Nga këto studime rezultojnë si çifte mbiemrash tradicionalë: "*good/bad*" (i mirë/i keq), "*hot/cold*" (i nxehtë/i ftohtë), "*heavy/light*" (i rëndë/i lehtë), "*slow/fast*" (i ngadaltë/i shpejtë), të cilat paraqesin dimensione semantike të meritës, temperaturës, peshës dhe shpejtësisë. Këto rezultojnë si antonime "*më të mira*" nga testet e kryera përmes metodave të ndryshme, si intervistimi me pyetësor i folësve, të cilët zgjodhën si çift më të gjetur antonimesh "*slow/fast*" (i ngadaltë/i shpejtë) në vend të "*slow/rapid*" (i ngadaltë/i shpejtë,i menjëhershëm), "*slow/express*"(ngadaltë/i shpejtë, ekspres)[291] etj.

Disa antonime ndërtohen thjesht për qëllime poetike e letrare dhe në të tilla raste është i nevojshëm motivimi i qartë kontekstual, në mënyrë të tillë që të kuptohen si kundërvënie binare të përbërësve kuptimorë. Paradis dhe Willners theksojnë, se "*midis*

[280] F. R. Palmer (1972) Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.105.
[281] C. Paradis, C. Willners Forthcoming. 'Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects', Studia Linguistica, f.54.
[282] T. Givon (2002)Bio-Linguistics, Amsterdam:John Benjamins, f.95.
[283] D.A.Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f.87.
[284] W. Croft, D. A. Cruse (2004) Cognitive Linguistics,Cambridge University Press, f.69.
[285] D. J. Herrmann, Chaffin, R., D., M. P. &R. S.Wool (1986) The Role f Elements of Relation Definition in Antonym and Synonym Comprehension. Zeitschrift für Psychologie, f.133–53.
[286] C. Fellbaum (1995) Co-occurrence and Antonymy. International Journal of Lexicography, f.281–303.
[287] D.Gross, U. Fischer &G. A.Miller (1989) The Organization Of Adjectival Meanings.Journal of Memory and Language, f. 92-106.
[288] J. S. Justeson, S. M.Katz (1991) Co-occurrences of Antonymous Adjectives and Theircontexts. Computational Linguistics, f.1–19.
[289]C. Willners (2001) Antonyms in Context. A Corpus-based Semantic Analysis of Swedish Descriptive Adjective.Sweden: Dept. of Linguistics, Lund University, f.174.
[290] S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London
[291] C. Paradis, C.WillnersForthcoming. 'Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects', Studia Linguistica, f.55.

dy ekstremeve gjenden një sërë çiftesh, të cilat…kanë vevojë për një kontekst të caktuar të dukshëm në mënyrë të tillë që të keni kuptimin e antonimeve"[292]. Si shembuj, ata japin fjali (kontekste) të tilla si në shembujt e mëposhtëm[293]:

I prefer ***calm*** dogs to ***high-strung*** dogs.
(Unë preferoj qentë ***e qetë*** në krahasim me qentë ***e nervozuar***.)

I prefer ***calm*** waters to ***flowing*** waters.
(Unë preferoj ujërat ***e qeta*** në krahasim me ujërat ***e rrjedhëshme*.)**

I prefer ***calm*** public to ***agitated*** public.
(Unë preferoj publikun ***e qetë*** në krasim me atë ***të shqetësuar***.)

I prefer ***calm*** conversations to ***flame*** warrings.
(Unë preferoj bisedat ***e qeta*** në krahasim me zënkat ***të flakta*.)**

Në shembujt e mësipërm, vërejmë se kuptimet e ndryshme antonimike të mbiemrit "*calm*" duket se janë të lidhura ngushtë me sfera të caktuara,[294]dhe dalin si të tilla vetëm në ndërtime strukturore të veçanta.[295]

Rikujtojmë që Lyons shprehet, se "*kundërvëniet formohen përgjatë dimensionit të ngjashmërisë*".[296] Pra, ato ndërtohen në bazë të ngjashmërisë semantike. Por cilat janë ato tipare semantike, të cilët duhet të jenë të ngjashme dhe cilat janë ato që kundërvihen mes fjalësh antonime? Përgjigjja e saktë e kësaj pyetjeje del vetëm përmes qasjes pragamtike, duke i studiuar antonimet dhe kunërvënien mes tyre në kontekst. Është Murphy ai i cili propozon një qasje pragmatike ndaj antonimisë. Sipas kësaj qasjeje, antonimet përbëjnë njohuri metagjuhësore,e cila mund të gjenerohet përmes një parimi të vetëm të marrëdhënies.[297] Nga ana tjetër, sipas studimeve tradicionale në lidhje me marrëdhëniet paradigmatike, mendohet se antonimet janë pjesë e njohurive tona leksikore. Sipas teorise së Murphy (Relation by Contrast/Marrëdhënies përmes Kundërshtisë) vetëm njëri tipar i fjalës kundërvihet.

Kështu, ai thekson se "*një strukturë leksiko-semantike përfshin të gjitha konceptet-fjalë, të cilat kanë të njëjtat tipare të përshtatshme në një kontekst, përveç njërit prej tyre***".**[298]Mënyra më e përshtatshme për përcaktimin e kundërvënies, sipas Murphy, është ajo e *analizës së përbërësve kuptimorë,* sipas të cilës strukturat në kundërvënie (ku përfshihen edhe antonimet) janë fjalë të cilat ndajnë një sërë tiparesh semantike, por dallojnë në një tipar të vetëm apo vetëm në një veçori të caktuar të një tipari. Për shembull, ngjyrat "*red/yellow/blue*" përbëjnë një strukturë në kundërvënie mes tyre, ku të gjtha janë ngjyra themelore, por dallojnë në veçorinë e tiparit të nuancës.

[292] C. Paradis, C. Willners, Forthcoming. 'Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects', Studia Linguistica, f.58.
[293] Shembuj të shkëputur nga C. Paradis, C. Willners. Forthcoming 'Antonyms In Dictionary Entries: Methodological Aspects', Studia Linguistica, f.59-63.
[294] G. A. Murphy, &J. M.Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy Inadjectives. Journal of Memory and Language, f. 301–319.
[295] Goldberg (1995)/(2006) , Croft (2001), Murphy (200), Boas (2008)
[296] J. Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f.279.
[297] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and Other Paradigms, University Press Camridge, f. 2.
[298] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and Other Paradigms, University Press Camridge, f.86.

Gjithashtu, Murphy thekson rëndësinë e përfshirjes së faktorëve semantik, ashtu si edhe atyre josemantik në analizën e antonimisë, pasi jo vetëm përbërësit semantik, por edhe forma e fjalës gjithashtu mund të dëshmojë e përforcojë kundërvënien. Kur bëhet fjalë për *ngjashmëri kuptimore,*Murphy u referohet "*tipareve të ngjashme të përshtatshme në kontekst*", dhe dallimi kuptimor i referohet "*një tipari të dallueshëm brenda një konteksti të vlefshëm"*. Si rezultat, kemi të bëjmë me një qasje me bazë kontekstin.

Sa më të ngjashme të jenë fjalët e një çifti antonimesh dhe sa më shumë të zgjerohen tiparet e përbashkëta të tyre, duke i kapërcyer edhe kontekstet me vetëm një tipar të dallueshëm, aq më i gjetur është ai çift antonimesh. Sipas këtij pohimi, rezulton, se *fjalët që janë identike në formë dhe kanë vetëm një tipar dallues janë antonime të përsosura*[299] dhe këtu bëhet fjalë për ato që njihen ndryshe si *Janus Words.*[300] Në gjuhën angleze gjejmë shembuj si fjala "*temper*", e cila del edhe në kuptimin "*to harden*" (forcoj) dhe në kuptimin e kundërt "*to soften*"(zbus), apo folja "*sanction*", e cila del në kuptimin "*to approve* " (*aprovoj*) dhe kuptimin e kundërt "*to censure*"(*ndaloj*).

Megjithatë, të tilla çifte fjalësh të njëjta me kuptime të kundërta, disa gjuhëtarë nuk i njohin si antonime të gjetura për dy arsye:

1. së pari, sepse dallimet e tyre semantike nuk janë minimale.

2. së dyti, sepse, sipas teorisë së marrëdhënies, kundërvëniet realizohen ndërmjet koncepteve fjalë dhe, nëse pranojnë enantioseminë si antonimi, atëherë nuk do të ishte nevoja të kemi koncepte fjalësh të ndara për nuanca të ndryshme kuptimore të fjalëve. Pra, do të kishim të njëjtën fjalë me nuanca kuptimore të ndryshme. Vetëm për qëllime studimore, duke përdorur shenja dalluese, ata i shohin fjalët enantiosemike, si çifte fjalësh në kundërvënie, p.sh "temper^{1}/temper^{2}".

Në përcaktimin e përsosmërisë së kundërvënies, vlen analiza e përbërësve përmes krahasimit të çifteve antonime me një përbërës të përbashkët, në një kontekst të caktuar. Nëse kjo analizë do të bëhej në një kontekst neutral, fjala mund të rezultojë të ketë më shumë sesa një antonim të gjetur të mundshëm, si p.sh "*sweet/sour"*(i ëmbël/i athët)dhe "sweet/*bitter" (i ëmbël/i hidhur).* Gjithsesi, përzgjedhja e antonimeve të përshtatëshme në kontekstet neutrale përbën interes sidomos në studimin e mbiemrave që lidhen me emocionin, shijen etj. Kështu, çifti "*happy/sad"*(i lumtur/i mërzitur) rezulton të jetë më shumë antonimik në gjuhën angleze sesa "*happy/angry"*. Në mënyrë të ngjashme, çifti "*sweet/bitter"* tingëllon më antonimik në krahasim me "*sweet/sour",* pasi lidhja ndërmjet "*sweet"* dhe "*bitter"* është e ndërmjetësuar nga *sour.*[301] I parë në një kontekst të veçantë, numri i antonimeve brenda dimensionit të shijes do të ishte më i lartë, duke përfshirë edhe mbiemra të tillë si "*salty" (i kripur), "hot" (djegës), "dry" (e athët,* për verën*), etj*.

Mbiemrat "*smooth"*(e lëmuar) dhe "*rough"(e ashpër)*rezultojnë të jenë çifte antonimesh ideale me një kontekst neutral, por në një kontekst të veçantë dhe e kundërta e mbiemrit "*smooth*" do të variojë në varësi të asaj çka ajo përshkruan dhe mund të rezultojë si "*bumpy*" (rruga në udhëtim), "*grainy" (me kokrra)*, "*ridged" (i mprehtë, me majë),* apo "*difficult" (e vështirë), etj*.

[299] E.V. Clark, H. H.Clark (1979) When Nouns Surface as Verbs, f.785.
[300] E njohur ndryshe si *enantiosemi.*
[301] W. G Charles, M. A., Reed, &D.Derryberry (1994) Conceptual and Associative, Processing in Antonymy and Synonymy. Applied Psycholinguistic, f. 329–354.

Kështu rezulton se kundërvënia del, jo vetëm përmes tipareve semantike, por edhe atyre pragmatike, ku konteksti dallon se cila nuancë kuptimore është e përshtatshme.[302]Studimet e Jones[303] japin një kontribut të vyer drejt qasjes pragmatike të antonimisë. Për më shumë, Murphy është i mendimit, se "*çdo dy fjalë mund të kundërvihen në mënyrë antonimike në një kontekst të gjuhës natyrore*".[304] Në vazhdim të qasjes së Murphy, taksonomia e Jones për funksionet e antonimisë si edhe kornizat sintaksore japin mundësinë e dallimit të antonimisë situative dhe kontekstuale, qasje e cila përputhet me parimet metaleksikore të Murphy. Pra, këto korniza na ndihmojnë të njohim antoniminë kontekstuale, por gjithashtu matja e frekuencës së përdorimit të këtyre kornizave dhe funksioneve të tyre në ligjërim, na ndihmon të përcaktojmë statusin kanonik të disa prej tyre.

Si rezultat, themi se kundërvënia në një kontekst neutral është më e kufizuar dhe shpeshherë më e preferuar për të përcaktuar antonimet kanonike, ndërkohë që marrja parasysh e kontekstit e vështirëson, por edhe e qartëson, më shumë kundërvënien.

2.4 Marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë dhe poliseminë si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe

Antonimia studiohet më mirë, kur shihet edhe në lidhje me marrëdhënie të tjera kuptimore, si antonimia, polisemia, homonimia apo edhe hiponimia. Murphy thekson rëndësinë e pragmatikës për të bërë dallimin mes marrëdhënieve të ndryshme semantike si antonimia, sinonimia, hiponimia etj. Ai shton, se "*për të dalluar atë çka dallon ndërmjet njësive në kundërvënie, duhet mbështetur tek pragmatika*".[305] Më poshtë do të përqendrohemi në marrëdhënien e antonimisë me poliseminë dhe sinoniminë.

2.4.1 Marrëdhënia e antonimisë me poliseminë, si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe

Polisemia ose *shumëkuptimshmëria*, siç e quan J. Thomai, quhet *ajo dukuri gjuhësore, e cila studion kuptimet e shumta të fjalëve*. Kuptimet e një fjale përbëjnë atë që quhet "*strukturë kuptimore e saj, e cila përbëhet nga kuptimi fillestar, kuptimi kryesor dhe kuptimet e prejardhura, si edhe kuptimet e fljalëve që dalin në lidhjet e saj frazeologjike*".[306] Fjalët polisemike mund të kenë antonime në disa nga kuptimet e tyre, por në disa nga kuptimet e tjera mund të mos kenë antonime. Në kuptime të ndryshme, një fjalë mund të ketë antonime të ndryshme, p.sh., mbiemri "*short" (e shkurtër),* kur përdoret për të treguar gjatësinë e një historie, "*short story" (histori e shkurtër),* ka si antonim mbiemrin "*long" (e gjatë),* por kur mbiemri "*short"*përdoret për të treguar gjatësinë e një njeriu, "*short man" (burrë i shkurtër*), merr si antonim "*tall"*(i gjatë), "*tall man*" (*burrë i gjatë*). Ndërkohë, në shprehjet e ngurtësuara apo frazeologjike, kur përdoret fjala "*short",* ajo ka kuptim tjetër dhe si pasojë edhe antonimi është i ndryshëm,

[302] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f.203.
[303]S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f.94.
[304] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f.204.
[305] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.207.
[306]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.123.

si p.sh., "*be short with somebody/ be civil with somebody*" (të jesh i pasjellshëm, arrogant me dikë/të jesh i sjellshëm me dikë), si në shembullin e fjalive të mëposhtme:[307]

You could tell dad was worried about something because he ***was short with*** everyone.
(Ishte e dukshme se babai ishtë i shqetësuar për diçka pasi ai ishte***i pasjellshëm*** me të gjithë.)
(*be short with s.b - >be rude,të jesh i pasjellshëm,arrogant*)

You should try ***to be civil*** with your friends.
(Ti duhet të përpiqesh të jesh ***i sjellshëm*** me shokët e tu.)
(be civil with s.b -> be nice, të jesh i sjellshëm)

Nga shembujt e mësipërm kuptojmë, se mbiemri, në varësi të emrit që përcakton, merr nuanca të ndryshme kuptimore, dhe si rezultat edhe antonime të ndryshme.

Në lidhjen e antonimisë me poliseminë, R. Memushaj vëren, se "*shpesh njëri kuptim i një fjale hyn në lidhje antonimike me një fjalë të caktuar, ndërsa një kuptim tjetër i kësaj fjale formon antonim me një fjalë tjetë*r"[308], si psh.: "*i fortë/i butë","i fortë / i dobët"*, etj.

Antonimet e formuara nga polisemia kanë kundërvënie të pjesshme, sepse kundërvihen kuptimet e dyta. Autorë të ndryshëm dallojmë disa tipe:

a. antonime polisemike, që kanë dy ose më shumë kuptime dytësore të kundërvëna; foljet: "shkoj/rri", etj.

b. kundërvënia e një fjale monosemantike me një fjalë polisemantike; shembull: "i lirë/ i kyçur", etj.

c. dy antonime polisemantike tek të dy gjymtyrët: foljet: "vë / heq", etj.

d. dy antonime polisemike me kuptime të drejtpërdrejta, ku një çift kundërvihet në kuptimin kryesor dhe të tjerët me kuptim dytësor, si për shembull: "e madhe/ e vogël", etj.

e. kundërvënie ndërmjet antonimeve të figurshme të lidhura ngushtë me stilet letrare: "i ndyrë / i pastër", në kuptimet e tyre të figurshme.[309]

Në lidhjen e antonimisë me poliseminë vërejmë se disa fjalë me përbërje fonetike të njëjtë kanë kuptime të ndryshme në kundërshti me parimin themelor të antonimisë, e cila ekziston në fjalë me përbërje fonetike të ndryshme".[310] Kjo njihet ndryshe si enantiosemi, si në shembujt: folja*"qit"* ka kuptimin *"nxjerr"*dhe kuptimin *"hedh brenda"*, folja "*godit*" ka kuptimin "*ndërtoj", "rregulloj"* por ka edhe kuptimin "*qëlloj", "i bie"*.

Gjithashtu, është me interes ekzistenca e marrëdhënieve të kundërvënies me fjalë të tjera, jo në të gjitha kuptimet leksikore, madje vetëm në njërin prej tyre, p.sh.,

[307]H. Jackson , E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.128.
[308]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.172.
[309] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.173.
[310] R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.173.

"*dal/hyj"* (edhe pse ka 35 kuptime). Po kështu, në mënyrë të ngjashme çiftet foljore "*kap/lëshoj"* krijojnë antonimi vetëm në njërin kuptim.

Në vazhdim, shohim se polisemia mund të krijojë probleme në përcaktimin e pikës së mesme neutrale, e cila lejon shkallëzimin e disa tipeve të antonimisë. Përcaktimi i pikës se mesme, sjell krijimin e shkallëve të ndryshme të kundërvënies, por përcaktimi i saj nuk është i lehtë, madje në çiftet antonimike të tipit "*shes/blej",* nuk mund të ketë një pikë të mesme. Përgjithësisht, kjo pikë e mesme përcaktohet nga përvoja e gjatë historike e përdorimit të antonimeve në një gjuhë të caktuar. Pra, themi se probleme me përcaktimin e kësaj pike të mesme përbëjnë edhe fjalët polisemantike, ku norma lëviz sipas kuptimit dhe fushës semantike ku ato përdoren.

Për më shumë, për sa i pëket polisemisë, vërejmë se në shumë njësi leksikore me çifte kanonike të cilat kanë polisemi të lartë, kundërvënia e tyre qendron në shumë prej kuptimeve të tyre. Për më shumë, Wirth vëren, se shumë "*nga modelet e polisemisë janë të zakonshme në shumë gjuhë*".[311] Kështu, p.sh., çifti mbiemëror "*big/little" (imadh/i vogël)* përdoret në kuptimin "*old/young" (i vjetër /i ri)* si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Një tjetër tipar universal vërehet në zhvendosjen kuptimore të antonimeve polisemike.Tek sruktura e gjymtyrës së shënuar tek antonimet polisemike vërejmë se kur dy fjalë kundërvihen në dy fusha semantike të ndryshme, nëse njëra prej gjymtyrëve është e pashënuar në njërën fushë, ajo do të jetë e tillë edhe në fushën tjetër.

2.4.2 Marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë, si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe

Sipas J. Thomait, "*sinonimet janë fjalë të afërta nga kuptimi dhe kanë si burim ngjyrimin stilistik*".[312] Gjymtyrët antonime mund të hyjnë në kundërvënie edhe me sinonimet e tyre, dhe kjo realizohet në mënyrë paralele ose të ndërthurur".[313] Në ndryshim nga sinonimet, antonimet janë një karakteristikë e vërtetuar dhe natyrale e gjuhës, që mund të përcaktohen me përpikëri.

Antonimia është parë edhe si e kundërta e sinonimisë me argumentin se, nëse dy fjalë janë antonime ato ndryshojnë në kuptim dhe formojnë dy pjesë plotësuese të ndryshme. Megjithatë, ky këndvështrim nuk qendron për arsyet që i kemi argumentuar më lart kur trjatuam antoniminë përballë mohimit, etj.

Për sa i përket raportit me sinoniminë, mund të themi, se pothuaj çdo fjalë mund të ketë një apo më shumë sinonime, por shumë pak fjalë kanë antonime. Si rezultat, themi se kundërvënia në raport me ngjashmërinë (sinonimin) nuk është aq e përhapur, por ashtu si edhe sinonimia, ka një rol të rëndësishëm në ristrukturimin e fjalorit të gjuhës. Gjithashtu, antonimia vjen në ndihmë të studimeve mbi sinoniminë, pasi vështrimi i sinonimeve në plan semantiko–sintaktik, dhe në raport me antonimet ndihmon për një përcaktim më të drejtë të karakterit të sinonimisë së fjalëve.[314]

---

[311] Citim i vjelë nga M. L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f.213.
[312] J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.129.
[313] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhes së Sotme Shqipe, Instituri Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[314] M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike,f.60.

Me interes është edhe fakti se të gjitha antonimet kanë sinonime të cilat i rezistojnë antonimisë.[315] Kështu për shembull, çifti mbiemëror "*happy*" (i lumtur) dhe "*sad*" (i zemëruar) janë të kundërta më të qarta sesa "*ecstatic*" (në ekstazë, i hahnitur) dhe "*miserable*" (mjeran, i trishtuar). Ndërkohë, si kundërargument i një shembulli të tillë kemi faktin se çifti sinonimik "*sad*" dhe "*miserable*" mund te jenë të ngjashëm në kuptim, por jo identik, ashtu sikurse dhe "*happy*" dhe "*estatic*" nuk janë tërësisht të shkëmbyeshëm me njëri-tjetrin. Pavarësisht se "*miserable*" dhe "*ecstatic*" i përkasin të njëjtës fushë semantike, asaj të lumturisë, këto fjalë nuk e kanë fuqinë antonimike të kundërvënies "*happy*" dhe "*sad*".

Tek antonimia stilistike dallojmë sinoniminë, që sipas Samarës,[316] mund të trajtohet e klasifikuar në katër lloje apo variante:

a) *antonimia stilistike* (e tipit *mësues*/*dhaskal*) që bazohet në kundërvënien midis fjalës stilistikisht asnjanëse dhe fjalës sinonim, që është vjetruar dhe ka fituar ngarkesë emocionale; në anglisht: *enemy*/*foe (armik/armik[317]).*

b*) antonimia stilistike* (e tipit *litar/fortomë* ose *helmohet/farmakoset*) që bazohet në kundëvënien midis fjalës së përgjithshme me përhapje të gjerë e stilistikisht asnjanëse dhe fjalës përgjegjëse krahinore ose të huaj, me përhapje të kufizuar, që ka marrë ngarkesë stilistike; në anglisht: *brotherly*/*fraternal (vëllazëror/vëllazëror[318]).*

c) *antonimia stilistike me bazë funksionale* (e tipit *gazetë*/*lëpushkë, atdhe*/*mëmëdhe, bëj*/*kryej, e vrau*/*epalosi*), që bazohet në kundërvënien midis fjalëve sinonime të ligjërimeve të ndryshme, ose të stileve të ndryshme funksionale të gjuhës letrare shqipe; në anglisht: "*die*/*pass away" (vdes/ndërroj jetë).[319]*

ç) *antonimia stilistike mbi bazën e kundërvënies së dy kuptimeve brenda strukturës semantike të së njëjtës fjalë*: të kuptimit pozitiv ose asnjanës dhe kuptimit të kundërt keqësues të saj të vënë zakonisht në thonjëza ose të shoqëruar me përcaktorët "gjoja", "i ashtuquajtur", si p.sh.,*trim* (i vërtetë)/*trim*(i rremë).

Antonimet dhe sinonimet shpesh vendosen në një grup, kur bëhet fjalë për "lidhje semantike ndërmjet fjalëve, që nuk vijnë nga njëra tjetra as si formime, as si kuptim, pra, ndërmjet fjalëve të ndryshme pa lidhje prejardhjeje, por që kanë një bosht kuptimor të përbashkët e mund të grupohen për këtë arsye në një klasë leksikore".[320] Këto lloj lidhjesh njihen si lidhje semantike të pakushtëzuara, në dallim nga lidhjet semantike të kushtëzuara, si ato ndërmjet fjalëve të parme dhe fjalëve të prejardhura.

Lidhja e ngushtë midis sinonimisë dhe antonimisë trajtohet edhe nga Cruse, sipas të cilit *dallimi midis sinonimeve dhe antonimeve është, që tek sinonimet tiparet e tyre të*

[315] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.114.
[316] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 218.
[317] Shënim: "*foe" përbën një shembull të ngjashëm me "dhaskal" për nga nuanca stilistikore e fjalëve të vjetëruara*
[318] Shënim: "*fraternal*" përbën një shembull të ngjashëm me "*fortomë*", për nga nuanca stilistikore e fjalëve krahinore
[319] Shënim: "*pass away*" përbën një shembull të ngjashëm me "*e palosi*", për nga nuanca stilistikore
[320] J. Thomai (2005) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Dudaj, f. 129.

përbashkëta janë më të rëndësishme, se dallimet midis tyre.[321] Për më shumë Palmer pranon rëndësinë që kanë antonimet gjatë dallimit të sinonimeve.[322] Përveç testit të zëvendësimit me gjymtyrët sinonime, ai e sheh antoniminë, si një mënyrë për testimin e sinonimisë. Kështu, "*superficial"*(sipërfaqsor) vendoset në marrëdhënie kundërvënieje me "*deep" (i thellë)* dhe "*profound" (i thellë)*, ndërsa "*shallow"* (i cekët) vendoset në këtë marrëdhënie vetëm me "*deep"*. Ndoshta, fakti që dy fjalë duket se kanë të njëjtat antonime është një arsye për t'i konsideruar sinonime, por shembujt e dhënë më sipër tregojnë se përsëri do të arrijmë tek fjalë që janë të këmbyeshme në disa kontekste, pasi është pikërisht në kontekstin në të cilin "*deep" (i thellë)* dhe *profound* (i thellë) janë të këmbyeshme ku ato marrin antonimin "*superficial*" (sipërfaqsor).

Sinonimia mund të shfrytëzohet, kur dallohen homonimet nga polisemia e fjalës. Një nga mënyrat për të bërë këtë dallim është kriteri i mëposhtëm: kemi homonime kur dy fjalëve mund t'u përgjigjen dy sinonime të ndryshme: p.sh: *çoj*$_I$ "dërgoj" / *çoj*$_{II}$ "ngre lart"; bie$_I$ "rrëzohem" / *bie*$_{II}$ "sjell"/ *bie*$_{III}$ "godas" etj; kemi polisemi, kur dy kuptimeve mund t'u përgjigjet një sinonim i përbashkët: p.sh., "*gjëmon"* (moti) dhe "*gjëmon"*(lufta) "*buçet, kërcet, uturin*", etj.[323]

Fjalët e gjuhës shqipe me foljet dhe mbiemrat, mumd të hyjnë njëkohësisht në marrëdhënie të ndryshme antonimie dhe sinonimie [324] , si p.sh., folje: "*çohem/ulem/shtrihem*", mbiemrat: "*i gjerë/ i ngushtë/i kufizuar"*. Në kuptimet e para në rrafshin horizontal kundervënia është më e qartë dhe më e plotë. Antonimia e fjalëve me kuptimin e figurshëm është më e dobët, dhe më e vogël në numër. Fjalët në kuptimet e abstraktuara kanë më shumë liri në përdorime sinonimie, si për shembull, "*i egër/i butë*", "*kokëfortë/qengj*" etj.

Nga ana tjetër, ekziston një tendencë e gjuhëtarëve për të evituar sinoniminë në gjuhë. Prandaj, mbiemra të tillë si "*high/low*" nuk kanë forma paralele morfologjike. Zimmer e vë në dukje këtë fakt me idenë e shmangies së sinonimisë në gjuhë.[325]

Ndryshe nga sinonimiet, antonimet nuk ndryshojnë në stil, në ngjyrim emcoional apo në shtrirje. Në pjesën më të madhe të konteksteve ato janë të shkëmbyeshëm. Gjithashtu vëm re, se i gjithë kuptimi i një fjalie do të ndryshojë nëse do të shkëmbejmë gjymtyrët e nje çifti antonim si në shembujt[326]:

"You may feel he is **clever**."
(mund ta kuptosh se ai është **mendjemprehtë**.)

"You may feel he is **foolish**."
(mund ta kuptosh se ai është **teveqel.)**

Në vijim, vërejmë se edhe fjalët antonime të përbëra e të përngjitura mund të hyjnë në marrëdhënie sinonimie me njëra-tjetrën. P.sh., kompozita "*fjalëpakë"* mund të

[321] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.115.
[322] F. R. Palmer (1981) Semantics.Cambridge: Cambridge University Press, f. 92.
[323] J. Thomai (1981) Tipat Themelor të Derivacionit Semantik të Gjuhës Shqipe, f.101.
[324] J. Thomai (1981) Tipat Themelor të Derivacionit Semantik të Gjuhës Shqipe, f.101.
[325] Cituar nga M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and Other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f .202.
[326] Shembuj të shkëputur nga M. L. Murphy(2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and Other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f .204.

hyjë në marrëdhënie sinonime me *fjalëkursyer*, kurse "*fjalëshumë"* mund të hyjë në marrëdhënie sinonimie me "*fjalëmadh"* ose "*fjalëgjatë"; "shpirtmirë"* ndërton sinonimi me"*shpirtbutë", "zemërmirë"* e "*zemërbutë"*, kurse antonimi "*shpirtkeq"* krijon sinonimi me "*shpirtlig", "shpirtegër"* e "*shpirtashpër", "zemërkeq", "zemërlig"*; fjala e përngjitur "*kurdoherë"* mund të formojë sinonimi me fjalët "*gjithnjë"* e "*gjithmonë"*, kurse "*asnjëherë"* mund të formojë sinonimi me "*kurrnjëherë"*[327]. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2002) ekziston një varg i gjatë fjalësh të përbëra sinonime me gjymtyrë të parë fjalën "*zemër"* ose "*shpirt"*, që mund të hyjnë në marrëdhënie antonime me një varg më të gjatë fjalësh të tilla përgjegjëse me kuptim të kundërt. *Mbiemrat e përbërë* mund të hyjnë edhe në marrëdhënie sinonimike me njera-tjetrën: "*fjalëpak/fjalekyrsyer/fjalëshumë/fjalëmadh*" etj.jo vetëm në kuptimet e fjalëve te tyre të veçanta, por në tërësine e tyre kuptimore".[328] Çiftet antonimike të përbëra mund të hyjnë dhe në marrëdhënie sinonimie të tipit "*zemërkeq, zemerlig*" përballë "*zemërmirë, zemërbutë*", si në skemën e mëposhtëme[329]:



Figura 4 Marrëdhënia antonimike ndërmjet gjymtyrëve sinonime të një çifti antonimesh të përbërë

Kur *togfjalëshat e qendrueshëm* leksikalizohen ato marrin kuptimin e një fjale të vetme, pra, ato kanë kuptim unik dhe shpesh dalin si sinonime të fjalëve ekzistuese.

1. *Paralele ose lineare sipas skemës*



Figura 5 Lidhjet paralele

Në skemën e mësipërme A dhe B formojnë kundërvënie kryesore, C dhe E janë sinonime të A, ndërsa D dhe J janë sinonime të B . Le të shohim disa shembuj:

Foljet**:**

qaj/qesh

dëshpërohem/gëzohem

Mbiemrat**:**

i turbullt/i kthjellët

i zymtë/i çelët

i vrerët/i qeshur

2. Lidhjet e ndërthurura ose radiale

[327] L. Danglli (2012) Çështje të Sinonimisë në Gjuhën Angleze dhe Shqipe, Punim Doktorate, f.78.
[328] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 175.
[329] Shembujt e skemat të shkëputura nga M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 175-177.



Figura 6 Lidhjet e ndërthurura

Mbiemrat:



Figura 7 Lidhjet e ndërthurura mbiemërore

Foljet:



Figura 8 Lidhjet e ndërthurura foljore

Pikërisht, grupi i antonimeve radiale[330] përbejnë antonime stilistikore, kurse ato lineare përbërjnë antonime të zakonshme, kryesisht të mirëfillta.

Në gjuhën shqipe, I. Goçi[331] dallon tre lloje antonimesh sinonimike:

1. *Një fjalë monosemantike, që ka si antonim dy ose më shumë sinonime* A-BCC.

Folje:

filloj / pushoj, përfundoj, mbaroj

Mbiemër:

i lirë/ i mbyllur, i burgosur, i lidhur, i robëruar, i kyçur

2. *Antonime sinonimike, ku gjymtyrët kanë një numër jo të barabartë sinonimesh, të cilat hyjnë në kundërvënie.*

A^1-B

A^2- CCD

Figura 9 Antonime sinonimike

Këtu kemi të bëjmë me një kundërvënie të pjesëshme.

3. *Antonime të degëzuara, jo paralele me kahje të ndryshme.*

[330] Shënim: terminologji e përdorur nga I.Goçi, "*rrezore*"
[331] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.21.

Antonimia stilistike si edhe sinonimia stilistike luajnë një rol të rëndësishëm në theksimin e idesë, e cila përcillet te lexuesit dhe dëgjuesit. Megjithatë, sinonimet i japin folësit a shkruesit më shumë mundësi zgjedhjeje për shprehësi, kështu që antonimet përbëjnë mjete stilistike periferike ".[332]

Ashtu si edhe sinonimet, ato zënë një vend të rëndësishëm në pasurinë frazeologjike të një gjuhe, si në shembujt[333] "*in black and white*" (zyrtare, me shkrim), "*play fast and loose*" (të jesh i papërgjegjshëm), etj.

Sinonimet kryesisht formojnë grupe, ndërsa antonimet kryesisht formojnë çifte. Edhe në rastet, kur kemi të bëjmë me më shumë se dy antonime brenda një boshti, përsëri gjymtyrët e këtij boshti mund të reduktohen në kundërvënie binare (*hot/warm/cool/cold* mund të ndahen në çifte "*hot/cold*", "*i nxehtë/i ftohtë*" dhe "*warm/cool*", "i ngrohtë/i freskët"). Për më shumë, Samara shton se "*një problem i rëndësishëm është edhe antonimia sinonimike midis fjaleve me parashtesa dhe pasqyrimi i tyre në fjalor*".[334]

Si përfundim themi, se gjymtyrët antonime mund të hyjnë në kundërvënie edhe me sinonimet e tyre, dhe kjo realizohet në mënyrë paralele ose të ndërthurur. Si sinonimia edhe polisemia janë të rëndësishme për studimin e antonimeve, pasi, sipas M.Samarës, "*në bazë të kuptimeve të kundërta të fjalëve polisemike dhe të afërsisë që ato kanë me fjalë të tjera të shqipes, krijohen disa tipe a modele lidhjesh ndërmjet vargjeve sinonimike e antonimike".*[335] Madhësia ose gjatësia e këtyre vargjeve në gjuhë të ndryshme është e ndryshme, p.sh.: "*i martuar/i pamartuar/ beqar"*. Për më shumë, njohja e strukturës polisemantike të fjalëve do të ishte me shumë rëndësi për studimin e marrëdhënieve të antonimisë që vendosen midis njësive sinonimike. Siç e pam më lart, fjalët polisemantike mund të vendosin marrëdhënie sinonime në një ose disa prej kuptimeve të tyre, por jo në të gjitha kuptimet.

2.5 Tipare të përgjithshme të antonimeve mbiemërore dhe foljore

Në literaturën e shqyrtuar në këtë studim evidentohen tipare të dallueshme dhe të shumëllojshme të antonimeve mbiemërore dhe foljore. Përmbledhurazi, Lehrer [336] karakteristikat e mëposhtme si tipare të përbashkëta të antonimeve.

1) Kanë shkallëzim të plotë (kryesisht mbiemrat dhe pak folje)

2) Gjymtyrët përbërës të një çifti paraqesin shkallë të një cilësie të caktuar, si për shembull: gjatësi, shpejtësi, peshë, etj.

3) Kur përcaktohen përmes fjalëve të tipit *very, fairly, moderately, extremely*, etj., gjymtyrët përbërës të një çifti lëvizin në drejtime të kundërta përgjatë boshtit, ku ato paraqesin shkallë të ndryshme të cilësisë së ndryshueshmërisë së tipit gjatësi, shpejtësi, peshë, etj. Për shembull, "*very heavy*" (shumë e rëndë) dhe "*very light" (shumë e lehtë)* janë më të ndara në shkallën e peshës sesa çifti "*fairly heavy"*(mjaft e rëndë) dhe "*fairly light" (mjaft e lehtë).*

[332] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 21.
[333] A. Lehrer, K. Lehrer (1982) Antonymy, Linguistics and Philosophy, f. 483–501.
[334] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 175.
[335]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 216.
[336] A.Lehrer, K. Lehrer (1982) Antonymy, Linguistics and Philosophy, f. 483–501.

4) Gjymtyrët e një çifti jo domosdoshmërisht ndajnë më dysh një fushë të caktuar, por ekziston një gamë vlerash të cilësisë së ndryshueshmërisë, të cilat qendrojnë midis vlerave të gjymtyrëve kundërshtuese. Si rezultat, një thënie që përmban një nga gjymtyrët përbërës të një çifti antonim,qendron në një lidhje kundërshtie me një thënie paralele që përmban termin tjetër të çiftit, p.sh. "*It's long"*(*Është e gjatë*) dhe "*It's short"*(*Është e shkurtër*) janë kundërshtuese, por nuk janë kontradiktore. Gjithashtu, kur themi "*It's neither long nor short" (Nuk është as e gjatë, as e shurtër),* nuk është paradoksale, pasi ekziston një hapësirë brenda shkallës së gjatësisë, që i përshtatet pikërisht këtij përshkrimi. Pra, duhet të themi, se antonimet krijojnë një bosht dhe shumë cilësi të tyre konceptohen në situata të tipit "*më shumë ose më pak"*. Ekziston një *pike zero* dhe një çift antonimik i vendosur në një shkallë të tillë përbëhet nga një term, i cili tenton drejt zeros dhe termi tjetër, i cili ka tendencë në drejtimin e kundërt. Gjithashtu, ekziston edhe një pikë e boshtit (*pike rrotullimi*) e cila përbën një zonë neutrale dhe nuk mund të referohet nga asnjë prej gjymtyrëve përbërës të çiftit antonimik. Cruse e quan ketë "*Pivotal Region*" dhe nuk emërtohet gjuhësisht nga ndonjë njësi leksikore. Këtu bën përjashtim vetëm njësia leksikore "*lukewarm*" (i vakët) dhe "*tepid*" (i vakët), të cilat i referohen pikërisht pikës së rrotullimit në bosht midis çiftit antonimik *hot /cold.* Ky pra është edhe përjashtimi i vetëm, ku kjo pikë e boshtit përfaqësohet nga një njësi leksikore. Mënyra se si funksionon ky bosht dhe se si përfaqësohet çifti antonimik në të është jo e thjeshtë për t'u shpjeguar, dhe duhet të kemi parasysh dy tipet e boshteve:

1) boshti absolut, që përfshin të gjitha vlerat e mundshme të cilësisë së shkallëzuar nga zeroja në pambarim.

2) boshti relativ, i cili është i lëvizshëm në lidhje me shkallën absolute dhe vlerat e të cilës lidhen drejtpërsëdrejti me gjymtyrët përbërës të çftit antonim.

Për shembull, çifti "*short/long"* (*i shkurtër/ i gjatë)* e paraqet vlerën në shkallën absolute, të cilat ndryshojnë në varësi të referentit me të cilin ato përdoren, p.sh.,"*long river/short river", "long hair/short hair",* etj.

Antonimia është përcaktuar si një marrëdhënie *simetrike, jorefleksive* dhe *jokalimtare.*[337] Në përgjithësi, antonimet janë simetrike, që do të thotë, se: "*Nëse A është e kundërta e B, B është e kundërta e A".* [338] Marrëdhënia e antonimisë është reciproke, por jo gjithmonë simetrike, pasi ndodh që një fjalë A të sjell një antonim B, por B mund të mos e sjell A në të njëjtën masë. Justeson dhe Katz,[339] janë ata që kanë theksuar *tendencën e antonimeve për t'u bashkërenditur në struktura simetrike*. Jones[340] identifikoi disa struktura ku **x** dhe **y** janë vendosur në pozicione simetrike dhe janë të anasjellta në një masë të caktuar.:

"**x** and **y**"
(**x** dhe **y**)

"from **x** to **y**"
(nga **x** në **y**)

[337] G. Evens (1976) Semantic Structure and Logical Form, f. 199–222.
[338]C. Paradis (2010) Good, Better and Superb Antonyms: A Conceptual Construal Approach.the Annual of Texts by Foreign Guest Professors, Faculty of Arts, Charles University Prague, f.75.
[339] J. S. Justeson, S. M. Katz (1991) Co-occurrences of Antonymous Adjectives and Their Contexts, Computational Linguistics, f. 1–19.
[340]S. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f..96.

"**x** or **y**"
(**x** ose **y**)

Figura 10 Strukturat e S. Jones

Antonimet janë jorefleksive për faktin, se një njësi leksikore nuk mund të jetë antonim i vetvetes. Këtu mund të përdorim si kundër argument faktin se ekzistojnë edhe fjalë antonime të vetvetes, si në rastin e enantiosemisë, të cilin i kemi trajtuar edhe më lart. Gjithsesi kjo mbetet një çështje e disktutueshme.

Në lidhje me tiparin *jokalimtar*, vërejmë se antonimet nuk mund të shikohen si kalimtare, për arsye se ky tipar nuk është tipik për çiftet antonime binare, si p.sh "*tall"(i gjatë)* është e kundërta e "*short" (i shkurtër),* ndërkohë që në një kontekst tjetër del se "*long"* është e kundërta e "*short*", por kjo nuk do të thotë se "*tall"* është e kundërta e "*long"*. Në raste shumë të pakta, në rrethana të caktuara, strukturat e kundërvëna mund të shihen si kalimtare, si p.sh: në kundërvënien e ngjyrave ku "*red" (e kuqe)* i kundërvihet "*yellow" (e verdhë)*, "*yellow"* i kundërvihet "*green" (jeshile),* por edhe "*red"* mund të kundërvihet me "*green"*.[341]

Tipar tjetër me rëndësi është edhe ai i *shënimit*. Tipari i gjymtyrës së shënuar është një burim kryesor i asimetrisë ndërmjet gjymtyrëve të çiftit antonim.[342] Madje disa gjuhëtarë, si Handke e shohin antoniminë si "marrëdhënie ndërmjet njësive të shënuara, dhe jo të shënuara". [343] Ai përdor termin "*gradable contrariety*" (kundërvënie e shkallëzuar) në vend të "*antonymy*". Ky tipar i antonimeve del qartë, pikërisht brenda mbiemrave të shkallëzuar, të cilët kanë një shpërndarje asimetrike brenda çiftit. Lehrer shpjegon qartë tiparet e gjymtyrës së pashënuar dhe përcakton si kriter bazë për t'i dalluar ato nga gjymtyra e shënuar, faktin se gjymtyrët e pashënuara përdoren në mënyrë neutrale. Ai gjithashtu radhit disa nga mënyrat më të zakonta, në të cilat ndodh neutralizimi për mbiemrat antonimikë:

- në format pyetësore të tipit "*How tall is he?", "Sa i gjatë është ai?"*
- në emërzim të tiparit, si për shembull "*warmth", "ngrohtësi"* ("*warm/cool", "i ngrohtë/i freskët",* emërzohen si *"warmth", jo "coolness"*)
- në shprehjet e matjes, si për shembull "*three feet tall", "tre shputa i gjatë"* (jo "*three feet short"*)
- tek çiftet antonime morfologjike gjymtyra që mban parashtesën negative është e shënuar ("*happy/unhappy", "i lumtur/jo i lumtur"*)
- gjymtyra e pashënuar është zakonisht pozitive, ndërsa ajo e shënuar është negative ("*good/bad*", "*i mirë/i keq*")
- gjymtyra e pashënuar tregon një sasi më të madhe të cilësisë ("*big/little*", "*i madh/i vogël*")
- në raporte asimetrike, gjymtyra e pashënuar ka më pak gjasa të dalë si "*commited*" (e angazhaur) si në shembullin "*X is better than Y"*(këtu X mund të jetë *good,*pra *i*

[341]C. Paradis (2010) Good, Better and Superb Antonyms: A Conceptual Construal Approach.The Annual of Texts by Foreign Guest Professors, Faculty of Arts, Charles University Prague, f.75.
[342]Vendler (1963) cituar ngaS. Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f..96.
[343]P. Handke (1995) Die Stunde Da Wir Nichts Voneinander Wußten. Ein Schauspiel, Suhrkamp, f.174.

mirë apo *bad, i keq*), "X is worse than Y", "X është më i keq sesa Y" (X është i keq, jo i mirë)

- vetëm gjymtyra e pashënuar gjendet në shprehje, që tregojnë proporcion, si për shembull "*twice as old", "dy herë më e madhe në moshë" (*dhe jo*"twice as young", "dy herë më e re në moshë")*

Cruse dhe Lehrer e kanë trajtuar këtë tipar si të rëndësishëm në raportet antonimike, ndërsa të tjerë gjuhëtarë nuk e kanë parë me kaq imtësi e me interes.[344] Për shembull, Bartsch dhe Vennemann theksojnë, se "*tipari i gjymtyrës së shënuar dhe jo të shënuar përbën vetëm mjë veçori leksikore të fjalëve*".[345]

Megjithatë, Cruse e justifikon trajtimin e zgjeruar të këtij tipari duke kundërshtuar qendrimin e Bartsch dhe Vennemann me faktin se "*ky është një tipar leksikor dhe përfaqësohet përmes antonimisë, pasi fjalët nuk janë të shënuara ose jo të shënuara në vetvete, por në raport me njëra-tjetrën".*[346] Kështu për shembull, mbiemri "*tall"* nuk është i pashënuar në vetvete, por në raport me mbiemrin "*short"*. Për më shumë, një njësi leksikore mund të dalë si e pashënuar përballë një gjymtyre antonime të caktuar, e më pas të dalë e shënuar përballë një tjetër gjymtyre.

Në lidhje me problematikën që ndeshim në trajtimin e këtij tipari brenda antonimisë, mund të vërejmë se ai është një tipar i cili varet nga konteksti i përdorimit të fjalëve. Për më shumë, ky tipar është i dukshëm brenda gjinisë natyrore, ku gjinia mashkullore në përgjithësi rezulton të jetë *e pashënuar* dhe ajo femërore *e shënuar* në gjuhën angleze.[347] Ndërkohë që kur flasim për profesione femërore si "*nurse" (infermiere)*, "*secretary" (sekretare)*, "*prostitute" (prostitut),* etj., del se gjinia femërore është *e pashënuar* në raport me atë mashkullore. Në të tillë shembuj gjinia mashkullore shënohet përmes formës "*male nurse" (infermieri)*.

Për sa i përket problemit të asimetrisë që lidhet me tiparin *e shënuar* apo *jo të shënuar* të mbiemrave antonime, Cruse jep kundërargumentin e tij në lidhje me këtë asimetri, duke ilustruar raportin simetrik (në kundërvënie me idenë e asimetrisë) të gjymtyrëve të çiftit "*tall/short*" (I gjatë/i shkurtër) si më poshtë:

Boshti i lartësisë

<short tall>

0----------(N)---------->∞

Figura 11 Raporti i simetrisë për "tall/short"

Në figurën e mësipërme duket qartë se "*tall"* paraqet drejtimin që largohet nga pika 0, ndërkohë që "*short"*paraqet drejtimin i cili shkon drejt pikës 0, pra si rezultat kuptimet e tyre janë simetrike në raport me një pikë neutrale (N). Kjo pikë neutrale varet nga konteksti i matjes së lartësisë, pra merret si një normë e lartësisë, e cila do të përcaktojë çka është me e lartë dhe më e shkurtër, sesa ajo pikë në një kontekst të caktuar.

[344]G. Sampson (1974) Semantic Structures by Renate Bartsch; Theo Vennemann:Foundations of Language, Springer, f.287-289.
[345] Cituar nga: G. Sampson (1974) Semantic Structures by Renate Bartsch; Theo Venneman :Foundations of Language, Springer, f.287-289.
[346] D.A. Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f.105.
[347]G. Leech (1974) Semantics. Middlesex, Penguin, f.157.

Vërejmë se edhe në gjuhën shqipe mbiemri "*i shkurtër"* (*short*) është i shënuar në raport me "*i gjatë"* (*tall*). Kjo është e dukshme pasi edhe në gjuhën shqipe plotësohen kriteret e Lehrer për gjymtyrën e pashënuar si në shembujt më poshtë:

- Sa *e gjatë* është ajo? (dhe jo *Sa e shkurtër është ajo?*)
- Zana është dy herë më *e gjatë* sesa e motra.
- Formimi i emrit për këtë dimension është "*gjatësi*" (dhe jo "*shkurtësi*") etj.

Sa më lart për gjuhën shqipe, përforcohet edhe nga mendimi i Wirth, i cili e konsideron këtë raport universal, duke theksuar, se "*asnjë gjuhë nuk ka një fjalë për* short *(si vlerë relative) që nuk është e shënuar në raport me fjalën që përdoret për* tall".[348] Megjithatë, ai shton, se edhe kur kemi raste të shënimit jouniversal "*ai e ka burimin tek asimetria me bazë kulturore*". [349]

Por jo të gjithë mbiemrat janë asimetrikë sipas tipareve të përcaktuara nga Lehrer[350]. Kështu për shembull, edhe pse çifti mbiemëror "*warm/cool*"*(i ngrohtë/i freskët)* është asimetrik dhe dallojmë "*warm"*si gjymtyrë të pashënuar dhe*"cool"* si gjymtyrë të shënuar, nga ana tjetër, çifti antonim brenda të njëjtit dimension "*hot/cold"(i nxehtë/i ftohtë)*rezulton të jetë simetrik. Kjo vërtetohet përmes faktit se si mbiemri *hot* edhe ai *cold* mund të emërzohen ("*heat/cold", "i nxehtë/i ftohtë"*). Të dyja përdoren njësoj në strukturat pyetësore të tipit "*How…?"(Sa…?), e*tj.

Si rezultat, ne mendojmë se marrëdhënia e antonimisë është simetrike nga ana logjike. Bazuar në provat e mësipërme të asociacionit të fjalës, rezulton se marrëdhënie të caktuara antonime mund të ruhen në mendjen tonë sipas drejtimeve të ndryshme që ato kanë. Ndërkohë që shpërndarja asimetrike e gjymtyrëve të çiftit tregon edhe natyrën e tyre semantike asimetrike.

Megjithatë, përpjekjet për ta paraqitur atë në leksikun e një gjuhe nuk janë të suksesshme, pasi asimetria përmes tiparit të shënimit është e bazuar tek informacioni konceptual që ne kemi për ato fjalë, dhe kjo nuk mund të paraqitet në leksik dhe jo të gjithë mbiemrat janë asimetrikë. Por, fakti se një pjesë e mirë e mbiemrave janë asimetrik në përdorim, brenda një konteksti të caktuar, gjithashtu vë në dyshim edhe bindjen e bazuar tek tradita se fjalët në një marrëdhënie paradigmatike duhet të jenë të zëvendësueshme nga njëra-tjetra në të gjitha kontekstet.[351] Kjo vihet në dyshim edhe nga shembulli i mëposhtëm[352]:

How *big* is your house?

(Sa e madhe është shtëpia jote?)

(këtu *big* nuk mund të zëvendësohet me *small*)

[348] Cituar nga M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and Other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f. 204.
[349] Cituar nga M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and The Lexicon: Antonyms, Synonyms and Other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f .204.
[350] A. Lehrer, K.. Lehrer (1982) Antonymy, Linguistics and Philosophy, f. 483–501.
[351] A.Lehrer, K..Lehrer (1982) Antonymy, Linguistics and Philosophy, f. 483–501.
[352] Shembull i shkëputur ngaA.Lehrer, K..Lehrer (1982) Antonymy, Linguistics and Philosophy, f. 483–501.

Një tjetër tipar përbën edhe fakti se disa çifte janë "antonime më të mira" se disa të tjera. Kjo lidhet me "*natyrën e kuptimeve të antonimeve më kanonike tradicionale në kundërvënie me antonimet e tjera, të cilat kanë gjymtyrë jo të dallueshëm mirë, dhe kjo çështje shihet përmes ndërtimit ontologjik (natyra e ekzistencës së tyre), simetrisë së antonimisë në raport me kufijtë e gjymtyrëve, konfigurimi i përmbajtjes dhe i gjymtyrëve, gama e përdorimit të tyre kontekstual si edhe frekuenca e përdorimit".*[353] Kështu, dallohen njësitë leksikore, të cilat lidhen ngushtë me një gjymtyrë partnere në gjuhë të cilët njihen si "*qenësisht binare*" në segmentin kuptimor.

Marrëdhëniet e antonimisë përcaktohen gjithashtu edhe nga tipari binar i tyre. Ndërkohë që strukturat kundërshtore përbëhen nga më shumë se dy gjymtyrë, në kundërvënie kemi kundërvënie ballëpërballë të dy gjymtyrëve. McNeill mendon, se "*Vetë natyra njerëzore ka aftësi të krijojë fusha kundërvënieje, në mënyrë që të shquajë dallimet*."[354] Pra, nuk shihet kundërvënia, si pjesë përbërëse e sistemit leksikor, por si aftësi e të menduarit njerëzor.

Murphy njihet edhe për përcaktimin e kushteve të binaritetit. Tipari binar në marrëdhëniet leksikore mund të lindë në mënyra të ndryshme. Një nga mënyrat më të mundshme është ajo e *rastësisë.*[355] Pra, ka raste që vetëm dy njësi leksikore në marrëdhënie kundërshtie qendrojnë brenda një strukture pa asnjë gjymtyrë të mesme. Të tillë janë çiftet e fjalëve që shënojnë gjymtyrët e trupit të njeriut. Cruse nuk i njeh si antonime ato çifte fjalësh të cilat kanë binaritet të rastësishëm, pasi ai mendon se "*të kundërtat janë binare në thelb, pra janë binare për shkak të një domosdoshmërie logjike*".[356]

Nga kjo ide e Cruse dallohet edhe tipi i dytë i binaritetit, *kundërvënia e shkallëzuar*, e cila mat një tipar të caktuar. Ajo përshkruan drejtime të kundërta në një bosht njëdimensional, pasi një bosht i vetëm lejon idenë e dy drejtimeve të kundërta, duke bërë që binariteti të lindë në mënyrë të natyrshme, si p.sh., tek çiftet "*tall/short" (i gjatë/i shkurtër), "wide/narrow" (i gjërë / i ngushtë), "warm/cool" (ngrohtë/freskët).* [357]

Tipi i tretë lidhet me natyrën binare të *mohimit* (*po/jo*). Në disa gjuhë të pasura nga karakteri morfologjik, kjo mund të shprehet përmes mohimit morfologjik të tipit "*blue/non-blue" (blu/jo blu), "logical/illogical" (logjike/jo logjke),*etj. Siç vërehet edhe nga përkthimi i çifteve të mësipërme, në gjuhën shqipe, parashtesat e gjuhës angleze "non-" dhe "il-" nuk funksinojn si parashtesapër mbiemrat e tipit "blu", "*logjike*", etj. por si pjesëza mohuese (*jo*). Ndërsa në gjuhën angleze, këto fjalë janë shumë të ngjashme, pasi ndajnë të njëjtin material semantik dhe fonetik në rrënjë.

Tipi i katërt, është binariteti i vendosur "*për hir të binaritetit*", që do të thotë se në fakt kemi të bëjmë me struktura tre ose më shumë gjymtyrëshe, të cilat krijojnë çifte binare me dy nga gjymtyrët më të favorizuar në kundërvënie për t'u klasifikuar si antonime. Kështu, për shembull, në rastin e "*sweet/sour/bitter"* kemi çift binar "*sweet/sour" (e ëmbël/e athët")*, apo për sa u përket mbiemrave të emocionit dhe ngjyrave dallojnë çifte binare si "*happy/sad" (e lumtur/e trishtuar, "red/green" (e*

[353]C. Paradis (2010) Good, Better and Superb Antonyms: A Conceptual Construal Approach.The Annual of Texts by Foreign Guest Professors, Faculty of Arts, Charles University Prague, f.75.
[354] D. McNeill (1997) A Stydy of Word Opposition, Chicago: University of Chicago Press, f.132.
[355] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and otherSemantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Press, f .203.
[356] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f.196.
[357] M. Bierwisch (1971) Modern Linguistics:Its Development, Methods, and Problems, f.87.

kuqe/jeshile), etj. Kur flasim për disa prej gjymtyrëve më të favorizuara nënkuptojmë, ato njësi leksikore brenda strukturës së kundërvënies, të cilat kanë më shumë tipare të përbashkëta dhe dallimet më minimale të mundshme. Kjo shpjegohet në praktikë me shembullin "*happy/sad/angry/surprised/frightened" (e lumtur/e trishtuar/e inatosur/e surprizuar/e frikësuar),* ku përzgjidhen "*happy/sad"(e lumtur/e trishtuar)*si çift binar për faktin se "*happy"(e lmtur)* dhe "*sad" (e trishtuar)* përbëjnë edhe dy shprehi të fytyrës së njeriut, që në vetvete janë e kundërta e njëra-tjetrës (*buzëqeshja dhe vrenjtja e fytyrës*).

Janë pikërisht konteksti dhe përcaktimi i imët i tipareve dalluese dhe të ngjashme ato që na ndihmojnë të reduktojmë një marrëdhënie kundërvënieje të zgjeruar me disa gjymtyrë deri në vetëm dy të tilla, pasi nëse ne pyesin "*Cila është e kundërta e X?"* atëherë do të merrej më shumë se një përgjigje në kontekste të ndryshme. Shembulli vlen përsëri për ngjyrat, ku si e kundërta e ngjyrës blue në një kontekst të caktuar del ngjyra "*red" (e kuqe)* si kundërvënie brenda një flamuri me dy ose me shumë ngjyra, ose del ngjyra "*orange" (portokalli),* pasi ato gjenden për karshi njëra-tjetrës në rrethin e ngjyrave, apo ngjyra "*gray"(gri)*si dy ngjyra të kundërta në qiell, të cilat nënkuptojnë edhe dy gjendje të kundërta të motit.

Eksperimentet e Medin, Goldstone dhe Gertner[358] vunë në dukje se informantët i vlerësuan *black(e zezë)* dhe *white (e bardhë)* si "jo shumë të ngjashme" kur ato u paraqitën si çift. Ndërkohë, kur po këto ngjyra u paraqitën në grup tresh bashkë me "*red",* atëherë informantët vlerësuan se*"black"(e zezë)* dhe "*white" (e bardhë)* janë shumë të ngjashme. Kjo u shpjegua me faktin se në rastin e parë informantët u munduan të gjenin dallimet minimale brenda çiftit, të cilat rezultuan të jenë të shumta. Ndërsa në rastin e dytë, "*black" (e zezë)* dhe "*white" (e bardhë)*rezultuan të jenë të ngjashme me njëra-tjetrën në raport me "*red" (e kuqe),* e cila ishte shumë më e ndryshme me to.

Si përfundim, ky eksperiment dëshmoi se perceptimi i dallimeve theksohet edhe më shumë në marrëdhënie binare, dhe kjo gjithashtu shpjegon arsyen pse tipari binar është kaq i veçantë për marrëdhëniet e antonimisë. Për më shumë, kjo vë në dukje edhe faktin pse ato çifte, të cilat rezultojnë si "rastësisht binare" kanë tendencë të shihen si të kundërta, edhe pse nuk klasifikohen si të tilla sipas kriterit logjik.

[358] D. L Medin, Goldstone, R. L., & Gentner, D. (1993) Psychological Review, f. 254-278.

KREU III

3. TIPOLOGJIA E PËRGJITHSHME NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

3.1 Antonimet tradicionale përballë kategorive të reja

Në më shumë se një shekull, mjaft punime shkencore dhe kërkime gjuhësore janë përqendruar në përcaktimin e nënkategorive të të kundërtave. Si rezultat, jemi ndeshur me taksinomi të ndryshme të të kundërtave, të cilat dallojnë nga numri i kategorive, apo nënkategoritë brenda këtyre kategorive. Kështu, vërejmë se duke qenë, se përkufizimi i shumicës së studiuesve të semantikës ka natyrë logjike, ata kanë dalluar shumë nënkategori të kundërtash, si pasojë e kësaj natyre logjike të të menduarit. Por, jo të gjitha të kundërtat hyjnë në marrëdhënie logjike të njëjta, e si pasojë edhe kategorizimi është i larmishëm. Në shumëllojshmërinë e kategorizimit dallojmë antonimet *klasike kanonike* me bazë logjike dhe, nga ana tjetër, ato të cilat shihen si *kategori të reja* në qasjet metalinguistike ndaj antonimeve.

Si pasojë, dallojmë dy grupe kryesore studiuesish në studimet e gjuhës angleze për antoniminë: ata tradicionalë, si Leech, Lyons, Cruse, Jackson, Carter, Palmer etj., dhe nga ana tjetër, ata të cilët e zgjerojnë studimin e tyre përtej teorisë dhe logjikës, duke përfshirë edhe koncepte të reja, siç janë korpusi dhe studimi i tij, konfigurimi i përmbajtjes, eksperimentet inovative, përdorimi i antonimeve në gjuhë, konteksti, bashkërenditja, etj., me emra të njohur në gjuhësinë e huaj, si Murphy, Paradis, Willners, Jones, etj. Më poshtë, do të trajtohen detaje në lidhje me këto dy rryma të studimit të antonimeve në fushën e gjuhësisë.

Për sa i përket studimeve në gjuhën shqipe kemi vërejtur, se fakti që nuk janë të shumtë emrat e studiuesve, të cilët kanë hulumtuar në këtë drejtim të gjuhësisë shqipe ka sjellë edhe një mungesë debati të fortë për çështje që lidhen me kategorizimin apo përdorimin e antonimeve në gjuhën shqipe. Është vënë re, se ka pasur një proces reflektimi e hulumtiminë lidhje me atë që kuptohet me fjalën antonim, por zakonisht këto reflektime janë bërë nga vetë studiuesit, e jo në vatrën e debatit gjuhësor. Në mënyrë të veçantë, dallojmë emra të gjuhësisë shqipëtare, si J.Thomai, M.Samara, I.Goçi, etj., të cilët kanë dhënë kontribut të vyer në gjuhën shqipe, për sa i përket antonimisë siç do e shohim edhe më poshtë.

Në studimet e gjuhës shqipe nuk mund të mos përmendim edhe studimet krahasimore, dygjuhësore, siç është edhe punimi shkencor i Sh.Delisë, e cila ka dhënë një kontribut të veçantë në përqasjen midis dy gjuhëve, asaj të gjuhës shqipe dhe asaj të gjuhës angleze, për çështje që lidhen me antoniminë.

3.1.1 Tipologjia tradicionale semantike në gjuhën angleze

Një grup jo i vogël gjuhëtarësh në rrafshin ndërkombëtar njihen të kenë studiuar dhe hulumtuar kuptimet e çifteve antonimike, duke i kategorizuar ato përmes teorive diferencuese të caktuara. Këtu mund të përmendim kontributin e vyer të gjuhëtarëve më me zë në fushën e gjuhësisë botërore, si Leech[359], Lyons[360], Cruse[361], Herrmann[362],

[359] G. Leech (1974) Semantics. Middlesex, Penguin, f.125.
[360] J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f. 189
[361] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.112.

Fellbaum[363], Gross dhe Miller[364], Justenson dhe Katz[365], Willners[366], Jones,[367] etj. Për sa i përket studimit të antonimisë në gjuhën angleze, duhet të ritheksojmë faktin, se dallohen dy drejtime të ndryshme në qasjen ndaj kësaj marrëdhënieje leksiko-semantike në gjuhë.

Së pari, do të dallojmë ata gjuhëtarë si Lyons, Cruse, Palmer, etj. të cilët antoniminë e ngushtojnë brenda mbiemrave të cilët mundtë përdoren të shkallëzuar të tipit "*heavy/light"(e rëndë/e lehtë), "new/old"(e re/e vjetër), "fast/slow"(e shpejtë/e ngadaltë),* etj. Ky grup gjuhëtarësh nuk njeh si antonime çifte mbiemrash si *"alive/dead" (e gjallë/e vdekur), false/true (e gabuar/ e vërtetë), "female/male"(femërore/mashkullore),* etj. pasi ata përdorin termin "të kundërta" për çdo çift fjalësh me kuptim të kundërt, të cilat nuk janë mbiemra të shkallëzuar. Nga ana tjetër qendrojnë gjuhëtarë si, Jones, Murphy, Paradis, Willners, etj, i nuk e ngushtojnë antoniminë në këto parametra. Ata mendojnë dhe argumentojnë, se antonimia është gjithëpërfshirëse e nuk mund të cungohet vetëm brenda mbiemrave të shkallëzuar. Kjo dëshmohet edhe në qendrimin e Jones i cili shprehet, se "*unë propozoj të zgjidhet ky problem duke përdorur termin antonimi në kuptimin e tij të zgjeruar, duke i'u referuar çdo çifti fjalësh, të cilat do të njiheshin si të kundërta në mënyrë intuitive*"[368].

Vërejmë, se të gjitha taksonomitë e ndryshme të antonimisë në përgjithësi i kategorizojnë antonimet në *antonime plotësuese* dhe *kundërshtuese.* Kemi vërejtur, se ndonjëherë antonimet mund të jenë të nënkategorizuara ndryshe, por në thelb i gjejmë në të gjitha taksonomitë. Në gjuhën angleze, në klasifikimet tradicionale është vënë theksi te dallimet teorike të fjalëve antonime.

Nga taksonomitë më të cituara bazë të gjuhës angleze janë ato të Lyons dhe Cruse dhe, për këtë arsye, ne do t'u referohemi kategorive të tyre si "*standarde*". Në përgjithësi, në literaturë ndeshemi me *taksonomi binare* dhe në shumë pak raste me *taksonomi jobinare* të marrëdhënieve semantike të kundërvënies. Në qasjen e antonimisë përmes përfaqësimit brendaleksikor, disa studiues janë të mendimit, se "*lidhjet brendaleksikore duhet të identifikohen sipas tipit apo nëntipit antonimik, në mënyrë të tillë që të bëhen parashikimet e duhura në lidhje me shpërndarjen në kontekst dhe përfundimet për sa u përket çifteve antonime*".[369] Nga ana tjetër, disa hulumtues si Murphy, janë të mendimit se "*veçanti të tilla brendaleksikore janë të panevojshme dhe joproduktive*".[370]

Në këndvështrimin metagjuhësor, të kundërtat konsiderohen marrëdhënie leksikore dhe nuk shihen në drejtim të nënkategorive dhe natyrës së tyre logjike. Cruse është ai i cili vuri themelet e kësaj qasjeje në marrëdhëniet leksiko-semantike. Ai thekson,

---

[362] D. J. Herrmann, R. Chaffin (1986) Comprehension of Semantic Relations as a Function of the Definitions of Relations. Human Memory and Cognitive Capabilities. Amsterdam: Elsevier, f. .311-9.
[363] F. C. Fellbaum (1995) Co-occurrence and Antonymy. International Journal of Lexicography, f. 281-303.
[364] D. Gross, U. Fischer, G. A. Miller (1988) Antonymy and the Representation of Adjectival Meanings. Cognitive Science Laboratory Report 13, Dept. of Psychology, Princeton University, f.205.
[365]J. S. Justeson, S. M. Katz (1992) Redefining Antonymy: The Textual Structure of a Semantic Relation. Literary and Linguistic Computing, f.176-184.
[366] C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f.96.
[367] S. Jones (2002) Antonymy: A Corpus-Based Perspective. London: Routledge, f.103.
[368] S. Jones (2002) Antonymy: A Corpus-Based Perspective. London: Routledge, f.1.
[369] J. S. Justeson, Slava M. Katz (1992) Redefining Antonymy: The Textual Structure of a Semantic Relation. Literary and Linguistic Computing, f.176-184.
[370] M. L. Murpy (2003) Semantic Relations and the Lexicon: Antonyms, Synonyms and other Semantic Paradigms. Cambridge: Cambridge University Presscituar nga Justeson, Katz (1992) Redefining Antonymy: The Textual Structure of a Semantic Relation. Literary and Linguistic Computing, f.176-184.

se "*marrëdhënia e vërtetë intuitive e të kundërtave si një kategori e përgjithshme, nuk të çon drejt një përkufizimi logjik.*".[371] Pra, Cruse është në kërkim të një përcaktimi jologjik të të kundërtave. Për më shumë, ai e vazhdon mendimin e tij duke shtuar, se "*është e dobishme të ekzistojë një kategori e përgjithshme prototipe e të kundërtave, pasi kjo kategori e përgjithshme është diçka për të cilën folësit vendas të një gjuhe e kanë intuitën ta dallojnë,... por nënkategoritë u përshtaten më shumë përkufizimeve logjike*".[372] Edhe Chaffin dhe Herrmann mendojnë, se "*ndërkohë që folësit naivë e perceptojnë antoniminë dhe kundërvënien në përgjithësi si shumë të ndryshme nga të gjitha marrëdhëniet e tjera, ata nuk janë në gjendje të dallojnë menjëherë nënkategoritë e antonimisë*".[373]

Antonimia përfshin një numër të caktuar llojesh kuptimi në kundërvënie. Tri janë llojet më tipike në gjuhën angleze:[374]

1. *antonimet e shkallëzuara, si për shembull:"beautiful/ugly"(e bukur/e shëmtuar,"long/short"(e gjatë/e shkurtër), etj.*

2. *antonimet kundërshtuese* apo *plotësuese*,si për shembull:*"dead/alive"(i vdekur/i gjallë, etj.*

3. *të anasjelltat,*si për shembull*: "long street"(rrugë e gjatë), "long ruler"(vizore e gjatë, etj.*

Çiftet e kategorisë së parë quhen "*të shkallëzuara*" për shkak se bëjnë pjesë tek llojet e kundërvënies "*më shumë/më pak*" dhe ato mund të shihen si skaje kufizuese të një vargu të vazhdueshëm (*continuum*)[375]. Kjo lloj marrëdhënieje është e dukshme në mënyra të ndryshme:

a) së pari, ajo lejon krahasimin

b) së dyti, vetë mbiemrat mund të përcaktohen nga ndajfolje si "*very*", "*extremely*" etj., p.sh.,*"very long/ very short"(shumë e gjatë/shumë e shkurtër),"very beautiful/ very ugly"(shumë e bukur/shumë e shëmtuar).*

Kuptimet e kundërta të disa prej antonimeve kundërshtuese përjashtojnë plotësisht njëri-tjetrin dhe midis tyre zakonisht nuk mund të futet ndonjë gjymtyrë tjetër e ndërmjetëme.[376] Interesant është mendimi se disa prej këtyre antonimeve qendrojnë njëri kundrejt tjetrit si dy gjysma sferash (A/B).[377]

[371] D. A Cruse (1994) Prototype Theory and Lexical Relations, f. 167-188.
[372] D. A Cruse (1994) Prototype Theory and Lexical Relations. f. 178.
[373] D. J Herrmann, R.Chaffin. (1986) Comprehension of Semantic Relations as a Function of the Definitions of Relations, Amsterdam: Elsevier, f.311-9.
[374] H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.106.
[375] H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.106
[376] H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.106.
[377] H. Jackson, E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary Modern English Lexicology 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.106.

Të anasjelltat lidhen me rastet kur vetë termi nuk paraqet vlerë absolute, dhe vlera e mbiemrave në fjalë varet nga emri të cilin ata përshkruajnë.[378] Nga shembujt e mësipërm do të dallojmë vlerën e mbiemrit "*long*" (*i gjatë*) në përcaktimin që ai u bën emrave të ndryshëm, në kontekste të ndryshme.

Çiftet antonimike, të cilat u përkasin llojeve të mësipërme, shprehin mënyra të ndryshme të kundërvënies kuptimore. Një kategorizim i tillë kryhet për qëllime studimore të hollësishme, çka nuk do të thotë se çdo folës i gjuhës angleze është i vetëdijshëm për këtë kategorizim gjatë kohës që përdor çifte antonimike nga llojet e mësipërme të kundërvënies.

L. Lipka[379], në librine tij «Outline of the English Lexicology», dallon dhe përshkruan disa tipe kundërvënieje, duke i kategorizuar si më poshtë:

a)kundërvënie plotësuese, p.sh.,"*male/female"(mashkull/femër), "married/single" (e martuar/beqare)*

b) antonime, p.sh.,"*good /bad"(i mirë/i keq)*

c) të anasjellta p.sh.,"*buy/sell"(blej/shes)*

Kundërvënien plotësuese, ai e përshkruan: "*mohimi i njërës gjymtyrë nënkupton pohimin e tjetrës, dhe e anasjellta*",[380]p.sh:

"*John **is not married**.*"

(*Xhoni **nuk është i martuar**.*)

Fjalia e mësipërme, nënkupton se:

"*John is **single**.*"

(*Xhoni është **beqar.***)[381].

Kjo lloj kundërvënieje njihet si "*vendimi po/jo*".

Antonimia dallon nga *kundërvënia plotësuese*, pasi ajo bazohet në marrëdhënie të tjera logjike.[382] Për shembull, tek çiftet e tipit "*good/bad", "big/small",* etj. "*pohimi i njërës gjymtyrë nënkupton mohimin e tjetrës, por jo e kundërta*".[383] P.sh: «*John is good*» nënkupton se «*John is not bad*», por «*John is not good*» nuk nënkupton se «*John is bad*»[384]. Dallimi kryesor midis këtyre dy kategorive është, se antonimet në përgjithësi

[378] H. Jackson ,E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.106.
[379] L. Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.De Gruyter, f.145.
[380] R.S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[381] Shembujt shkëputur nga R.S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[382] R. S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[383] R. S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[384] Shembujt shkëputur nga R.S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English /A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.

janë të shkallëzueshme, p.sh.,"*hot, warm, tepid, cold"* (*i nxehtë, i ngrohtë, i vakët, i ftohtë*), etj.

Të anasjelltat Lipka i njeh si *imazhe pasqyruese,*[385] si p.sh.,"*husband/wife" (bashkëshort/bashkëshorte), "pupil/teacher" (nxënës/mësues), "preceed/follow" (paraprij/ndjek), "above/below" (sipër/poshtë),*etj. Përmes shembullit "*John bought the car from Bill*" (*Xhoni e bleu makinën nga Bill*.), ai nënkupton se "*Bill sold the car to John*" (*Bill i'a shiti makinën Xhonit.)*[386]. Këto fjali ngjajnë me natyrën e fjalive pësore dhe veprore. Ndërkohë që tjetër tipar është forma e tyre krahasore: nëse "*Y is smaller than X*" (*Y është më i vogël sesa X*) atëherë "*X is larger than Y*" (*X është më i madh sesa Y*) .[387]

L. Lipka dallon edhe *kundërvënien e drejtimit*, si p.sh.,"*up/down" (lart/poshtë), kundërvënien e pasojës* "*learn/know" (mësoj/di), kundërvënien antipode* "*North/South" (very/jug), "East/West" (lindje/perëndim).* Kështu, çiftet foljore të tilla si "*come/go" (vij/shkoj), "arrive/depart" (mbërrij/nisem)* nënkuptojnë lëvizje në drejtime të ndryshme ndërsa në rastin e "*up/down"* kemi të bëjmë me lëvizje nga një pikë **P,** ndërsa në rastin "*come/go"* kemi të bëjmë me lëvizje nga dhe drejt folësit.[388]

Gjithashtu, L. Lipka dallon edhe *kundërvënien jobinare* përmes disa gjymtyrëve,p.sh: shkallën e temperatures: "*hot/warm/tepid/cool/cold"* (*i nxehtë, i ngrohtë, i vakët, i ftohtë*), ngjyrat:*"black/grey/white" (e zezë/ gri/ e bardhë),* gradat: "*marshal/general/colonel/major/captain*" (*marshall/general/colonel/major/kapiten*), etj.[389]Në të tilla struktura disagjymtyrëshe kemi edhe çifte të jashtme e të brendshme. Ai dallon edhe ciklet si p.sh. spring, summer, autumn, winter, të cilat nuk kanë gjymtyrë ekstreme[390].

Për më shumë, ai thekson, se "*jo të gjitha fjalët kanë antonime në gjuhë,*dhe se *antonimia gjendet vetëm te mbiemrat dhe derivatet e tyre"*.[391]Në këtë perceptim, çiftet antonimike mbiemërore, si "*beautiful/ ugly"(e bukur/e shëmtuar)* kanë derivate të tipit "*to beautify/to uglify"(të zbukurosh/të shëmtosh), "beauty / ugliness"(bukuri/shëmti)*. Gjithashtu, ai shton, se:"*antonimia gjendet edhe në disa fjalë të cilat tregojnë ndjenja ose gjendje".*[392] Shembuj të kësaj kategorie kemi: "*respect/scorn"(respekt/përçmim), "to respect/to scorn" (të respektosh/të përçmosh), "respectful/scornful" (i respektueshëm/i përçmuar), "to live/to die"(të jetosh/të vdesësh), "alive/dead"(i gjallë/i vdekur), "life/death"(jetë/vdekje, etj*. Madje, ato i gjejmë edhe në disa fjalë të cilat tregojnë drejtim dhe kohë, p.sh.,"*here/there" (këtu/atje), "up/down" (lart/poshtë), "now/never"*

[385] R. S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[386] Shembujt shkëputur nga R.S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology
[387] R. S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[388] R. S. Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology, f. 147-148.
[389] L. Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.De Gruyter, f.146.
[390] L. Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.De Gruyter, f.145.
[391] L. Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.De Gruyter, f.145.
[392] L. Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.De Gruyter, f.145.

*(tani/kurrë), "before/after" (përpara/pas), day/night (ditë/natë), "early/late" (herët/vonë),*etj.

Për më shumë në lidhje me kategorizimin në gjuhën angleze, Saeed[393] përmbledh disa lloje antonimesh:

- *Antonime të thjeshta*, të cilat shprehin marrëdhënie midis fjalëve, ku gjymtyra negative nënkupton gjymtyrën tjetër pozitive si p.sh., "*dead/alive" (i vdekur/i gjallë)*.

- *Antonimet e shkallëzuara* shprehin marrëdhënie midis të kundërtave, ku gjymtyra pozitive e çiftit jo domodoshmërisht nënkupton të kundërtën e gjymtyrës tjetër, p.sh., "*rich/poor"(i pasur/ varfër)*.

- *Motrat taksonomike* janë ato fjalë të cilat janë në të njëjtin nivel në një taksonomi të caktuar, si p.sh. ngjyrat: "*red, orange, yellow, black ,white, green" (e kuqe, portokalli, e verdhë, e zezë, e bardhë, jeshile)* etj.

Në vazhdim të klasifikimit të antonimeve në gjuhën angleze, sipas Leech,[394] ato paraqiten si më poshtë:

1. *Taksonomia binare***,** si në çiftet "*dead/alive" (i vdekur/i gjallë), "married/unmarried" (i martuar/i pamartuar)*etj. Për këtë kategori, gjuhëtarë si Palmer, Jackson, Carter, Leech, përdorin termin *antonime plotësuese.*[395] Për më shumë, Kempson përdor termin "*kundërvënie e thjeshtë binare*" dhe i quan ato "*antonime të vërteta"*.[396] Nga ana tjetër shohim se Cruse[397] dhe Lyons[398] nuk e njohin taksonominë binare si një formë të antonimeve. Kriter i domosdoshëm për një kundërvënie që të quhet binare, është aplikimi i njërit antonim të përjashtojë përdorimin e tjetrit[399]. Kështu, nëse *X është i pagëzuar*, *X nuk mund te jetë i papagëzuar* (*If X is baptised , X cannot be unbaptized*).[400]

2. *Taksonomia shumëfishe* njihet ndryshe si *papajtueshmëria shumëfishe*, dhe për herë të parë u përdor nga Carter[401]. Ajo paraqet karakteristika të ngjashme me taksonominë binare, por ndryshe nga kjo e fundit, shtrihet në më shumë se dy gjymtyrë, si p.sh.: "*solid/liquid /gas" (e ngurtë/e lëngët/e gaztë),varg antonimesh ky i cili funksionon si një sistem tregjymtyrësh, sipas parimit se një objekt X nuk mund të jetë njëkohësisht më shumë sesa*

[393] Cituar nga F.R Palmer (1976) Semantics: A New Introduction. Cambridge: Cambridge University Press
[394] G. Leech (1974) Semantics: The Study of Meaning. New York: Penguin Books cituar nga S. Jones, Corpus Approaches to Antonymy,University of Central Lancashire, f.93-157.
[395] F. R Palmer,. 1976. Semantics: A New Introduction. Cambridge: Cambridge University Press
[396] R. U Kempson (1977) Semantic Theory. Cambridge, Cambridge University Press, f. 126.
[397] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f. 206.
[398] J. Lyons (1977) Semantics, vol. 1. Cambridge: Cambridge University Press, f. 178.
[399] G. Leech (1974) Semantics: The Study of Meaning. New York: Penguin Books cituar nga S. Jones, Corpus Approaches to Antonymy,University of Central Lancashire, f.93-157.
[400] Shembulli shkëputur nga S. Jones, (2003) Corpus Approaches to Antonymy,, University of Central Lancashire Artikull, f.297-310
[401] R.Carter (1987) Vocabulary. London, Allen & Unwin, f.103.

një gjymtyrë e këtij sistemi[402], thënë ndryshe: nëse objeti X është *i gaztë* nuk mund të jetë edhe *i ngurtë.*

3. *Antonimet polare*, ku përfshihet pjesa më e madhe e të kundërtave në përdorim në jetën e përditshme, si p.sh.,"*cold/hot" (i ftohtë/i nxehtë), "old/new"(i vjetër/i ri), "wet /dry", "happy/unhappy"(i lumtur/i palumtur),* etj. Karakteristikë e të kundërtave polare është, se ato nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën siç ndodh në taksonominë binare. Lyons, Cruse, dhe Jackson përdorin termin "*gradable antonymy*" [403] (*antonime të shkallëzuara*) për këtë kategori.

4. *Kundërvënia relative* ka të bëjë me marrëdhëniet reciproke si në foljet "*teach/learn" (jap mësim/mësoj), "buy/sell*" (*blej/shes*), etj. Kempson, Palmer dhe të tjerë semanticienë përdorin termin "*converses*" (*antonime të anasjellta*). Sipas skemës ku fjalia "A **x** B" nënkupton fjalinë "B **y** A" dhe fjalia "A **y** B" nënkupton "B **x** A" ku "**x**" dhe "**y"** janë dy folje të anasjellta.[404] Shembull:[405] *"B precedes A"* nënkupton se "*A follows B" (A ndjek B),* ku çifti i foljeve të anasjellta është ("*precede/follow", "paraprij/ndjek"*) dhe "*A follows B"*(*A ndjek B*) nënkupton se "*B precedes A"(B paraprin A).*[406] Kjo kategori është tipike për foljet.

5. *Kundërvënia e anasjelltë.* Kjo lloj kundërvënieje është e diskutueshme dhe shpeshherë mund të mos shihet si e tillë. Leech e përshkruan këtë kategori të kundërtash përmes shembujve "*remain /become" (qendroj/bëhem)* në fjalitë: "*She did not became a smoker" (Ajo nuk u bë duhanpirëse)*, të cilën ai e sheh si sinonimike me "*She remained a nonsmoker"(Ajo mbeti joduhanpirë).*[407]

Për më shumë në lidhje me kategorizimin, *Cruse*[408]e krijon taksonominë e tij të të kundërtave në bazë të përdorimit të tyre gjuhësor, ku dallohen tri nëntipe:

1. polare

2. të mbivendosura

3. me polaritet të barabartë

Të trija këto nënkategori gjenden në modele të ndryshme përdorimi në kontekst. Cruse i quan këto *modele përdorimi arbitrare* dhe është i mendimit, se ato duhet të analizohen në mënyrë brendaleksikore. Cruse përdor si modele të përdorimit strukturat pyetësore me "*How…?*" dhe ato *krahasore*, si më poshtë:

---

[402]S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire Artikull, f.297-310.
[403]S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire Artikull, f.297-310
[404]S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire, Artikull, f.297-310.
[405] Shembulli shkëputur nga S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire Artikull, f.297-310.
[406] Shembulli shkëputur nga S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire Artikull, f.297-310.
[407] G. Leech (1974) Semantics: The Study of Meaning. New York: Penguin Books cituar nga S. Jones, (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire, Artikull, f.297-310.
[408] D.A Cruse, (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.207.

a. *antonimet polare*, të cilat kanë një gjymtyrë që mund të gjendet në pyetjet e tipit "*How…?"* si edhe një gjymtyrë tjetër që nuk mund të përdoret në këtë strukturë. Shembull:[409]

How *long* is that string?

(Sa e gjatë është spango?)

How *short* is that string?*[410]

(Sa e shkurtër është spango?)

Gjymtyra që ndodhet në strukturën pyetësore me "*How*…?, njihet ndryshe si *e paanshme*[411] pasi ajo nuk presupozon veten (mbiemri "*long"* në strukturën "*How long …?"* nuk nënkupton se "*The string is long."*, pra "*Spango është e gjatë"* .) Në të njëjtën mënyrë interpretohen këto dy gjymtyrë antonime në strukturën krahasore.

b. *antonimet e mbivendosura* janë më asimetrike në përdorim dhe interpretim. Në pyetjet me *How…?* njëra nga gjymtyrët është *e paanshme*, ndërkohë që gjymtyra tjetër është "*e angazhuar*"[412], pra presupozon përgjigjen e pyetjes në fjalë. Shembuj:[413]

How *good* is that book? *(e paanshme)*

(Sa i mirë është ai libër?)

How *bad* is that book? *(e angazhuar)*

(Sa i keq është ai libër?)

c. antonimet me polaritet të barabartë janë simetrike në përdorim dhe interpretim:

How *hot* is the casserole

? *(e angazhuar)*

(Sa e nxehtë është tava?)

How *cold* is the casserole? *(e angazhuar)*

(Sa e ftohtë është tava?)

Siç e pamë në shembujt e mësipërm, të dy gjymtyrët e çiftit "*hot/cold",* janë të angazhuara, që do të thotë se e nënkuptojnë veten e tyre në përgjigje.Kur themi se "e nënkuptojnë veten e tyre në përgjigje" nënkuptojmë se kur ato përdoren në një fjali

[409] D.A Cruse, (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.207.
[410] Shënim: "*short*" në këtë shembull nuk mund të përdoret në përgjithësi vetëm nëse ne e parakuptojmë se "*the string is short"* dhe duhet të dimë *How short it really is?(sa i shkurtër është ai)*
[411]Shënim: *impartial* në gjuhën angleze.
[412]Shënim: *committed* në gjuhën angleze.
[413] Shembujt shkëputur nga D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.105.

pyetësore, ne presim që në përgjigje të kemi të njëtën cilësi. Për shembull, kur pyesim *How cold…?* (*Sa i ftohë…?), ne presim që objekti në fjalë të jetë i ftohtë.*

Cruse vëren, se në gjuhë të ndryshme çiftet e antonimeve mund të gjenden në modele të ndryshme nga ato të gjuhës angleze. Në gjuhën gjermane mbiemrat "*gut/schlecht"*(*i mirë/i keq*) janë *antonime polare,* ndërsa në gjuhën angleze i njëjti çift mbiemëror,"*good/bad",* janë *të mbivendosura*. Cruse gjithashtu është i mendimit se "*çiftet antonime duhet të përcaktohen në nënkategori, sipas shpërndarjes dhe përdorimit të tyre, dhe kjo bëhet në mënyrë arbitrare"*. Ai thekson, se për "*këtë arsye duhet të përcaktohen edhe në leksik (në fjalor)".*[414]Ky argument është i lidhur me qasjen e tij të përfaqësimit brendaleksikor të antonimisë.

Nga ana tjetër, Cruse nuk bie dakord me këtë përfundim, duke argumentuar, se "*konceptet e kundërvëna mund të përfaqësohen nga nëntipe të ndryshme të antonimeve, por kjo nuk provon që nënkategoritë e antonimeve duhet të paraqiten në mënyrë brendaleksikore (kuptimet e fjalëve përcaktohen në mënyrë individuale)".*[415]

3.1.2. Tipologjia tradicionale strukturore në gjuhën angleze

Në kriterin morfologjik apo strukturor, dallojmë *antonimet e lidhura morfologjikisht* dhe *antonimet e palidhura morfologjikisht*. Për sa u përket atyre të palidhura morfologjikisht, duhet thënë se nuk ka ndonjë lidhje të dukshme të rrënjës së çiftit antonimik. Nga ana tjetër, çiftet antonime të lidhura morfologjikisht kanë të njëjtën rrënjë (root) dhe formohen përmes modeleve fjalëformuese me parashtesim: "*dis+rrënjë*" "*in+rrënjë* ""*un+rrënjë*", si p.sh.,*dishonest (i pandershëm), infertile "jopjellor", unpleasant(i pakëndshëm),*etj., dhe prapashtesim "*rrënjë+ful/rrënjë+less*" si p.sh.,*useful (i dobishëm), useless (i padobishëm),* etj. Pra, vërejmë se gjuha angleze, ashtu si edhe gjuha shqipe, ka mundësi të mëdha në formimin e kundërvënies morfologjike.

Në lidhje me antoniminë tradicionale kanonike, Miller vëren se "*pjesa kryesore e antonimeve kanonike në gjuhën angleze janë me rrënjë të ndryshme, por shumica e antonimeve në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera janë me rrënjë të njëjtë, pra të lidhura morfologjikisht*".[416]

Në mënyrë ironike, Gross vë në dukje faktin se terminologjia e përdorur është interesante për shkak se e kundërta e "*morphological related*" (morfologjikisht e palidhur) është "*opaque antonyms*" (antonime opake),që nuk është e formuar me ndajshtesim "*morphological unrelated*" (morfologjikisht të palidhura).[417]

Përmbledhurazi, mund të themi se studiues të huaj, duke u mbështetur në shumë kritere logjike, i klasifikojnë antonimet zakonisht në tre grupe:

A) antonime *kontradiktore,* sipas koncepteve kontradiktore që ato shprehin,

B) antonime të *kundërta,*sipas koncepteve të kundërta që ato shprehin,

C) antonime *reciproke,* të cilat shënojnë koncepte me ligje të ndërsjella.

[414] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.105.
[415] D. A.Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.106.
[416] G. Miller (1992) Lexical & Conceptual Semantics, f.238.
[417] D. Gross, U. Fischer, G.A. Miller (1988) Antonymy and the Representation of Adjectival Meanings. Cognitive science laboratory report 13, Dept. of Psychology, Princeton University, f.204

3.1.3 Klasifikimi i përgjithshëm tradicional i antonimeve në gjuhën shqipe

Për sa u përket studimeve të antonimisë në gjuhën shqipe, kontribut të vyer kanë dhënë studiues si, M. Samara, I. Goçi, J. Thomai, Sh. Delija, etj. Për të parë se si kategorizohen antonimet në bazë të kuptimit apo kriterit semantik në gjuhën shqipe, fillimisht do t'u referohemi parametrave që Samara identifikon në lidhje me përcaktimin e antonimisë. Kështu, Miço Samara përcakton katër parametra kryesorë në përcaktimin e antonimisë në gjuhën shqipe:[418]

- *parametri i parë,* i përcatuar nga M.Samara është *mohimi*. Ky parametër ka të bëjë me karakterin e kundërt të kuptimeve të fjalëve dhe të togfjalëshave të qendrueshëm, mundësia e aftësia e fjalëve dhe e njësive frazeologjike për t'iu kundërvënë njëra-tjetrës në kuptimin e tyre pohues, dhe në qoftë se kjo mundësi nuk ekziston, ato nuk mund të quhen *antonime.*[419] Samara gjithashtu thekson se "elementi themelor i kundërvënies së tyre është pohimi i një kuptimi leksikor të caktuar". Ky element pohues vihet re edhe tek fjalët antonime me parashtesa mohuese (*tipi i pastër/i papastër*). M. Samara shton, se "*në qoftë se mohimi i një fjale na sjell ndër mend një tjetër, kjo nuk do të thotë se ato janë antonime".*[420]

- *parametri i dytë i përcaktuar nga M.Samara* është *boshti i përbashkët semantik, i cili lidh a bashkon fjalët ose dy gjymtyrët e një çifti antonimik me njëra–tjetrën*,p.sh.,*i gjatë / i shkurtër, i gjerë/ i ngushtë* etj., janë antonime, sepse *përveç kuptimeve të kundërta që kundërvihen, kanë si bosht lidhës përmasat në hapësirë të sendit a të frymorit të cilësuar nga këta mbiemra.*[421] Shembujt "*e bardhë/e zezë"* janë antonime me kuptim të kundërt, por që të dyja kanë edhe një bosht të njëjtë semantik. Kështu, dallojmë antonimet përveç elementeve dalluese, të cilët përcaktojnë kundërvënien e tyre, kanë edhe elemente të përbashkëta, të cilat i gjejmë pikërisht në këtë bosht semantik mjaft të abstraguar e të përgjithësuar, si p.sh.,*i ngrohtë/i ftohtë, zemërmirë/zemërkeq,* etj., të cilët lidhen nga ana logjike me "*konceptet e bashkënënshtruara*". Përmbajtja e këtij koncepti nënshtrues lidhet me atë që M. Samara e quan *boshti i njëjtë semantik* i atyre antonimeve.[422]

- *parametri i tretë,* lidhet me mundësinë e krahasimit të gjymtyrëve antonime përmes kuptimit. Kuptimet e fjalëve antonimike janë të krahasueshme, dhe është pikërisht ky tipar, i cili i fut ato në marrëdhënie kundërvënieje. Kjo cilësi është më e dukshme për mbiemrat, pasi ato kanë shkallë krahasimi të modelit **A >B,** kur **B<A**[423]. Krahasimi realizohet edhe midis kuptimeve të antonimeve foljore: p.sh: *çifti foljor "forcoj-zbut".*

Tek *foljet* krahasimi bëhet:

a. sipas mënyrës që kryhet veprimi

b. sipas drejtimit të kryerjes së veprimit

[418]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[419]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[420]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[421]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[422]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[423]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.

c. sipas shkallës së intensitetit të veprimit

M. Samara flet edhe për një *parametër të katërt*, që është shkalla e caktuar e kundërvënies së kuptimit, e cila thekson ai, *nuk është e njëjtë në të gjitha çiftet*[424]. Pra, diku ajo del më e fortë e diku më e dobët. Shembuj të tillë si çifti *i mbuluar/ i pambuluar* tregojnë se ky çift është më i dobët se *"i mbuluar / i zbuluar"*. Në këto shembuj struktura e fjalëve antonimike bën që në çiftin e parë gjymtyra "*i pambuluar"* të jetë më e dobët se në gjymtyrën e çiftit të dytë "*i zbuluar"*, pasi kjo e fundit përmban *vlerë inherente (të qenësishme, të brendëshme) të cilësisë së shënuar*[425]. Shkallëzimi çon në polarizimin apo skajshmërinë e çifteve antonimike.

Duke u nisur nga tipari i shkallëzimit apo gradacionit M. Samara[426] dallon antonimet si më poshtë:

a) të mirëfillta skajore

b) jo të mirëfillta

Megjithatë, jo të gjitha çiftet antonimike kanë shkallëzim të kundërvënies. Duhet theksuar se shumica e antonimeve me bazë reciprociteti, nuk kanë shkallë krahasimi dhe shkallëzimi, p.sh.,"*shes/blej"*. Për të matur shkallën e kundërvënies shërben një *pikë e mesme* (*normë*)[427]. Përcaktimi i pikës së mesme sjell krijimin e shkallëve të ndryshme të kundërvënies, por përcaktimi i saj nuk është i lehtë, madje në çiftet antonimike "*shes/blej"*nuk mund të ketë një pikë të mesme. Përgjithësisht, kjo pikë e mesme përcaktohet nga përvoja e gjatë historike e përdorimit të antonimeve në një gjuhë të caktuar. Probleme me përcaktimin e kësaj pike përbëjnë edhe fjalët polisemantike, ku norma lëviz sipas kuptimit dhe fushës semantike ku përdoren.

M. Samara shton si parametër të rëndësishëm edhe *aftësinë e gjymtyrëve të një çifti antonimik për t'u lidhur semantikisht dhe gramatikisht me të njëjtën fjalë*[428]. Ai pohon,se *nëse nuk do të ishte e mundur lidhja e antonimeve me të njëjtën fjalë nga ana semantike apo gramatikore, apo me të njëjtin subjekt nga ana logjike, nuk do të ishte i mundur as krahasimi midis tyre.*[429] Në një këndvështrim leksiko-gramatikor M. Samara thekson, gjithashtu,rëndësinë e gjymtyrëve homogjene nga e njëjta pjesë e ligjëratës. Si një kundërargument për këtë tipar, ai dallon argumentin logjik, sipas të cilit ekziston kundërvënia kuptimore edhe midis gjymtyrëve homogjene të tipit "*hyj/dal"*, pasi të dyja gjymtyrët kanë të bëjnë me procese veprimi të kundërta. Ka diskutime mbi këtë çështje dhe gjithmonë e më shumë flitet për një lloj antonimie modis pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Për më shumë, në lidhje me këtë çështje, E. N. Miller thekson: "*forma e ndryshme gramatikore nuk pengon, që në fjalët me rrënjë të njëjtë të ruhet diçka e përbashkët nga kuptimi leksikor*". [430]

[424]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[425]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[426]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[427]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[428]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[429]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[430] G. E. Miller (1990) WordNet: An On-Line Lexical Database. International Journal of Lexicography, f. 235-312.

Për sa i përket kontekstit fonetik, M. Samara [431] thekson, se antonimet mund të jenë:

A) fjalë fonetikisht pothuaj të ndryshme (*afroj/largoj*)

B) fjalë fonetikisht krejt të ndryshme (*dashuroj/urrej*).

Theksojmë se dallimet fonetike nuk përbëjnë një kriter për përcaktimin e antonimisë, pasi antonimia është kundërvënie e kuptimeve leksikore të fjalëve, dhe jo dukuri e opozicioneve fonetike.

Megjithatë, ndonjëherë vërehet, se konteksti fonetik ndihmon në përcaktimin e shkallës së kundërvënies. Kështu, *antonimet me kuptim të kundërt dhe fonetikisht krejtësisht të ndryshme janë të mirëfillta, kurse ato me parashtesa dhe karakter fonetik jo krejt të ndryshëm janë antonime jo të mirëfillta*[432].

Ashtu siç pohon Samara, *kasifikimi i antonimeve sipas kriterit semantik është më i ndërlikuar në krahasim me atë strukturor, pasi ai mbështetet në strukturën kuptimore të tyre, në karakterin e kuptimeve leksikore të kundërta dhe në tipin e tyre, në përbërësit e kundërt kuptimplotë, që marrin pjesë për kundervënien e fjalëve nga kuptimi dhe në shkallën e antonimisë a të kundërvënies.* [433] Klasifikimi i antonimeve sipas kriterit semantik është përmbledhur si më poshtë, nga M.Samara:[434]

1) Duke u mbështetur *në strukturën kuptimore*, fjalët antonime në gjuhën shqipe mund të kundërvihen:

   a) pothuaj në të gjitha kuptimet e fjalëve të një çifti, a pothuaj në tërë përmbajtjen kuptimore të tyre:

      i mirë / i keq
      poshtë /lart
      i ngrohtë/i ftohtë, etj.

2) duke u bazuar në *tipin e kuptimeve*, fjalët antonime mund të kundërvihen në kuptimet[435]:

   a) *parësore (themelore)*, të cilat janë edhe kuptimet e tyre më të përgjithshme e më të përdorshme:

      ngre/zbraz
      hyj / dal, etj.

   b) *të prejardhura*

      i rëndë / i lehtë
      (mendim) i errët / i qartë
      (sjellje) e bukur /(sjellje)e shëmtuar, etj.

   c) *të figurshme*

[431]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[432]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[433]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[434]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[435]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.

krye/bisht,
luan/lepur
i hollë nga mendja /i trashë (nga mendja) etj.

Ky klasifikim i fjalëve antonime në gjuhën shqipe, sipas tipit të kuptimeve të kundërta, ka rëndësi për të bërë të njohur çiftet antonimike më të qendrueshme e më të përdorshme, të cilat janë ato që krijohen mbi bazën e kuptimeve themelore të fjalëve.

3) Duke u mbështetur në karakterin ose në *shkallën e kundërvënies së kuptimeve,* nga ana semantike, fjalët antonime shqipe mund të jenë *të mirëfillta* ose *jo të mirëfillta*[436].

Fjalët *antonime të mirëfillta,*janë zakonisht fjalë me rrënjë të ndryshme [T/T_1]:

i hollë / i trashë,
i vogël / i madh etj.

Kuptimet e kundërta të disa prej këtyre antonimeve përjashtojnë plotësisht njëri-tjetrin dhe midis tyre zakonisht nuk mund të futet ndonjë gjymtyrë tjetër e ndërmjetme. Disa prej këtyre antonimeve qendrojnë njëra kundrejt tjetrës, si dy gjysma sferash (A/B), të cilat në raporte pohimi ose mohimi formojnë një të tërë (S), prandaj janë quajtur edhe *antonime komplementare,* si në shembullin e çiftit "*i gjallë / i vdekur",* etj.

Grupimi i fjalëve antonime sipas karakterit antonimik, ose sipas shkallës së kundërvënies, është një klasifikim mjaft i përgjithshëm, prandaj brenda kësaj ndarjeje kemi bërë edhe nëndarje të tjera, duke u mbështetur në analizën semantike të antonimeve në gjuhën shqipe.

3.1.4 Klasifikimi i antonimeve në gjuhën shqipe sipas kriterit strukturor

Klasifikimi i antonimeve në gjuhën shqipe sipas kriterit strukturor është më i thjeshtë, pasi ai mund të bëhet më lehtë, duke pasur si pikënisje dhe mbështetje strukturën e tyre formale, si dhe analizën fjalëformuese e morfomatike të bërë më lart. Duke qenë se gjuha shqipe dallohet për fjalëformim të zhvilluar, vërejmë se edhe antonimet e formuara me këto modele të shqipes janë po aq prodhuese. Në bazë të kësaj analize del, se antonimet shqipe në përgjithësi mund të jenë:[437]

1. fjalë *antonime me rrënjë të ndryshme*, me skemë strukturore A[T] /B[T][438]:

i madh /i vogël
i bukur / i shëmtuar, etj.

2. fjalë *antonime me parashtesa,* të cilat mund të marrin pjesë[439]:

a) si gjymtyrë të çiftit antonimik në njërin prej krahëve të tij A[p+T]/B[T]:

[436]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 34 -43.
[437]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës Së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.
[438]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës Së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.
[439]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës Së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.

i pastër/i papastër
i bërë / i pabërë
kamje /skamje, etj.

b) si gjymtyrë në të dy krahët e çiftit antonimik, me skemë A[p+T]/B[p_1/T]:

i mbiujshëm/i nënujshëm
mbitokë/nëntoke
ngarkoj/shkarkoj, etj.

Është e qartë, se te këto çifte rolin kryesor antonimik e luajnë parashtesat, në shembujt më sipër, përkatësisht *nën-, n-/sh-*, etj. Për sa u përket prapashtesave, në gjuhën shqipe nuk ka të tilla fjalëformuese të antonimeve, edhe pse nga ana stilistikore dallohen të tilla prapashtesa si: "-ak","-ac","-cuk", etj.,[440] në shembujt "*verdhacuk", "burrac"*, etj.[441]

3. Fjalë *antonime të përbëra ose të përngjitura*, me skemë A[t+t_1]/B[t+t_2] ose A[t_1+t]/B[t_2+t] që nga pikëpamja strukturore janë të ngjashme me fjalët antonime me parashtesa të grupit 2.b), sepse kanë të njëjtë njërin prej dy gjymtyrëve ose prej temave të tyre[442]:

zemërmirë /zemërkeq
shpirtgjerë/shpirtngushtë, etj.

Mbiemrat që shprehin ngjyrë dhe shije kanë shërbyer gjatë zhvillimit të gjuhës për të formuar kompozita apo fjalë të përbëra të tipit "*bardhezi*", "*gojëmbël*", etj.

4. antonimet në përbërjen e *togfjalëshit frazeologjik ose jofrazeologjik,* përbëjnë një tip të veçantë strukturor të antonimeve në gjuhën shqipe; ato janë togfjalësha të qendrueshëm me dy a më shumë gjymtyrë, nga të cilët njërën gjymtyrë e kanë zakonisht të njëjtë[443]:

marr hua/jap hua
më hyn në zemër (dikush) /më del nga zemra, etj.

Sipas aftësisë që kanë fjalët antonime shqipe për të marrë pjesë në strukturën e shkallëve më të larta, del se disa prej tyre (si *p.sh., i mirë / i keq, mirësi/ligësi , mirësoj/keqësoj, mirëkuptim/keqkuptim, i butë / i ashpër etj*.) kanë strukturë a çerdhe më të gjerë fjalëformuese, kurse disa të tjera kanë strukturë më të ngushtë e të kufizuar fjalëformuese (krhs. *p.sh. i njomë / i thatë , njom/thaj, i ftohtë / i ngrohtë, ftoh/ngroh etj*.).[444]

[440] Shënim: do t'i shohim më poshtë.
[441]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.
[442]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.
[443]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.
[444]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 65-98.

3.1.5 Klasifikimi gramatikor në gjuhën shqipe dhe angleze

Çiftet antonimike përmbajnë kuptime të, dhe i përkasin të njëjtës kategori gramatikore. Në përgjithësi, gjuhëtarët pranojnë kushtin, se që të kemi të bëjmë me kundërvënie ndërmjet dy njësive leksikore, minimalisht duhet që këto fjalë t'i përkasin të njëjtës klasë gramatikore, pra dy mbiemra, dy folje, etj. Por nga ana tjetër, ka edhe nga ata, që nuk i kufizojnë antonimet brenda së njëjtës klasë gramatikore, siç është Fellbaun, i cili thekson, se "*antonimia nuk qendron vetëm ndërmjet çifteve të të njëjtës klasë fjalësh, por ekziston edhe përtej klasës së fjalëve*".[445] Kështu për shembull, në shkrime të autorëve të ndryshëm mund të gjejmë raste midis fjalëve "*loving" (i dashur)* dhe "*hate*"*(urrej),* të cilat i përkasin përkatësisht klasës së mbiemrit dhe foljes.

Xh. Lloshi jep këtë mendim për antoniminë: "*Dy fjalë kanë kuptime të kundërt, nëse shënojnë një tipar cilësor, janë bashkëplotësuese në shënimin e një fushe, ose tregojnë drejtime të kundërta të hapësirës, lëvizjes a kohës*." [446] Ai shton, se "*në përgjithësi, antonimet janë fjalë të një gjinie: p.sh. hyj/dal, por në kontekst për qëllime stilistike mund të vihen në marrëdhënie kundërvënëse edhe dy fjalë çfarëdo, duke u shndërruar në llojet e po asaj gjinie*".[447]

Në kundërvënie të perceptimit se përgjithësisht antonimia është një marrëdhënie midis fjalëve që i përkasin të njëjtës pjesë të ligjëratës, qendron argumenti se *për aq kohë sa antonimia është një marrëdhënie semantike, ajo mund të qendrojë edhe midis fjalëve në pjesë të ndryshme të ligjëratës,*si më poshtë:[448]

1. midis një foljeje dhe një emri

"***Lighten*** our ***darkness***,
Lord, we pray,
and in your great mercy
defend us from all perils and dangers of this night,
for the love of your only Son,
our Saviour Jesus Christ."[449]

*(**Ndriço errësirën** tonë,….)*

2. midis një foljeje dhe një mbiemri

"In my experience, the heavy-handed, terror-inspiring approach ***closes*** as many doors as it smashes ***open***." [450]

*(Bazuar në eksperiencën time, metoda e ashpër dhe terrorizuese **mbyll** aq dyer sa edhe **hap**.)*

---

[445] C. Fellbaum, 1995. Co-occurrence and Antonymy. International Journal of Lexicography f.281-303.
[446] Xh. Lloshi, (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 134.
[447] Xh. Lloshi, (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 135.
[448]H. Jackson ,E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vocabulary in Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology f.113.
[449] Lutje fetare tipike në gjuhën angleze cituar nga H. Jackson ,E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.113.
[450]*Dan Abnett, Xenos* cituar nga H. Jackson ,E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.114.

Në gjuhën shqipe çiftet e antonimeve krijohen kryesisht me fjalë që shënojnë cilësi, kohë, madhësi, moshë, tipare të karakterit, veprime etj.[451] Tek J. Thomai[452] këto paraqiten përmes kategorive gramatikore të mbiemrave për cilësinë, ndajfoljeve, foljeve për veprimet.

Gjithashtu, mund të bëhet edhe një klasifikim i fjalëve antonime shqipe sipas kategorisë leksiko-gramatikore. Nga ana leksiko-semantike, antonimet shqipe janë më shumë *fjalë kuptimplote e shënuese*, kurse nga ana kategoriale, gramatikore, ato janë *mbiemra, folje, emra, ndajfolje, përemra dhe pak parafjalë, pjesëza e pasthirrma*.[453]Duke i'u referua kategorizimit leksiko-gramatikor të M.Samarës,[454] antonimet sipas pjesëve të ligjëratës, me të cilat shprehen, renditen si më poshtë:

1) fjalët antonime ***mbiemra*** shënojnë cilësi të kundërta në mënyrë të drejtpërdrejtë (si psh. i *ngrohtë/i ftohtë, i ëmbël / i hidhur*,) ose në mënyrë të ndërmjetësuar (*i jashtëm/i brendshëm, i sipërm /i poshtëm* etj), ato shënojnë ngjyra (*i bardhë/i zi*), formën, madhësinë, ose shtrirjen e dikujt a diçkaje në hapësirë (*i gjatë/i shkurtër, i gjerë/i ngushtë*), shijen e diçkaje (i *shijshëm/i pashijshëm*) veti mendore a fizike (i *zgjuar/budalla*), gjendje shpirtërore e shëndetësore (i *kënaqur / i pakënaqur*), është shumë e pasur në gjuhën shqipe.[455]

2) fjalët antonime **folje** në gjuhën shqipe tregojnë zakonisht veprime të kundërta, ose lëvizje që bëhen ballëpërballë në hapësirë (si p.sh. *hyj/dal, ulem/ngrihem* etj); ka raste kur njëra prej antonimeve folje shënon një veprim që kryhet në një drejtim të caktuar, kurse tjetra i shënon ndalimin e atij veprimi (p.sh. *fillon/mbaron, nis/pushon*). Fjalët antonime folje, mund të tregojnë gjithashtu dukuri të kundërta të natyrës (*gdhihet/ngryset, lind/perëndon, ngrin/shkrin*), ndryshime të kundërta cilësore në gjendjen fizike të frymorëve, ose të sendeve (*sëmuret/shërohet, lodhem/çlodhem*), në gjendjen shpirtërore (*gëzohem/hidhërohem, dashuroj/urre*j), në gjendjen shoqërore/ekonomike (*varfërohet/pasurohet*), etj.[456]

3) fjalët antonime **emra** në gjuhën shqipe tregojnë caqe të kundërta e skajore në kohë (si p.sh. *ditë/ natë, verë/dimër, mëngjes/mbrëmje*) ose në hapësirë (*lindje/perëndim, very/jug , fillimi/fundi*) , veprime a procese të kundërta të lidhura me kuptimin e foljes (*hapje/mbyllje, afrim/largim*) ose gjendje të rezultateve të veprimeve të kundërta (*hyrje/dalje*), ndjenja ose gjendje shpirtërore krejt të kundërta të njeriut (*gëzim/hidhërim, dashuri/urrejtje*), veti a cilësi të kundërta (*fuqi/ dobësi*).[457]

4) fjalët antonime **ndajfolje** mund të tregojnë mënyra e rrethana të kundërta. Nga këto, ndajfoljet antonimike përcaktojnë e tregojnë tipare të kundërta të veprimit: mënyra të kundërta se si kryhet ai (*si p.sh. mirë/keq*) ose shkallë të kundërta të cilësisë a të rrethanës (*shumë/pak*); ndajfoljet antonimike rrethanore tregojnë caqe kohore a rrethanore të kundërta, në të cilat kryhen veprimet (*sot/nesër, ditën/natën*), caqe a vende skajore ku ndodhemi, ku drejtohemi ose ku kryhet veprimi (*majtas/djathtas, andej/këtej*, etj.).[458]

[451]J. Thomai, (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.33-49.
[452]J. Thomai, (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.33-49.
[453]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[454]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[455]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[456]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[457]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[458]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.

5) antonimet **përemra**, janë më shumë dëftorë (*ky/ai, kjo/ajo*) e pak të pakufishëm (*shumë/pak*).[459]

Fjalët antonime joshënuese janë shumë të pakta në gjuhën shqipe. Ato mund të jenë si më poshtë [460]:

6) disa **parafjalë** kryesisht me origjinë ndajfoljore , si p.sh.,*(para/prapa, sipër/poshtë);*

7) pak **pjesëza** , si psh., *jo/po , pak/shumë*;

8) ndonjë **pasthirrmë** , si p.sh.,*tungjatjeta/mirupafshim.*

Në gjuhën angleze kundërvënia është "k*ryesisht e dukshme në klasën e mbiemravë*"[461], ku pjesa kryesore e tyre gjendet në çifte antonimike të tipit: "long/short", "true/false", "rich/poor", etj. Megjithatë, ne mbështesim mendimin se nuk mund ta kufizojmë antoniminë brenda klasës së mbiemrave, pasi ajo është e dukshme tek një pjesë e konsiderueshme e foljeve (*bring/take*), emrave (*death/life*), ndajfoljeve (*noisily/quitly*), parafjalët (*above/below*), apo lidhëzave (*after/before*).

3.2. Kategoritë e reja të antonimeve

Kategoritë klasike janë parë sipas këndvështrimit logjik dhe teorik. Tashmë antonimet mund të kategorizohen në bazë të kriterit të korpusit për të evidentuar atë çka antonimet bëjnë në një fushë të caktuar, dhe jo thjesht për të përshkruar atë çka antonimet janë në vetvete. Interes të veçantë, paraqet tipologjia e antonimisë sipas qasjes metagjuhësore me bazë korpusin. Si korpus, mund të përdoren revistat periodike, librat artistikë etj., por duhet theksuar, se korpusi gazetaresk ofron një fushë të gjerë gjuhësore me një gjini të përcaktuar. Ai pasqyron përdorimin e gjuhës së shkruar joartistike dhe shumë natyrale. Si bazë të dhënash, mund të përdoret një grup i indeksuar antonimesh i ngjashëm më atë të Justeson dhe Katz, [462] të cilët përdoren 40 antonimet më të rëndësishme në histori si bazë të dhënash, të cilët ishin mbledhur nga Deese,[463]përmes metodës së testeve së asocacionit (shoqërimit)të fjalëve.

Të tjerë studiues, kanë përdorur fjalorin e njohur *Roget's Thesaurus*[464]. Të gjitha këto korpuse, përbëjnë përpjekje për të identifikuar çiftet e antonimeve në bazë të intuitës së vetë studiuesit. Problemet që dalin më të tilla korpuse, janë përdorimi i vjetëruar i disa fjalëve, të cilat në gjuhën e sotme nuk përdoren më. Problem tjetër, është dhe fakti se është e pamundur që intuita të jetë e saktë kur bëhet fjalë për fenomenet psikolinguistike, siç është antonimia.

3.2.1 Kategorizmi në bazë të funksionit në bashkërenditje

[459]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[460]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 187-191.
[461]H. Jackson , E. Z. Amvela (2007) Words, Meaning and Vogabulary Modern English Lexicology, 2nd Edition: An Introduction to Modern English Lexicology, f.114.
[462] J. S. Justeson, S.M. Katz (1991) Redefining Antonymy: The Textual Structure of a Semantic Relation. Literary and Linguistic Computing, f. 176-184.
[463] J. Deese (1965) The Structure of Associations in Language and Thought. Baltimore: Johns Hopkins University Press, f.108.
[464] Roget's Thesaurus/ Roget, P.Mark (1962) [1852], Dutch, Robert A., O.B.E., ed., The Original Roget's Thesaurus of English Words and Phrases (Americanized ed.), New York: Longmans, Green & Co./Dell Publishing Co., Inc.

Vetë procesi i përcaktimit të çifteve të fjalëve antonime në studim është i ndërlikuar dhe paraqet një dinamikë problematike. Për këtë arsye, përkufizimet dhe kategorizimet e ndryshojnë nga një gjuhëtar te tjetri, por edhe nga njëri fjalor te tjetri. Jones[465] hartoi një listë të re antonimesh në studimin e tij të vlefshëm për shekullin XXI, duke formuar një bazë të dhënash me çifte antonimesh, si më poshtë:

*** NË POZICION TË GJYMTYRËS SË PARË**	***NË POZICION TË GJYMTYRËS SË DYTË**	**TIPI FUNKSIONAL**
* and adj alike *si * dhe mbiemri*	adj and * alike *si mbiemri dhe **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
between * and adj *ndërmjet * dhe mbiemri*	between aj and * *ndërmjet mbiemër dhe **	VARIOUS *tip i ndryshëm*
both * and adj *si * dhe mbiemri*	both adj and * *si mbiemri edhe **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
either * or adj *ose * ose mbiemri*	either adj or * *as mbiemër as **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
from * to adj *nga * tek mbiemri*	from adj to * *nga mbiemër në **	TRANSITION/CO-ORDINATED *kalimtare/ e koordinuar*
* versus adj ** përballë mbiemri*	adj versus * *mbiemër përballë **	CONFLICT *Konflik*
whether * or adj *ose * ose mbiemër*	whether adj or * *ose mbiemër ose **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*

Tabela 1: 14 kornizat e përdorura në studim[466]

Çiftet e antonimeve në kornizat e mësipërme u studiuan në bashkërenditje brenda fjalisë. Kështu, u mblodhën nga një total prej 3000 fjalësh dhe si rezultat u vu re se parashtesa *un-* është mjeti morfologjik më prodhimtar i gjuhës angleze. Bazuar në këtë studim, rezultuan *8 kategori* të reja antonimesh, si më poshtë[467]:

1. *antonimet ndihmëse (të varura);* këto antonime kanë rol ndihmës, pasi na ndihmojnë të shqyrtojmë gjymtyrën tjetër të çiftit të pranëvendosur, si në shembullin:

[465]S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire, Artikull, f.297-310.
[466] Shënim: studim i kryer nga S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire, Artikull, f.297-310.
[467]S. Jones (2003) Corpus Approaches To Antonymy, University of Central Lancashire, Artikull, f.297-310.

"…The community charged was *popular* with conservative voters and *unpopular* with labour voters"
(…i *familjarizuar me... jo i familjarizuar* me …)

2. *Antonimet krahasuese,* një çift antonimesh ndërtohet në krahasim më një çift tjetër në një kornizë leksiko-sintaktike, si në fjalinë e mëposhtëme:

" Some living composers are *more dead* than *alive*"
(…*më shumë të vdekur se të gjallë*…)

"It is possible to accept both that Dr.Higs was *a lot more right than wrong* in her diagnoses."

(…ishte *shumë më tepër e saktë sesa e pasaktë*…)

3. *antonimet e koordinuara*, të cilat përdoren në një kontekst të unifikuar dhe të koordinuar. Funksioni i tyre është të dallojë një bosht dhe më pas ta shpërbëjnë atë. Qëllimi i tyre është të shprehin përfshirje dhe në përgjithësi bashkëlidhen përmes lidhëzave "*dhe*", "*ose*" si në fjalinë e mëposhtme :

"White hall was yesterday unable to *conform or deny* other simulated devolutions"
(…*të konfirmonte apo të mohonte*...)

4. *antonimet e dallueshme* kanë të bëjnë me mosngjashmërinë semantike midis antonimeve sipas formulës: midis X dhe Y(ku n është dallimi). Shembull:

"He still doesn't know the difference between *right and wrong*"
(… midis *të vërtetës dhe të gabuarës*..)
" One must distinguish between *hard and soft drugs*"
(… drogave *të rënda dhe të lehta*…)

5. *antonimet ekstreme* janë të ngjashme me antonimet e koordinuara, por dallojnë nga fakti, se kundërvënia ndërtohet jo midis antonimeve, por midis dy skajeve fundore të boshtit semantik nga njëra anë, dhe hapësirës semantike të ndërmjetme nga ana tjetër. Këto antonime lidhen përmes lidhëzave "*ose*", "*edhe*" të paraprira nga ndajfoljet "*very*" (*shumë*) ose "*too*" (*shumë*) si në fjalinë:

"The advantages are that the track does not need watering, and can be used when conditions are either *too dry or too wet* for racing on turf."
(…*ose shumë të thata ose shumë të lagështa*…)

6. *Antonimet idiomatike,*shumë çifte antonimesh gjenden së bashku si pjesë e një shprehjeje, togfjalëshi, proverbi, si në shembujt e mëposhtëm:

" *The long and short of it* is that height counts"
(*ajo që ka rëndësi është se...*)
" They evindently knew that they could teach *this old dog a few new tricks* "
(…*t'i mësonin këtij ujku të vjetër disa hile të reja*…)

7. *antonimet e mohuara*, të cilat gjenden në fjali ku mohohet një antonim në mënyrë të tillë që të theksohet më shumë antonimi tjetër, sipas modelit: X not Y (X jo Y). Shembull:

"Democracy means more than the right to pursue one's own self-interest-government must play *an active, not passive,* role in addressing the problems of the day"
(…*një rol aktiv e jopasiv*...)

8. *antonimet kalimtare*, funksioni i antonimeve të kësaj kategorie është të ndihmojë përshkrimin e lëvizjesnga njëra gjendje te tjetra sipas modelit: "*from X to Y*" *(nga X tekY).*

"Inflation is a tax which redistributes wealth *to the sophisticated from the unsophisticated*"
(…*nga të sofistikuarit tek jo të sofistikuarit*…)

Si përfundim, në këto kategori të reja të antonimeve vërehet rëndësia e përdorimit të kriterit leksikor dhe sintaksor në përcaktimin e tipologjisë (në dallim nga kriteri logjik, teorik i kategorizimit tradicional) për më shumë lidhjet sintagmatike. Përdorimi i antonimeve brenda një konteksti (fjalie) përbën një hap përpara në studimin e antonimeve.

3.2.2 Kategorizimi sipas interpretimit të konfigurimit dhe përmbajtjes së kuptimit

Në bazë të studimeve leksikografike, tekstuale dhe psikolinguistike në lidhje me antonimet konvencionale dhe ato të cilët kërkojnë një motivim të caktuar kontekstual për t'u klasifikuar si të tilla, përmes një metode dinamike të përdorimit të kuptimit dhe të nxjerrjes së kuptimit, u vëzhgua kuptimi leksikor ontologjik dhe interpretues. Nga këto studime rezultojnë dy lloje të ndryshme strukturash kategorike[468]:

1. *kategorizimi i antonimisë përmes konfigurimit apo skemës*
2. *kategorizimi përmes strukturave përmbajtësore të kuptimit*

Këto dy kategori përbëjnë të kundërtat e njëra-tjetrës. Si rezultat, antonimet janë kuptime të cilat përdoren në kundërvënie binare përmes një interpretimi krahasimor.[469] Paradis dhe Willners, theksojnë se tipari binar lidhet me konfigurimin në hapësirën konceptore, e cila përdoret dhe kuptohet si kundërvënie përmes shtrirjes dimensionale dhe krahasimit. Në këtë këndvështrim, të gjitha gjymtyrët kanë status të njëjtë si antonime.

Ndërkohë, kategorizimi sipas strukturës përmbajtësore i përmbahet idesë, se ekziston një vazhdimsi çiftesh të lidhura ngushtë në njërën anë, dhe nga ana tjetër ka kuptime fjalësh të cilat nuk kanë gjymtyrë leksiko-semantike.[470]

[468]C. Paradis, C. Willners, Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects, Studia Linguistica, f.67.
[469]C. Paradis, C. Willners, Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects, Studia Linguistica, f.67.
[470]C. Paradis, C. Willners, Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects, Studia Linguistica, f.68.

Si rezultat, vërejmë se çiftet e lidhura ngushtë janë ato të cilët përputhen në një gamë të gjerë kuptimesh, nuk kanë struktura tipike të preferuara bashkërenditjeje, janë të shpeshta në përdorimin gjuhësor, si të mëvetësishme ashtu edhe në çifte, dhe profilizojnë cilësi ku jepen jo më shumë se dy mundësi për shkak të konfigurimit në pjesë të ndara përmes një kufiri ndarës, apo që qendrojnë si dy pole të të njëjtit bosht.

3.3 Kategorizime të tjera

3.3.1 Antonimet ndërkulturore

Antonimia cilësohet si një marrëdhënie universale ndërmjet fjalëve dhe kuptimeve të tyre. Murphy thekson, se "fakti që kjo marrëdhënie është universale tregon se ekziston një aftësi e brendshme tek ne për të kuptuar dhe përdorur antoniminë.[471] Mendohet, se antonimia ekziston në të gjitha gjuhët e botës, dhë të gjitha ato kanë antonimi të leksikalizuar për sa u përket dimensioneve (big/little, i madh/i vogël), tipareve fizike (hard/soft, i fortë/i butë), moshës (young/old, i ri/i vjetër), vlerës (good/bad, i mirë/i keq), dhe shpejtësisë (fast/slow, i shpejtë/i ngadaltë). Në përgjithësi, në të gjitha gjuhët mbizotëron klasa gramatikore e mbiemrave[472]. Një tjetër veçori e përbashkët e gjuhëve, është edhe fakti se për disa cilësi emocionale si inati dhe çudia, shumica e gjuhëve europiane nuk kanë një fjalë të kundërt.[473] Weigand shton se "*antonimia kuptohet njësoj në kultura të ndryshme"*. [474] Reybeck dhe Herrmann shtojnë, se "*anëtarët e kulturave të ndryshme bien dakord për antoniminë më shumë se për çdo marrëdhënie tjetër kuptimore*".[475] Megjithatë, ekzistojnë disa faktorë të caktuar kulturorë, të cilët ndikojnë në mënyrën e çiftimit të fjalëve antonime, në rolin e tyre në gjuhën dhe kulturën e një vendi.

Willners[476] i kategorizon gjuhët në dy grupe:

1. gjuhë me vetëdije të qartë të antonimeve
2. gjuhë me vetëdije të nënkuptuar të antonimeve

Ai shton, se vetëdija e nënkuptuar shprehet përmes gabimeve në gjuhë, kur antonimet zëvendësojnë njëra-tjetrën. Ndërkohë, vetëdija e qartë nënkupton përdorimin e veçantë të antonimeve për qëllime semantike dhe ligjërimore. Willners e klasifikon gjuhën angleze si "gjuhë me vetëdije të nënkuptuar".[477] Megjithatë, ndarja mes tipologjisë së gjuhëve në lidhje me qasjen e tyre ndaj antonimisë nuk mund të bëhet lehtë. Kjo shpjegohet, siç e kemi vënë re më sipër, me rolin e antonimeve në ligjërim, e si e tillë, gjuha angleze ka edhe vetëdije të qartë për antonimet.

[471]M. L. Murphy, Jane M. Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy in Adjectives. Journal of Memory and Language , f.301-19.
[472] Cituar nga M. L. Murphy, Jane M. Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy in Adjectives. Journal of Memory and Language , f.301-19.
[473] Cituar nga M. L. Murphy, Jane M. Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy in Adjectives. Journal of Memory And Language , f.301-19.
[474] Cituar nga M. L. Murphy, Jane M. Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy in Adjectives. Journal of Memory And Language , f.301-19.
[475] D. Raybeck, D. Herrmann (1996) Antonymy and Semantic Relations: The Case for a Linguistic Universal Cross-Cultural Research 30, f.154-83.
[476]C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f.163.
[477]C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f.164.

3.3.2 Antonimet stilistike

Antonimet stilistike lindin "*në dritën e një qendrimi të caktuar*".[478] Janë faktorët shoqërorë ato që kushtëzojnë antonimet stilistike.[479] Antonimet kanë vlera afektive, të cilat shprehen kryesisht në përshkrimet letrare, ironi apo sarkazëm, si edhe për të ndërtuar figurën letrare të antitezës. "*Nëpërmjet antonimisë stilistike, ashtu sikundër nëpërmjet polisemisë e sinonimisë stilistike, mund të pasqyrohet qendrimi emocionues i një autori, i cili e përdor këtë dukuri për të prekur të tjerët më shumë në shpirt… duke bërë edhe krijime individuale fjalësh ose togfjalëshash…..për të ngjallur te lexuesi a dëgjuesi, një ndjenjë a situatë ironie dhe përqeshëse*".[480]

Burime të zakonshme të shprehjes për leksikun janë edhe antonimet si dhe lidhjet sinonimike. Antonimet stilistike janë të lidhura ngushtë me sinoniminë dhe stilistikën dhe krijohen midis gjymtyrësh sinonimike, ku njëra prej tyre përdoret në kuptim negativ për shkak të interpretimit me ngjyrim emocional, stilistikor, si p.sh., *dhaskal/mësues*. A. Kostallari shton, se "fjalët stilistikisht *joasnjanëse (joneutrale)* kanë një ngjyrim a vlerësim emocional të veçantë, ose një fuqi shprehëse të figurshme, gjë që nuk e kanë fjalët stilistikisht asnjanëse (neutrale)".[481] P.sh., dhaskal (keqësues) dhe mësues (neutral), *zabit* (keqësues) *oficer* (neutral), *etj*.

Në letërsi, stili i autorit ka lirshmëri të mjaftueshme për të formuar çifte antonimike stilistikore, të cilat pasqyrojnë botën e brendshme, ndjenjat e forta përmes antitezave. Në gjuhën shqipe, F. Noli shquhet për antiteza të fuqishme. Sipas Xh. Lloshit, **"***stili është veçantia e një tërësie gjuhësore të organizuar në një mënyrë që ia jep ligjërimi, në veçanti në realizimin e përmbajtjes, duke synuar përshtatjen me qëllimet e komunikimit me kushtet dhe synimet vetjake*".[482] Për qëllimet stilistikore përdoret përsëritja, si dhe mjetet fonetike, morfologjike, leksikore-semantike gjatë përsëritjes. *"Antonimet dhe sinonimet shërbejnë si mjete leksikore-semantike në përsëritje vijëzore*",[483] siç shihet në shembujt e mëposhtëm[484]:

…
Gju për gju janë ulë e po rrinë,
kan fillue pijen e po pinë.
….
(sinonimet "*ul /rrimë"*, antonimet "*po rrinë/ po pinë"*)

Qendrimin emocional në raport me vlerën e fjalës e cek edhe M. Çeliku[485], i cili shprehet se "*në këto raste folësi apo autori nëpërmjet formës së shumësit mban edhe njëfarë qendrimi emocional, duke shprehur një nuancë përbuzëse ose një tjetër nuance*", p.sh., kur fjalën "*mik*" e vendosim në thonjëza brenda një konteksti, nënkuptojmë gjoja "*mik*", pra ka një ngjyrim emocional negativ,"*mik1 /mik2*", i ngjashëm me "*mik/armik*".

[478]M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politiko-Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Antonimia, f.176.
[479]I.Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë, f. 113.
[480]M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politiko-Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Antonimia, f. 176.
[481]A. Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, Stuimet Filologjike
[482] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.11.
[483] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.11.
[484] Shembujt të Shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.11.
[485] M. Çeliku (1969) Çështjet të Normës Morfologjike në Letërsinë Artistike pas Çlirimit, Studime Filogjike, f. 20.

Për më shumë, M. Samara mendon, se *edhe dy kuptime enantiosemike mund të kundërvihen, ku njëri ka ngjyrim dhe tjetri është pa ngjyrim, si në shembullin "rrogëtar", në kuptimin "nëpunës i rregullt, që merr një rrogë të zakonshme", dhe në kuptimin e figurshëm "nëpunës që punon sa për të marrë një rrogë, duke i shërbyer verbërisht dikujt pa iu përkushtuar punës apo profesionit të vet*".[486]

Kemi ngjyrim emocional keqësues edhe me fjalë të huazuara nga turqishtja, p.sh.,*tregtar/matrapaz,* nuk kemi të bëjmë me dallime të dukshme, por me ngjyrime emocionale të kundërta: foljet: "*hekuros/shtyp", "palos/vras", "i pasur/ fukara,i varfër", "qetësoj/sekëlldis", "dorshtrënguar/xhymert",* etj.

Në kundërvënie mund të qendrojnë edhe një fjalë në gjuhën shqipe dhe forma e saj e shumësit me prapashtesën /ra me vlerë stilistikore. Të tjera prapashtesa keqësuese janë edhe "*–acak" ("burrë/burracak") -ak ("çun/çunak") "-line" ("çupë/çupëlinë"),* etj. Theksojmë se të tilla prapashtesa u japin fjalëve vlerë stilitikore dhe u kundërvihen me fjalët përkatëse (burrë, çun, çupë). Të tilla antonime quhen antonime stilistikore[487] dhe japin shembuj të kundërvënies midis fjalëve sinonime, të cilat nga kuptimi s'kanë dallime të dukshme, por kanë ngjyrime emocionale të kundërta, pasi përdoren në kontekste të ndryshme.

Samara thekson, se në përmbajtjen kuptimore të fjalëve hyjnë edhe ngjyrimet stilistikore emocionale të fjalës, ose të togfjalëshit të qendrueshëm frazeologjik, prandaj ai është i mendimit se "*në konceptin e përgjithshëm të antonimisë leksikore duhet të përfshihet edhe antonimia stilistikore".[488]* I. Goçi dallon midis rrafshit të thyer dhe rrafshit horizontal, duke theksuar se "*në rrafshin e thyer gjymtyrët e çiftit antonimik nuk pasqyrojnë kundërvënie ekstreme, në rrafshin horizontal fjalët në kundërvënie të plotë mund të kalojnë në kuptime të figurshme, duke e humbur kështu kundërvënien e plotë*".[489] Në kuptimet e para në rrafshin horizontal kundërvënia është më e qartë dhe më e plotë. Antonimia e fjalëve me kuptim të figurshëm është më e dobët dhe më i vogël në numër.

Gjithashtu, Xh. Lloshi shton, se "*struktura e aktit të të menduarit luan rol të rëndësishëm në vendin e gjymtyrëve antonimikë më qëllimin stilistikorë të kundërshtimit*".[490] Në stile të ndryshme, dalin antonime të ndryshme (si për shembull, në stilin bisedor, libror, etj). Kështu për shembull, në stilin libror "*qaj / qesh"* ka kuptimin "*vuaj"* dhe "*jam i lumtur"*.

Në rrafshin stilistikor dallojmë përdorim të antonimisë sipas modeleve të mëposhtme të përcaktuara nga Xh. Lloshi[491]:

- *arkaizmat* në rrafshin historik nuk përdoren më për shkak se dukuritë që ata shënojnë janë mënjanuar prej kohësh nga përdorimi.[492] Për të arritur një efekt shprehës gjejmë në letërsinë shqipe përfshirjen e arkaizmave apo historizmave me ngjyrim kontrastues.

[486] M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politiko-Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Antonimia, f. 176.
[487] J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f. 59.
[488] M. Samara (2008) Rreth Leksikut Politiko-Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Antonimia, f. 176.
[489] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë, f. 113.
[490] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.12.
[491] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.12.
[492] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 13.

- *orientalizmat* apo huazimet orientale në konktakt të drejtpërdrejtë me turqishten gjithashtu kanë vlerën e tyrë stilistikorë në lidhjet sinonimike të tipit "*fukara/i varfër"*, "*sakat/i gjymtuar*", etj., si dhe gjegjësët e tyre antonimikë.Gjuha e shkruar ka përvetësuar shumicën e formimeve me *ndajshtesa,* të cilat janë ndërkombëtarizuar, si psh: anti-, de-, poli-, mono-, etj.

- *frazeologjia dhe togjet e qendrueshme,* të cilat përdoren si njësi të gatshme leksikore apo togje frazeologjike, kanë një valencë kuptimore në sistemin leksikor. Frazeologjia është karakteristikë për ligjërimin bisedor dhe përdorimi i idiomave është një karakteristikë e stilit popullor të shkrimtarit.

- *antiteza dhe oksomoroni.* Antiteza është *kalimi i menjëhershëm nga një portë të tjetra në nxjerrjen në pah të një kundërvënieje që zakonisht nuk vihet re*. Ajo përdoret gjerësisht në poezi, publicistikë, folkor etj., si në shembujt e mëposhtëm :

"Zhvish rrobat e djalërisë, vish rrobat e dhëndërisë" (folkor)
"...se të qante kur të qeshnin, se të vishte kur të zhveshnin…".[493]

Kur f*jalët antonime vendosen jo pranë, por më një lidhje gramatikore me përshtatje ose me varësi, figura që del quhet oksimoron.*[494]*Kjo figurë letrare* është përdorur gjerësisht nga F. Konica më qëllim diskretitues, përmes mjeteve shprehëse përçmuese: p.sh: "*një lartësi e përulur"*, nga gazetaria "*qetësia shurdhon"*. *Antiteza* kërkon që të prapavihen parafjalë të së një njëjtës pjesë të ligjëratës, kurse për *oksimoronin* kjo nuk është e domosdoshme (ç*organizim i organizuar*).

3.3.3 Antonimet kontekstuale

Kur flasim për antonimi kontekstuale, kemi të bëjmë me një kundërvënie brenda një konteksti të caktuar, jashtë të cilit kjo kundërvënie nuk duhet të ekzistonte, psh.*,"i bukur/i shëmtuar", "sa bukur/sa zi*".[495] Kjo lloj antonimie është e lidhur ngushtë më stilin e autorit që e përdor dhe figurativitetin, ku në rastin e mësipërm "zi" synon kuptimin e fjalës "*keq*", kjo lloj kundërvënie është dytësore, pasi nuk është e lidhur me kuptimin themelor të gjymtyrëve.[496] Goçi shton, se ato funksionojnë në formën e metaforave dhe përdoren gjërësisht në stilin letrar, poetik, artistik, aty ku liria e shprehjes është më e mundshme.

Brenda kontekstit, antonimia kalon deri në shkallë sinonimie me njërën prej gjymtyrëve: p.sh: "*hesht/flet", "hesht/bërtet", "hesht/pëshpërit", "e pastër/e papastër", "e pastër/e pistë", "e pastër/e përlyer",*etj.

Një lloj të veçantë antonimesh kontekstuale janë edhe ato foljorë të cilët shprehin:

- kryerjen e një veprimi, kohën dhe vendin ku fillon e mbaron, në skaje ekstreme të tipit: "*Nga lufta vijmë në luftra shkojmë".*[497]

[493] F. Noli shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 13.
[494] Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 13.
[495]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë, f. 114.
[496]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë, f. 114.
[497] I. Kadare, Motive me Diell, f. 65, Shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 135.

- kundërvënie ndërmjet jetës së filluar, në vazhdim dhe vdekjes të tipit rroj /vdes si në shembullin: "*…që të rrojë ku të lutem, që të vdes ku të futem…"*[498] Këto formojnë kundërvënie radiale të tipit:"*vdes/lind, rroj, jetoj, gjallëroj".*

- kundërvënie të paskajshme të formuara prej foljes kam + gjymtyrë antonimike: p.sh.: "*S'paska fund e s'paska krye".*[499]

- antonime që shprehin kundërvënie të njëkohshme: p.sh. "*për ty qaj e për ty qesh, rroj për ty e vdes për vete vdes".*[500]

Të tillë antonime mund të jenë paralele me dy veprime për (foljet), apo dy cilësi për (mbiemrat), (*lagur më lot, djegur me flagë*, F.Noli). Përbëjnë diskutim pjesoret "*lagur", "djegur",* pasi disa i shohin si folje, disa i shohin si mbiemra.[501] Mendojmë se "djegur" dhe "lagur" në vargun e mësipërm janë përdorur semantikisht si mbiemra, sepse marrëdhënia kuptimore që ato shënojnë është një tipar për një njeri, një objekt, etj. Antonimet kontekstuale janë të lidhura me teorinë e togfjalëshit, antonimet gjenden shpesh edhe në gjëagjëza në formë të bashkërenditura, si p.sh.,"*hap e mbyll,dritë si yll"*

[498] A. Asllani, poezi shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.135 .
[499] N. Frashëri shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 135.
[500] N. Frashëri shkëputur nga Xh. Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f.135.
[501] F. Agalliu i sheh si mbiemra.

KREU IV

4. TIPOLOGJIA E ANTONIMEVE TË SHPREHURA ME MBIEMËR DHE FOLJE NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE



Figura 12 Tipologjia semantike dhe strukturore [502]

4.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe, parë semantikisht

Fusha semantike është një sektor i fjalorit i karakterizuar nga një koncept i përbashkët, elementet e së cilës nuk janë sinonime, por janë të gjitha të lidhura së bashku nga një përbërës semantik i përbashkët.[503] Ky përbërës i përbashkët semantik mund të jetë koncepti i përkatësisë fisnore, koncepti i ngjyrës, koncepti veprim, temperature, etj. Fjalët janë të lidhura në këtë fushë semantike sepse *gjërat që ato emërtojnë janë të lidhura së bashku ngushtë në realitet.*[504]

4.1.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën shqipe, parë semantikisht

Sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe, mbiemri përcaktohet, si "*ajo pjesë e ligjeratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini,*

[502] R.S Ginsburg (1979) A Course in the Modern English Lexicology, f.147.
[503] R.S Ginsburg (1979) A Course in the Modern English Lexicology, f.148.
[504] R.S Ginsburg (1979) A Course in the Modern English Lexicology, f.148.

numër, e për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi".[505] Gramatika e Gjuhës Shqipe jep edhe një klasifikim kuptimor të mbiemrave si më poshtë[506]:

1. *Mbiemra që tregojnë cilësi* (mbiemra cilësorë): emërtojnë veti a cilësi që rroken drejtpërsëdrejti me shqisa, ose që janë vetëm të mendueshme, të përfytyrueshme, si p.sh., ngjyra, shtrirja hapësinore, madhësi, formë, veti fizike.[507] Këto mbiemra kanë disa veti morfologjike, si p.sh. për sa i përket fjalëformimit, ato mund të jenë *të parmë, të prejardhur ose të përbërë*. Ndërkohë, ajo që na intereson në studimin tonë është fakti se ato mund të formojnë çifte antonimike si p.sh. *i ri/i vjetër, trim/frikacak, i lehtë/i rëndë, i mirë/i keq, zemërmirë/zemërkeq, gjakftohtë/gjaknxehtë, i gjallë/i vdekur*, etj. Këto mbiemra *emërtojnë një cilësi të drejtpërdrejtë, e cila mund të perceptohet me anë të shqisave, dhe që është lehtësisht e mendueshme. Ato shprehin rrethana objektive, në bazë të cilësisë së dukurive dhe sendeve në natyrë.*[508]

2. *Mbiemra që tregojnë marrëdhënie* (mbiemra marrëdhëniorë) të cilët japin tiparin e sendit nëpërmjet emërtimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër, ose me një rrethanë, një veprim a një numër. Ato *shprehin marrëdhënie lëndore, përkatësore, hapësinore, me numër apo sasiore dhe janë të prejardhur nga emra, ndajfolje, numërorë apo folje*.[509] Ato nuk mund të formojnë çifte antonimike, po vetëm mohim.Në gjuhën shqipe, mbiemrat cilësorë janë më të paktë në numër sesa ato marrëdhëniore, këto të fundit mund të kthehen në mbiemra cilësorë duke u përdorur në kuptim të figurshëm.[510]shembuj të mbiemrave marrëdhëniorë janë çiftet: *afëtr/i largët, i ngurt/i lëngët,* etj.

Kundërvënia del e qartë në *ballafaqimin e përbërësve kuptimorë* të fjalëve. Zakonisht, *antonimet kundërvihen në të gjithë përbërësit e tyre, por kanë një përbërës kuptimor të përbashkët, që i lidh si një bosht kuptimet e kundërta,*[511] si p.sh.,"*i bardhë/ i zi"*, kundërvënie sipas ngjyrës, "*i ftohtë/ i nxehtë"* sipas temperaturës, *hip/ zbres* sipas lëvizjes me drejtim pingul a të pjerrët, etj. Në lidhje me antonimet e gjuhës shqipe është M. Samara ai që jep një kategorizim të detajuar dhe analizon imtësisht tiparet semantike të mbiemrave.Gjithashtu, në studimet e tij bëhen edhe *analiza sematike* në gjuhën shqipe.Në gjuhën angleze, ështëLeechai i cili, përdor metodën e analizës së përbërësve të një fjale për të zbërthyer kuptimin e saj. Kështu, për shembull, fjalën "*burrë"*ai e zbërthen në tre përbërës përkatësisht "njeri" + "i rritur" + "mashkull". Nga ana tjetër, ai zbërthen fjalën "*grua"* duke analizuar elementet përbërës të fjalës grua në kundërvënie me atë të fjalës burrë duke analizuar elementet përbërës si: "njeri" + "e rritur" + "jo mashkull". Kempson përdor analizën e përbërësve kuptimorë në analizën e tij për antoniminë dhe vëren, se *kjo strategji është e dobishme kur kemi të bëjmë me disa çifte antonimike të caktuara, kryesisht ato që kanë të bëjnë me gjininë dhe farefisninë si për shembull*

[505] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.153- 201.
[506] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.153- 201.
[507] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.153- 201.
[508]I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 118.
[509] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.153- 201.
[510] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.153- 201.
[511]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.157.

"sister/brother" (vëlla/motër).[512] Megjithatë, fuqia shpjeguese e kësaj lloj analize duket se ka limitet e saj. Edhe pse Kempson beson se "*analiza e përbërësve është një mënyrë më e qartë për të karakterizuar marrëdhëniet…"*[513]disa gjuhëtarë vënë në dukje, se *kjo analizëështë një mjet i dobishëm për të përshkruar vetëm disa çifte antonimike,dhe nuk mund të themi se, kjo analizëështë gjithmonë kaq e dobishme dhe e saktë.*[514] Për shembull, kur trajtohet rasti i njëçifti antonimik mbiemëror i tipit "*active/passive*" (aktiv/pasiv) vërehet se analiza e përbërësve kuptimorë të këtyre mbiemrave nuk është e qartë, pasi për çdo fjalë mund të themi se përmbajn përbërësin kuptimor "përshkrues", i cili nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar fjalë të tjera me kuptim të kundërt, siç mund të ishte fjala "*joaktiv*".

Për më shumë, Samara i kushton vëmendje të veçantë edhe *rolit të kontekstit si një fakt i ligjërimit, i cili sjell dallime në kuptimin leksikor antonimik,* për shembull: "*send i pazëvendësueshëm/njeri i pazëvendësueshëm",* ku fjala "*i pazëvendësueshëm"* në të dyja kontekstet ka të njëjtin kuptim, i cili ekziston edhe jashtë kontekstit dhe është në kundërvënie me *"i zëvendësueshëm"*.[515]

Ai propozon edhe konceptin e teorisë së fushës semantike, gjatë analizës semantike në kontekstin e gjuhës shqipe. Sipas kësaj teorie, *kuptimi i fjalës zbulohet e përcaktohet, lind a krijohet gjithnjë në kontekst ose në mikrokontekst.*[516] Në punimet e tij të para Samara është i mendimit, se "*sipas kësaj teorie, konteksti është i mbivlerësuar, pasi lidhjet dialektike në kuptimin leksikor me nocionin, lidhjet e fjalëve me sendet e dukuritë e realitetit objektiv janë neglizhuar dhe nënvlerësuar nga kjo teori*."[517] Pra, fillimisht, Samara vë theksin në kuptimin leksikor si përcaktues, në raport me kontekstin.

M.Samara ndalet edhe për *forcën antonimizuese* të gjymtyrëve të çifeve antonimike. Në shqip në çiftin antonimik "*i fortë/ i butë",* lidhjet antonimike të fjalës *i butë* janë zhvilluar në sajë të ndikimit të kuptimit të fjalës "*i forte",* si gjymtyrë kryesore e çiftit antonimik. Pra, kuptimi i një antonimi ushtron një forcë ndikuese (antonimizuese) tek antonimi tjetër brenda çiftit.Në mënyrë të ngjashme, edhe në gjuhën angleze njëri nga elementët e çiftit ka cilësi dhe "forcë" më shumë sesa elementi tjetër. Në këtë mënyrë, në gjuhën angleze dallojmë "*marked items/unmarked items"*[518] brenda çiftit antonimik, ku i pari ushtron këtë forcë ndikuese si në shembujt: "*long/short"*(*i gjatë/i shkurtër*), ku ai mbiemër, i cili shpreh diçka më të madhe në masë, peshë, cilësi, etj. ka aftësi të kryej funksione të cilat mbiemri tjetër i çiftit nuk i kryen. Ndër këto funksione është edhe formimi i emrave të prejardhur nga mbiemrat, si p.sh.:

"*long->length"*

(i gjatë->gjatësi)

Sipas M.Samarës, në bazë të llojit të kuptimit të kundërvënë dallojmë[519]:

1. kundërvënie kuptimesh parësore

[512]R. M. Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f .86.
[513] R. M. Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f .86.
[514] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.114.
[515] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 185.
[516] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 185.
[517] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 185.
[518] Shënim: element *të shënuar* dhe *jo të shënuar*; për më shumë në lidhje me këtë çështje do të ndalemi më poshtë
[519]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 180.

2. kundërvënie kuptimesh dytësore (të prejardhura)

3. kundërvënie kuptimesh të figurshme.

Një mënyrë tjetër klasifikimi semantik lidhet me natyrën e kuptimit të mbiemrave. Sipas I. Goçit, antonimia mbiemërore mund të jetë "*elementare* ose *e abstraktuar*".Ai shprehet, se *antonimia mbiemërore është elementare, kur cilësia e emërtuar nga mbiemri është pasqyrim i botës reale, natyrës, dhe perceptohen lehtë nga shqisat*.[520] Ndërkohë që kemi të bëjmë me *antonimi të abstraktuar,* kur ky çift antonimik mbiemëror përdoret në kuptim abstrakt, jo duke iu referuar natyrës[521]. Kështu p.sh., "*i butë/i fortë*" do të formojnë kundërvënie elementare, nëse shoqërohen me një send, i cili nga vetë natyra sendore mund të jetë i butë apo i forte, si p.sh., *buka, topi, goma, djathi*, etj. Ndërkohë që i njëjti çift mbiemëror mund të dalë si antonimi e abstraktuar në kontekste, kur cilëson një frymor (*njeri, burrë, grua*) nga ana e karakterit të tij apo të saj, p.sh. "*grua e fortë/grua e butë*". Në përgjithësi, fjalët në kuptimet e abstraktuara kanë më shumë liri në përdorime sinonimie[522], si për shembull "*i egër/i butë*", "*kokëfortë/qengj*", etj.

Për sa i përket natyrës së kundërvënies, M. Samara dallon mbiemra me *kundërvënie të mirëfilltë dhe jo të mirëfilltë*.[523]

a) *Kuptime të mirëfillta*.

Sipas M. Samarës, *kuptimet e kundërta të disa antonimeve të mirëfillta skajore përbëjnë skajet më ekstreme të çiftit, të cilat mund të përfytyrohen si dy rrathë (A e B) përballë njëri-tjetrit, që kanë një largësi të barabartë nga një pikë (M) me mjedisin e kësaj largësie*.[524]



Figura 13 Antonime të mirëfillta skajore

Këto mund të quhen edhe *antonime të mirëfillta skajore*, midis të cilave futet edhe ndonjë fjalë tjetër, që mund të hyjë në marrëdhënie antonimike me njërën ose me tjetrën gjymtyrë të këtij çifti, si p.sh.,"*i ftohtë (A)/i nxehtë (B)"*, në marrëdhënie me fjalë të ndërmjetme *"i freskët/i ngrohtë"*.[525]

[520] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[521] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[522] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[523]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 181.
[524]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 181.
[525]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 181.



i ftohtë--i frekët --------M----------i ngrohtë—i nxehtë

Figura 14 Kundërvënie e shkallëzuar në boshtin e temperaturës

Të katërta këto fjalë lidhen me të njëtin tipar a të njëjtën cilësi (të temperaturës), lindin edhe kundërvënie të shkallëve të ndryshme, si dhe një varg çiftesh antonimike: *A/b jo të mirëfillta skajore*,[526] *A/B* antonime të mirëfillta skajore, *a/b* janë antonime të shkallëzueshme, të cilat pasqyrojnë një shkallë më të ulët a më të dobët të kundërvënies së kuptimeve.

Në grupin e antonimeve të mirëfillta mund të futet edhe kundërvënia brenda kuptimeve të së njëjtës fjalë (*enantiosemia*),që janë të pakta por gjenden, si në gjuhën shqipe dhe ne atë angleze. Në këtë tip të antonimisë, mund të futet edhe *kundërvënia stilistikore*, që vihet re midis kuptimeve negative e pozitive të së njëtës fjalë. Në lidhje me këtë dukuri shprehet edhe J.Thomai, i cili thekson, se "skaje të kundërta në këtë këndvështrim mund të qendrojnë edhe kuptime a ngjyrime emocionale të së njëjtës fjalë, p.sh.,'*qasem'* ka kuptimin '*afrohem'* dhe '*largohem'"*.[527] Është pikërisht kjo kategori të kundërtash e cila njihet si *enantiosemi.*

Në grupin e antonimeve të mirëfillta mund të futen dhe fjalët antonime me parashtesa të tipit *mbitokë/ nëntokë* (me skemë **p+T/P₁+T**)[528], me parashtesat *ç-/sh/-zh-, kundër-* etj. si p.sh. i "*rregullt/çrregullt", "vesh/zhvesh*", etj.

b) Mbiemrat antonime jo të mirëfillta e shprehin kundërvënien e kuptimeve të tyre në mënyrë jo të plotë, ose në mënyrë të dobët.[529] Ato janë zakonisht fjalë të formuara me *parashtesat pa- , mos- , jo-*, si p.sh.,"i *bindur/i pabindur", "i armatosur/i paarmatosur",* etj., të cilat kanë në bazë të kundërvënies së tyre kryesisht mohimin. Kuptimet e tyre nuk janë plotësisht të kundërta dhe nuk qendrojnë në pikat skajore të vargut antonimik. Ato *mund të përfytyrohen si dy rrathë, nuk janë shumë larg njëri-tjetrit, por edhe mund të priten*

Në këtë grup të antonimeve jo të mirëfillta mund të futen disa antonime të shkallëzuara si dhe antonimet e rastit (rastësore) ose ato kontekstuale, të cilave u mungojnë përbërësit kuptimplotë plotësisht të kundërt.[530] Antonimet kontekstuale

[526] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 181.
[527] J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.159.
[528]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 182.
[529]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 182.
[530]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 183.

dhe ato okazionale janë karakteristike për një situatë ligjërimore të dhënë, ku kundërvënia del më shumë si një realizim i mundshëm dhe jo si një realitet i përhershëm. Këto çifte mund të quhen "*kuaziantonime*"ose "antonimoide".

Megjithatë, duhet thënë se kufij të prerë midis fjalëve antonime të mirëfillta dhe jo të mirëfillta nuk ka. *Kuptimi i njërës gjymtyrë të çiftit mohon kuptimin e tjetrës, por mohimi nuk mund të merret si i vetmi kriter i drejtë i ndarjes së tyre në antonime të mirëfillta dhe jo të mirëfillta, sepse, ashtu sikurse është vërtetuar gjatë analizës semantike të antonimeve shqipe, mohimi antonimik është pjesë përbërëse e kuptimit pohues të të gjitha fjalëve antonime*.[531]

Sipas J. Thomait [532] *antonimet mbimërore* kategorizohen si më poshtë, nga *kundërvënia kuptimore* në kuptimet themelore:

1. *antonime të plota* (nuk varen nga konteksti)

2. *antonime kontekstuale* (nuk janë antonime në kuptimet themelore, por në kontekste të caktuara dalin si antonime)

Nga numri i kuptimeve në kundërvënie në gjuhën shqipe fjalët mund të kundërvihen në[533]:

- një kuptim
- në disa kuptime
- në të gjitha kuptimet.

Nga këtu dallojmë *antonime të pjesshme,* të cilat nuk kundërvihen në të gjitha kuptimet dhe *të plotat*, të cilat kundërvihen në të gjitha kuptimet.

J. Thomai dallon edhe *kundërvënien në rrafshin stilistik* të mbiemrave[534], i cili ndërtohet ndërmjet fjalëve sinonime, që nga kuptimi nuk kanë dallime të dukshme, por kanë ngjyrime emocionale të kundërta, p.sh.,"*tregti/pazarllëk", etj*. Këto *antonime stilistike* përdoren si mjete me fuqi të madhe shprehëse.

Nga ana skematike, J. Thomai boshtin kuptimor e përfytyron si një vijë, ku kuptimet e fjalëve antonimike qendrojnë në skajet më të tejme të kësaj vije[535]:

A----------B

1. i bardhë i zi(*ngjyra*)

2. fig.i bardhë i zi(*tipar abstrakt*)

Figura 15

Kuptimi i njërës fjalë në kundërvënien kuptimore të antonimeve nuk është thjesht mohimi i kuptimit të fjalës tjetër. Fjala e dytë është antonim i fjalës së pare, jo vetëm kur

[531]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 183.
[532]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.159.
[533]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.159.
[534]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.160.
[535]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.

e përjashton kuptimin e fjalës së parë, por edhe kur pohon kuptimin e kundërt.[536] Për sa i përket *shkallës së kundërvënies* kuptimore, antonimet mund të jenë *krejt të kundërta* (qendrojnë në skajet më të largëta) ose *të një shkalle më të ulët*. Sipas J. Thomait, mbiemrat që tregojnë ngjyrë, dendësi, temperaturë etj., dhe formimet me parashtesa *jo-, pa -,* dhe *mos-*, karakterizohen nga kundërvënia jo e plotë, por gjejmë edhe raste të kundërvënies së plotë në këto shembuj, sipas skemës së mëposhtme:[537]

A----------C----------B

i nxehtë i ngrohtë i ftohtë

A----------C----------B

i armatosur i paarmatosur i çarmatosur

Figura 16

Duke i'u referuar R. Memushajt,[538] tipologjia semantike e mbiemrave jepet si më poshtë:

1. *antonime të pashkallëzueshme ose komplementare (plotësuese),* të cilat shënojnë kuptime që kundërshtojnë njëri-tjetrin, ku pohimi i njërit nënkupton mohimin e tjetrit, p.sh. "*i gjallë/i vdekur", "i vërtetë/ i rremë", "i martuar/ beqar", "ngre/ul", "dal/ hyj",* etj. Këto çifte nuk pranojnë gjymtyrë të ndërmjetme.

2. *antonime të shkallëzueshme* shënojnë cilësi të shkallëzuara apo lëvizje hapësinore me drejtim të kundërt, të cilët mund të tregojnë cilësi (*i vjetër/ i ri , i madh / i vogël, i pastër / i ndotur*), lëvizje horizontale (*afrohem / largohem*) apo lëvizje pingule. Ky grup antonimesh nuk e mohojnë njëri-tjetrin, pasi është e mundur që dikush apo diçka të mos jetë as e madhe as e vogël, duke pranuar një gjymtyrë të mesme dhe duke formuar atë që njihet si *radhë antonimike.*[539] Antonimet e këtij grupi renditen në seri, ku dallojmë dy gjymtyrë skajore dhe gjymtyrë të tjera të ndërmjete, të cilat qendrojnë në vijë lineare sipas një shkalle të caktuar, që mund të jetë temperatura etj. R. Memushaj përmend gjithashtu edhe radhët rrethore midis ditëve të javës, muajit dhe stinës etj.

Ndërkohë, I. Goçi[540] flet për kundërvënie *të plotë* dhe *të pjesshme.*

a) Për sa i përket kundërvënies së plotë tek mbiemrat, ajo shihet më qartë tek kuptimi parësor apo kryesor. Përmbledhurazi, sipas I.Goçi, ato mund të shënojnë[541]:

- *peshë: i rëndë/i lehtë*
- *madhësi: i vogël/i madh*
- *masë: i gjatë/i shkurtër*
- *cilësi: i mirë/ i keq*
- *gjendje: i lagur/ i tharë*
- *ngjyrë: i bardhë/i zi*
- *shtrirje hapësinore: i gjerë/i ngushtë*

[536]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.
[537]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.
[538]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.48.
[539]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.49
[540] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[541] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.

- *shije: e ëmbël/e hidhur*
- *veti fizike: i butë/ i fortë*
- *gjendje shpirtërore: i kënaqur/i pakënaqur*
- *cilësi mendore: budalla/i mençur*
- *gjendje lëndore: i ngurtë/i butë*
- *kohë: e hershme/e vonshme*
- *hapësirë: e sipërme/e poshtme*[542]

b) Për sa i përket kundërvënies së pjesshme në antonimet mbiemërore vërejmë, se antonimet e pjesshme kundërvihen vetëm në disa nga kuptimet e tyre, kanë një zbutje të nocionit të polaritetit, pra jo deri në skaje estreme. Mund të themi se këtu kemi të bëjmë pikërisht me një kundërvënie të zbutur. Shembull: "*e pastër/e papastër"* përballë çiftit "*e pastër/e pistë,e ndyrë"*. Këtu theksojmë se fjalët "*i papastër*" dhe "*i pisët/i ndyrë*" nuk përbëjnë sinonime mes tyre. Ato formojnë sinonime të tipit "*i papastër, i përlyer*" apo "*i pistë, i ndyrë, i fëlliqur*". Të gjitha këto hyjnë në marrëdhënie kundërvënieje të plotë apo të pjesshme me fjalën "*i pastër*". Shkallëzimi ndihmon të analizojmë kuptimet dhe raportin e çifteve antonimike te kundërvënia e pjesshme.

Në kuptimet e para, në rrafshin horizontal kundërvënia është më e qartë dhe më e plotë.[543] Antonimia e fjalëve me kuptimin e figurshëm është më e dobët dhe më e vogël në numër. *Në rrafshin e thyer, gjymtyrët e çiftit antonimik nuk pasqyrojnë kundërvënie ekstreme, kurse në rrafshin horizontal, fjalët në kundërvënie të plotë mund të kalojnë në kuptime të figurshme, duke e humbur kështu kundërvënien e plotë*[544]**.**

I.Goçi dallon kundërvënien e pjesshme tek mbiemrat e ngjyrave. Kjo kundërvënie është e pjesshme dhe nga ana kuptimore edhe nga ajo vizuale.[545] Ka disa gjuhëtarë, të cilët mendojnë se ngjyrat nuk shprehin aspak kundërvënie mes tyre, e si të tilla nuk formojnë antonime mbiemërore, pasi ato kanë tipare thjesht dalluese. Ata mendojnë, se ngjyrat mund të jenë në raport kundërvënës vetëm në kuptimin e tyre të figurshëm, jo në kuptimin themelor të lidhur ngushtë me pasqyrimin e tyre në natyrë. Nga ana tjetër, qendrojnë ata studiues të antonimeve, të cilët mendojnë se kemi të bëjmë me antonimi ngjyrash edhe pse në nivel të pjeshëm, jo të plotë, madje dhe me intensitet të ndryshëm në kundërvënie me njëra-tjetrën.[546] Kështu, ata mendojnë, se "*i bardhë/i zi*" ka kundërvënie më të fortë sesa "*i bardhë/i verdhë*".

Kundërvëniet e pjesëshme qoftë në pikëpamjen e kuptimit themelor ashtu edhe në kuptimin e figurshëm, shprehin edhe mbiemrat përcaktues të shijeve "*i ëmbël/i hidhur/i thartë etj*." Edhe këtu flasim për intensitet jo të njëjtë të kundërvënies, ku "*i ëmbël/i hidhur*" është me intensitet më të lartë sesa "*i ëmbël/i thartë*".

Si ngjyrat ashtu edhe shijet, ilustrohen skematikisht përmes rrafsheve që formojnë në raport me gjegjësen e tyre antonimike, ku dallojmë rrafshin horizontal ("*i bardhë/i zi*" dhe "*i ëmbël/i hidhur*") si edhe rrafshin e thyer ("*e bardhë/e kuqe*" apo "*e ëmbël/e kripur*"). Mendohet, se kundërvënia në rrafshin horizontal është e plotë dhe ajo në rrafshin e thyer del si kundërvënie e pjesshme. Interesant është edhe fakti se në

[542] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[543] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[544] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[545] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[546] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.

përgjithësi, gjymtyrët antonimike formojnë edhe rrafshe të thyera paralele, si më më poshtë:[547]



Figura 17 Rrafshet e thyera paralele

Në përgjithësi, mbiemrat që shprehin ngjyrë dhe shije kanë shërbyer gjatë zhvillimit të gjuhës për të formuar fjalë të përbëra të tipit "*bardhezi*", "*gojëmbël*", etj. Për sa u përket shijeve, *kjo skemë është më e thjeshtuar, pa rrafshe të thyera paralele*.[548] Kështu, mbiemrat e shijeve "*i ëmbël/i thartë*" apo "*i ëmbël/i hidhur*" në kuptimin elementar përcaktojnë shijen, kurse në kuptimin e tyre të abstraktuar ato përcaktojnë një buzëqeshje që mund të jetë e atillë, apo një *shikim të ëmbël* apo *të hidhur*, etj.

4.1.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze, parë semantikisht

Shumë studime janë bërë vitet e fundit për të kategorizuar mbiemrat antonime nga gjuhëtarë të shumtë, nga të cilët në kontekstin ndërkombëtar dallojmë, Leech,[549] Lyons,[550]Cruse,[551]Herrmann,[552]Fellbaum,[553] Gross dhe Miller,[554] Justensonin dhe Katz[555], Willners,[556]Jones,[557] etj. Nga këto studime rezultojnë si çifte mbiemrash tradicionalë si, "*good/bad*" (*i mirë/i keq*), "*hot/cold*" (*i nxehtë/i ftohtë*), '*heavy/light*" (*i rëndë/i lehtë*), "*slow/fast*" (*i ngadaltë/i shpejtë*), të cilët paraqesin dimensione semantike të meritës, temperaturës, peshës dhe shpejtësisë. Këto rezultojnë si antonime "*më të mira*" nga testet

[547] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64 .
[548] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 37-64.
[549] G. Leech (1974) Semantics. Middlesex, Penguin, f. 93.
[550] J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.168.
[551] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.136.
[552] D.J. Herrmann, R.J.S. Chaffin, G. Conti, D. Peters, P.H. Robbins (1979) Comprehension of Antonymy and the Generality of Categorization Models, f.145.
[553] C. Fellbaum (1995) Co-occurrence and Antonymy, International Journal of Lexicography, f.297.
[554] D. Gross, K.. J. Miller (1990). 'Adjectives in WordNet', International Journal of Lexicography 3, f. 265–77.
[555] J.S. Justeson, S.M. Katz (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts, Computational Linguistics, f. 18.
[556]C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f.89.
[557]S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, f.290.

e kryera përmes investigimit me pyetësorë të folësve[558], të cilët zgjodhën si çift më të mirë antonimesh "*slow/fast*"(*i ngadaltë/i shpejtë*), në vend të "*slow/rapid*"(*i ngadaltë/i shpejtë*), "*slow/express*" (*i ngadaltë/i shpejtë*), etj.[559] Në këndvështrimin e tipologjisë tradicionale mbiemërore në gjuhën angleze dallojmë tipe mbiemërore të kategorizuara në mënyra të ndryshme nga studiues e gjuhëtarë të ndryshëm në bazë të kritereve mbi të cilat ata i kanë bazuar hulumtimet e tyre.

Përmbledhurazi, *Saeed*[560] dallon disa tipe antonimesh mbiemërore:

- *antonime të thjeshta*, të cilët shprehin marrëdhënie midis fjalëve ku gjymtyra negative nënkupton gjymtyrën tjetër positive, si p.sh.,"*dead/alive"*.
- *antonimet e shkallëzuara* shprehin marrëdhënie midis të kundërtave, ku gjymtyra pozitive e çiftit jo domodoshmërisht nënkupton të kundërtën e gjymtyrës tjetër, p.sh., "*rich/poor"*.
- *motrat taksonomike* janë ato fjalë të cilat janë në të njëjtin nivel në një taksonomi të caktuar, si p.sh. ngjyrat: "*red, orange , yellow, black , white, green*", etj.

Tipologjia më e njohur e gjuhës angleze, është ajo e Lyons dhe Cruse tek kategoria tradicionale dhe tipologjia e Murphy dhe Jones në tipologjinë e re bazuar në korpuset gjuhësore. Dy tipet kryesore, që gjenden pothuaj në çdo kategorizim, janë ato të *mbiemrave të shkallëzuar* dhe *plotësues.*[561]

4.1.2.1 Antonimet mbiemërore të shkallëzuara

Në këndvështrimin tradicional, një grup hulumtuesish i sheh antonimet brenda kufijve të shkallëzimit dhe kundërshtimit, ndër to edhe Lyons dhe pasuesit e tij. Të tilla të kundërta të shkallëzuara përbëjnë tregues të mirë të konceptit të kundërvënies binare. Një fjalë mund të konsiderohet *e shkallëzuar* nëse përshkruan një cilësi, gjendje, apo veprim i cili mund të rezultojë në nivele më të larta apo më të ulëta. Sapir thekson, se "në përgjithësi, fjalët e shkallëzuara janë në gjendje të përcaktohen nga ndajfolje si "*very"(shumë)* dhe "*slightly"(paksa),*dhe shpesh gjenden në struktura krahasore dhe sipërore".[562] Kështu mund të kemi mbiemra të shkallëzuar, sikurse mund të kemi edhe mbiemra të pashkallëzuar.

Në përgjithësi, të kundërtat e shkallëzuara janë në *kundërvënie kundërshtuese,* që do të thotë, se pohimi i njërës rezulton në mohimin e tjetrës. Kështu, nëse X[563] është P, ai nuk mund të jetë Q, ku P dhe Q përbëjnë një çift të *kundërtash kundërshtuese*.[564]Tipari kyç i kundërshtisë është, se përfundimi mund të nxirret nga pohimi i P, i cili të çon drejt mohimit të Q, por jo e anasjellta, p.sh.,: "*long/short"*:

The morpheme is not short.

[558]Shënim: testime të kryera nga Justeson, J.S. and S.M. Katz (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts, Computational Linguistics.
[559]Shënim: siç shihet edhe nga përkthimi, në gjuhën shqipe përdorim "*i shpejtë*" edhe pë "*fast*" edhe për "*rapid*".
[560]J. I.Saeed (2009) Sematics, Wiley-Blackwell, f. 67 cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Cituar nga S. Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, f.290.
[561]Shënim: edhe pse ndeshen edhe me terminologji e cila varion nga njëri studiues tek tjetri.
[562]D. Bolinger (1967) Adjectives in English: Attribution and Predication. Lingua, f.18.
[563]Shënim: me "X" do të kuptojmë një emër i cili përcaktohet nga një mbiemër prej çiftit antonim "P/Q"
[564] J.Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.156.

(Morfema nuk është e shkurtër.)[565]

The morpheme is not long.

(Morfema nuk është e gjatë.)[566]

Si rezultat, Cruse thekson, se "*të kundërtat e shkallëzuara nuk e ndajnë më dysh një sferë të caktuar*".[567] Disa hulumtues si M. L. *Murphy, A. Lehrer dhe K. Lehrer* ndajnë mendimin se antonimia është e përqendruar kryesisht në kundërvënie, që janë vënë në mënyrë simetrike në një bosht ("*hot/cold", "i nxehtë/i ftohtë"*) dhe të tilla të kundërta simetrike të shkallëzuara konsiderohen *antonime perfekte*.

Në lidhje me shtrirjen e shkallëzimit në pjesë të ndryshme të ligjëratës, Sapir dhe Bolinger argumentojnë, se shkallëzimi "*është një fenomen semantik, i cili nuk mund të kufizohet në pjesë të caktuara të ligjëratës*".[568] Për më shumë, fakti se gjuha angleze karakterizohet nga një sasi e lartë mbiemrash në krahasim me pjesët e tjera të ligjëratës, të krijon idenë se shkallëzimi lidhet vetëm më mbiemrat.[569]

Për sa u përket *mbiemrave të shkallëzuar,* mund të themi se kundërvënia është me e theksuar kur mbiemrat nuk kanë sinonime shumë të afërta në gjymtyrën e kundërvënë. Në lidhje me boshtet bazë të kundërvënies së shkallëzuar dallohen disa nëntipe. Kështu, Ogden dallon "*antonimet në një bosht të vërtetë* (*black/white*), *të cilat janë në rritje të vazhdueshme në formën fiziologjike dhe psikologjike nga minimumi tek maksimumi*".[570] Nga ana tjetër, ai dallon mbiemra të tillë, si: *red/green,* në të cilat tiparet janë përjashtuese në mënyrë reciproke dhe të shkallëzuar, por nuk përbëjnë intensitete të ndryshme të të njëjtit bosht. Ogden është i mendimit, se çifti *green/red* përbën të kundërta, pasi ato kundërvihen me njëra-tjetrën në rrethin e ngjyrave. Nënkategoritë e Ogden bazohen në tiparet e kategorive që kundërvihen.

Murphy është i mendimit, se "*përdorimi dhe shpërndarja e njësive leksikore individuale në raport me njëra-tjetrën varen nga dimensionet dhe tiparet që këto njësi përshkruajnë, dhe nga dallimet e leksikalizimit në gjuhë të ndryshme*".[571] Kështu, Murphy është i mendimit se nënkategoritë e të kundërtave të shkallëzuara nuk përbëjnë tipe shumë të ndryshme të kundërvënies, pasi ato janë të kundërtat, të cilat përdoren dhe aplikohen në struktura të ndryshme semantike. Ai rithekson se *"veçoritë brendaleksikore të marrëdhënieve të kundërshtisë apo përcaktimi i parimeve të veçanta për parashikimin e kundërvënies, nuk janë të nevojshme, pasi tiparet semantike të fjalëve në vetvete janë ato që parashikojnë modelet e përdorimit dhe të interpretimit*".[572]

---

[565] Shënim: "*is not short*" (*nuk është e shkurtër*) s'do të thotë se është "*long"*(e gjatë), pasi morfema mund të mos jetë as *e gjatë* as *e shkurtër*, por në gjatësi mesatare (Murphy 1989)

[566]Shënim: "*is not long*" s'do të thotë se është "*short" (*e shkurtër), pasi morfema mund të mos jetë as *e gjatë* as *e shkurtër*, por në gjatësi mesatare (Murphy, 1989)

[567] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge: Cambridge University Press, f.204.

[568]D. Bolinger (1967) Adjectives in English: Attribution and Predication. Lingua, f.18.

[569]Shënim: por ka edhe disa folje të cilat do të trajtohen tek kapitulli i foljeve antonime

[570] C. K. Ogden (1967) Opposition: a Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f .57.

[571] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.196.

[572] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.196.

Palmer[573] gjithashtu i trajton *mbiemrat e shkallëzueshëm* përmes analizës me çifte antonimesh si "*wide/narrow", "old/young", "big/small",* etj., të cilat tregojnë shkallëzim të gjerësisë, moshës, përmasës, etj. Sapir[574] i trajtoi mbiemra të tillë në lidhje të ngushtë me shkallëzimin. Ai bëri dallimin midis formës krahasore të mbiemrave dhe asaj bazë, ku dalloi "*shkallëzimin e qartë*" (*explicit*) dhe "*shkallëzimin e nënkuptuar*" (*implicit*). Kjo qartësohet përmes shembullit që ai mori me mbiemrin "*wide*" (*i gjerë*) dhe formën e tij krahasore "*wider*" (*më i gjerë*), ku vuri re se nga ana logjike "*wider*" e paraprin "*wide*" për vetë faktin, se ajo kuptohet si diçka *më e gjerë* (*wider*) se diçka tjetër, apo sesa norma e gjerësisë në një kontekst të caktuar.[575] Norma përcaktohet vetëm nga objekti i cili po përshkruhet në një situatë të caktuar, pasi mbiemri "*small*", i përdorur për të përcaktuar një elefant në togun "*small elephant*" në krahasim me një "*mi"* (*mouse*) "*të madh"* (*big*) në togun "*big mouse*" (*mi i madh*), rezulton si mbiemri "*small"*(*i vogël*) i përdorur për të përshkruar një "*elephant" (elefant)* është më i madh në përmasat konkrete sesa ai "*big*" (*i madh*), i përdorur për të përcaktuar një "*mouse" (mi).* Pra, ato e kanë shkallëzimin të nënkuptuar dhe janë antonime me shkallëzim të nënkuptuar. Meqenëse të tilla antonime janë të shkallëzuara, ekzistojnë edhe gjymtyrë të ndërmjetme, si në shembullin e mbiemrave "*hot/warm/cool/cold*" (*i nxehtë/i ngrohtë/i freskët/i ftohtë*), ku vetë "*warm/cool*" (*i ngrohtë/i freskët*) formojnë një çift antonimesh.

Gjithashtu, brenda çifteve të shkallëzuara antonimesh dallojmë *termin i shënuar* dhe *jo i shënuar* (*marked/unmarked*). Ato dallohen për nga fakti se vetëm njëri prej tyre përdoret për të pyetur apo përshkruar një cilësi të shkallëzueshme. Kështu, në praktikë, ne pyesim "*How wide is it?"* dhe jo "*How narrow is it?",* duke nënkuptuar dhe pritur si përgjigje se objekti mund të jetë ose *i gjerë* (wide) ose *i ngushtë* (*narrow*) në varësi të përmasës. Edhe kur përgjigjemi përdorim përsëri këtë term, si në shembullin:

"It is four yards ***wide****".*

Pra, këtu kemi të bëjmë me një term *të pashënuar* (*unmarked*) siç është mbiemri "*wide*". Gjymtyra tjetër brenda çiftit (*narrow*) është term *i shënuar*, pasi nëse e përdorim për të bërë pyetje të tipit "*How narrow is it*?", ne nënkuptojmë se objekti në fjalë është "*i ngushtë"* (*narrow*), nuk mund të jetë "*i gjerë"* (*wide*). Është pikërisht mbiemri "*i pashënuar"*, i cili formon edhe emrin e cilësisë së përshkruar, si në rastin tonë mbiemri "*wide*" formon edhe emrin e clësisë në fjalë "*width*".

Në lidhje me karakterin universal të këtij tipari të mbiemrave të shkallëzuar, shohim se në gjuhën angleze është pikërisht gjymtyra e cila shënon diçka "*më të madhe*", e cila është *e pashënuar. Në mënyrë të ngjashme,* të njëjtën gjë vërejmë edhe në gjuhën shqipe ("*i gjerë/i ngushtë", "Sa e gjerë është copa?", "gjerësi*"). Por sipas Palmer, "*ky nuk është tipar universal, sepse ka gjuhë për të cilat vlen e kundërta*".[576]

Sapir[577] i quan këto "antonime të marrëdhënieve *më pak/më shumë*",[578] sipas modelit të mëposhtëm:

A is wider than B

[573] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.85.
[574]Shënim: cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.85.
[575] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.85.
[576]Shënim: Palmer jep shembuj të gjuhës gjermane ku raporti është i përmbysur (F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University f.86)
[577]Shënim: cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.86.
[578] Shënim: ai i quan ato *more/less relationships*

(A është më e gjerë sesa B)

B is narrower than A
(B është më e ngushtë sesa A)

A is less narrow than B
(A është më pak e ngushtë sesa B)

B is less wide than A
(B është më pak e gjerë sesa A)

Në lidhje me antonimet, mund të themi, se vetëm antonimet e vërteta të shkallëzuara mund të trajtohen si "*të kundërta marrëdhëniore*" si në shembullin e "*wide/narrow*", forma krahasore e të cilave ("*wider/narrower*", "*më e gjerë/më e ngushtë"*) formon *të kundërta marrëdhëniore,* pasi nëse "*a is wider than b*" (*a është më e gjerë se b*) atëherë dhe "*b is narrower than a*" (*b është më e ngushtë se a*). Kjo marrëdhënie mund të jetë dhe kalimtare sipas modelit nëse "*a is wider than b*" (*a është më e gjerë sesa b*) dhe "*b is wider than* c"(*b është më e gjerë sesa c*) atëherë edhe "*a is wider than c*"(*a është më e gjerë sesa c*).[579] Për më shumë, nëse i përdorim sipas modelit të krahasimit të barazvlefshëm të tipit "*as wide as*" (*po aq e gjerë sa*), "*as narrow as*" (*po aq e ngushtë sa*), ato dalin si kalimtare, vetvetore dhe simetrike në të njëjtën kohë.[580]

Antonimia binare karakterizohet nga tipari binar. Në lidhje me këtë tipar të kundërvënies, Murphy vëren, se marrëdhëniet e kundërshtisë mes gjymtyrëve të *strukturave kundërvënese* disagjymtyrëshe mbiemërore, si p.sh.,"*sweet/sour/salty/bitter"* (*e ëmbël/e athët/e kripur/e hidhur*) realizohen në çifte antonimesh, si p.sh.,"*sweet/bitter" (e ëmbël/e hidhur)*.[581] Megjithatë, ne mendojmë se këto çifte nuk përbëjnë kundërvënie të vërtetë (*long/short, e gjatë/e shkurtër*) dhe nuk qendrojnë brenda të njëjtit bosht dimensional, por janë të ngjashme me tipin "*red/green" (e kuqe/jeshile)* [582] dhe përfaqësohen në boshte të ndryshme.

Si rezultat, ato nuk janë të kufizuara nga ana logjike në kundërvënien binare. Struktura disagjymtyrëshe "*sweet/sour/salty/bitter"* mund të konsiderohet strukturë kundërvënëse kundërshtie për vetë faktin, se nëse një përbërës X është "*i ëmbël" (sweet),* kjo tregon se nuk është "*i thartë"*(sour), "*i kripur"*(salty) apo "*i hidhur"* (*bitter*). Për më shumë, diçka që nuk është "*e ëmbël"* (*non sweet*) nuk na çon në përfundimin se është në një nga shijet e tjera brenda strukturës disagjymtyrëshe (as e ëmbël, as e thartë, as e kripur, as e hidhur) pasi diçka mund të ketë shije neutrale, ose të jetë pa shije fare[583].

Përmes këtyre argumenteve të Murphy provojmë, se marrëdhëniet e kundërshtisë ekzistojnë në strukturat kundërvënëse disagjymtyrëshe, por në një shkallë më të ulët kundërvënieje.

[579] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f..86.
[580] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.86.
[581]M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press f.198.
[582] C. K. Ogden (1967) Opposition: a Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f .58.
[583]M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.198.

Për sa u përket *ngjyrave*, dhe pikërisht çiftit "*red/green"*, ai konsiderohet antonimik, pasi ato përballen me njëra-tjetrën në rrethin e ngjyrave dhe njëkohësisht këto dy ngjyra kundërvihen edhe me termat e tjera të ngjyrave themelore në gjuhën angleze (ngjyrat kromatike: "*orange/yellow/blue/purple", "portokalli/e verdhë/blu/lejla"*). Le të ndalemi te shembulli i mëposhtëm:

This spot is red.
(Kjo pikë është e kuqe.)

Me ngjyrën "*red*" (*e kuqe*) nënkuptojmë, se ajo nuk është as e verdhë, as portokalli, as jeshile, as blu dhe as lejla. Ogden[584] i vendos ngjyrat në një bosht, ku ato fillojnë nga vetja e tyre deri tek ngjyra gri, të cilën ai e konsideron një pikë të mesme të domosdoshme për marrëdhënien e kundërshtisë. Megjithatë, Murphy mendon, se shembulli i mësipërm nuk është i saktë për shkak se "ngjyrat, përveçse gjenden në një bosht deri në ngjyrën '*gri'*, gjithashtu janë në një vazhdimësi me ngjyrën e tyre fqinje, pasi diçka që është '*e kuqe'* mund të jetë edhe pak '*portokalli"*'.[585] Për këtë arsye, struktura disagjymtyrëshe e kundërvënies së ngjyrave është e *mbivendosur* ndryshe nga ngjyrat primare, të cilat formojnë strukturën "*red/yellow/blue"*, të cilat janë *jo të mbivendosura*.

Gjithashtu, edhe në shembujt e Lyon[586], "*excelent/good/fair/poor/bad/atrocious"*, njësoj si ato të ngjyrave, kufijtë ndërmjet gjymtyrëve shkrihen me njëra-tjetrën. Ne mendojmë, se këto njësi leksikore kundërvihen, por ekzistojnë edhe cilësi të ndërmjetme, të cilat nuk përbëjnë një pikë neutrale logjike për kundërshtinë, p.sh., diçka mund të jetë midis *të kuqes* dhe *portokallisë*, (*red*/*orange*) ashtu sikurse diçka mund të jetë ndërmjet "*good"* dhe "*fair"*, por kjo pikë e ndërmjetme nuk përbën *një pikë të mesme logjike*, pasi të jesh ndërmjet *të kuqes* dhe *portokallisë* nuk do të thotë të mos jesh as *i kuq* dhe as *portokalli*, pra nuk kemi kundërshti logjike.[587] Si rezultat, flasim për *cilësi të shkallëzuara jokundërshtore*,[588] të cilat janë jo pak të zakonshme.

4.1.2.2 Antonimet mbiemërore plotësuese

Cruse, në lidhje me *të kundërtat plotësuese, shton se "ato perceptohen si fjalë të cilat përbëjë një çift plotësues dhe ndajnë midis tyre një fushë konceptore në dy pjesë reciproke*"[589], që do të thotë, se ajo e cila nuk përfshihet ne njërën nga pjesët në mënyrë të padiskutueshme përfshihet tek tjetra. Kështu, themi se nuk ka një terren të mesëm, neutral, apo një mundësi për një gjymtyrë të tretë midis tyre. Shembuj mbiemëror të kësaj kategorie janë edhe çiftet "*true/false"*, "*dead/alive",* etj. Të tilla çifte plotësuese të të kundërtave dallohen përmes teknikës së mohimit të njërës prej gjymtyrëve, ku si rezultat në të njëjtin kontekst do të zëvendësohet nga gjymtyra tjetër e këtij çifti. Për shembull:

[584] C. K. Ogden (1967) Opposition: a Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f .59.
[585]M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.199.
[586]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f. 140.
[587]M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press f.199.
[588]Shënim: të cilat, siç i pamë më lat, njihen si motra taksonomike nga J. I.Saeed, cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.87.
[589] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge, Cambridge University Press, f.197.

"*John is not alive.*"

(*Xhoni nuk është gjallë.)*[590]

Nisur nga shembulli i mësipërm, nëse themi "*not alive*" ne nënkuptojmë "*dead*" (*John is dead.*)

Një tjetër prove, mund të bëhet përmes mohimit të të dyja gjymtyrëve brenda të njëjtit kontekst, si për shembull:[591]

"*John is neither dead nor alive.*"

(*Xhoni nuk është as i vdekur, as i gjallë.)*

Siç shihet, në fjalinë e mësipërme, "*neither dead nor alive*" (*as i vdekur, as i gjallë*) nuk ka kuptim. Për sa kohë jemi të mendimit që çifti plotësues i të kundërtave ndan në dy pjesë një fushë konceptuale të caktuar, cilësitë e këtyre termave brenda çiftit shfaqen vetëm brenda asaj fushe. Brenda kategorisë së të kundërtave plotësuese dallojmë edhe *çiftet plotësuese të vërteta* dhe *pseudoplotësuese*, si në shembullin e antonimeve emërore,"*lion/lioness"* (*luan/luaneshë)* të cilat përfshijnë brenda tyre kundërshtinë plotësuese mbiemërore, midis "*mashkull/ femër".*[592]

Nisur nga një qasje krahasimore ndërmjet kundërvënies plotësuese dhe asaj kundërshtuese/të shkallëzuar, Ogden bën dallimin ndërmjet antonimisë kundërshtuese/të shkallëzuar dhe plotësuese, duke theksuar, se "*të kundërtat mund të jenë ose dy ekstreme të një boshti ose dy anët e një prerjeje*".[593] Lyons e përcakton tipologjinë në bazë të marrëdhënieve ndërmjet gjymtyrëve të një çifti antonim, përmes modelit të shembujve të mëposhtëm:[594]

"if X is P, X is not Q"

(nëse X është P, nuk është Q)

"if X is not Q, X is P"

(nëse X nuk është Q, X është P)

The monster is alive./The monster is not dead.

(Mostra është i gjallë./Mostra nuk ka vdekur.)

The monster is not alive./The monster is dead.

(Mostra nuk është e gjallë./Mostra ka vdekur.)

Për sa i përket tiparit binar në këtë kategori, ai është i domosdoshëm, pasi gjymtyrët ndajnë një fushë të caktuar në dy pjesë, por edhe në disa struktura disagjymtyrëshe, ku gjymtyrët ndajnë një fushë në kategori më të vogla, dhe marrëdhënia

[590] Shembujt shkëputur nga J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press
[591] Shembujt shkëputur nga J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press
[592] J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f. 143.
[593] C. K. Ogden (1967) Opposition: a Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f. 57-146.
[594] Shembujt shkëputur nga J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press

ndërmjet gjymtyrëve të kësaj strukture është e ngjashme me atë të përshkruar nga Lyons, sipas të cilës gjymtyrët përjashtojnë njëra-tjetrën.

Një tjetër kategori antonimesh, janë ato që Lyons i njeh si "*complementaries*"[595] apo "*plotësuese*", ku gjymtyrët e një çifti plotësojnë njëri-tjetrin. Lyons i klasifikon ato në kategorinë e *të kundërtave* (*opposites*) dhe jo antonime, pasi për këto të fundit ai njeh vetëm mbiemrat e shkallëzueshëm. Këto antonime janë të lidhura ngushtë me *fjalët e papajtueshme* por kanë si karakteristikë dalluese faktin, se dalin në çifte dyshe dhe jo në grupe shumëgjymtyrëshe, siç dalin fjalët e papajtueshme. Këto dy kategori fjalësh ngjajnë mes tyre për faktin, se edhe antonimet plotësuese kanë karakter papajtueshmërie, pasi kur themi se dikush është "*married*"(*i martuar*) nënkuptojmë që ky person nuk mund të jetë "*single*"(*beqar*). Por ato dallojnë në atë që thamë më lart, se mohimi i njërës sjell në mendje tjetrën, pasi kemi zgjedhje midis dy alternative ("*single/married*"), kurse te grupet e fjalëve të papajtueshme kemi më shumë se dy alternative, e si pasojë mohimi i njërit tipar nuk na sjell domosdoshmërisht një tipar tjetër specifik[596]. Po kështu, ato dallojnë edhe me mbiemrat antonime të shkallëzueshme, pasi edhe në rastin e këtyre të fundit nuk kemi vetëm dy mundësi, por më shumë. Për shembull, kur diçka nuk është "*cold*" (*i ftohtë*) mund të jetë "*warm*" (*i ngrohtë), "cool" (i feskët), "hot" (i nxehtë),* pra ka më shumë se dy alternativa të shkallëzuara në intensitet.

Nga ana tjetër, edhe brenda mbiemrave të shkallëzuar ka raste kur nuk ekziston një term i ndërmjetëm si në shembullin e çiftit "*wide/narrow*" (*i gjerë/ingushtë*), ku diçka që nuk është "*wide*" jo domosdoshmërisht është "*narrow*", por as nuk ekziston një fjalë që të shënojë një gjerësi të mesme, edhe pse nënkuptohet përmes fjalisë në shembullin e mëposhtëm:

"*It is neither wide nor narrow*."

(*Nuk është as e gjerë as e i ngushtë.*).[597]

Ndonjëherë hasim *raste komplekse,* ku antonimet plotësuese mund të përdoren si kundërshtuese/të shkallëzuara apo e anasjelltas. Cruse të tilla antonime i njeh si *antonime plotësuese të shkallëzuara*[598].

Kjo ilustrohet përmes shembullit të Palmer[599]në fjalinë:

"Someone is more dead than alive."

(Dikush është më shumë i vdekur sesa i gjallë.)

She is very married.

(Ajo është shumë e martuar.)

Këtu kemi të bëjmë me mbiemra të pashkallëzuar (plotësues), të cilët janë përdorur në formë të shkallëzuar në këto kontekste. Nga ana tjetër, disa çifte të

[595] J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.143.
[596] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.202.
[597] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.202.
[598] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.203.
[599] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.89.

shkallëzuara përbëjnë mohim të gjymtyrës që kanë përballë, nëse pohohet njëra prej tyre. Shembull[600]:

"Ari is not honest." – "Ari is dishonest."

(Ari nuk është i ndershëm. - Ari është i pandershëm.)

"Ari is not dishonest." - "Ari is honest."

(Ari nuk është i pandershëm. - Ari është i ndershëm.)

Në lidhje me masën e shkallëzimit të gjymtyrëve të çiftit antonimik, vërejmë se në shumicën e rasteve njëra nga gjymtyrët e çifteve plotësuese të shkallëzuara është më shumë e shkallëzuar sesa tjetra, kështu p.sh., në çiftin "*open /shut",* "*open"* është më shumë e shkallëzuar sesa "*shut"* pasi është e zakonshme në fraza të tipit "*slightly open"* por jo "*slightly shut**". Ndërkohë që në çiftet e tjera plotësuese të shkallëzuara, si p.sh.,"*clean/dirty"* (*i pastër/i pisët*) apo "*honest/dishonest" (i ndershëm/i pandershëm),* të dyja gjymtyrët janë të shkallëzuara në të njëjtën masë. Gjithsesi, mendojmë, se në këta shembuj në përgjithësi nuk kemi të bëjmë me antonimi plotësuese të mirëfilltë, për shkak se ato nuk ndajnë një fushë të caktuar në dy pjesë, dhe mbi të gjitha ndërmjet tyre ekziston një *pikë e mesme neutrale,* si në shembullin e çiftit "*clean/dirty"*:[601]

The kitchen is *neither clean nor dirty.*

(Guzhina nuk është as e pastër e as e pisët.)

Ari is neither *honest nor dishonest.*

(Ari nuk është as i ndershëm as jo i ndershëm)

Cruse e justifikon këtë problem duke shprehur mendimin, se të tilla fjalë kanë dy nuanca kuptimore, pra një në kundërvënie plotësuese dhe një tjetër në kundërvënie kundërshtore. Këto dallime të marrëdhënieve antonime, kanë të bëjnë me dallimet në strukturën semantike të vetë fjalëve. Ato që mund të jenë si plotësuese, ashtu dhe kundërshtuese përshkruajnë "*gjendjet, të cilat mund të konceptohen si pamundësi të një vije të mesme ose si skajore*".[602]

Në gjuhësi, ky tipar njihet si tipari *privativ* ose *mohues* për çiftet e tipit "*clean/dirty" (e pastër/e pisët),* "*honest/dishonest" (i ndershëm/i pandershëm),* të cilat mund të intepretohen në të dyja mënyrat. Në këtë lloj kundërvënieje një gjymtyrë e çiftit përcaktohet nga mungesa e diçkaje, ndërsa gjymtyra tjetër nga prania e saj.[603] Kështu p.sh.,"*clean*" (*e pastër*) përcaktohet nga mungesa e "*dirt" (pisllëk),* ndërkohë që "*dirty"(e pisët)* përcaktohet nga prania e "*dirt".* Por, kur këto dy clësi përdoren në kuptim relativ në lidhje me standardet shoqërore kontekstuale, kemi si rezultat kundërvënie kundërshtore. Ndërkohë, mbiemra të tjerë rezultojnë të jenë thjesht plotësues ose kundërshtorë, edhe nëse përdoren në njërin kuptim dhe në tjetrin. Atëherë kemi të bëjmë me nuanca

[600] Shembujt shkëputur nga M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.202.
[601] Shembujt shkëputur nga M. L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.203.
[602] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.209.
[603]M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.204

kuptimore të të njëjtit mbiemër, p.sh.,"*dead/alive"* janë *plotësuese,* por nëse i përdorim si *të shkallëzuara,* natyra e tyre antonimike ndryshon në *kundërshtuese*.

4.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën angleze dhe shqipe, parë semantikisht

4.2.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën angleze, parë semantikisht

Në lidhje me foljet e gjuhës angleze, përbën interes fakti se disa disa autorë si, Lyons, Cruse në analizën e foljeve nuk shohin antonimi, por *kundërvënie në kuptim më të përgjithësuar*, pasi ata e shohin antoniminë të lidhur ngushtë me shkallëzimin (i cili në përgjithësi është tipar i mbiemrave). Ne do ti referohemi termit antonim në kuptim gjithëpërfshirës të kundërvënënies pasi në studim foljet dhe mbiemrat do i trajtojmë si pjesë të ligjeratës me aftësi për të krijuar lidhje kuptimore antonimike. Në një këndvështrim përgjithësues, Saeed [604]përmbledh disa tipe antonimesh foljore:

- *të kundërta,* të cilat shprehin një marrëdhënie midis gjymtyrëve që përshkruajnë lëvizje, ku gjymtyra që përshkruan lëvizjen është në një drejtim të caktuar, ndërkohë që gjymtyra që përshkruan lëvizjen tjetër është në drejtim të kundërt, si p.sh.,"*come/go" (vij/shkoj), etj*.

- *antonimet e anasjellta* përshkruajnë një marrëdhënie të parë nga këndvështrime të ndryshme, p.sh. foljet, "*own /belong to" (posedoj/i përket)***, "***buy/sell" (blej/shes), etj*

Kur kemi të bëjmë me *kategorizimin e antonimisë,* sistemi i përdorur nga Cruse është më i kuptueshmi, por edhe më i ndërlikuar. Në përgjithësi, Cruse përdor terminologjinë e Lyons, por ai e thellon në nënkategori më të detajuara. Në veçanti, Cruse formuloi nocionin e "*treshes antonimike*", duke argumentuar se foljet antonimike kërkojnë që të përmbushet një kusht në mënyrë të tillë që të kuptohet potenciali i tyre kundërvënës. Për shembull, nëse çifti binar "*jetoj*" dhe "*vdes*" do të merret si i tillë, si parakusht duhet që të ketë ndodhur edhe "*lindja*".

Duke ndjekur këtë logjikë, Cruse krijon treshen "*be born/live/die*" (*të lindësh/ të jetosh/ të vdesësh)* dhe e emërton atë "*plotësuese të anasjellta*"(*reversive complementarity*).[605] Ai përdor këtë term për shkak, se çifti i skajeve "*të lindësh*" dhe "*të vdesësh*" janë të anasjellta, (*reversives*) sepse paraqesin ndryshim në kahe të kundërta. Shembuj të tjerë mund të ishin edhe "*learn/remember/forget*" (*mësoj/kujtoj/ harroj*) apo "arrive/stay/leave" (*mbërrij/qendroj/largohem).*

Një lloj i dytë i treshes antonimike që Cruse formuloi, është ajo e njohur si "*ndërvepruese*" (*interactives*). Kjo ka të bëjë me ato çifte antonimike, të cilat janë në vetvete një përgjigje ndaj një stimuli të caktuar. Kështu për shembull, **"*request/give/refuse*" (*kërkoj/ jap/ refuzoj*),** përbëjnë një treshe ndërvepruese, ku "*give*" (*jap*) dhe "*refuse*" (*refuzoj*) janë reagime ndaj një stimuli që është kërkesa (*request*).

[604]J. I.Saeed (2009) Sematics, Wiley-Blackwell, f. 67 cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.81.
[605] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.210.

Kështu, themi se fjala "kërkoj" është ndërvepruese edhe me fjalën "jap" edhe me atë "refuzoj".

Së treti, marrëdhënia midis fjalëve që nënkuptojnë një përpjekje për të bërë diçka, e ndjekur nga një sukses ose jo, përbën atë që quhet "*satisfactive anthonimes*",[606] si p.sh., treshja "*compete/win/lose*" (*konkurroj/ fitoj/humbas*).

Kategoria e katërt dhe e fundit e tresheve plotësuese (*complementary*), ka të bëjë me "*counter-actives*" (*kundërveprueset*), ku termi i parë i treshes përfaqëson një veprim aktiv, i dyti një masë për të neutralizuar atë veprim, dhe i treti pasojën e paaftësisë për ta neutralizuar atë veprim.[607] Për shembull, treshja "*attack/defend/surrender*" (*sulmoj/ mbroj/dorëzohem*).

Vetë Cruse e pranon faktin se dy kategoritë e fundit janë më pak themelore se dy të parat.[608] Edhe në këndvështrimin tonë, shumë nga ilustrimet e tij nga antonimet e shkallëzuar janë për t'u vënë në diskutim. Madje, është e vështirë të gjejmë treshe antonimesh, që mund të përshtaten me kategoritë e mësipërme të lartpërmendura nga Cruse pa i kaluar kufijtë e atyre që folësit e një gjuhe i quajnë të kundërta. Mund të themi, se edhe vetë Cruse, do të ketë pasur vështirësi në gjetjen e shembujve të vlefshëm për kategorinë "*counter-actives*", për arsye se numri i foljeve që tregojnë një veprim agresiv, një masë për ta neutralizuar atë, dhe një pasojë e paaftësisë për ta neutralizuar atë është shumë i limituar. Nga ana tjetër, një argument pro qendrimit të Cruse mund të jetë fakti se *treshja e antonimisë* është e rëndësishme për të tërhequr vëmendjen ndaj kërkesave të caktuara, që duhet të përmbushen nga çiftet e antonimisë foljore.

Siç edhe e theksuam më lart, ne do e trajtojmë antoniminë në kuptim të zgjeruar, duke përfshirë edhe kundërvënien e foljeve si kundërvënie antonimesh. Në përgjithësi, antonimet foljore në gjuhën angleze, ndahen në:[609]

- *antonime plotësuese:* janë fjalë të cilat karakterizohen nga një kundërvënie binare e vetme, që mund të kenë vetëm dy gjymtyrë, ku mohimi i njërës prej gjymtyrëve në kundërvënie nënkupton pohimin e gjymtyrës tjetër, si p.sh., foljet"*remember/forget" (kujtoj/harroj),etj.*

- *antonime të anasjellta:* fjalë të cilat shënojnë të njëjtin referent të parë në këndvështrime të ndryshme, pikërisht në atë të subjektit dhe atë të objektit, si në shembujt foljorë të tipit: "*buy/sell"* (*blej/shes*), "*give/receive"* (*jap/marr*), etj.

Për sa u përket antonimeve plotësuese, Cruse thekson, se përveç mbiemrave, në këtë kategori ka edhe folje që dallohen nga fjalët e kundërta plotësuese mbiemra për shkak se fusha në të cilën të kundërtat plotësuese foljore veprojnë, shprehet nga një gjymtyrë e vetme leksikore, e cila në vetvete krijon marrëdhënie të dukshme kundërshtie me një nga përbërësit e çiftit plotësues. Për shembull,"*obey/disobey" (bindem/ nuk bindem)* e shpreh marrëdhënien plotësuese kundërshtuese vetëm në kontekstin e dhënies së një komande. Nëse nuk ekziston një komandë apo nëse kjo komandë nuk është dhënë ashtu siç duhet, nuk mund të flasim për "*obeying/disobeying*". Në këtë shembull, vetë

[606] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.210.
[607] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.211.
[608] D.A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.211.
[609]Shënim:kategorizim i mbështetur tek F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University; D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press

folja "*command"*(*komandoj*) përcakton kontekstin për gjymtyrët "*obey/disobey"*. Ndonjëherë vërejmë se vetë termi "*command"* shihet si një marrëdhënie kundërshtuese me termin "*obey"*. Megjithatë, Cruse mendon, se "nëse pyesim dikë për të kundërtën e fjalës '*obey'*, përgjigja më e mundshme do të ishte fjala '*disobey'"*[610] për shkak se siç thekson Cruse, "çifti '*obey/disobey'* përben të kundërta 'më të mira' sesa çifti '*command/obey'* "[611]. Antonimet plotësuese njihen edhe si *kontradiktore,* si në shembujt,"*remember/forget*" (*kujtoj/harroj*), etj. Këto çifte antonimike bëjnë pjesë në marrëdhënien e kundërshtisë të tipit "*kjo/apo ajo*".

Në lidhje me *të kundërtat plotësuese, Cruse shton, se "ato perceptohen si fjalë, të cilat përbëjnë një çift plotësues dhe ndajnë midis tyre një fushë konceptore në dy pjesë reciproke*"[612], që do të thotë se ajo e cila nuk përfshihet në njërën nga pjesët, në mënyrë të padiskutueshme përfshihet tek tjetra. Kështu, themi se nuk ka një terren të mesëm, neutral, apo një mundësi për një gjymtyrë të tretë midis tyre me shembuj foljorë si,"*pass/fail" (kaloj/ngel, dështoj), etj.*

Në këtë kontekst, Cruse [613] dallon *katër tipe* të kundërtash, marrëdhëniet karakteristike të të cilave vendosen midis njësisë leksikore, e cila shpreh presupozimin e domosdoshëm për një çift antonimesh plotësuese dhe njërës prej gjymtyrëve të çiftit plotësues:

a) të anasjelltat (*reversives).* Një shembull i treshes leksikore që gjeneron nga kjo marrëdhënie mund të jetë "*be born/live/die" (të lindësh/të jetosh/të vdesësh)*, ku "*be born"* dhe "*die"* njihen si *çift i jashtëm* dhe janë të anasjellta, pasi ato tregojnë një ndryshim në drejtim të kundërt, përkatësisht "*ardhje në jetë/lënien e jetës*". Brenda të njëjtës treshe leksikore dallojmë çiftin plotësues kundërshtues të plotë "*live/die" (jetoj/vdes)* përmes provës "*He shall not live"(Ai nuk do të jetojë.)*si ekuivalente e "*He shall die" (Ai do të vdesë.)*. Kundërshtia themelore në këtë kategori qendron midis "vazhdimësisë së gjendjes" apo "ndryshimit në një gjendje alternative. Të tjerë shembuj janë edhe foljet "*learn/remember/forget" (mësoj/kujtoj/harroj)*, apo edhe "*earn/ save/ spend",* etj.

b) ndërveprueset (interactives) kanë një marrëdhënie të tipit përgjigje stimuli. Folja që shpreh kushtet për çiftin plotësues kundërshtues përcakton një veprim që ka si qëllim gjenerimin e përgjigjes të përcaktuar nga e kundërta e saj ndërvepruese, e cila është një nga gjymtyrët e çiftit plotësues kundërshtues. Shembuj të tillë kemi treshet leksikore të tipit,"*invite/accept/turn down" (ftoj/pranoj/refuzoj).*

c) *përmbushëset* (satisfactives), ku njëri nga termat e të kundërtave tregon një përpjekje për të bërë diçka, kurse termi tjetër tregon një performancë të suksesshme. Këto janë shumë të ngjashme me ndërveprueset e lartpërmendura. Shembuj të përmbushëseve kemi: "*compete/win" (konkuroj/fitoj), try/succed (përpiqem/ja dal mbanë), etj*. Ka debat në përfshirjen e këtyre çifteve si të kundërta. Ne do të pranojmë se ekziston në mënyrë të dukshme një marrëdhënie binare i një lloji të caktuar midis termave të një çifti të tillë. Pjesa kryesore e këtyre çifteve mund të formojë treshet leksikore të tipi: "*try/succed/ fail",*

[610] D.A. Cruse, P. Togia (1995) Towards a Cognitive Model of Antonymy. Lexicology, f.108.
[611]Shënim:Cruse dallon shembuj të mirë dhe shembuj më pak të mirë në kategorinë e të kundërtave
[612] D.A. Cruse, P. Togia (1995) Towards a Cognitive Model of Antonymy. Lexicology, f.109.
[613]D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press,f.211.

apo*"compete/win /lose"*. Për këtë arsye, shpesh shihen nga gjuhëtarët si shumë të ngjashme me ndërveprueset dhe ndonjëherë edhe të padallueshme nga ato.

d) *kundërveprueset* (*counteractives*), ku gjymtyrët përbërës të çifteve plotësuese kundërshtuese paraqesin një përgjigje aktive ose pasive ndaj veprimit fillestar. Shembuj kemi çiftet e tipit "*attack/counterattack" (sulmoj/kundërsulmoj)*,si përgjigje të një veprimi agresiv fillestar. Të tilla kundërvepruese dinamike nuk shprehen kurrë me një rrënjë leksikore të mëvetësishme në gjuhën angleze, por nga parashtesimi me parashtesën "*counter"*.

Palmer, ashtu si edhe Cruse më sipër, foljet i përfshin në grupin e marrëdhënieve semantike, që njihet si *marrëdhënie të anasjellta,* por *jo antonime*. Ashtu si Lyons dhe Cruse, ai bën dallimin midis *antonimeve* dhe *të kundërtave*. Kështu, për sa u përket këtyre të fundit, Palmer thekson, se ato gjenden tek ato çifte, të cilët kanë marrëdhënie të anasjellta, si në shembujt foljorë të tipit "*buy/sell*" (*"blej/shes")* duke argumentuar se "*if A sells to B*" (*nëse A i shet B*) atëherë "*B buys fromA*" (*B blen nga A*). Shembuj:[614]

Lydia bought the car from Kirsten.
(Lidia e bleu makinën nga Kërsten.)

Kirsten sold the car to Lydia.
(Kësten i'a shiti makinën Lidias.)

Lyons propozon emërtimin e tyre si "*conversives*" (*të anasjelltat*), ndërsa Palmer propozon termin "*relational opposites*" (*të kundërta marrëdhëniore*) pasi siç thekson ai, "*gjuhëtarëve u intereson të veçojnë karakteristikat marrëdhëniore kryesore*".[615] Në këtë kategori, gjejmë folje të tipit: "*lend/borrow*" (*jap hua/marr hua*), "*rent/let*" (*marr me qira/jap me qira*), "*own/belong to*" (*zotëroj/i përkas*), "*give/receive*" (*jap/marr*), etj. Gjithashtu, këtu janë kategorizuar edhe forma *veprore* dhe *pësore* e të njëjtës folje sipas modelit "*A hits B*" (*A godet B*) dhe "*B is hit by A*" (*B goditet nga A*).[616]

Në këndvështrimin logjik, të tilla marrëdhënie janë simetrike, kalimtare dhe vetvetore. Marrëdhënia është simetrike, nëse argumentet a dhe b lidhen (R) mes tyre në të dy drejtimet, pra nëse pranojmë "a R b" atëherë edhe "b R a" si në shembulli "*be married to*":[617]

Nëse "John is married to Mary." edhe "Mary is married to John."

(*Nëse "Xhoni është i martuar me Merin.", edhe "Meri është e martuar me Xhonin.*")

Një marrëdhënie është kalimtare sipas modelit "nëse a lidhet me b dhe b lidhet me c, atëherë a lidhet me c" (a R b, b R c, a R c). Shembuj foljorë nuk kemi në këtë tipar, por vetëm shembuj fjalësh që shënojnë pozicione në hapësirë, pra ndajfolje të tilla si "*above/below" (sipër/poshtë), north/south (veri/jug),* etj. Për sa i përket tiparit vetvetor, këtu do të përmendim disa folje të tipit "*resemble*" (*ngjan*) dhe "*equal*" (*është e*

[614] Shembujt e marrë nga F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.82.
[615] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.83.
[616] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.83.
[617] Shembujt e marrë nga F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.84.

baarbartë), të cilat lidhin një argument të caktuar me veten, si në fjalinë "*John resembles himself*." (Xhon i ngjan vetes.)[618]

Nga tiparet e mësipërme, ajo që na intereson më shumë në studimin tonë, është pikërisht simetria. Për sa i përket simetrisë së foljeve, duhet theksuar, se ky nuk është tipar universal i foljeve, pra, nëse "*be married*" (*të jesh i martuar*) është simetrike, pasi nuk mbart dallime gjinore si në gjuhën angleze edhe atë shqipe, ajo nuk del e tillë në ato gjuhë, ku për *bashkëshortin* përdoret folja në formën aktive, dhe për *bashkëshorten* përdoret forma pësore.

Me interes të veçantë janë edhe ato folje të cilat nuk mund t'i kategorizojmë tek ato që Palmeri i quan "*të kundërta marrëdhëniore*", por që dallojnë në drejtimin hapësinor, siç janë foljet "*come/go*" (*vij/shkoj*), dhe "*bring/take*" (*sjell/marr*). Fillmore ishte ai që vuri në diskutim marrëdhëniet mes këtyre foljeve.[619] Vërehet se folja "*come*" është e kufizuar, pasi ajo tregon drejtim drejt folësit apo dëgjuesit në kohë reale, ose në të shkuarën apo të ardhmen. Ajo mund të përdoret edhe për të shënuar drejtim drejt një vendi ku folësi apo dëgjuesi ndodhen zakonisht (shtëpia, puna, zyra etj), edhe pse nuk dihet nëse ai ndodhet aty në atë moment apo jo.[620] Në këtë rast, folja "*come*" mund të zëvendësohet me foljen "*go*", si në shembullin "*Come to my office*" (*Eja në zyrën time),* ose "*Go to my office*" (*Shko në zyrën time*)[621]. Lëvizja mund të jetë drejt folësit/dëgjuesit ose larg tij. Nëse nuk ka asnjë informacion në lidhje pozicionin e folësit/dëgjuesit, atëherë do të përdorim "go"[622].

Më tej, Palmer trajton edhe një grup foljesh, të cilat ai i njeh si *"marrëdhënie të përkohshme*", si për shembull midis çifteve "*ask/reply"(pyes/përgjigjem), "offer/accept" (ofroj/pranoj),* etj. Në çiftin "*offer/accept"*(*ofroj/pranoj*) nënkuptojmë se është bërë një pyetje ("*ask", "pyes"*) dhe gjymtyrë të tjera të mundshme në vend të "*accept*" (*pran*oj) në një situatë të caktuar mund të jenë edhe "*reply*" (*përgjigjem*) ose "*refuse*" (*refuzoj*).[623]

Cruse, gjithashtu, dallon një kategori tjetër të kundërtash foljore, të cilat i quan *"të kundërta jo të pastra" (impure opposites)* me të cilat nënkupton ato të kundërta të cilat përfshijnë brenda kuptimit të tyre një kundërshti më elementare, si në shembujt *giant*/*dwarf* (*gjigand/shkurtabiq*), të cilat në vetvete përfshijnë një kuptim të kundërt midis "*i madh/ i vogël"*.[624] Në mënyrë të ngjashme jepen dhe shembujt e tipit "*shout/ whisper" (ulëras/psherëij),* që përfshijnë brenda kuptimit të tyre "*me zë të lartë/me zë te butë"* (*loud voice/ soft voice*).Të tilla çifte fjalësh të kundërta përcaktohen nga Cruse si "*idiosyncratic" (të dallueshme, të veçanta)*[625] dhe të paparashikueshme për sa u përket tipareve të tyre dhe përdorimit.

4.2.2 Shkallëzimi dhe foljet

Tek *antonimet e mirëfillta*, polariteti semantik është relativ, kundërvënia është e shkallëzuar dhe mund të përfshihen disa elemente në shkallë të ndryshme të të njëjtës

[618] Shembull i marrë nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.84.
[619] Cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.85.
[620] Cituar nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.86.
[621] Shembujt e marrë nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.88.
[622] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.88.
[623] F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.88.
[624] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.211.
[625] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press,f.211.

cilësi[626]. Kjo kategori është tipike për mbiemrat, por ka edhe studiues, të cilët i njohin foljes këtë tipar. Në lidhje me shtrirjen e shkallëzimit në pjesë të ndryshme të ligjeratës, Sapir dhe Bolinger [627] argumentojnë, se "*shkallëzimi është një fenomen semantik, i cili nuk mund të kufizohet në pjesë të caktuara të ligjeratës*". Fakti i përmendur më lartë se gjuha angleze karakterizohet nga një sasi e madhe mbiemrash në krahasim me pjesët e tjera të ligjeratës, të krijon idenë, se shkallëzimi lidhet vetëm më mbiemrat. Por ka edhe gjuhë të tjera, si ajo kineze, e cila duke mos pasur mbiemra, e shprehin kundërvënien, përmes foljeve. Edhe në gjuhën angleze foljet kanë aftësi të shkallëzimit, si p.sh. foljet "*love/hate"(dashuroj/urrej)* në shembujt e mëposhtëm:[628]

I love /hate him very much.

(Unë e dua/urrej atë shumë.)

I love/hate him more than you do.

(Unë e dua/urrej atë më shumë sesa ti.)

I love him. -> I don't hate him.

(Unë e dua atë.-> Unë nuk e urrej atë.)

I don't love him.

(Unë nuk e dua atë.)

Duhet sqaruar se "*I don't love him*" jo domosdoshmërisht nënkupton "*I hate him".* Veprimet që foljet përshkruajnë janë komplekse dhe duhen studiuar në detaje dhe shumë tipare të tyre lidhen edhe me veprime të tjera, të cilat përdoren për t'i përshkruar ato. Për këtë arsye, është më e vështirë të përcaktohet shkallëzimi i foljeve.

4.2.3 Problematikat në klasifikim e foljeve antonime

Antonimet e anasjellta, antonimet e kundërta apo të drejtimit, janë ato që përbëjnë edhe kategoritë më të diskutuara të foljeve në kundërvënie. Për sa i përket tipologjisë së antonimisë, vërejmë se kategorizimi i tyre është jo i rregullt, dhe gjuhëtarë të ndryshëm i kanë trajtuar ndryshe ato. Disa nënkategori problematike janë edhe kundërvënia *e anasjelltë, e përmbysur* dhe *e drejtimit*, të cilat do të trajtohen, si më poshtë:

Kundërvënia e anasjelltë përbën një nga tipet kryesore e Lyons, të cilin ai e paraqet sipas modelit[629]:

If X is **p** to Y→Y is **q** to X

*(nëse X është **p** kundrejt Y, atëherë Y është **q** kundrejt X)*

If Y is **p** to X → X is **q** to Y

*(nëse Y është **p** kundrejt X, atëherë X është **q** kundrejt Y)*

[626] F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.84.
[627] Cituar nga D.A. Cruse, Pagona Togia (1995) Towards a Cognitive Model of Antonymy. Lexicology, f..115.
[628] Shembujt nga F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University, f.84.
[629]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.143.

Shembuj të kësaj kategorie të njohur nga Lyons përbëjnë antonimet foljore të tipit "*buy/sell"(blej/shes),* "*give/receive" (jap/marr),* etj.

Ndërkohë, disa gjuhëtarë të tjerë, si Ogden dhe Cruse, i klasifikojnëfjalët antonime të anasjellta si *antonime të drejtimit*. Kjo për arsye, se e shohin të njëjtën marrëdhënie nga kënde të ndryshme.Ogden argumenton, se "*ato nuk kanë shkallë intensiteti mes tyre dhe as nuk ndajnë një fushë të caktuar në dy pjesë, pra nuk janë as të shkallëzuara dhe as të kundërta*".[630]

Teoria e*"marrëdhëniespërmes kundërvënies"* e Murphy e njeh këtë kategori të anasjelltash, pasi ato janë maksimalisht të ngjashme dhe minimalisht të ndryshme. Jones jep një kundërargument në lidhje me kategorinë e antonimeve foljore të anasjellta, pasi ai mendon, se "*gjymtyrët e çiftit teach/learn (jap mësim/përvetësoj) nuk janë tërësisht të anasjellta, pasi mund të kemi mësimdhënie, pa mësimnxënie*".[631]

Lyons gjithashtu dallon antonimet e drejtimit, të cilat përbëhen nga gjymtyrët ***p*** dhe ***q***, të cilat kundërvihen në raport me një pikë vendndodhjeje **P**.[632] Një shembull i tillë është çifti foljor "*come/go" (vij/shkoj)*. Kështu, Lyons i dallon ato nga *të anasjelltat*. Megjithatë, Murphy është i mendimit, se "*dallimi i kësaj kategorie nga kategoria e të anasjelltave nuk është e dobishme dhe as e justifikueshme*"[633], pasi siç thekson ai: "*edhe gjymtyrët e çifteve të kundërshtisë, plotësuese dhe të anasjellta mund të kundërvihen në drejtime të ndryshme*". [634]

Për më shumë, Ogden vëren, se "*disa çifte antonimesh të drejtimit sillen edhe si të shkallëzuara*". [635] Për këto arsye, ai mendon, se "nuk është e nevojshme që ato të kategorizohen si një kategori më vete".[636]

Cruse dallon edhe kategorinë e *kundërvënies së përmbysur* (*reversives*), e cila nënkupton zhbërjen e një veprimi, gjendjeje, apo cilësie. Në gjuhën angleze, ato dalin të lidhura nga ana morfologjike, si për shembull "*do/undo" (bëj/zhbëj),* por ka edhe shembuj foljorë jo të lidhur morfologjikisht, si për shembull "*build/demolish" (ndërtoj/shemb).* Murphy i quan ato "*imazhe pasqyruese*" pasi, siç shprehet ai, "*veprimi apo gjendja e përshkruar nga njëra gjymtyrë është kryerja së prapthi i veprimit tjetër*".[637] Sipas teorisë së Murphy, këto njihen si *maksimalisht të ngjashme* për shkak të veprimit mbi të cilat ngrihen, por edhe *minimalisht të ndryshme,* pasi pikat përfunditare të këtyre fjalëve janë të përmbysura[638]. Cruse i trajton këto si *nënkategori të kundërvënies së drejtimit,* madje i ndan ato në dy nëntipe: *të përmbysura, të pavarura* ("*raise/lower", "rrit/ul"*) dhe *të kthimit* (restitutive) të cilat nënkuptojnë kthim në gjendjen fillestare ("*kill/resurrect",*

[630] C. K. Ogden (1967) Opposition: A Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f.143.
[631] S. Jones (2002) Antonymy: A Corpus-Based Perspective. London: Routledge, f.124.
[632]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.143.
[633] M.L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.197.
[634] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.197.
[635] C. K. Ogden (1967) Opposition: A Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f.146.
[636] C. K. Ogden (1967) Opposition: A Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f.146.
[637] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.205.
[638] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.205.

"vras/ringjall"). Cruse gjithashtu dallon edhe një tjetër kategori, të cilën e quan "homologe" ose "*counterparts*".[639]

Varley në hulumtimet e saj ofron prova që dëshmojnë, se "*të kundërtat e drejtimit dhe të anasjelltat përpunohen ndryshe nga ato plotësuese dhe kundërshtuese*".[640] Kjo do të thotë se ato përfaqësohen ndryshe në mendje. Në studimin e saj, informantët treguan një performancë të dobët në gjenerimin e të kundërtave të drejtimit dhe të anasjelltave, duke treguar nga ana tjetër një preferencë të dukshme për ato plotësuese dhe kundërshtuese, pasi këto të fundit rezultojnë të jenë tipe kundërvëniesh më prototipe.

Gjithashtu, me interes për t'u vëzhguar është edhe kundërvënia e paklasifikuar dhe e ndërlikuar. Kështu, disa nënkategori antonimesh mbivendosen si më lart, ndërkohë që disa të tjera nuk janë pjesë e asnjë prej atyre nënkategorive. Disa çifte foljore, si "*ask/answer"* duket sikur ngjajnë me ato të *anasjelltat*, por ato janë dy veprime të ndryshme, dhe jo dy këndvështrime të ndryshme të të njëjtit veprim.[641] Në mënyrë të ngjashme, edhe foljet "*start/finish",* të cilat duket se ngjajnë me antonimet e *kundërshtisë* për shkak se duket se ekziston një vijë e mesme ndërmjet këtyre dy veprimeve, por ndryshe nga kundërshtueset, ato nuk qendrojnë në lidhje logjike kundërshtore. Murphy, në lidhje me çiftin foljor "*ask/answer",* është i idesë, se "*kemi të bëjmë me një çift antonimesh plotësuese kontekstuale"* [642] . Ai shton, se "*edhe çifti 'start/finish' kategorizohet si antonimi plotësuese kontekstuale, për shkak se këto gjymtyrë janë të ngjashme, pasi përshkruajnë skaje të përkohëshme të një ngjarjeje, dhe të ndryshme pasi shënojnë skaje të kundërta"*.[643]

Si përfundim, themi se një taksonomi e përcaktuar qartë e në mënyrë përfundimtare nuk ekziston, pasi përsëri flasim për antonime që mbivendosen (siç janë edhe antonimet e shkallëzuara dhe ato të drejtimit) dhe për disa të tjera, që nuk kategorizohen lehtë në një nga kategoritë e njohura e të pranuara në mënyrë logjike. Problem i përcaktimit të një taksonomie fikse lidhet edhe me qasjet e ndryshme gjuhësore të hulumtuesve, ku dallojmë ato të qasjes psikologjike, të cilët mendojnë se marrëdhëniet antonimike dhe nëntipet e tyre përfaqësohen në mënyrë brendaleksikore, dhe nga ana tjetër kemi hulumtuesit e *Teorisë së Marrëdhënies përmes Kundërvënies* si p.sh., Murphy, me qasje metagjuhësore, të cilët ndajnë mendimin, se kategoritë e antonimeve nuk paraqesin kodime të ndryshme të çifteve në leksik, por reflektojnë përdorimin e të njëjtit parim marrëdhëniesh në tipe të ndryshme fjalësh.

4.3 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe, parë semantikisht

Klasifikimi i antonimeve foljore në gjuhën shqipe do të shihet semantikisht dhe strukturalisht. M.Samara thekson, se "*klasifikimi i antonimeve sipas kriterit semantik është më i ndërlikuar, sepse mbështetet në strukturën kuptimore të tyre, në karakterin e kuptimeve leksikore të kundërta dhe në tipin e tyre, në përbërësit e kundërt kuptimplotë, që marrin pjesë për kundërvënien e fjalëve nga kuptimi dhe në shkallën e antonimisë a të kundërvënies"*.[644]

---

[639] D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press,f.63-203.
[640] R. Varley (1991) Referene, Sense and Antonymy in the Assessment of Lexical Semantic Abilities in Aphasia. Aphasiology, f.168
[641] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.205.
[642] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.205.
[643] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.205.
[644] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 177.

Në rastin e foljeve, në gjuhën shqipe nuk është e lehtë të bëhet një ndarje e mirëfilltë mes *kundërvënies së plotë* dhe asaj *të pjesshme* për nga vetë natyra dhe funksioni kryesor i foljes. Meqenëse foljet emërtojnë një veprim të një frymori, sendi apo fenomeni, në brendësi të këtij kuptimi qendron edhe qendrimi i vetë folësit.[645] Në përgjithësi, këto folje tregojnë mënyrën e veprimit dhe në gjuhën gjermane njihen si *akdionsart.*[646] Shembuj të çifteve të foljeve në gjuhën shqipe, që tregojnë kundërvënie të plotë a të pjesshme, janë: *"filloj/mbaroj", "marr/jap", "vij/shkoj",* etj.

E njëjta folje mund të dalë në kundërvënie të plotë me një fjalë dhe në kundërvënie të pjesëshme me një tjetër. Kështu për shembull, "*hesht*" është në kundërvënie të plotë me "*flas*" dhe në kundërvënie të pjesëshme me foljen "*këndoj*".

I. Goçi i referohet J. D. Apresjanit duke dalluar disa tipa antonimesh foljore[647]:

- tipi "*filloj/ndërpres*" del në kundërvënie të plotë, si për shembull, "*punoj/pushoj", "këndoj/qaj", "qaj/qesh", "hap/mbyll", "hyj/dal", "afrohem/largohem", "ndez/fik", "jetoj–vdes",* etj., por jo gjithmonë është i plotë.

- tipi "*veprim/zhdukje e rezultatit të veprimit*", ku njëra gjymtyrë eliminon rezultatin e gjymtyrës tjetër. Ky tip del gjithnjë i plotë në kundërvënie. Për shembull, "*qep/shqep", "lidh/zgjidh", "fitoj/humbas",*etj. Këto njihen ndryshe si "*antonime likuiduese*" dhe shprehin marrëdhënie kauzale siç kategorizohen nga Apresjani[648] më poshtë:

  - kauzal likuidim i objektit: "*robëroj/liroj*", "*bëj/zhbëj*", etj.
  - kauzal-likuidim i gjendjes së jashtme fizike të sendit: "*lidh/zgjidh", "mbath/zbath",* etj.
  - kauzal-likuidim i gjendjes së brendshme fizike të sendit: "*ngrin/shkrin", "zbut/forcoj",* etj.
  - kauzal-likuidim i kontaktit të veprimit: "*vesh/zhvesh", "fryj/shfryj", "përdor/shpërdor",* etj.
  - kauzal-likuidim i gjendjes jofizike të sendit:*"hap/mbyll", "mbush/zbraz", "fitoj/humbas", "marr/jap",*etj.

M. Samara flet për *antonime reciproke*, që shënojnë koncepte me ligje të ndërsjellta, të cilat i njeh si tipi i antonimeve me "kundërvënie vektoriale", që lidhet me fjalët që shënojnë veprime dhe lëvizje në drejtime të kundërta, si p.sh.,"*ngrihem/ulem", "hyj/dal",* etj.[649]

Në grupin e *antonimeve të mirëfillta* duhet të futet edhe kundërvënia brenda kuptimeve të së njëjtës fjalë (enantiosemia),që janë të pakta në gjuhën shqipe, si për

[645] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[646] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[647] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[648] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[649] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.

shembull folja "*qasem*", e cila ka kuptimin "*afrohem",* por edhe kuptimin e kundërt, "*largohem*".[650] Në këtë tip të antonimisë mund të futet edhe *kundërvënia stilistikore*, që vihet re midis kuptimeve negative dhe pozitive të së njëjtës fjalë.[651] Në grupin e antonimeve të mirëfillta, mund të futen dhe fjalët antonime me parashtesa (me skemë **T/P+T**), me parashtesat *ç-/sh-/zh-, kundër-* etj., si p.sh.*"vesh/zhvesh",* etj.[652]

Pra, që të kemi kundërvënie të plotë te foljet, nevojitet që "*gjymtyra e dytë e çiftit antonimik të likuidojë thelbësisht rezultatin e veprimit të gjymtyrës së parë, apo ta detyrojë të marrë një kahje të kundërt nga ajo e para*".[653]

Te çifti antonimik foljor "*shkoj/vij*" dallohen qartë tiparet e kundërvënies së plotë përmes drejtimeve të kundërta në drejtim të startit apo fillimit të veprimit. Këto folje kanë të përbashkët kahjen në drejtim gjithnjë përpara. Ndërkohë, çifti antonimik "*shkoj/ndalem*" është jo i plotë në kundërvënie (në krahasim me "*shkoj/vij*") pasi foja "ndalem" nuk e likuidon rezultatin e foljes "shkoj"[654]. Këtu, veprimi i foljes "ndalem" mund të thuhet se mbetet në gjysmë të rrugës. Prandaj, I. Goçi e sheh këtë çift si joantonimik, por në kufijtë e mohimit.[655]

I. Goçi thekson, se "nuk flitet për kufij të prerë në gjuhësi", kur flitet për dallimin e foljeve antonime të mirëfillta a të plota dhe jo të plota. Antonimet janë të plota, kur u kundërvihen shumica e kuptimeve themelore. Këtu kemi të bëjmë me *kundërvënie të pastër***,** edhe jashtë kontekstit. Shembuj: "*jap/marr", "prish/rregulloj", "bëj mirë/bëj keq",* etj. Ato studiohen kryesisht nga korpusi i antonimeve në fjalorë, pasi konteksti nuk ka rëndësi në këtë analizë. Mund të themi, se kanë burim ontologjik, pra lidhet me pasqyrimin e botës reale, jo të shumta në numër, janë të paravëna, ndryshe nga ato kontekstuale, të cilat kushtëzohen nga kuptimi reciprok i dy antonimeve". [656]

Mjetet e ndryshme leksikore dhe fjalëformuese te foljet me kundërvënie të plotë ndahen në:

- Folje rrënjësh të ndryshme, si për shembull: "*hap/mbyll", "shkoj/vij", "shes/blej",* etj
- Folje me rrënjë të njëjtë përmes parashtesimit përmes paarshtesave "ç-", "z-", "sh-", "xh-" "nën-", "mbi- si në shembujt:*"bëj/zhbëj", "vesh/zhvesh", "burrërohem/zhburrërohem",* etj.

Antonimet kryesore me kundërvënie të plotë janë ato foljore, pasi veprimi i shprehur vihet në situata kundërvënëse të dallueshme dhe në të shumtën e rasteve janë të së njëjtës rrënjë. Përcaktimi i qartë i tyre bëhet i mundur përmes nocioneve polare apo ekstreme dhe nuk kanë nevojë të kuptohen përmes kontekstit. Përdoren gjerësisht edhe në letërsi për të formuar antiteza të fuzqishme. Në bazë të kundërvënies së plotë nuk qendron vetëm në raportin e semeve të papajtueshme, por edhe ekzistenca e semeve të përbashkëta.

[650] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[651] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[652] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[653] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.52.
[654] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[655] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 51.
[656] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.53.

Sipas I. Goçi, ndërtimi strukturor i antonimeve të pjesëshme[657] mund të jetë dyllojesh si më poshtë:

- *antonime rrënjësh të ndryshme, ku ballafaqohen kuptimet thelbësore*
- *antonime rrënjësh të njëjta me parashtesim, të tipit i regjistruar-i paregjistruar, ku kundërvënia e pjesshme bëhet përmes ballafaqimit sematik dhe strukturor. Këtu si shkak i kundërvënies është parashtesa "pa-".*

Nëse e krahasojmë kundërvënien midis dy çifteve antonimike të formuara nga e njëjta temë (p.sh. mbiemri *i regjistruar*) por me parashtesa të ndryshme "pa-" dhe "ç-" si në shembullin "*i regjistruar/i paregjistruar*" dhe "*i regjistruar/i çregjistruar*" vërejmë, se edhe pse nga ana strukturore kemi dy ndërtime parashtesore me të njëjtën temë fjale, kundërvënia nuk qendron në të njëjtin nivel tek të dy çiftet. Këtu theksojmë, se kundërvënia është më e fortë midis çiftit "*i regjistruar/i çregjistruar*", ku veprimi i parë është kryer një herë e më pas është kthyer me kah të kundërt deri në pikën fillestare. Për sa i përket mbiemrit tek "*i paregjistruar*" nuk është filluar fare veprimi. Kjo mund të shprehet skematikisht si më poshtë[658]:



- ***B** është në kundërvënie të pjesshme me **A***
- ***C** është në kundërvënie të plotë me **A***
- ***C** dhe **B** nuk janë as sinonime, e as antonime*

Figura 18 Kundërvënia midis dy çifteve antonimike të formuara nga e njëjta temë

Me këtë model skematik ne mund të gjenerojmë shembuj të tjerë mbiemëror prejpjesorë të tipit "*i aktivizuar(A)/i paaktivizuar (B)/i çaktivizuar(C)*", "*i veshur/i paveshur/i zhveshur*", "*i montuar/i pamontuar/i çmontuar*" etj.

Sipas M. Samarës, "*shkalla e kundërvënies së antonimeve strukurore me parashtesa, është më e dobët se ajo me rrënjë të ndryshme".*[659]Megjithatë, siç u vu re më sipër, ne morrëm si raste me kundërvënie të plotë mbiemrat, apo foljet, të cilat e formojnë kundërvënien përmes parashtesave "sh-", "ç-","xh-". Për sa u përket foljeve, kemi shembujt "*thur/shthur*", "*armatos/çarmatos*" etj., të cilët paraqesin kundërvënie të plotë.

Ch. Bally thekson, se "*antonimi i një fjale abstrakte është një pjesë e kuptimit të tij*". [660] I. Goçi gjithashtu dallon edhe ndërmjet *antonimisë elementare* dhe *të abstraktuar*.Antonimi elementare kemi atëherëkur veprimi i shprehur nga folja është pasqyrim i botës reale, natyrës, dhe perceptohet lehtë nga shqisat[661]. Shembuj foljor me antonimi elementare dhe të abstraktuar kemi çiftin "hyj/dal" si në shembujt "*hyj në*

[657] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.53.
[658] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.53.
[659] M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.161.
[660]Ch. Bally (1951) Traite De Stilistue Francise, vol.I, II, Geneva-Paris, f.42, cituar nga I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.53.
[661] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f.53.

shtëpi/dal nga shtëpia" (antonimi elementare, pasi lidhet me drejtimin në natyrë) dhe "*hyj në jetën e dikuj/dal nga jeta e dikujt*" (kuptim i abstraktuar i foljeve "*hyj/dal*").

4.3.1 Analiza e përbërësve kuptimorë dhe kundërvënia tek foljet

Nga studimet e kryera në fushën e semantikës, si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, rezulton se marrëdhëniet e kundërvënies mund të kenë natyra të ndryshme, ku mund të dallojmë kundërvënie të kuptimeve që lidhen me veprime me drejtime të kundërta (*shkoj/vij*), me kuptim reciprociteti (*shes/blej*), marrëdhënie midis fjalëve që plotësojnë njëra–tjetrën, etj. Për më shumë, vërejmë se kundërvënia ekziston, jo vetëm midis fjalëve, por edhe midis *togfjalëshave frazeologjikë të ndryshueshëm* (*e solli kokën/ e këputi qafën*).

Janë pikërisht *përbërësit kuptimorë*[662] dhe *analiza semantike*, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e ligjeve antonimike midis fjalëve në kuptimin leksikor.[663] Në aspektin e marrëdhënieve antonimike, Samara, përbërësit e caktuar kuptimorë, i quan *përbërës të kundërt të përmbajtjes kuptimore të fjalëve antonime*.[664] Ai shton, se nuk do të kishim antonimi nëse nuk do të kishte përbërës semantikë të kundërt midis një çifti antonimik. Samara thekson, gjithashtu, edhe rëndësinë që ka natyra e përbërësve të kundërt të përmbajtjes kuptimore, ku si kriter bazë përmend *simetrinë midis përbërësve të kundërt*. Pra, përbërësit e kundërt duhet të jenë homogjenë, në mënyrë të tillë që të kemi të bëjmë me marrëdhënie kundërvënieje të kuptimit të fjalëve.[665] Kështu p.sh., çifti foljor "*jap/rrëmbej"* nuk përbën çift antonimik, pasi i mungon përbërësi i kundërt kuptimor simetrik. Në këtë rast, përbërësi në rastin "*marr me dhunë diçka a dikë* " i foljes "*rrëmbej"* nuk ka një homogjen antonimik te folja "*jap"*.

Në këndëvshtrimin e analizës semantike, dallohen dy lloje antonimesh[666]:

a) antonime të plota (që kundërvihen në të gjithë përbërësit në kontekste të caktuara)

b) antonimet rastësore/okazionale, situative ose kontekstuale (që kundërvihen vetëm në një a disa prej atyre përbërësve në kontekste të caktuara). Për shembull: "*sjell/heq"* në kontekstin letrar "*disa sjellin shishe birre, disa të tjerë hiqnin shishet e porsambaruara*" [667] . Shembulli duhet të jetë i kategorisë së dytë "*mbjell/ korr", "luftoj/fitoj"*, ku nga ana leksikore mungojnë përbërësit e kundërt kuptimorë. Të gjithë këta shembuj janë të modelit "*shkak /pasojë"*, i cili nuk është kriter për përcaktimin e antonimisë.[668]

---

[662]Shënim: sema ose njesi semantike minimale [J.Thomai (1981) Tipat Themelore të Derivacionit Semantik të Gjuhës Shqipe, f.88

[663]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[664]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[665]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[666]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[667]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[668]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

Në vazhdimin e këndvështrimit polisemantik antonimia mund të lindë midis kuptimeve të së njëjtës fjalë, p.sh., çifti foljor "*qasem1/ qasem2"*, ku në gjymtyrën e parë ka kuptimin "*afrohem"* dhe në kuptimin e dytë "*largohem"*. Ky njihet, si një tip i veçantë i antonimisë, *enantiosemia*. Në gjuhën angleze, ka shembuj jo të shumtë, por të qartë të këtij tipi, si p.sh.,çifti foljor *dust1/dust2 (fshij pluhurin),* ku në kuptimin e parë shpjegohet si "*remove something/add something"(heq diçka, pluhurin/shtoj diçka, pluhurin)*. Shembull tjetër, në gjuhën angleze, është mbiemri "*fast1/fast2"*, ku në kuptimin e parë nënkupton "*steady,not moving*" (*i qëndrueshëm, që nuk lëviz*) dhe në gjymtyrën dytë "*high speed*". Murphy i quan ato *Janus Words*, ndërkohë që Alex Wulanbarg i quan "*autoantonimi"*. Samara jep shembullin e mbiemrit *i bukur* përballë kuptimit stilistikor ironik të po këtij mbiemri.[669] Pra, në një situatë të caktuar do të dallonim çiftin autoantonimik mbiemëror "*bukur1/bukur2"*, ku në gjymtyrën e parë ka kuptimin *"i mirë , i dobishëm"* dhe në gjymtyrën e dytë "i keq, i padobishëm". Këtu kemi të bëjmë me atë që Xh. Lloshi e sheh si "*kundërvënie midis kuptimit asnjanës me kuptimin me ngjyrim të theksuar emocional, i cili është pjesë përbërëse epërmbajtjes së fjalës".*[670]

4.4 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe, parë strukturalisht

4.4.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze, parë strukturalisht

Klasifikimi strukturor i përgjithshëm në të dyja gjuhët në studim dallon[671]:

A. *antonimet morfologjike*

B. *antonime jomorfologjike*

Antonimet morfologjike ndahen në:[672]

1. antonime absolute me fjalë rrënjësh të ndryshme

2. antonime të prejardhura përmes ndajshtesave negative

Lyons, për sa i përket klasifikimit morfologjik, dallon:[673]

1. *antonimet rrënjore* (me temë të ndryshme)

2. *antonimet të prejardhura* (nga ndajshtesimi ku në gjuhën angleze mbizotërojnë parashtesat të tipit:*"dis-", "il-", "im-", "in-", "ir-", "non-", "un").*

Në kriterin morfologjik, studiuesit e të dyja gjuhëve, dallojnë antonimet e lidhura morfologjikisht dhe antonimet e palidhura morfologjikisht. Për sa u përket atyre të

[669]M. Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimit të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, f.146.

[670] Xh.Lloshi (1997) Gjuha, Stili dhe Redaktimi në Shtyp, f. 17.

[671]Shënim: klasifikim i njëjtë për autorë të ndryshëm, me ndryshime terminologjie të tipit "morfologjike ose me rrënjë të ndryshme", "jomorfologjike ose rrënjore apo të prejardhura".

[672]Shënim: klasifikim i përgjithshëm i cili del në mënyrë të përgjithësuar tek të gjithë autorët e studimeve në këtë fushë

[673]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.197.

palidhura morfologjikisht, duhet thënë se nuk ka ndonjë lidhje të dukshme të rrënjës së çiftit antonimik. Nga ana tjetër, çiftet antonimike të lidhura morfologjikisht kanë të njëjtën rrënjë dhe formohen përmes modeleve fjalëformuese me *parashtesim* (*dis+rrënjë, in+rrënjë, un+rrënjë,* etj.) p.sh.,"*dishonest"(i pandershëm), "infertile" (jopjellor), "unpleasant"(i pakëndshëm),* etj., dhe me *prapashtesim* (rrënjë+ful; rrënjë+less;) p.sh.,"*useful" (i dobishëm)*, "*useless"(i padobishëm),* etj.

Në lidhje me prapashtesat, ato nuk janë shumë prodhuese në gjuhën shqipe dhe as në gjuhën angleze. Kështu, në gjuhën angleze gjendet prapashtesa *"-less",* e cila në fakt nuk është konsideruar si mjet morfologjik për të formuar antonime mbiemërore nga gramatikat e sotme të gjuhës angleze.[674] Por, shembuj mbiemrash në kundërvënie me prapashtesën *-less* dhe *–ful* në gjuhën angleze gjenden jo pak, si për shembull "*useful/useless*" (*i dobishëm/i padobishëm*), "*hopeful/hopeless*" (*me shpresë/pashpresë*), "*careful/careless*" (*i kujdesshëm/i pakujdesur*), etj. Në këto shembuj paraqiten modele fjalëformimi me ndajshtesim për të dyja gjymtyrët e çiftit antonim, ku kundërvënia realizohet përmes kundërvënies kuptimore të prapashtesave, pra pesha e kundërvëniesbiete këto të fundit.

Megjithatë, në gjuhën angleze, e cila e ka këtë prapashtesë, vërehet një tendencë për të përdorur parashtesën "*un-"* në vend të kësaj prapashtese, si në shembujt "*selfish/unselfish*" dhe jo "*selfishless". Gjuha shqipe, e cila nuk e ka këtë prapashtesë, në vend të "*-less*" përdoret parashtesa "*pa-*", si në shembujt: *"careless"-"i pakujdesur", "speechless"-"pafjalë", "useless"-"i padobishëm"*, etj.

Por ka edhe raste mbiemrash në gjuhën angleze, të cilat përfundojnë me "*-ful*", por nuk formojnë antonime me të njëjtën rrënjë, duke i prapashtesuar "*-less*", si për shembull "*successful*" *(i suksesshëm*), nuk ka një formë paralele në kundërvënie të tipit "**successless*", por ajo i kundërvihet mbiemrit të formuar me parashtesim "*unsuccessful*". Në gjuhën shqipe në përgjithësi prapashtesa e gjuhës angleze "-ful" (e cila e ka kuptimin "-plotë) shprehet përmes formës pohore të mbiemrit, si në shembujt: *"successful"-"i suksesshëm", "careful"-"i kujdesshëm",* etj.

Në përgjithësi, në çiftet e antonimeve ndajshtesore kundërvënia shprehet morfologjikisht, pasi gjymtyra e ndajshtesuar është në kundërvënie me atë jo të ndajshtesuar. Si rezultat themi, se motivimi morfologjik është tipar përcaktues i kundërvënies.

Duhet pranuar, se modelet e fjalëformimit në antonimi nuk janë universale, dhe se, edhe brenda gjuhës gjenden raste ku këto modele nuk mund të zbatohen, siç është shembulli i foljes "*disappoint*" (*to make someone unhappy by not being as good as expected/zhgënjej*), e cila nuk është formuar nga parashtesa "*dis-"* dhe folja "*appoint*" (*choose to have a particular job/caktoj,emëroj),* ashtu sikurse as folja "*unman*" (*to deprive of human qualities/zhburrëroj)* nuk është antonim i foljes *"man"(to furnish with personnel/plotësoj me ekuipazh*). Edhe në gjuhën shqipe, gjejmë përjashtime të tilla nga modeli fjalëformues, të cilat semantikisht nuk kundërvihen, edhe pse përmbajnë një parashtesë negative, si në shembullin e foljes "*zhgënjej*" dhe "*gënjej*". Edhe pse në pamje të parë duket sikur kemi të bëjmë me një çift antonimesh, në fakt, semantikisht, këto folje nuk kanë përbërës kuptimorë të përbashkët që t'i lidhin në kundërvënie me parashtesim përmes parashtesës "*zh-*" (e cila në vetvete formon çifte antonimesh si variant i "z"). Pra, vërejmë se "*zhgënjej*" nuk formohet me ndajshtesim, por konsiderohet si rrënjë më vete.

[674] E. Weiner, Grammar in Early Modern English, Deputy Chief Editor, OED

Ndërkohë, në gjuhën angleze fjala "*zhgënjej*" (*dissatisfy*) e formon kundërvënien me anë të parashtesimit me parashtesën "dis-" (kundrejt "*satisfy*"), kurse në gjuhën shqipe me rrënjë të ndryshme "*kënaq/zhgënjej*". Një tjetër shembull interesant përbën krahasimi i formimit të antonimis te çifti "obey/disobey". Në gjuhën angleze ai është formuar përmes ndajshtesimit (parashtesa "*dis*-") ndërsa në gjuhën shqipe ajo del si mohim, përmes pjesëzës mohuese "*nuk*": "*bindem/nuk bindem*". Në mënyrë të ngjashme vërejmë, se në gjuhën shqipe mbiemër me këtë problematikë është "*i çfarosur*" si mbiemër prejpjesor, që nuk ka një gjymtyrë paralele si "**i farosur*", edhe pse "*i çfarosur*" në pamje të parë krijon idenë e një parashtesimi.

Vërejmë, se antonimet rrënjore dhe ato morfologjike, nuk dallojnë vetëm nga format morfologjike, por edhe nga semantika e tyre. Në një këndvështrim logjik, Cruse thekson, se "*një çift antonimesh të prejardhur, formojnë kundërvënie binare privative (mohuese) ndërkohë që antonimet rrënjore formojnë antonime polare të një kundërvënie të shkallëzuar, e cila mund të përfshijë edhe gjymtyrë të ndërmjetme, të cilat mund të ndryshojnë nga zero deri në disa njësi të tilla, si në shembullin,'beautiful/good-looking/plain/ugly*" (*e bukur/e pashme/e thjeshtë, mesatare/e shëmtuar*).[675]

K. Miller vëren, se "*pjesa kryesore e antonimeve kanonike në gjuhën angleze janë me rrënjë të ndryshme, por shumica e antonimeve në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera janë me rrënjë të njëjtë, pra të lidhura morfologjikisht*".[676] Gross vë në dukje ironinë që qendron në terminologjinë e përdorur, ku e kundërta e "*morphological related*" (të lidhura morfologjikist) është "*opaque antonyms*" (*antonime opake*) dhe jo "*morphological unrelated*" (*të palidhura morfologjikisht*).[677]

Në përgjithësi pranohet dhe vihet re dukshëm se gjuha angleze ka mundësi të mëdha në formimin e kundërvënies morfologjike, ashtu si edhe gjuha shqipe. Kështu, për sa i përket parashtesimit, si mënyra më prodhimtare për fjalëformim, dallojmë ndajshtesimin me parashtesim ku parashtesa të tilla si "*non-"* formojnë mbiemra antonimesh plotësuese, si për shembull "*blue/nonblue*" (blu/jo blu) apo "*happy/nonhappy*" (i lumtur/jo i lumtur). Në gjuhën shqipe parashtesa "*non*-" e gjuhës angleze është pjesëza "*jo*", e cila nuk quhet element fjalëformues dhe nuk merret si antonim, por si mohim). Zimmer e njeh "*non*-" si fjalëformuese. Ai gjithashtu thekson, se "ajo përdoret në vend të "*un*-", pasi "*happy/nonhappy*" del edhe "*happy/unhappy" (i lumtur/i palumtur).*[678] Në shembullin e fundit dallojmë se parashtesa "*un*-" e gjuhës angleze del si një parashtesë edhe në gjuhën shqipe ("*pa*-").

Horn ndan të njëjtin mendim me Zimmer duke shtuar, se *"non-", "in-", "un-"* formojnë mbiemra antonime plotësuese.[679] Më pak prodhuese është edhe parashtesa "*a*-" si në shembullin mbiemëror "*moral/amoral*". Edhe në gjuhën shqipe dallojmë shembuj të parashtesimit me "*a*-", e cila konsiderohet si parashtesë më origjinë nga greqishja, si në shembujt: "*fetar/afetar"*, "*normal/anormal"*, etj.

[675] D. A. Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.203.
[676] D. Gross, U. Fischer, G. A. Miller. (1988). Antonymy and the Representation of Adjectival Meanings. Cognitive Science Laboratory Report 13, Dept. of Psychology, Princeton University, f.177.
[677] D. Gross, U. Fischer, G. A. Miller (1988) Antonymy and the Representation of Adjectival Meanings. Cognitive Science Laboratory Report 13, Dept. of Psychology, Princeton University, f.178.
[678] Zimmer cituar nga D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.204.
[679] Horn (1989) cituar nga D.A Cruse (1986) Lexical Semantics. Cambridge, Cambridge University Press, f.204.

Për sa u përket foljeve, dallojmë parashtesa të tilla si *"dis-", "de-",* dhe *"un-",* të cilat formojnë antonime foljore të anasjellta, si për shembull "*tie/untie*" (*lidh/zgjidh*), "*engage/disengage*" (*angazhohem/çangazhohem*), etj. Gjithashtu, edhe parashtesa "*contra-*" formon çifte foljore, si "*inidicate/contraindicate*" (*shënoj/kundërshënoj*), etj.

Ndonjëherë, si në gjuhën angleze edhe në atë shqipe vërejmë, se gjenden dy ndajshtesa në kundërvënie të cilat u ndajshtohen rrënjëve të njëjta për të formuar çifte antonimesh. Këto ndajshtesa janë në përgjithësi *parashtesa*, por ndonjëherë dalin edhe prapashtesa, si në shembullin e gjuhës angleze "*useful/useless*" (*i dobishëm/i padobishëm)*. Kjo aftësi e gjuhës për të formuar kundërvënie në mënyrë "mekanike" përmes ndajshtesimin duket se e bën më lehtë analizën e kundërvënies si edhe na çon të mendojmë se është e kotë të kemi antonime rrënjësh të ndryshme për sa kohë që mund të ndërtohen antonime me rrënjë të njëjta, të cilat në vetvete janë sinonime me ato të rrënjëve të ndryshme. Meqenëse gjithmonë e më shumë mbështetet ideja e shmangies së sinonimisë në gjuhë, Lyons sugjeron, se "*nuk ka arsye të logjikshme për të pasur antonime opake, nëse ekzistojnë mjetet për të formuar antonime përmes prejardhjes morfologjike*".[680] Lyons bën këtë ndërhyrje kur vëren nga hulumtimet e tij, se njerëzit kur i pyet për të kundërtën e një fjale, kanë tendencë që të gjejnë një antonim opak/rrënjor, e jo një të prejardhur, madje edhe kur nuk ka një antonim kanonik, ata thjesht e injorojnë mundësinë e ekzistencës së një antonimi me lidhje morfologjike. [681]

Murphy në hulumtimet e tij kërkimore dallon *antonime morfologjike të përcaktuara mirë në gjuhë,* të cilat tashmë janë bërë kanonike (p.sh. "*logical/illogical", "i logjikshëm/i palogjikshëm"*), si edhe mundësi formimi antonimesh të lidhura me ndajshtesim, të cilat nuk janë shumë të përdorura në gjuhë ("*contrasting/uncontrasting", "kundërshtues/jokundërshtues"*). Ai vuri re, se"*Kur informantët e tij u pyetën gjatë kërkimit, ato nuk prodhonin antonime rrënjësh të njëjta kur mungonte një gjegjës antonimik opak për një fjalë të dhënë*".[682]

Por, nga ana tjetër, këto modele fjalëformimi krijojnë neologjizma në gjuhë, të cila mund të shmangen duke përdorur forma gramatikore sintaksore në fjali në vend të një fjale të re. [683] Kështu, për shembull, në vend që të futet gjerësisht në përdorim "*uncontrasting*" (*jokundërshtues*), mund të përdorim "*not contrasting*" (*mos kundërshtues*), ku mohimi realizohet me një morfemë të lirë.[684] Gjithashtu, mund të përdorim edhe përshkrimin "*that does not contrast*" (që nuk dallon). Kjo nuk do të thotë që nuk duhet të përdorim mohimin neologjik, por që përdorimi i tij kufizohet nga mjete të tjera gjuhësore.

Një argument interesant për favorizimin e antonimeve opake në gjuhë është edhe ai i parimeve të "*përpjekjes më të vogël*" të Zipfit[685], i cili thekson se "ne presim që konceptet më të përdorura në gjuhë të kodohen sa më shkurt dhe sa më thjesht"[686]. Për këtë arsye, duket më e arsyeshme dhe më thjesht e gjenerueshme të japim mbiemrin "*single"*(*beqar*) për "*married*" (*e martuar*) sesa ta zgjerojmë fjalën me ndajshtesim

[680]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.143.
[681]J. Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f.143.
[682] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.202.
[683] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.202.
[684] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press f.202.
[685]Cituar nga M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.202.
[686] Cituar nga M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.202.

"*unmarried*" (*i pamartuar*). Megjithatë, Murphy thekson se edhe vetë fjalët sinonime '*unmarried*' dhe "*single*" kanë dallime kuptimore pasi, siç argumenton ai, dikush që është "*widowed"* (*e ve)* mund të quhet*"single" (beqar),* por jo "unmarried" (*i pamartuar*).[687] Për më shumë, jo të gjitha fjalët kanë aftësi të formojnë antonime të lidhura morfologjikisht.[688] Për shembull, mbiemra të tillë si "*high/low*" (*e lartë/e ulët*) nuk kanë forma paralele morfologjike. Zimmer e shpjegon këtë fakt me idenë e shmangies së sinonimisë në gjuhë. Megjithatë, jo pak fjalë në gjuhën angleze i kanë paralelisht të dyja format e antonimisë.

Ndajshtesa të ndryshme antonimike formuese kanë vlera semantike të ndryshme dhe jo rrallë mund t'i ndajshtohen të njëjtës rrënjë, duke i dhënë asaj nuanca të ndryshme kuptimore. Në këtë mënyrë dallojmë mbiemrat "*feminine/unfeminine*" (*femërore/jofemërore*) dhe "*feminine/non-feminine*" (*femërore/jofemërore*). Gjithashtu, vlen për t'u dallur edhe nuanca kuptimore e ndryshme ndërmjet çifteve të formuara me ndajshtesim dhe atyre rrënjore, të cilat në dukje mund të jenë sinonime, por kanë edhe dallime kuptimore, si për shembull "*friendly/unfriendly*" (*miqësor/jomiqësor*) dhe "*friendly/hostile*" (*miqësor/armiqësor*), ku mund të themi se "*unfriendly*" thjesht "*që nuk është miqësor*" dhe nuk nënkupton se është "*armiqëso*r". Në rastin e "*friendly/unfriendy*" kemi dy skaje të të njëjtit bosht, pra një bosht të mirëfilltë, ndërsa tek "*friendly/hostile*" kemi rast të ngjashëm me "*red/green*" (*e kuqe/jeshile*) të Ogden, pra, dy boshte cilësish të papajtueshme.[689]

4.4.2 Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën shqipe, parë strukturalisht

Në këndvështrim historik, studimet për antoniminë parashtesore nisin me J. Stefin, Leksikologjia shqipe 1961, më pas antonimet me parashtesa janë trajtuar edhe në Fjalorin Shqip-Greqisht të K. Kristoforidhit, të përpunuar prej A. Xhuvanit 1961.[690] A. Xhuvani dhe E. Çabej, u kanë kushtuar një studim të tërë parashtesave të gjuhës shqipe, më 1956, ku antonimia del si karakteristikë dalluese e funksionit të parashtesave. Një problem i rëndësishëm, është edhe antonimia sinonimike midis fjalëve me parashtesa dhe pasqyrimi i tyre në fjalor. M. Samara trajton nga ana semantike dhe strukturore parashtesimin me funksion mohues dhe privativ, ku përfshin parashtesa të tilla, si: *anti-, ç-, çpër/shpër-, kundër-, mos-, pa-, s-, mbi-, nën-, para-* dhe *prapa-, k-dhe a-*. Ai shprehet, se "*rastet ku marrëdhëniet antonimike shfaqen jo të plota, të dobëta, janë më të shpeshta midis kuptimeve të fjalëve të formuara me parashtesat mohuese 'mos-', e 'pa-'".*[691]Nga ana strukturore, ai dallon dy nëntipe:[692]

a. skema P+T <-> T, e cila ka kundërvënie më të dobët në krahasim me grupin e dytë.

b.skema P+T<->P1+T, e cila karakterizohet nga një kundërvënie e mirëfilltë, në skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta .

[687] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press f.202.
[688] Zimmer cituar nga M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press f.202.
[689] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.202.
[690] M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.157.
[691] M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.157.
[692] M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.158.

Mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe, sipas Gramatkës së Gjuhës së Sotme Shqipe, janë:[693]

- *prejardhja dhe nënndarja e saj* (prejardhja parashtesore, prapashtesore, parashtesore-prapashtesore , pandajshtesë)
- *nyjëzimi*
- *kompozimi*
- *përngjitja*
- *konversioni, përmbysja*
- *mënyrat e përziera*(përngjitje dhe parashtesim, përbërje dhe prapashtesim, nyjëzim dhe prapashtesim, nyjëzim dhe parashtesor-prapashtesim, nyjëzim dhe përngjitje)

Për më shumë, mënyrat e fjalëformimit ndahen në dy grupe më të mëdha[694]:

A. *mënyra morfologjike* (ndajshtesimi, nyjëzimimi, kompozimimi)

B. *mënyra jomorfologjike* (përngjitja dhe konversioni)

Për sa i përket prejardhjes parashtesore, vërejmë se parashtesa nuk e ndërron kategorinë leksiko-gramnatikore të fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj një kuptim të ri plotësues.[695] Parashtesat mund të jenë *të parme* (*sh- , zh- , ç-, stër- , shpër-* etj) ose *të formuara prej fjalësh të tjera*, si p.sh. parafjalore (*mbi- , nën- , pa- , ndër-*).[696]

R. Memushaj, për sa u përket antonimeve të palidhura morfologjikisht, i sheh si fjalë "me rrënjë të ndryshme", por ka edhe nga ato fjalë që në rrafshin sinkronik tingëllojnë si rrënjë të ndryshme, por që në rrafshin diakronik, duke analizuar ndryshimet në kohë, dalin me rrënjë të njejtë (p.sh foljet lidh/zgjidh).[697]

J. Thomai[698] ndërtimet e antonimeve në shqip i ndan në dy lloje:

1. prej *fjalësh krejt të ndryshme*, si p.sh., *i ashpër/i butë, ngjitem/zbres, zgjat/shkurtoj, i lirë/i shtrenjtë* etj., të cilat janë antonime të mirëfillta.

2. antonime të formuara *me parashtesa* me burim të përbashkët p.sh. *fuqizoj/shfuqizoj, kurdis/shkurdis, qep/shqep, qetësoj/shqetësoj, thur/shthur, vulos/zhvulos, zyrtar/jozyrtar* etj.

Ka disa shembuj në gjuhën shqipe, ku nuk dallohet qartë ndërtimi, pasi tema prodhuese është vështirë të veçohet nga parashtesat, p.sh.,*i ngathët/i shkathët, ngarkoj/shkarkoj, ngrin/shkrin, ngul/shkul, lidh/ zgjidh, mbuloj/zbuloj, mbërthej/zbërthej*

[693] Gramatika e gjuhes shqipe 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f58.
[694] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Akademia eShkencave eShqipërisë, Tiranë (2002) Mënyrat dhe Tipat eFjalëformimit, f.58.
[695]Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Akademia eShkencave eShqipërisë, Tiranë (2002) Mënyrat dhe Tipat eFjalëformimit, f.58.
[696]Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë (2002) Mënyratdhe Tipat e Fjalëformimit, f.58.
[697]R. Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.138.
[698]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.

etj.[699] Të tillë shembuj duhen studiuar në rrafshin diakonik, për të parë se si kanë arritur deri në formën përfundimtare të përdorimit në ditët e sotme.

Për sa i përket përdorimit të fjalëve antonime rrënjore/opake, të cilat kanë forma paralele të lidhura morfologjikisht vërehet, se për të zbutur tonin e ligjërimit përdoren formime parashtesore përballë atyre me rrënjë të ndryshme, si në rastin,"*i pastër/i fëlliqur/i papastër"*.[700]

3. fjalët me *prapashtesë*, mbiemrat me nuancë keqësuese, sharëse, përbuzëse me prapashtesat *–ak, -ac, -uc, -acuk-, -aq, -uq , -hash, -ec,* si p.sh.,"*burrë/ burracak",* etj.

M. Samara thekson, se **"***klasifikimi i antonimeve shqipe sipas kriterit strukturor është më i thjeshtë. Ai mund të bëhet më lehtë sepse si pikënisje dhe mbështetje kemi strukturën e tyre formale, si dhe analizën fjalëformuese e morfologjike*"[701]. Në bazë të kësaj analize del, se antonimet shqipe në përgjithësi mund të jenë[702]:

1. fjalë antonime *me rrënjë të ndryshme,* me skemë strukturore A[t] –B[T], si p.sh., në çiftet,*i madh /i vogël , i bukur/i shëmtua*r etj.

2. fjalë antonime *me parashtesa***,** të cilat mund të marrin pjesë:

   a) si gjymtyrë të çiftit antonimik në njërin prej krahëve të tij, me skemë A[p+T]/B[T] , *si p.sh., i pastër/i papastër, i bërë/i pabërë, kamje/skamje etj*.

   b) si gjymtyrë në të dy krahët e çiftit antonimik , me skemë A[p+T]/B[p_1/T], si p.sh. "*i mbiujshëm/i nënujshëm", "mbitokë/nëntokë", "ngarkoj/shkarkoj",*etj. Në të gjitha këto çifte, rolin e funksionin kryesor antonimik e luan parashtesa.

3. fjalë antonime *të përbëra ose të përngjitura*, me skemë A[t+t_1]/B[t+t_2]a A[t_1+t] –B[t_2+t], që nga pikëpamja strukturore janë të ngjashme me fjalët antonime me parashtesa të grupit 2-b , sepse ato kanë të njëjtë njërin prej dy gjymtyrëve ose prej temave të tyre, si p.sh., *"zemërmirë/zemërkeq"*, *"shpirtgjerë/shpirtngushtë",*etj.

4. antonime *togëfjalëshash frazeologjikë ose jofrazeologjikë* përbëjnë një tip të veçantë strukturor të antonimeve në gjuhën shqipe; ato janë togëfjalësha të qendrueshëm me dy a më shumë gjymtyrë, nga të cilat a) njërën e kanë zakonisht të njëjtë, *si p.sh. "marr hua/ jap hua", "më hyn në zemër (dikush)/më del nga zemra",*etj. Sipas aftësisë që kanë fjalët antonime shqipe për të marrë pjesë në strukturën e shkallëve më të larta, del se disa prej tyre (si *p.sh.,"i mire/i keq", "mirësi/ligësi", "mirësoj/keqësoj", "mirëkuptim/keqkuptim", "i butë/i ashpër",*etj.) kanë strukturë a çerdhe më të gjerë fjalëformuese, kurse disa të tjera kanë strukturë më të ngushtë

[699]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.
[700]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.
[701]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 175.
[702]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f. 175.

a të kufizuar fjalëformuese. (krhs. *p.sh.,"i njomë/i thatë", "njom/thaj", "i ftohtë/i ngrohtë", "ftoh/ ngroh",*etj.)

Duke i'u referuar A. Dhrimo, nga klasifikimi i mbiemrave me struktura fjalëformuese kemi[703]:

1. *mbiemra të parmë,* janë të pazbërthyeshëm.

Ndërsa A. Xhuvani i përkufizon ato si "të parshëm kur janë të thjeshtë dhe nuk kanë dalë prej një tjetër fjale."[704] Shembuj: *i bardhë, i keq, i lig, i shëndoshë, i verdhë, i zi, i dobët*, etj.

Për sa u përket *mbiemrave të huazuar,* A. Dhrimo i cilëson ato si "*elemente të pazëvendësueshme të fondit aktiv të shqipes, të cilët morfologjikisht duhet të trajtohen si mbiemra të parmë*"[705], si p.sh.,"*konkret/abstrakt", "absolute/relative", "absurd/normal"*, etj.

2. *mbiemra të prejardhur*

Prejardhja është e shumëllojëshme:

A. *me parashtesim,* parashtesa tipike në ndërtimin e antonimeve të prejardhura. A. Dhrimo dallon parashtesat si më poshtë:

- parashtesa me origjinë greke: **a-** me funksion mohues, përjashtues gjendet e përdorur në gjuhën e shkrimit. A. Xhuvani dhe E. Çabej e kanë parë si parashtesë edhe në formimin e fjalëve shqipe, si p.sh. fetar/afetar. Shembuj për fjalët e huaja janë mbiemrat "*politik/apolitik", "normal/anormal",* etj.

- parashtesa me origjinë greke **anti-** me kuptim kundërshtues formon mbiemra të tipit *"ajror/antiajror", "fetar/antifetar", "amerikan/antiamerikan", "kombëtar/antikombëtar",* etj. Kjo parashtesë është shqipëruar me parashtesën "*kundër*-". Gjatë shqipërimit ndodh që të shqipërohet edhe tema fjalëformuese, si p.sh.,"*kundërrevolucionar",* etj.

- parashtesa e lashtë e shqipes **ç-,** e cila sipas A. Xhuvanit dhe E. Çabejit, u ngjitet foljeve duke u dhënë kuptim antonimik dhe disa të tjerave duke u dhënë një kuptim intesiv. Gjithashtu, kemi dhe antonime mbiemërore me këtë parashtesë "*njerëzor / çnjerëzor", "i rregullt / i çrregullt", "i mobilizuar/i çmobilizuar",* etj. Për sa i përket këtij të fundit, A. Dhrimo është i mendimit se "*i çmobilizuar"* nuk është i formuar me parashtesën **ç-,** por thjesht nga nyjëzimi i pjesores së foljes *çmobilizoj*.[706] Ekzistojnë disa variante të kësaj parashtesesi në shembujt: "i *drejtë / i **zh**drejtë", "i kujdesur/ i **sh**kujdesur", "i këputur / i **sh**këputur", "i fryrë / i **sh**fryrë",* etj.

[703]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 46.
[704]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 48.
[705]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 49.
[706]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 50.

- parashtesa**an-** (nga greqishtja) është shumë pak prodhimtare, p.sh. "***an****alfabet*, etj.

- parashtesat e latinishtes **i-, in-, im**- janëjo shumë prodhimtare e formojnë mbiemrat *"legal/**illegal**", "moral/**immoral**", "personal/**im**personal", "direkt/**indirekt**", "tranzitiv/**i**ntranzitiv",* etj.

- parashtesat me origjinë parafoljore **jashtë-** dhe brenda formojnë mbiemra si në shembullin *"jashtëgjuhësor/**brenda**gjuhësor", "jashtëshkollor/**brenda**shkollor",* etj.

- parashtesa **jo-** shërben në formimin e mbiemrave. A. Dhrimo pohon, se kjo parashtesë është plotësisht e njëvlershme me parashtesën **pa-** e **mos-**, ndryshimet midis tyre janë thjesht strukturore.[707] Disa gjuhëtarë nuk i shohin si parashtesa, por si pjesëza që marrin pjesë në kompozita. A. Dhrimo i sheh ato si parashtesa, të cilat formojnë antonime të tipit "*përparimtar/ jopërparimtar", "vëllazëror/ jovëllazëror", "normal/ jonormal",*etj. Mbiemrat e nyjshëm formohen vetëm me parashtesën **pa-**, ndërsa mbiemrat e panyjshëm me parashtesat **jo-** e **mos-.**

- prashtesat **mbi-** dhe **nën-** kanë origjinë parafjalore. Shembuj: *i mbivlerësuar/ i nënvlerësuar* etj. Parashtesa **mos-,** sipas A. Dhrimos, del me të njëjtën vlerë me parashtesat **jo-**, **pa -**.Shembuj: "*mospërfillës", "moskokëçarës", "mosmirënjohës",*etj.

- parashtesa me prodhimtare është parashtesa **pa-** me kuptim përjashtues dhe formon mbiemra të nyjshëm, p.sh.,"*i drejtë / i padrejtë", "i denjë / i padenjë", "i botuar / i pabotuar", "i fuqishëm / i pafuqishëm", "i kufizuar/ i pakufizuar",* etj.[708] A. Xhuvani dhe E.Çabej, për sa i përket modelit të fjalëformimit me parashtesën **pa-**, janë të mendimit, se përveç me parashtesim, kemi të bëjmë me prapashtesim (**-shëm**) dhe paranyjëzim të njëkohshëm. A. Dhrimo është i mendimit, se prapashtesa nuk duhet lidhur me parashtesën **pa-,** sepse nuk mund të jenë formuar nga modeli "fuqi/i pafuqishëm", por janë formuar nga modeli "i fuqishëm/ i pafuqishëm", që do të thotë, se A. Dhrimo e sheh vetëm si parashtesim fjalëformimin e mbiemrave të tipit,"*i ndershëm/ i pandershëm", "i lavdishëm/i palavdishëm", "i kundërshtueshëm/i pakundërshtueshëm",* etj.
  Parashtesat ***para-***dhe***prapa-***formojnë mbiemra si,*"paraveprues/ prapaveprues", "parashtesorë/prapashtesorë", "i paravendosur/ i prapavendosur",*etj.[709]

[707]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 52.
[708]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f .52.
[709]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 52.

- parashtesat **pro-** në kundërvënie me **anti-,** ku **pro-** ka kuptim aprovues dhe **anti-** ka kuptim kundërshtues. Shembuj: "proamerikan/antiamerikan*"*, "*proimperialist/anti-imperialist*", etj. Ne mendojmë se kjo kundërvënie mund të zgjerohet me tre elemente, ku formohen dy kundërvënie të ndryshme: 1. "*amerikan/antiamerikan"* 2. "*proamerikan/antiamerikan"*. Në kundërvënien e parë, dikush që është *amerikan* do të thotë që është nga Amerika, ndërkohë që *proamerikan* nuk do të thotë që është nga Amerika, por pajtohet me politikat amerikane. Të dyja këto i kundërvihen antonimit *antiamerikan* ose e shqipëruar *kundëramerikan*.

B. *me prapashtesim*, për sa i përket antonimit dhe prapashtesave disa gjuhëtarë janë të mendimit se prapashtesa ***-aç, -açak, -açuk, dhe /ak, -an, -anik***, sipas A. Xhuvanit dhe E. Çabejt, *mund të formojnë mbiemra me kuptim keqësues*,[710] por jo antonimi.

C. me *paranyjëzim* dhe *prapashtesim*

Ç. *paranyjëzim, parashtesim*dhe *prapashtesim* njëherazi

D. me *paranyjëzim*

Shndërrimi i parafjalëve e pjesëzave në*parashtesa* e ka burimin te përngjitja, prandaj ndarja e kufijve ndërmjet tyre është e vështirë. Përgjithësisht, sot ato vështrohen si formime parashtesore dhe jo si përngjitje. Parashtesat e tipit ***para-, pas-, prapa-, jashtë-, brenda-, pranë-, lart-, sipër-, larg-*** etj., shpesh ngatërrohen me kompozimet, si p.sh., "*brendashkruaj/jashtëshkruaj", "i lartpërmendur/i poshtpërmendur", "pararojë/praparojë", "parauniversitar/pasuniversitar",* etj., ku parashtesa ka vlerë ndajfoljore, ndërsa tema vlerë foljore.[711]

Ka një numër fjalësh me *rrënjë të lidhur*, të cilat përmbajnë një parashtesë, p.sh. "*mbuloj/zbuloj", "mbath/zbath", "ngarkoj/shkarkoj", "ngjit/shqit",* etj., (ndryshimet fonetike të tingujve nistorë të rrënjës te disa nga këto fjalë kanë ndodhur nga ndikimi i parashtesës).[712] Te fjalët e mësipërme dallojmë parashtesat ***m-, z-, n-, sh-,*** sepse për çdo rrënjë mund të gjendet të paktën një çift fjalësh me kuptime të ndryshme , por të motivueshme nga po ajo rrënjë.[713]

Në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe një numër parashtesash të huaja, si: ***a-, anti-, de-, dez-, dis-, pro-, pan-, trans-, ultra-*** etj.[714] Parashtesat, ashtu si dhe prapashtesat, huazohen jo si të tilla, por nëpërmjet fjalëve të formuara me anë të tyre. Në rast, se krahas fjalës me parashtesë përdoret në gjuhë edhe fjala motivuese e saj, p.sh. "*anormal/normal", "dezinfektoj/infektoj",* etj, ose kur përdoren të paktën dy fjalë të prejardhura me po atë rrënjë, p.sh., "*importoj/eksportoj"*, atëherë parashtesat e huaja janë të dallueshme edhe nga pikëpamja e sistemit fjalëformues të shqipes. Por fjalë të tilla, si "*anarki", "antagonist", "intervistë", "konstrukt", "dinstiktiv",*etj., që nuk i përmbushin

[710] Cituar nga A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 45.
[711]A. Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 52.
[712]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.157.
[713]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.157.
[714]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.158.

kushtet e mësipërme, për gjuhën shqipe janë fjalë të parme, megjithëse në gjuhët nga rrjedhin nuk janë të tilla.[715]

Disa nga parashtesat e huaja janë asimiluar nga sistemi i fjalëformimit të shqipes në një shkallë të tillë, që kanë formuar edhe fjalë të reja, duke u bashkuar me fjalë shqipe, p.sh.,*"afetar", "antikombëtar", "antipopullor", "panshqiptar", "pannjerëzor",* etj.[716] Por, prirja kryesore që vihet re në gjuhën e sotme është zëvendësimi i parashtesave të huaja me parashtesa të shqipes, p.sh.*, "kundërajror", "kundërgaz", (antiajror, antigaz), "çmilitarizim", "shpolarizim" (demilitarizim, depolarizim), "ndërkontinental", "ndërmolekular", (interkontinetal, intermolecular,*etj.[717]

Sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe mbiemrat, për sa i përket fjalëformimit, mund të jenë[718]:

1. *mbiemra të parmë* (quhen ato mbiemra që sot janë të paanalizueshëm në pjesët e tyre përbërës dhe nuk mund t'u hetohet as tema fjalëformuese, as ndonjë format fjalëformues).

2.*mbiemrat e prejardhur* përmes parashtesimit, prapashtesimit, nyjëzimit dhe parashtesim të njëkohësishëm, si dhe me nyjëzim, parashtesim, prapashtesim të njëkohshëm.

- Në lidhje me *parashtesimin***,** mund të themi se nuk është shumë i madh numri i parashtesave në gjuhën shqipe. Nga etimologjia dallojmë parashtesat e *gjuhës shqipe* dhe të *gjuhës së huaj*.Mbiemrat te gjuhës shqipe të formuar me parashtesa, sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe, mund të dalin me *kuptim mohues, përjashtues apo kundërshtues*, ku dallojmë parashtesa, si më poshtë[719]:

  - parashtesa***"pa-"***dhe **jo-** janë më prodhimtaret, ***"pa-"*** shoqërohet me mbiemra cilësorë të nyjshëm dhe **jo-** shoqërohet me mbiemra marrëdhënjorë të panyjshëm. Në vend të parashtesës ***"pa-"*** , mund të vendosim edhe parashtesën ***"mos-",*** por me mbiemra të panyjshëm si p.sh.,"*mirënjohës/mosmirënjohës*", "*përfillës/mospërfillës*", etj. Me po të njëjtin kuptim, përdoret parashtesa **a-**, si në shembujt: "*simetrik/asimetrik", "politik/apolitik", "fetar/afetar", "normal/anormal",*etj.

  - në gjuhën shqipe ka një tendencë të zëvendësimit të kësaj parashtese me formën e gjuhës shqipe **jo-,** si p.sh.,"*simetrik/josimetrik", "politik/jopolitik", "normal/jonormal",* etj.

  - **anti-**shoqërohet me mbiemra marrëdhënjorë të panyjshëm dhe shpreh kundërshtim, p.sh.,*"fashist/antifashist", "kombëtar/antikombëtar", "popullor/antipopullor", "amerikan/antiamerikan",* etj. Kohët e fundit, vihet re zëvendësimi i gurrës shqipe me parashtesën e gjuhës shqipe

[715]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.159.
[716]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.160.
[717]M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f.161.
[718] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.184.
[719] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.184.

kundër-, si p.sh.,"*atomik/kundëratomik", "bërthamor/kundërbërthamor", "kimik/kundërkimik", "ligjor/kundërligjor", "i ligjshëm/i kundërligjshëm", "shtetëror/kundërshtetëror"*.

- me parashtesën **pro-,** me kuptim pajtues, formohen çifte mbiemrash marrëdhënjorë të panyjshëm, si p.sh.,"*antiamerikan/proamerikan", "antirevisionist/prorevizionist", "antisovjetik/prosovjetik",*etj. Këtu kemi të bëjmë me parashtesim për të dy gjymtyrët e çiftit.

- parashtesa***"para-"*** formohon mbiemra marrëdhënjorë të panyjshëm dhe tregon që tipari i dhënë tregon një kohë më të hershme sesa tipari i shënuar nga tema fjalëformuese, ose që pozicioni i sendit të përcaktuar është përpara tij që tregon tema fjalëformuese e mbiemrit.[720] Të tillë mbiemra dalin në kundërvënie me mbiemrat me parashtesën ***"pas-",*** edhe pse jo shumë prodhimtarë, p.sh. *paragjuhësor/pasgjuhësor, i paralindur/ i paslindur, paratheksor/pastheksor, parauniversitar/pasuniversitar,*etj. Me të njëjtën vlerë, përdoret edhe parashtesa ***"prapa-",*** p.sh., *"i paravendosur/i prapavendosur", "paraveprues/prapaveprues",*etj. Ka nga ata që e shohin si përbërje dhe jo prapashtesim, duke e konsideruar ***"prapa-"*** si ndajfolje.

- Parashtesa ***"mbi-"***dhe ***"nën-"*** formojnë çifte mbiemrash marrëdhënjorë me kuptim përkatësor, p.sh.,"*mbitokësor/nëntokësor", "mbiujor/nënujor"*, etj.

- Parashtesa ***"ndër-", si*** p.sh.,"*kombëtar/ndërkombëtar*", "*shtetëror/ndërshtetëror*", "*ballkanik/ndërballkanik*", etj. Kjo parashtesëka zëvendësuar parashtesën e gurrës së huaj *"**pan-**"*, p.sh "*evropian/panevropian", "ballkanik/panballkanik",* etj.[721]

- Parashtesat ***"ç-", "sh-, "zh-",*** janë joprodhimtare. Shembuj: "*njerëzor/çnjerëzor", "i rregullt/i çrregullt", "i drejtë/i zhdrejtë", "i kujdesur/i shkujdesur",*etj.

- Parashtesat e huaja ***"an-", "i-", "in-",***dhe***"im-"*** janë joprodhimtare dhe janë zëvendësuar nga parashtesa **jo** -, p.sh.,"*organik/joorganik,inorganik,* etj.

- Parashtesat ***"lart-","poshtë-"*** , sipër si në shembujt:*"i lartëpërmendur,i sipërpërmendur/i poshtëpërmendur", "i lartëshënuar/ i poshtëshënuar",*etj.

[720] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.184.
[721] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.184.

Gramatika e Gjuhës Shqipe njeh edhe "*siparashtesat*", si p.sh.,***"brenda-"*** dhe ***"jashtë-"*** (*brendagjuhësor/jashtëgjuhësor, i jashtëshkruar/ i brendashkruar* etj) ***"gjysmë-"*** dhe "***plot-".***[722]

Si parashtesat e huaja ***"mono-"*** dhe ***"poli-"***dhe antonimia me parashtesën "**pseudo-"**, p.sh. *shkencor/pseudoshkencor, revolucionar/pseudorevolucionar*etj.

- *Formimi prapashtesor te mbiemrat*

Prapashtesa ***"–ak"*** është mjaft prodhimtare dhe përdoret në kuptim përkatësor dhe keqësues, p.sh. *i vogël / vocërrak*etj Gjithsesi, vetëm në rrafshin stilistik mund të shihen si antonime.[723]

- *Formimi me prapashtesim dhe nyjëzim*

Shembuj:*i ujshëm / i lëngshëm, i brendshëm/ i jashtëm, i sotshëm/ i djeshëm, i këtushëm / i atyshëm, i mëparshëm/ i mëtejshëm, i rëndomtë / i veçantë, i shpeshtë / i rrallë, i ngrohtë / i ftohtë , i mprehtë/ i zbehtë*, etj.

- *Formimi i mbiemrave me nyjëzim (mbiemra prejfoljorë)*

Në lidhje me mbiemrat prejpjesorë, në gjuhën shqipe, ka pasur një zhvillim në perceptimin e tyre si të tillë, ku dallojmë gjuhëtarë si, K. Cipo, i cili nuk bën dallim midis pjesores së vërtetë dhe mbiemrit foljor të formuar nga pjesorja e nyjëzuar, si në shembujt *njeri i ditur*, *burrë i pasur* etj., edhe pse kur ai trajton mbiemrat flet për prejardhjen e tyre foljore.[724]A. Xhuvani ka dhënë një kontribut të vyer në dallimin midis pjesores dhe mbiemrit foljor. Pjesorja e gjuhës shqipe është e kohës së shkuar.[725] Sh. Demiraj thekson se tek mbiemrat foljorë dallohet kuptimi pësor.[726]*Shembuj*: "*i hapur/ i mbyllur", "i afruar/ i larguar", "i besuar / i dyshuar",* etj.

- *Formimi i mbiemrave me nyjëzim, parashtesim dhe prapashtesim, si p.sh., "i përhershëm / i përkohshëm", "i përciptë / i përpiktë", "i përgjithshëm / i përveçëm",* etj.

Antonimet e përbëra dalin në gjuhën shqipe tek mbiemra si: *gjakftohtë/gjaknxehtë; mirëpres/keqpres*, *të përngjitura: i paraçlirimit/ i pasçlirimit.* Për sa i përket *para* dhe *pas*, të cilat janë parë si parafjalë, Samara thekson, se "*ato marin vlerën e një parashtese, luajnë rolin e një prefiksioidi (fonetike dhe gramatike e gjuhës së sotme letrare shqipe".*[727]

[722] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.185.
[723] Gramatika e Gjuhës Shqipe (2002) Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.185
[724]F. Agalliu (1972) Pjesorja në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike
[725]F. Agalliu (1972) Pjesorja në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike
[726]F. Agalliu (1972) Pjesorja në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike
[727]M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.122.

I. Goçi thekson, se"*kompozitat shprehin një unitet kuptimor më vete, kështu që çifti antonimik ipërbërë prej kompozitave kundërvihet jo vetëm në kuptimet e fjalëve të tyre të veçanta, por në tërësinë e tyre kuptimore*".[728] Ai dallon dy grupe kryesore**:**

1. antonime të përbëra përcaktore, që formojnë edhe **folje** edhe **mbiemra**p.sh.*gojëmjaltë/gojëhelm, kokërrmadh/kokërrvogël (emër+mbiemër) fjalëshumë/fjalëpak (emër+përemër), dashamir/dashakeq (folje+ndajfolje), mirëbërës/keqbërës,brendagjuhësorë/jashtgjuhësorë (ndajfolje+mbiemër)*.

2. antonime të përngjitura si rezultat i leksikalizimit të togfjalëshit të qendrueshëm, si p.sh., *paradite/pasdite*, të cilat formojnë **ndajfoljet e kohës**.

Megjithatë, jo gjithmonë fjalët e *përbëra*dhe*të përngjitura* përmbajnë një element të përbashkët apo një çift antonimik, si në shembujt: "*shtijëkeq/fjalëmirë",* ku tema është e ndryshme apo "*atdhedashës/atdhemohues",* ku tema është e njëjtë, por kundërvënia realizohet nga fjalët e ndryshme, të cilat nuk janë antonime.[729] Këto raste dëshmojnë, se nuk duhet nisur nga ana strukturore formale e fjalëve të përbëra e të përngjitura për t'i përcaktuar nëse janë antonime.[730]

Samara shprehet, se *fjalët antonime të përbëra janë tërësisht kompozitapërcaktore*.[731] A. Kostallari ka dhënë një kontribut të madh në studimin e kompozitave të shqipes. Ai vëren, se kompozitat pronësore njihen ndryshe si *Bahuvrihi* (nga gramatikat indiane) dhe thekson, se "bëjnë pjesë në grupin e *kompozitave nominale ekzocentrike***,** të cilat formohen mbi bazën e nocionit të pronësisë, p.sh., "*fatkeq/fatmirë", "zemërbutë/zemërgur", "shpirtmirë/shpirtkazmë",*etj". [732] Përgjithësisht, kompozitat ekzocentrike formohen nga *mbiemra antonimë të përbërë***,** të cilët shënojnë cilësi, e në vetvete formohen përmes çifteve antonimike të mirëfillta me rrënjë të ndryshme, ku kundërvënia nuk është e plotë dhe shënojnë cilësi konkrete të jashtme të frymorëve apo sendeve jofrymore, dukurive të natyrës, etj.[733]

Ndihmesë të veçantë në gjuhën shqipe ka dhënë edhe K. Cipo. Megjithatë, fillimisht ato janë trajtuar nga O. Dozoni, por në një mënyrë shumë të përgjithshme. Mbiemrat *Bahuvrihi* tregojnë *një cilësi të një sendi a frymori, "kokërrvogël/kokërrmadh", "cipëhollë/cipëtrashë", "kokëmadh/kokëvogël", "mjekërbardhë/mjekërzi", "sybardhë/syzi",* etj.[734]Ato ndahen në dy kategori:[735]

1. kompozita që tregojnë cilësi trupore ose fizike. Këto mund të përdoren edhe në kuptim të figurshëm, për të treguar një cilësi shpirtërore.

[728] M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.123.
[729] M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.122.
[730]M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.123.
[731] M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.123.
[732]A. Kostallari, Mbi Disa Veçori të Strukturës Semantike të Kompozitave Pronësore të Shqipes, Studime Filologjike.
[733] M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.123.
[734]A. Kostallari, Mbi Disa Veçori të Strukturës Semantike të Kompozitave Pronësore të Shqipes, Studime Filologjike.
[735] K. Cipo (1948) Kompozitat Determinative, Studime Filologjike, f. 9-12.

2. kompozita mbiemërore që tregojnë cilësi mendore shpirtërore, p.sh. "*zemërmirë/zemërkeq", "shpirtmirë/shpirtkazmë" ose "shpirtmirë/shpirtkatran", "dorëlëshuar/dorshtrënguar",* etj. Këto kanë nuanca emocionale stilistike.

Shembuj të tjerë:[736]

emër+emër:*atdhedashës/atdhemohues, gojëmjaltë/gojëhelm*;

emër+mbiemër:*kokëmadh/kokëvogël, lëkurëhollë/lëkurëtrashë, vetullhollë/vetullltrashë, shpirtmadh/shpirtvogël, faqebardhë/faqezi* etj.,

emër+peremër:*fjalëshumë/fjalëpak, dritëshumë/dritëpak,* etj.,

folje+ndajfolje:*ndjellamirë/ndjellakeq, dashamir/dashakeq*, etj.,

ndajfolje+mbiemër:*jashtëfisnore/brendafisnore, i jashtëshkruar/ i brendashkruar, keqbërës/mirëbërë*s,etj.

Formula e përgjithshme e formimit të tyre jepet, si: **T+TI<-> T+T2** ose **T1+T<->T2+T**.[737]

4.5 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe dhe angleze, parë strukturalisht

4.5.1 Tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën shqipe, parë strukturalisht

Sipas *Gramatikës e Gjuhës Shqipe 1*:**"***folje quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një veprim (gjendje ose ndryshim të gjendjes) si proces dhe që ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe diatezës*".[738] Ajo përbën bërthamën kryesore të fjalisë.

Për sa i përket *tipologjisë semantike,* foljet mund të emërtojnë[739]:

1. veprime që e kryen ose e pëson kryefjala ("*ulem/ngjitem", "regjistrohem/çregjistrohem",* etj).

2. gjendje të kryefjalës ose ndryshim të gjendjes (*"plakem/rinohem", "gëzohem/zemërohem",*etj).

3. një veprim që kryefjala e fjalisë e kryen që të pësojë ndryshim një tjetër (*"ul/ngre"*, etj).

[736]Shembuj shkëputur nga: M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.124.
[737]M. Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f.123.
[738] Gramatika e gjuhës shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.259.
[739]Gramatika e gjuhës shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f. 259-260.

4. veprime që kryhen me anë të një lokucioni të qendrueshëm, të formuar nga një folje plus një fjalë tjetër, ku rolin gramatikor e luan folja, kurse kuptimin leksikor kryesor e ka fjala tjetër, "*ngre lart / ul poshtë"*, "*vlerësoj / nënvlerësoj",* etj.[740]

Foljet e gjuhës shqipe, mund të jenë:[741]

1. të parme, pra nuk janë formuar me anë të ndajshtesave, përngjitjes apo përbërjes (hap/mbyll, fut/qit, dal/hyj, marr/jap, blej/shes, qesh/qaj, anuloj/procedoj, etj.)
2. të prejardhura, të përbëra,
3. të përngjitura.

Bazuar në Gramatikën e Gjuhës Shqipe, nuk konsiderohen fjalë të parme foljet që formojnë çifte antonimike të tipit *ngarkoj/shkarkoj, ngul/shkul*, tek të cilat kuptimi antonimik del nga kundërvënia e parashtesave përkatëse. Të tilla folje *do të konsiderohen të prejardhura, edhe pse tema pas parashtesës nuk ekziston si një fjalë më vete në gjuhën e sotme.*[742]

Foljet e prejardhura në gjuhën shqipe formohen nga emrat, foljet, mbiemrat apo ndajfoljet, por ekziston një numër i vogël foljesh të prejardhura nga numërorë, përemra ose pjesëza.[743]

Për sa u përket mjeteve dhe mënyrave morfologjike, foljet e prejardhura mund tëformohen me:[744]

- prapashtesa
- parashtesa
- prapashtesë dhe parashtesë njëkohësisht
- pa asnjë ndajshtesë

- ***Formimi parashtesor te foljet antonime***

Në përgjithësi, Samara vëren, se "fjalë antonime prejfiksale folje janë të pakta"[745], p.sh., "nënçmoj/mbiçmoj", "mbath/zbath", "kurdis/çkurdis", "mësohem/çmësohem", "kopsit/çkopsit", "kridhem/çkridhem", etj. Parashtesat "mos-", "pa-", "anti-", nuk shërbejnë fare si elemente fjalëformuese për të formuar folje.

[740] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.259-260.
[741] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.
[742] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.
[743] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.
[744] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.
[745] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.

Për sa i përket kundërvënies, janë pikërisht foljet e prejardhura nga foljet me parashtesën ***"sh-", "ç-", "zh-",*** të cilat kanë kuptim të kundërt me anë të temës fjalëformuese. Ato janë edhe parashtesat me prodhimtare të foljeve të prejardhura që formojnë kundërvënie. Ato përdoren para zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të zëshme (*l, m, n, r, rr*). Shembuj: "*armatos/çarmatosem", "mall/çmallem", "ngjyros/çngjyros", "rregulloj/çrregulloj".* Trajta zh-, përdoret para bashkëtingëlloreve të zëshme, p.sh.,"*duk / zhduk", "vesh /zhvesh", "vleftësoj/ zhvleftësoj",* etj. Trajta *"sh-"*, përdoret me të gjitha rastet e tjera, p.sh. "*palos/shpalos", "qep/shqep", "thur/shthur", "ngarkoj/shkarkoj", "ngrij /shkrij",* etj. Të tilla folje, janë formuar kryesisht nga foljet dhe nga emrat.

Do të konsiderohen folje të prejardhura me parashtesim edhe rastet e tipit: ngrij/shkrij, ku përveç parashtesës, e cila formon kundërvënien, kemi edhe modifikim të temës.

Parashtesat **s-**, **z-** formojnë folje të prejardhura nga folje dhe mbiemra. Kundërvënie kemi në rastet e prejardhjes nga folja përmes parashtesave **s-**, **z-** dhe **m-**, **n-**, duke formuar çifte antonimike të tipit: "*mbath/zbath", "mbërthej/zbërthej", "mbuloj/zbuloj",* etj.

Parashtesa **m-, n-** , ku **m-** përdoret para bashkëtingëlloreve buzore, siç është **b-** dhe **p-**, ndërsa në rastet e tjera përdoret **n-**. Këto parashtesa formojnë folje, tema fjalëformuese e të cilave nuk del më vete, siç është folja "*ngul/shkul", "mbuloj/zbuloj", "ndrydh/shtrydh", "ngarkoj/shkarkoj", "ngatërroj/shkatërroj", "ngrij/shkrij", "ngjesh/zgjesh", "mbath/zbath", "mbërthej/zbërthej", "mbrej/zbrej",* etj.

Parashtesat **mbi-** dhe **nën-** krijojnë antonimi me njëra-tjetrën dhe formojnë folje të prejardhuara nga foljet.[746] Parashtesa **mbi-** emërton një veprim që është më intensiv sesa tema fjalëformuese, ndërsa parashtesa **nën-** emërton një veprim më pak intensiv.Shembuj: "*nënçmoj/mbiçmoj", "mbivlerësoj/nënvlerësoj", "nënvleftësoj/mbivleftësoj",* etj.

Parashtesa **de-** formon folje me kuptim të kundërt nga folje të tipit *centralizoj/decentralizoj, "gradoj/degradoj", "maskoj/demaskoj", "kompozoj/dekompozoj", "shifroj/deshifroj",* etj. Kjo parashtesë është e huazuar ashtu siç janë edhe temat fjalëformuese me të cilat ajo ndajshtohet.[747]

Përbën debat parashtesimi me ato elemente që Gramatika e Gjuhës Shqipe i njeh, si "s*iparashtesa*", si p.sh.,"***brenda-", "jashtë-", "para-", "pa-", "prapa-"***,etj., si në shembujt:
"*brendashkruaj/jashtëshkruaj","paravendos/prapavendos","parapaguaj/prapapaguaj",* etj. Debati ka të bëjë me faktin se disa gjuhëtarë i shohin këto raste si fjalë të cilat kanë në përbërjen e tyre dy ose më shumë tema motivuese, pra dalin si kompozita të formuara nga *ndajfolje + folje*. Nga ana tjetër, ka gjuhëtarë që mendojnë se këtu kemi të bëjmë me parashtesim, pasi ndajfoljet e tipit *jashtë-*, *brenda-*, *para-*, *prapa-*, janë kthyer në parashtesa.

Në lidhje me kompozitat foljore, tipi më prodhimtar është *ndajfolje+folje*, kryesisht me ndajfoljet *mirë-* dhe *keq-* si p.sh. "*mirëkuptoj/keqkuptoj", "mirëtrajtoj/keqtrajtoj",* etj.Samara thekson se "fjalët e përbëra folje ndërtohen nga:

[746] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.
[747] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f.343-348.

ndajfolje+folje, si në shembujt "*mirëkuptohem/keqkuptohem", "mirinformohem/ keqinformohem", "mirëpres/keqpres",* etj".[748]

Është interesant fakti se l. Dodbiba dhe S. Spasse shprehen se "*janë të përngjiura fjalët, kur formohen me parashtesa që vihen para një foljeje, p.sh.,"palos/shpalos", "kaloj/tejkaloj", etj."*[749]Ata dallojnë parashtesat kryesore të foljevetë përngjitura ***ç-, sh-, s-,***si p.sh.,*"palos/shpalos", "liroj/çliroj" (*gjithashtu *tejkaloj* dhe *stërholloj* mund të shikohen si antonimike kundrejt *kaloj* dhe *holloj)"*.[750] Ata shtojnë se "parashtesat **ç-** dhe **sh-** përdoren para foljeve të parme për të formuar folje të përngjitura dhe u japin këtyre kuptim të kundërt nga i pari, si p.sh.,"*vesh/çvesh"* (heq nga shtati), "*thur/shthur"* (prish një gjë të thurur).[751] Ndodh që parashtesat **ç-** dhe **sh-**, në vend që të prishin kuptimin e foljes, e fuqizojnë më tepër, si në rastet "*liroj/çliroj", "këput /shkëput*",etj.[752]

Forca antonimike e njërit prej gjymtyrëve në çiftet foljore antonimike të gjuhës shqipe dhe asaj angleze, jo rrallë mund të rezultojë në përftim të një fjale të re antonimike, shpeshherë falë aftësive fjalëformuese të vetë gjuhës, p.sh.,"*dehem"* ka sjellë në formimin e fjalës antonimike "*zhdehem"*. [753] Prej këtej formohen edhe modele fjalëformimi, të cilat ndikojnë në prodhimtarinë e një gjuhe. Duke u bazuar në modelin e mësipërm në parashtesën "*ç"*përpara foljeve janë formuar edhe çifte antonimike të tipit,"*mat/çmat","mendohem/çmendohem",*etj.

4.5.2 Antonimet e shprehura me folje dhe togfjalësh

Marrëdhëniet antonimike mund të lindin ndërmjet fjalësh me kuptim themelor ose të derivuar. Kundërvënia është e mirëfilltë tek antonimia me kuptim themelor, ndërsa për sa i përket kuptimit të derivuar, të prejardhur apo të figurshëm, është më i vogël në numër, dhe jo aq i plotë sa në kuptimet themelore.[754]

M. Samara e pranon si një antonimi të dobësuar sidomos nëse togfjalëshi i qendrueshëm ka një gjegjëse tjetër antonimike, përveç mohimit me pjesëzat mohuese, si p.sh., më zë gjumi/më del gjumi është me e plotë sesa: më zë gjumi/ s'më zë gjumi. Samara thekson se "*kjo antonimi përdoret kur kundërvënia nuk mund të shprehet me një fjalë të vetme, ose me një togfjalësh tjetër të qendrueshëm*".[755]

Nga pikëpamja leksiko-gramatikore kemi togfjalësha strukturorë me vlerë foljore, me vlerë ndajfoljore dhe me vlerë emërore.[756] Në këtë punim, ne do t'i referohemi vetëm atyre me vlerë foljore. Frazeologjizmat me vlerë foljore formohen përmes një foljeje dhe një emri foljor: *"bëj pushim", "bëj durim",* etj. Shembuj: "*ndërroj udhë", "heq dorë",*etj.

[748] M. Samara (1980) Vëzhgime rreth antonime të fjalëve të përbëra dhe të përngjitura të gjuhës shqipe, Studime Filologjike, f.124.
[749] l. Dodbiba, S .Spasse (1955) Gramatika e Gjuhës Shqipe, f.262.
[750] l. Dodbiba, S .Spasse (1955) Gramatika e Gjuhës Shqipe, f.262.
[751] l. Dodbiba, S .Spasse (1955) Gramatika e Gjuhës Shqipe, f.263.
[752] l. Dodbiba, S .Spasse (1955) Gramatika e Gjuhës Shqipe, f.263.
[753] M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe. f. 185.
[754]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.64.
[755]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.64.
[756]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike. f.64.

- *Foljet që shprehin mënyrën e veprimit me togfjalësha*

Foljet që shprehin mënyrën e shtjellimit të një veprimi nuk dalin të mëvetësishme në fjali, por shoqërohen me një formë foljore tjetër.[757] Togfjalëshat e qendrueshëm gjithashtumund tëshprehin edhe urime ose mallkime të tipit *paç faqene bardhë/ paç faqen e zezë*.[758] Disa nga tiparet themelore gjatë trajtimit të frazeologjisë janë idiomatizimi, motivimi, shkalla e ngurosjes, ngjyrimi emocional, etj.[759]

Foljete veprimit përdoren për të treguar:

1. fillimin e një veprimi (*"filloj/nis", "zë", "bëj", "marr", "vihem",*etj) p.sh.,"*bëj të iki", "filloj të dal", "nis të lëmoj", "zuri të padiste",* etj.

2. foljet që shprehin vazhdimin e një veprimi (*vazhdoj* dhe *vijoj)* p.sh.,"*vazhdoi të vraponte"*, "*vijoi të rrinte në gjunjë",* etj.

3. rritje progresive të një veprimi (folja vij, p.sh., "*vinte duke rënë", "sa vinte e zgjerohej",*etj.)

4. shprehin mbarimin e një veprimi (folja mbaroj ose pushoj, p.sh.,"*mbaroj së foluri", "pushoj së ekzistuari"*, etj.)[760]

Të tilla folje janë të pakta në numër krahasuar me togëfjalëshat ku këto folje vendosen duke formuar çifte togëfjalëshash antonimike me kundërvënie të plotë apo të pjesëshme. Ato ndiqen nga një formë e pashtjelluar foljore dhe mund të formojnë çifte antonimike si edhe shkallëzim të kundërvënies me gjymtyrë skajorë togfjalëshat foljorë: *filloj të bëj diçka* në kundërvënie me *mbaroj së bëri diçka*, të ndërmjetësuar nga kundërvënia e shkallëzuar e togfjalëshave foljorë të tipit *vazhdoj të bëj diçka* dhe *sa vjen e bëhet.*[761]

A----------B----------Ç----------D

filloj të dobësohem, vazhdoj të dobësohem, sa vjen e dobësohem, pushoj së dobësuari

Figura 19 Kundërvënia e shkallëzuar e togfjalëshave foljorë

Kur togfjalëshat e qendrueshëm leksikalizohen, marrin kuptimin e një fjale të vetme, pra kanë kuptim unik dhe shpesh dalin si sinonime të fjalëve ekzistuese.[762] M. Çeliku thekson, se "*ato përdoren si njësi të gatshme njësoj si fjalë dhe nuk formojnë*

[757]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike. f.64.
[758]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.186.
[759]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.186.
[760] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit , f.264-265.
[761] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit , f.264-265.
[762] Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit , f.264-265.

modele formimi".[763] J. Thomai gjithashtu i ka kushtuar vëmendje të veçantë frazeologjisë në gjuhën shqipe.[764]

4.6 Klasifikimi i antonimeve të shprehura me togfjalësh

Në gjuhën shqipe sipas M. Samarës antonimia e shprehur permes togfjalëshit paraqitet si më poshtë.[765]

1. antonimia ndërmjet një togfjalëshi të qendrueshëm dhe një fjale të mëvetësishme, si p.sh. *merr fund/fillon* është një model i ngjashëm me atë të kundërvënies së fjalës me dy rrënjë të ndryshme.

2. antonimia ndërmjet dy togfjalëshave të qendrueshëm, ku nuk ka asnjë gjymtyrë të përbashkët, "*ngul këmbë/lëshoj pe"*, "*e solli kokën/e këputiqafën", "sy ndër sy/ prapa krahëve",*etj. Këtu kemi të bëjmë me kundërvënie të plotë, të mirëfilltë.

3. antonimet midis dy togfjalëshave, të cilët në përbërjen e tyre kanë çifte antonimike me rrënjë të ndryshme, ose me parashtesa:*"ul kokën/ngre kokën", "fitoj pikë/humb pikë", "iu lidh goja/iu zgjidh goja",* etj. Këtu, siç e shohim nga shembujt, kemi një gjymtyrë të përbashkët në të dyja gjymtyrët frazeologjike.

Disa nga foljet, të cilat marrin pjesë në këta togfjalësha janë "*dal/hyj", "ul/ngre",* etj. Mbiemrat që marrin pjesë në këto formime janë,"*i mirë /i keq", "plot /bosh",* etj.

4. Antonime midis togfjalëshave të qendrueshëm që nuk kanë fjalë antonime në përbërje, por kanë një fjalë të përbashkët, si p.sh.,"*mbaj fjalën/dal nga fjala", "ngul në mendje/heq nga mendja",* etj. Peshën e kundërvënies e ka gjymtyra jo e njëjtë.

5. Antonimi midis togfjalëshave të qendrueshëm dhe mohimit të kuptimit të tij me pjesëzat mohuese mos**-, pa-, jo-, nuk- (s')**, p.sh.,"*ma ha mendja/s'ma ha mendja"*, "*ia vlen barra qiranë/s'ia vlen barra qiranë",* etj. Këtu kundërvënia nuk është e plotë. Xh. Lloshi mendon, se kemi të bëjmë me "*mohim sintaksor*".[766] Këtu kemi të bëjmë me mohim, pasi pjesëzat mohuese nuk janë pjesë e pandashme.

Ka disa raste, kur pjesa mohuese është pjesë e pandashme dhe hyn në marrëdhënie kundërvënieje me një togfjalësh tjetër të qendrueshëm pa asnjë gjymtyrë të përbashkët, p.sh.,*s'e çan kokën* nuk ka si përgjegjës antonimik ndonjë togfjalësh të qendrueshëm të tipit "*çan kokën"*, por i kundërvihet togfjalëshit të qendrueshëm, "*i bie prapa"*. Në gjuhën shqipe ekzistojnë togfjalësha të qendrueshëm, të cilët janë formuar nga çifte antonimike foljore të tipit,"*jap e marr"* (*përpiqem*), "*sa çel e mbyll sytë"* (*shpejt*), "*as të ngroh as të ftoh",* etj. Në këto togfjalësha kuptimi antonimik është shkrirë në një kuptim të vetëm.[767]

Sipas J. Thomait, "*rruga më e pasur e lindjes së frazeologjizmave është përmes krahasimit dhe metaforës të leksikalizuar".*[768] P.sh.,"*e kam halë në sy"* (*e urrej*) është formuar nga krahasimi "*e kam si halë në sy*".[769] Lidhëza krahasuese ndonjëherë ruhet e

[763]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.186.
[764]J. Thomai (1964) Probleme të Frazeologjisë së Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike
[765]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.186.
[766]Xh. Lloshi (1966) Shënime për Fjalën dhe Togfjalëshin, Studime Filologjike.
[767]M. Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.34 -191.
[768]J. Thomai, Vëzhgime mbi Frazeologjizmat e Gjuhës Shqipe, Studime Filogjike.
[769] Shembujt e shkëputur nga J.Thomai ,Vëzhgime mbi Frazeologjizmat e Gjuhës Shqipe, Studime Filogjike.

ndonjëherë humbet, si "*e ëma e Zeqos në majëtë thanës*", "*si kali në lëmë*", "*si sytë e ballit*" etj. Kemi edhe frazeologjizma që formohen me përsëritjen e të njëjtit element, p.sh.,"*brez pas brezi" , "kokërr për kokërr", "flakë për flake*",etj. [770]

Antonimet shprehen tek togfjalëshat e qendrueshëm të cilët e kanë fituar kuptimin gjatë përdorimit shumëvjeçar në gjuhë. Sipas M. Samarës, antonimet e shprehuara në togfjalësha të qendrueshëm janë jo të mirëfillta, meqenëse kanë marrë kuptime figurative, të cilat e kanë dobësuar fuqinë e shkallës kundërvënëse ndërmjet tyre.[771] Pra, ka humbur kuptimi themelor dhe si rezultat është e thjeshtë të krijojnë sinonime të tipit "*e ka dorën e lehtë/ e ka dorën e rëndë",* ku e ka dorën e lehtë mund të sinonimizojë me *i mëshirshëm* dhe gjymtyra tjetër *i pamëshirshëm*. Kundërvënia te togfjalëshat e qendrueshëm përgjithësisht është e plotë. Shembuj *e nderoi/e turpëroi* del edhe në kundërvënie togfjalëshash, si*"ia zbardhi fytyrën/ia nxiu fytyrën"*. Samara jep këtë klasifikim:[772]

1. çifte antonimike midis një togfjalëshi frazeologjik dhe një fjale të vetme, "*e mori më qafë/e shpëtoi", etj*.

2. midis dy togfjalëshave frazeologjikë, të cilët kanë në përmbajtjen e tyre fjalë të njëjta, "*e preu në besë/i doli në besë",* etj.

3. midis dy togfjalëshave frazeologjikë, të cilat përmbajnë fjalë antonime, por rezultati nuk është i njëjtë me to: "*hap sytë / mbyll sytë", "hap gojën /mbyll gojën","bëri mirë / bëri keq", etj*.

4. togfjalëshat e qendrueshëm të përbërë prej antonimeve që e kanë humbur kuptimin e tyre të parë, duke fituar kuptim të figurshëm, *jep / merr (mundohet*), etj.

5. antonime prej togfjalëshash, të cilët nuk përmbajnë fjalë me kundërvënie, *me plot gojën/me gjysmë gojë (i sigurt/ i pasigurt),* etj.

Samara pranon se "*togfjalëshat frazeologjikë përballë njëri-tjetrit ku njëri prej tyre paraprihet nga pjesëza mohuese s, ose nuk mund të formojnë çift antonimik*"[773]. Nga ana tjetër, studiuesi I. Goçi mendon, se nuk kemi të bëjmë me çift antonimik në rastin,"*ia marr dorën/s'iamarr dorën",* por vetëm me mohim.[774] Ai shton, se *në të tilla raste, theksi kuptimor bie kryesisht mbi fjalën kryesore të përcaktuar*.[775]

[770] J. Thomai, Vëzhgime mbi Frazeologjizmat e Gjuhës Shqipe, Studime Filogjike.
[771]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.58.
[772]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.59.
[773]M. Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.63.
[774] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 11-113.
[775] I. Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 11-113.

KREU V

5. KORPUSI I ANTONIMEVE DHE STUDIMET EKSPERIMENTALE

5.1 Studime të rëndësishme të antonimeve, përmes korpusit dhe eksperimenteve gjuhësore

Puna me korpusin në gjuhën angleze daton që më 1950 me studimin e përdorimit te gjuhës angleze në Universitetin e Londrës dhe me Korpusin e Universitetit Brown në Providencë, ishulli i Rodosit. Në 1990, u hartua një burim masiv që njihet si "The British National Corpus", "The International Corpus of English" ,"Bank of British" nga Universiteti i Birmingamit në Angli. Nga përpjekjet e reja me bazë korpusi dallojmë Collins Cobuild, një seri fjalorësh të gjuhës angleze me citime të marra nga gjuha dhe ligjërimi i botës reale. Në përgjithësi, pjesa më e madhe e studimeve janë të lidhura ngushtë me fjalorëtnjë dhe dygjuhësh.

Fjalori përshkruhet si *një listë fjalësh sipas rendit tematik (thesari) ose rendit indeksor (fjalori tipik) të cilëve i shtohen përkufizmet*.[776] Gramatika studion format e ndryshme që një fjalë mund të marrë, por, siç e kemi theksuar, fjalori dhe gramatika nuk janë dy përbërës të ndarë të gjuhës, pasi në mënyrë tradicionale është përdorur metoda teorike e përcaktimit të kritereve klasifikuese apo të dallimit të tipareve të çifteve antonimikë. Kështu, kategorizimi i standardizuar (konvencional) sipas Herrman[777] bëhet përmes tre treguesve kryesorë për përcaktimin e antonimeve "*më të mira*" apo "*më të gjetura*" dhe janë pikërisht këto tre tregues, të cilët janë përdorur në përgjithësi tradicionalisht edhe nga studiues të tjerë të kësaj fushe, për të dalluar antonimet "*e mira*" nga ato "m*ë pak të mira*". Treguesit janë[778]:

1. Qartësia e dimenstioneve në të cilat bazohen antonimet.

   Kjo do të thotë, sesa më e qartë të jetë marrëdhënia, aq më të mira janë çiftet e antonimeve. Kështu, dallimi i çifteve "*good/bad*" (i mirë/i keq) dhe "*holly/bad*" (*i shenjtë/i keq*) në boshtin apo dimensionin e meritës qartësohet përmes faktit se "*holly*" nuk ka vetëm dimensionin e meritës (siç vlen për "*good*") por ka edhe "drejtësinë morale" të përfshirë, gjë që e bën çiftin e dytë "*holly/bad*" më pak të qartë, sesa "*good/bad*".[779]

2. Dimesioni duhet të jetë me natyrë denotative, dhe jo konotative.

3. Treguesi i tretë lidhet me pozicionin që zë kuptmi i fjalës në dimension.

   Që të kemi të bëjmë me një çift antonimesh "*të mirë*" duhet që gjymtyrët e tij të qendrojnë në dy skajet e kundërta në raport me pikën qendrore të bushtit, dhe që

[776] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones, (Forthcoming) 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f.92.
[777] D.J. Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy and Synonym Comprehension, f. 134.
[778] D.J. Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy and Synonym Comprehension, f. 134.
[779] D.J. Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy and Synonym Comprehension, f. 134.

kjo largësi nga pika qendrore të jetë e barabartë për të dyja gjymtyrët, si p.sh., "*hot/cold" (i nxehtë/i ftohtë*) si dhe të mos jenë të vendosura në të njëjtën anë si "*cool/cold*" (*i freskët/i ftohtë*).

Në vitet e fundit, vëmendja është përqendruar te studimet me në qendër kontekstin, përdoruesin e gjuhës, korpuset konkrete e praktike të gjuhës, etj., përmes metodave moderne eksperimentale. Studime të tilla ofrojnë një qasje tjetër me të qartë të antonimeve dhe përdorimit dhe natyrës së tyre në gjuhë. Në këtë drejtim, Murphy[780] thekson rëndësinë për një parim të përgjithshëm pragmatik, *Marrëdhënia përmes Kontrastit (RC, Relation by Contrast),*e cila drejton të gjitha marrëdhëniet semantike, siç janë: *antonimet, sinonimet, hiponimet, bashkëhiponimet, meronimet*, etj. Ky parim i përkufizon marrëdhëniet në bazë të dallimeve minimale. Përsa i përket antonimeve, *marrëdhënia kundërvënëse qendron ndërmjet gjymtyrëve të një çifti, vetëm nëse ato kanë të njëtat tipare kontekstuale, përveç një tipari.*[781]

Për më shumë, Paradis dhe Willners paraqesin metodën e tyre metagjuhësore të studimit të antonimisë dhe e përkufizojnë antonimin si "*një levizje binare në të cilën dy çifte kuptim – formë përdoren si të kundërta, dhe kundërvënia binare realizohet përmes një interpretimi krahasues, në të cilin një dimension kuptimor (X ndahet nga një konfigurim kufizues edhe kuptimet në secilën anë të kufirit përdoren dhe kuptohen si të kundërta)".*[782]Kjo njihet ndryshe, nga Paradis dhe Willners, si *dikotomia antonimike* e një strukture kuptimore.

Skematikisht ajo paraqitetnga Paradis dhe Willners si më poshtë:[783]



Figura 20 Dikotomia antonimike

Në përgjithësi, gjatë përdorimit të antonimeve në kontekste të caktuar, është krahasimi i cilësisë apo veprimit, ai që krijon dhe motivon antoniminë. Për shembull, për të thënë që "*These trousers are expensive.*" (*Këto pantallona janë të shtrenjta.),* ne kemi përcaktuar një vlerësim të bazuar tek një krahasim me "një palë pantallona", të cilat janë "*më të lira*" (*cheaper)*. Në këtë rast, të dyja këto tipare gjenden në të njëjtin bosht, apo dimension, atëtë kostos, apo çmimit. Përmes këtij studimi dëshmohet dobia e tri përbërësve kryesorë:*përmbajtja, konfigurimet dhe interpretimet.*[784]

[780] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press.
[781] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press.
[782] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones, Forthcoming. 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f.92.
[783] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones, Forthcoming. 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f.93.
[784] C. Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones, Forthcoming. 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f.93.

Dallimi midis konfigurimeve ose skemave dhe interpretimeve nuk përcaktohet qartë nga studiuesit në fushën e semantikës njohëse.[785] Konfigurimi i kufizimit përbën një domosdoshmëri absolute për kuptimet brenda një segmenti të caktuar të përmbajtjes, në mënyrë të tillë që ato të përdoren si antonime. Ky është dhe kategorizimi skematik i antonimisë, pra, kategorizimi përmes konfigurimit. Kjo kategori e antonimeve nuk ka një strukturë të brendshme, por përdor kufizimin, si kriter përfshirës standartizimi të çifteve antonime. Përbën interes dallimi i çifteve të cilat janë antonime "*të mira*", "*jo të mira*", apo"*perfekte*" në gjuhën angleze. Kjo realizohet në kundërvënie të cilat kërkojnë një mbështetje situative më të veçantë. Pra, sa më pak e lidhur me situatën apo kontekstin të jetë një çift antonimesh, aq më e fortë është lidhja e tyre, e aq më të gjetur janë ato.

Ndërmjet mbiemrave me antonime të përcaktuara në fjalorin Collins, 95 % shënojnë kuptime të shkallëzuara, të cilat mund të ndodhen në bosht siç është "*big / small"* (*i madh/i vogël*) ose pa bosht siç është "*dead/alive" (i vdekur/i gjallë)*.[786] 5% i mbetur janë antonime të pashkallëzuara siç janë çiftet mbiemërore "*female/male"* (*femër/mashkull*) ose "*abctract/concrete*" (*abstrakte/konkrete*).[787] Nga studimi i Paradis dhe Willners dallojmë, se të gjitha mbiemrat e shoqëruar me gjymtyrë antonime në fjalor kanë të përbashkët faktin se ato shënojnë cilësi të mëvetësishme, si p.sh., përmasë, ekzistencë, shpejtësi, fuqi, gjerësi, meritë, përgjithësim, shkëlqim dhe gjini.[788] Kjo tregon, se gjymtyrët e një çifti antonimesh janë shumë të ngjashme, përsa i përket anës së përmbajtjes së kuptimeve të tyre. Kështu, "*big/small" (i madh/i vogël)* lidhen me të njëtën fushë apo cilësi, sikurse është ajo e përmasës, brenda të njëjtin bosht të shkallëzuar. Ndërkohë që "*dead/alive"* lidhen me ekzistencën, e cila ndodhet në të dyja anët e kufirit ndarës. [789]

Ndërkohë, shumica e kuptimeve foljore antonime në fjalor kanë të bëjnë me ngjarje të përcaktuara, si për shembull: "*agree/disagree" (bie dakord/nuk bie dakord), "accept/reject*" (*pranoj/refuzoj),* etj.[790] Gjithashtu, një numër i madh foljesh në fjalor lidhen me veprime të shkallëzuara, si për shembull: "*diminish/increase*" (*zvogëloj/rris*), "*criticize/praise*" (*kritikoj/lavdëroj*), etj. Ndërkohë, një pjesë e vogël e tyre kanë të bëjnë me gjendje të shkallëzuara, si për shembull: "*love/hate" (dashuroj/urrej), "like/dislike"(pëlqej/nuk pëlqej*[791]*),* etj. Tiparet semantike janë të ngjashme me ato të mbiemrave, në faktin se konceptohen si tipare me tendencë natyrale të ndarjes në dy pjesë të një fushe apo sfere,apo të formojnë pole të kundërt në një bosht.

Përmbajtja shprehet në kombinim me një konfigurim të boshtit, ose me një kufi ndarës, të cilat përbëjnë një kundërvënie binare. [792] Përsa i përket antonimeve të

[785]W. Croft, D., A. Cruse (2004) Journal of Pragmatics , f.54.
[786] Njihen si *scalar* dhe *not scalar nga* C. Paradis, C. Willners
[787] Rezultatet e gjetura nga C. Paradis, and C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress
[788] C. Paradis, and C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.
[789] C. Paradis, and C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.
[790] C. Paradis, and C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.
[791]Shënim: vërejmë se "*dislike*" nuk ka një formë të ngjashme në gjuhën shqipe, pra nuk ka një parashtesë ekuivalente me "dis-" për foljen "*pëlqej*" (*like*)
[792] C. Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.

pashkallëzuara, shumica prej të cilave janë të prejardhura nga emrat, duhet theksuar se ato nuk kanë të njëtin aftësi natyrale për të formuar çifte antonimesh,[793] si p.sh., nuk është shumë e natyrshme të gjendet gjymtyra antonime për mbiemra të tillë, si "*financial" (financiar), "linguistic" (gjuhësor),* etj.

Të tillë mbiemra mund të leksikalizohen me parashtesën "*non-"* në kuptimin "*not being X",* të ngjashëm me mohimin dhe në këtë këndvështrim ka dallim të dukshëm me gjymtyrët e qartë antonime, përgjatë një dimensioni të caktuar. Paradis dhe Willners mendojnë, se prodhueshmëria e parafjalës "*non-"* në fjalëformim, e bën atë më pak të dobishëm në fjalor. Pra, ajo mund të mos jetë e nevojshme për aq kohë sa i njëjti nocion shprehet me forma të tjera, pa pasur nevojë të formojmë fjalë të reja. Konkretisht, ata vërejnë se shumë rrallë është e nevojshme të kemi njësi leksikore të tipit "*non-financial" (jofinanciar)*, "*non-linguistic" (jogjuhësor)*, etj. Në një vështrim përqasës mes gjuhës angleze dhe asaj shqipe, mund të themi, se edhe në gjuhën shqipe parashtesa "*jo-*", e njëjtë me "*non-",* del herë e shkëputur si pjesëz mohuese e herë e ndajshtuar si parashtesë.

Mendojmë se edhe në shqipe nuk është e nevojshme të leksikalizohet një formë e tillë për vetë faktin, se mohimi me pjesëz mjafton për të qartësuar komunikimin, dhe se antonimia me një pjesëza të tillë të leksikalizuar nuk është e fortë apo e plotë ashtu edhe J.Thomai thekson,se, *"...formimet me parashtesa "jo-", "pa-", dhe "mos-", karakterizohen nga kundërvënia jo e plotë..."*[794]. Në përgjithësi, siç e pamë në kapitullin e katërt, ajo konsiderohet si një nga prodhimtaret në gjuhën shpiqe dhe shoqërohet me mbiemra marrëdhënjorë të panyjshëm, si p.sh. *"joaktiv", "jonormal", "jogjuhësorë*", "*jofetar",*etj. Megjithatë, në gjuhën shqipe ajo ka edhe vlera të shqipërimit të fjalëve, pasi, zëvendëson parashtesën e huaj "*a-"si në shembujt: "politik/apolitik" (jopolitik), "fetar/afetar" (jofetar), etj.*

Antonimet mbiemërore janë ato të cilat konsiderohen si "*çifte form-kuptim".*[795] Në përgjithësi ato janë më të shpeshta dhe për këtë arsye përbëjnë objekt studimi të pjesës më dërrmuese të studimeve eksperimentale dhe tekstuale. Në lidhje me aftësinë e tyre për bashkërenditje apo lidhje sintagmatike brenda fjalisë, vetëm një numër i vogël mbiemrash u identifikuan në korpusin e studimit si çifte të cilat bashkërenditen fuqishëm në fjali "*good/bad" (i mirë/i keq), "wide/narrow" (i gjerë/i ngushtë), "dark/light" (i errët/i çelët), "thin/thick" (i hollë/i trashë), "weak/strong" (i dobët/i fuqishëm), "fast/slow" (i shpejtë/i ngadaltë*). Këto gjymtyrë antonime shfaqën tipare frekuence maksimale në përdorim, jo vetëm në bashkërenditje, por edhe të mëvetësishme. Ky fakt dëshmon se ato aplikohen lehtë në struktura kuptimore të gjëra, si dhe janë të dobishme në kontekste të shumëllojshme, si të mëvetësishme ashtu edhe në çifte.[796] Për këtë arsye, ato njihen si *çifte të konvencionalizuara apo t*ëstandardizuara, pasi janë lehtësisht të dallueshme në kontekst.

Për më shumë, rezultatet e studimit treguan, se polisemia e fjalëve nuk i kufizon ato nga përfshirja në çifte antonimesh ku njëra gjymtyrë është e konvencionalizuar, por në kuptim polisemik, dhe tjetra jo, si për shembull: "*light/heavy*" (*e lehtë/e rëndë*),

[793] C. Paradis (2004) Where Does Metonymy Stop? Senses, Facets and Active Zones. Metaphor and Symbol, f.245 -264.
[794]J. Thomai (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, f.161.
[795]Shënim: terminologji e C. Paradis
[796] C. Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.

"*narrow/open*" (*e ngushtë/e hapur*), etj.[797] Paradis dhe Willners, gjithashtu, theksojnë dhe provojnë përmes eksperimenteve studimore, se antonimia ka kryesisht natyrë konceptuale,ndryshe nga strukturalisët[798] të cilët mendonin, se antonimia është kryesisht një marrëdhënie leksikore mes formave të fjalës.

Në lidhje me çiftet e fjalëve në kundërvënie semantike, janë kryer disa studime dhe eksperimente të tjera për ta shpjeguar, se përse disa prej këtyre çifteve shihen si antonime kanonike. Një nga studimet me rëndësi dhe me rezultate interesante është ai i kryer nga disa gjuhëtarëme zë në fushën e semantikës, siç janë Jones, Paradis, Murphy dhe Willners.[799] Në këtë studim, antonimet u vëzhguan për sjelljen tyre brenda disa kornizave të veçanta, të cilat përcaktojnë modele bashkrënditjeje të çifteve antonime në fjali, si p.sh: "*X and Y alike*", "*from X to Y*", "*either X or Y*", modele këto të cilat u evidentuan nga kërkimi shkencor i Justeson dhe Katz ,[800] në vitin 1991. Në këtë studim, antonimet jo vetëm u vendosën në kornizat e mësipërme, por, gjithashtu, u panë në raport me funsksionet ligjërimore të përshkruara nga Jones, siç janë[801]:

- funksioni i tipit të koordinuar
- funksioni i shumanshëm
- funksioni i kalimit apo tranzicionit
- funksioni i konfliktit.

Kusht paraprak, për fillimin e këtij studimi ishte hipoteza sesa më kanonik të jetë një çift antonimesh, aq me më shumë përpikmëri do të kishte në të tilla korniza. Përcaktimi i korpusit të studimit përbën një çështje problematike për shkak të volumit të tij dhe besueshmërisë së të dhënave. Në këtë studim u përdor pikërisht korpusi i të dhënave të internetit, *World Wide Web*[802], megjithatë vetë studiuesit e përfshirë në këtë kërkim, u ndeshën me vështirësinë e një korpusi të tillë, në lidhje me standardet e një korpusi të vërtetë të përcaktuar nga Kennedy, Biber, Fetcher dhe Sharoff.[803] Sipas tyre, të dhënat e internetit nuk përbëjnë një përmbledhje të strukturuar tekstesh të përshtatshme për analiza gjuhësore. Megjithatë, studiuesit vlerësuan, se perfeksioni i kufizuar i korpusit *Google* përbën një disavantazh, jo shumë domethënës për studimin e tyre. Kjo, pasi, qëllimi i studimit është të matet frekuenca relative, në të cilën fjalët përdoren në pozicione të caktuara, brenda shprehjeve të zgjedhura, si korniza.

Në literaturën e studimeve gjuhësore të gjuhës angleze, disa studiues, si p.sh., Gross[804] dhe Carles,[805] ndajnë mendimit se çiftet e antonimeve mund të jenë *kanonike* ose

[797] C. Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f.213-220.
[798]Shënim: qendrimet strukturaliste të trajtuara në kreun II
[799]S. Jones, C. Paradis, M. L. Murphy, C. Willners, (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity. Corpus-based Language Learning, Language Processing and Linguistics Journal, f.132.
[800]J. S. Justeson,. Slava M. Katz (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and Their Contexts. Computational Linguistics, f. 1-19.
[801] S. Jones (2002): fusksionet ligjërimore të trajtuara në kreun III
[802]Shënim: shkurtimi "WWW";njësistemidokumentevetë ndërlidhura "HyperText"të cilatjanë të disponueshme nëpërmjet internetit
[803] Cituar nga S. Jones, C. Paradis, M. L. Murphy, C. Willners, (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity. Corpus-based Language Learning, Language Processing and Linguistics Journal, f.132.
[804] D. Gross, K. J. Miller. (1990) Adjectives in WordNet, International Journal of Lexicography 3 f.265–77.
[805] W. G. Charles, Marjorie A. Reed, D. Derryberry (1994) Conceptual and Associative Processing in Antonymy and Synonymy. Applied Psycholinguistics, f.54.

jo kanonike duke bërë dallimin midis çifteve kanonike të tipit "*cold/hot*" (*i ftohtë/i ngrohtë*) në dallim me ato *jo kanonike* "cool/hot" (*i freskët/i nxehtë*).[806] Murphyshton, se *"antonimet më shumë se çdo gjë tjetër semantike janë në gjendje të arrijnë një status kanonik në gjuhë*".[807] Nga ana tjetër, qendrojnë ata gjuhëtarë, të cilët ndajnë idenë e një gjuhësie ndërmjet këtyre dy kategorive, të tillë janë: Herrman dhe Murphy. Gjatë studimeve mbi antonimet kanonike, janë përdorur disa metoda, si p.sh., testet e shoqërimit të fjalëve[808], testet e gjykimit,[809] apo eksperimentet e vjeljes (mbledhjes) së fjalëve.[810]

Qëllimet e studimittë tyre janë**:**

- të vlerësohet masa në të cilën një grup strukturash leksiko-gramatikore mund të përdoren për të studiuar antoniminë;

- të matet fuqia e lidhjes së çifteve të antonimeve, të cilat i përkasin 10 boshteve semantike; (matja e fuqisë së lidhjes realizohet duke studiuar bashkërenditjen e tyre me përpikmëri brenda këtyre strukturave apo kornizave.)

- të vlerësohet dobia e përdorimit të korpusit të internetit.

Antonimet kanonike përbëjnë interes në studim për shkak të rolit të tyre te rëndësishëm në gjuhë, si p.sh., në fjalor, në enciklopedi, në leksikun kompjuterik, si dhe në eksperimentet gjuhësore.

Me çift antonimesh do të kuptojmë *fjalë të cilat kundërvihen semantikisht dhe janë të papërputhshme të paktën në njërin nga kuptimet e tyre*[811]. Një çift antonimesh thuhet se quhet *kanonik* nëse dy gjymtyrët e tij lidhen përmes "traditës", ashtu si edhe përmes marrëdhënies semantike. Pra, "*çiftet antonime kanonikenjihen si çifte njësish leksikore, të cilat janë kombinime të formës dhe kuptimit, jo thjesht çifte të prejardhura nga rregullat semantike në kombinimin kuptim-kuptim*".[812] Përsa i përket traditës dhe *çifteve tradicionale* do të kuptojmë çifte të cilat bashkërenditen në një numër më të gjërë kontekstesh, që do të thotë, se ata nuk kundërvihen vetëm brenda një shprehjeje apo togfjalëshi të caktuar. Për këtë arsye themi, se çifti "*rich/poor"*(*i pasur/i varfër*) është më kanonik sesa çifti "*rags/riches"*(*leckaman*/*të pasur*). Një tjetër element për tiparin tregues për çiftin antonimik kanonik është edhe reciprociteti apo ndërsjellja, p.sh., në çiftin "*fast/slow"(i shpejtë/i ngadaltë)*, "*slow"*(*i ngadaltë),*del si e kundërta më e mirë si për "*fast" (i shpejtë*) ashtu edhe për "*rapid"(i shpejtë, i menjëhshëm)*, ndërkohë që "*slow"* mundet vetëm ta kthejë këtë antonimi për mbiemrin "*fast"* por jo *"rapid"*. Prandaj,

[806] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.126
[807] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.126
[808] H.H. Clark (1970) Word Associations and Linguistic Theories, cituar nga J. Lyons (ed.) New Horizons in Linguistics, f.271–86. Baltimore: Penguin, f.148.
[809] D.J., Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool. (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy and Synonym Comprehension. Zeitschrift fur Psychologie, f. 138.
[810] C. Paradis, C. Willners (2006) What A Corpus-Based Dictionary Tells Us About Antonyms
[811]S. Jones, C. Paradis, M. L. Murphy and C. Willners (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity, f.131.
[812]S. Jones,C. Paradis,M. L.Murphy, C. Willners (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity, f.131.

Lehrer thekson, se "*forca e antonimeve kanonike mund të matet në lidhje me frekuencën reciproke të shoqërimit ndërmjet dy fjalëve, si edhe nga besnikëria e çiftimit*".[813]

Studimet në lidhje me antonimet kanonike nuk janë bazuar vetëm në korpuset gjuhësore por edhe në veprimtaritë metalinguistike. Sipas kësaj të fundit " *përdoruesit e gjuhës janë në gjendje të dallojnë antonimet e 'mira' ose prototipe nga ato 'jo aq të mira' dhe 'të këqija*'".[814] Kjo realizohet përmes intuitës së dëgjuesit.[815] Herrman[816] ishte ai i cili përdori një qasje metalinguistike në studimin e tij, duke i kërkuar informatëve të tij të gjykonin antoniminë e 100 çifteve në një shkallë nga 1 deri te 5. Si rezultat, çifti me vlerësimin më të lartë ishte çifti foljor *maksimize/minimaze* i ndjekur nga çifti emëror "*night/day"* dhe më pas "*good/bad"*. Një qasje tjetër me interes ishte ajo e testeve të shoqërimit të fjalëve përmes intuitës[817]. Në këto teste informatët duhet të thonë apo të shkruajnë fjalën e parë, e cila vjen në mendjen e tyre pas dëgjimit apo leximit të një fjale stimul. Si rezultat, ndërmjet këtyre fjalëve më të shpeshta ishin çiftet e tipit "*inside/outside"*, "*right/wrong", etj*.

Por, siç shihet edhe më lart, modelet e mësipërme të eksperimenteve metalinguistike, nuk arrijnë të vlerësojnë, se si gjuha përdoret por vetëm atë që informantët reflektojnë, përsa i përket kuptimeve të fjalëve të dhëna dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre . Nga ana tjetër, studimet me bazë korpusi vlerësojnë antonimet në përdorimin natyral të gjuhës dhe shumica e tyre janë bazuar tek bashkërënditja si një tregues kyç për antonimet kanonike.[818] Nga të tilla studime rezulton,*se antonime të drejtëpërdrejta bashkërënditen tre deri ne dymbëdhjetë herë më shumë sesa pritet.*[819]Në përgjithësi Jones thekson, se "*antonimet bashkërënditen në fjali 6.6 herë më shumë sesa e lejon mundësia*".[820]

Megjithatë, kriteri i bashkërenditjes nuk mund të jetë i vetmi në dallimin e antonimeve sepse shumë çifte fjalësh bashkërenditen pa qenë të kundërta, p.sh: "*surf/net*", "*climate /change*", etj. Antonimet dallojnë nga të tilla bashkrënditje për faktin, se ato kanë tendencë të gjenden brenda disa strukturave të veçanta leksiko-gramatikore, duke shërbyer në një nga funksionet ligjërimore nëtestet e S. Jones. Edhe kjo qasje, ka kufizimet e saj pasi shumica prej tyre trajtojnë çifte antonimesh, kanonike të njohura duke i krahasuar me çifte që perceptohen si më pak kanonike. Kështu që, ato nuk nuk përbëjnë një mjet për të zbuluar çifte antonimesh, por thjesht një mënyrë për të konfirmuar intuitat ekzistuese në lidhje me marrëdhëniet antonimike.[821]

Si përfundim, themi, se mënyrat se si njerëzit e përdorin dhe ndërveprojnë me antoimet tregojnë, se ndërkohë që kundërvënia është e dukshme nga ana psikologjike,

[813]A. Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity, cituar nga Cruse, D.A., F. Hundsnurcher, M. Job and P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology, Berlin: de Gruyter, f.498-508.
[814] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Cambridge: Cambdge University Press, f.11.
[815] V. Muehleisen (1997) Antonymy and Semantic Range in English, (Ph.D dissertation), University of Illinois. f.
[816] D.J Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool. (1986) The Role of Elements Of Relation Definition in Antonymy And Synonym Comprehension. Zeitschrift fur Psychologie, f. 133-53.
[817] H. H. Clark (1970) Word Associations And LinguisticTheories, cituar nga J. Lyons (ed.) New Horizons in Linguistics, Baltimore: Penguin, f. 271–86.
[818]C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f .78.
[819]C. Willners (2001) Antonyms in Context. Lund: Lund University, f .78.
[820]S. Jones (2002) Antonymy: A Corpus-Based Perspective. London: Routledge, f. 115.
[821]C. Paradis (2004) Where Does Metonymy Stop? Senses, Facets and Active Zones. Metaphor and Symbol, f.254.

disa marrëdhënie semantike si ato kundërshtuese dhe plotësuese nuk dallohen qartë nga përdoruesit e gjuhës. Kjo është e dukshme edhe në eksperimentet psikolinguistike si edhe në përdorimin e gjuhës, ku kategoritë e antonimeve janë të papërshtatëshme me funksionet e tyre në ligjërim. Kështu, teoria e Murphy e *Marrëdhënies Përmes Kundërshtisë,*[822]ofron një mënyrë për të identifikuar antonimet pa e specifikuar se si fjalët kundërvihen. Sipas tij, *çdo strukturë fjalësh (çift, grup) mund të kundërvihet, nëse ekziston një kontekst i mjaftueshëm*.[823] Fakti që fjalët dallojnë në tiparet e tyre semantike, tregon se kategori të ndryshme fjalësh kundërvihen në mënyra të ndryshme. Kjo sjell si rezultat edhe tipe të ndryshme të antonimisë.

Metodologjia e përdorur nga Jones, Paradis, Murphy dhe Willners[824]

Studimi i Jones, Paradis, Murphy dhe Willners është një qasje e kombinimit të dy metodave të mësipërme duke shmangur disa problem që lidhen me to.

Ata përdorin metodën e vjeljes së fjalëve nga një korpus i gjuhës në përdorim. Kjo realizohet përmes një procesi me tre veprime:

1. identifikohen strukturat gramatikore apo kornizat, brenda të cilave çiftet e antonimeve bashkërenditen më shpesh.

2. gjetja e atyre kornizave të cilat përmbajnë një "bërthamë mbiemërore" në pozicionin X ose Y ("*X and *alike*""si X edhe *"*, "*thin and *alike*""si i trashë edhe *"*).

3. vlerësohet se cilët mbiemra gjenden më shpesh në pozicionin *(në strukturën e mësipërme rezultojne mbiemra të tillë, si "*thick"(i trashë), "fat"(i shëndoshë)*, *"heavy"(I rëndë)*dhe *"overweight"(mbipeshë*).

Në këtë mënyrë, përzgjodhën një numërtëcaktuar kornizash tipikepër çiftet antonime, siç janë:*"X and Y alike" (si X edhe Y), "between X and Y" (ndërmjet X dhe Y), "both X and Y" (si X dhe Y), "either X or Y" (ose X ose Y), "from X to Y" (nga X tek Y), "X versus" Y (X përballë Y), "whether X or Y" (ose X ose Y).* Këto skema pasqyrojnë një sërë funksionesh ligjërimore të përcaktuara nga Jones, siç janë ai i tipit *funksional, i koordinuar, konfliktual, i shumëanshëm*, *kalimtar* apo *tranzitiv*.[825] Për studimin, u zgjodhën ato skema apo struktura, të cilat ishin katër ose më pak fjalëshe. Testet pilote u zhvilluan me 11 struktura 4 fjalëshe. Rezultoi, se skemat më produktive lidheshin me kategorinë funksionale të *antonimeve të koordinuara,* si psh.:

X and Y alike
(si X edhe Y)

X as well as Y
(X ashtu si edhe Y)

[822] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press
[823] M.L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.124.
[824]S. Jones,C. Paradis,M. L. Murphy, C. Willners (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity
[825]C. Paradis (2004) Where Does Metonymy Stop? Senses, Facets and Active Zones. Metaphor and Symbol, f.254.

both X and Y
(si X dhe Y)

either X or Y
(ose X ose Y)

neither X nor Y
(as X as Y)

whether X or Y
(ose X ose Y)

Numri i këtyre skemave u reduktua në katër, (duke përjashyuar dy skema siç janë: *"neither X nor Y", "as X as Y" dhe "X as well as Y", "X ashtu si edhe Y"*) dhe u shtuan edhe 3 të tjera:

from X to Y
(nga X në Y)

between X and Y
(ndërmjet X dhe Y)

X versus Y
(X përball Y)

Duke e vendosur mbiemrin (*) në pozicionin fillestar(të gjymtyrës së parë) apo të dytë mbiemërore, në shtatë kornizat e mësipërme, rezulton një total prej 14 strukturash apo kornizash të tilla, në studim:

*** NË POZICION TË GJYMTYRËS SË PARË**	***NË POZICION TË GJYMTYRËS SË DYTË**	**TIPI FUNKSIONAL**
* and adj alike *si * dhe mbiemri*	adj and * alike *si mbiemri dhe **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
between * and adj *ndërmjet * dhe mbiemri*	between aj and * *ndërmjet mbiemër dhe **	VARIOUS *i ndryshëm*
both * and adj *si * dhe mbiemri*	both adj and * *si mbiemri edhe **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
either * or adj *ose * ose mbiemri*	either adj or * *as mbiemër as **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*
from * to adj *nga * tek mbiemri*	from adj to * *nga mbiemër në **	TRANSITION/CO-ORDINATED *kalimtare/ e koordinuar*
* versus adj ** përballë mbiemri*	adj versus * *mbiemër përballë **	CONFLICT *konflik*
whether * or adj *ose * ose mbiemër*	whether adj or * *ose mbiemër ose **	CO-ORDINATED *tip i koordinuar*

Tabela 2 Strukturat (kornizat) dhe tipi funksional

Mbiemrat e zgjedhur si fjalë bërthamë

Mbiemrat e listuar si fjalë bërthamë në kornizat e mësipërme janë mbledhur nga studimi bazuar tek stimuli dhe përgjigja përmes metodës së vjeljes së informacionit, nga Paradis.[826]Përgjigjet e tyre ishin kriteri i radhitjes së mbiemrave nga numri më i ulët deri te ai më i lartë i antonimeve të vjelura. Kështu, ato fjalë të cilat morën si përgjigje të njëjtin antonim nga të 50 informantët shihen si antonime të përsosura, si p.sh., "*clean/dirty"(i pastër/i pisët).* Për studimin u përzgjodhën 10 mbiemrat e parë në listën e C. Paradis.

Përzgjedhja e korpusit

Në këtë studim fillimisht u përzgjodhën 10 çiftet mbiemërore, të cilat rezultuan nga Paradis, si në tabelën e mëposhtëshme:

[826] C. Paradis, C. Willners (2006) Antonymy and Negation: The Boundedness Hypothesis

FJALA STIMUL	FJALËT PËRGJIGJE
Beautiful	Ugly (50)
Poor	Rich(50)
Open	Closed(40)
Large	Small(48)
Rapid	Slow(47)
Exciting	Boring(36)
Strong	Weak(47)
Wide	Narrow(45)
Thin	Fat(35)
Dull	Bright(28)

Tabela 3 Çiftet mbiemërore

Më pas u mendua, se ishte e nevojshme një korpus më i gjërë fjalësh dhe u përzgjodh *World Wide Web.*

Rezultate dhe analiza

Interes të veçantë përbën analiza e mbiemrit "*dull"*, e cila në total rezultoi të gjendej në 2760 kontekste brenda korpusit. Nga bashkërenditja në këto kontekste e mbiemrit "*dull"* me gjegjësit e saj antonime, u dalluan 10 antonimet me frekuencë më të lartë, si në tabelën e mëposhtshme:

Rendi	Mbiemri	Frekuenca	Kornizat
1	Bright	103	11
2	Dynamic	83	3
3	Sharp	73	8
4	Dazzling	60	2
5	Shiny	50	8
6	Boring	28	4
7	Brilliant	22	5
8	Delightful	21	1
9	Exciting	19	6
10	Interesting	19	6

Tabela 4 Antonimet me frekuencë më të lartë në bashkërenditje

Nga 10 mbiemrat e listuara më sipër, vetëm 9 prej tyre mund të shihen si të kundërta semantike. Përjashtim përbën mbiemri "*boring",* i cili edhe pse del në një frekuencë të lartë brenda këtyre kornizave nuk qendron në lidhje kundërvënieje me mbiemrin "*dull"*por mund të shihet si një kandidate e mirë për marrëdhënie sinonimie. Ky fakt mund të vërë në diskutim karakterin kundërvënës të skemave të përdorura në studim, megjithatë çdo kornizë apo strukturë e përdorur, sidomos ato me funksion koordinues, mund të shoqërohen me më shumë se një kuptim. Si rezultat vërejmë, se jo gjithmonë ato kanë karakter kundërnënieje. Megjithatë, përdorimi i tyre në kuptime të tjera është më i rrallë prandaj edhe*"dull"* bashkërënditet me "*boring"* në formë jo kundërvënëse vetëm në 4 prej 14 kornizave në studim.

Më poshtë, do të paraqesim listën e plotë të çifteve antonime kanonike të identifikuara në këtë studim:

DIMENSIONI/BOSHTI	**ÇIFTET KANONIKE**

BEAUTY	*beautiful/ugly*
WEALTH	*poor/rich, poor/wealthy*
OPENNESS	*closed/open, laparoscopic/open*
SIZE	*large/small, big/small, big/little*
SPEED	*fast/slow*
INTERESTINGNESS	*(nuk u identifikua asnjë çift)*
STRENGTH	*strong/weak*
WIDTH	*narrow/wide, broad/narrow*
THICKNESS/ FATNESS	*thick/thin, fat/thin, fat/skinny, fat/lean*
LUMINOSITY	*bright/dull, bright/dim, bright/dark*

Tabela 5 Çiftet antonime kanonike

Studiuesit[827] argumentojmë se përsëritja e bashkërenditur e tyre brenda një pjesë të madhe kornizash antonimike bën, që "*laparoscopic/open*"(*laparoskopike/e hapur*) të jenë shumë të mundëshme për të formuar një çift kanonik, edhe pse intuita e shumicës së folësve të gjuhës angleze nuk ka shumë gjasa ta parashikojë këtë.

Në përgjithësi mendohet, sesa më shumë i njohur të jetë çifti i antonimeve, aq më shpesh do të ndeshet. Megjithatë, antonimet veprojnë edhe në kontekste më të kufizuara (të tilla, si "*laparoscopic/open"* (*laparoskopike/e hapur*), ose shembulli i përdorur nga Murphy,[828]"*derivational/inflectional" (e derivuar, e prejardhur/e lakuar),* mund të jenë më të fortë në aspektin e kundërvënies të tyre, edhe pse ato janë pak të njohur nga folësit amëtar të gjuhës angleze.

Po të krahasojmë rezultatet e arritura për mbiemrin bërthamë "*bright*" përmes metodës së "vjeljes" së informacionit, dhe studimit të përdorimit tekstual, do të kemi rezultatet e mëposhtëme:

[827] S. Jones, C. Paradis, M. L. Murphy dhe C. Willners
[828] M. L. Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon. Cambridge: Cambridge University Press, f.178.

Antonimet intuitive për "bright"	**Antonimet tekstuale për "*bright*"**
1. dark (42 %)	1. dark (27 %)
2. dull (28 %)	2. dim (8 %)
3. dim (14 %)	3. dull (3 %)
të tjera (16 %)	të tjera (62 %)

Tabela 6 Krahasimi i antonimeve kontekstuale dhe intuitive për mbiemrin "bright"

Tre atonimet kanonike e mbiemrit *"bright" (i shëndritshëm)*, të identifikuar në këtë studim, janë të njëjta si tre "të kundërtat" që renditen më lartë në eksperimentin e bazuar tek ""vjelja"" përmes intuitës.

Boshti i përmasës përbën një çështje me interes të veçantë. Që nga studime të mëparëshmë, si përshembull ai i Justeson dhe Katz (1991), dallohet tendenca dhe instikti i folësve të gjuhës angleze për të çiftuar "*large / little", "big/ small"* (por jo "*big / little"*).

Studimi i S. Jones, C. Paradis, M. L. Murphy dhe C. Willners[829] tregon, se marrëdhëniet ndërmjet mbiemrave kyç në shkallën e përmasës janë komplekse dhe asimetrike. Për shembull, edhe pse antonimi i preferuar për "*little"* është "*big"*, ky favorizim nuk është reciprok, sepse "*big"* ka si të preferuar gjegjësen*"small"* dhe jo "*little"*. Për më tepër, studimi tregon se ashtu sikurse "*little"* nuk është antonim i preferuar për "*big"*(i cili kërkon më së shumti "*small"* si antonim), në mënyrë të ngjashme,*"big"* nuk është i preferuar për "*small"* pasi "*small*" preferon "*little"*. Kjo preferencë është reciproke, dhe për këtë arsye konsiderohet të jetë çifti më kanonik i boshtit.

Nëse do të ndalemi tek përqasja me gjuhën shqipe, këtu mund të vërejmë se në gjuhën shqipe këto dallime nuk ekzistojnë për vetë faktin se për mbiemrat "*big*" dhe "*large*" dhe "*small*" dhe "*little*" në gjuhën shqipe kemi vetëm një njësi leksikore, përkatësisht "*i madh*" dhe "*i vogël*". Këto rezultate theksojnë rëndësinë e reciprocitetit të antonimeve kanonike. Dy çiftet brenda shkallës *("big/little"* dhe "*large/small"*) konsiderohen *paralele leksikore,*[830] dhe më të pajtueshmet në bashkërenditje janë dy çifte, të cilat tërheqin njëri-tjetrin në normat më të afërta. Rezultatet, gjithashtu, konfirmojnë se testet e bazuara në vjeljen përmes intuitës nuk janë gjithmonë pasqyrim i saktë i përdorimit të antonimeve.

Për shembull, kur një informati i kërkohet të paraqesë 'të kundërtën' më të mirë të mbiemrit "*small"*, 68% e informatorëve sugjeruan "*big"* (dhe 30 % sugjeruan "*large"*). Megjithatë, në studimin në fjalë, "*small"* kërkon "*big"* në më pak se 9 % të konteksteve (dhe "*large"* në mbi 53 %).

[829] S. Jones,C. Paradis,M. L. Murphy, C. Willners (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity

[830]J. S. Justeson, S.M. Katz (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts,Computational Linguistics, f. 1-19.

Një dimension semantik që prodhoi rezultate të papritura ishte ai "*i bukurisë"*. Mbiemri *"ugly"* gjeneroi një grup mbiemrash antonime, ku mbiemra të tillë si "*beautiful"*, "*pretty"*, "*cute"* dhe "*handsome"* u rradhitën në majë të listës me 10 mbiemra.

Për sa i përket mbiemrit "*beautiful*", rezultatet e mëposhtëme tregojnë, se cilët janë antonimet më të mundëshme:

ANTONIMI PËR FJALËN "BEAUTIFUL"	**FREKUENCA**	**KORNIZAT**
UGLY	374	14
FUNCTIONAL	82	3
USEFUL	62	5
PRACTICAL	44	4
BIZARRE	35	5
DURABLE	32	2
HIDEOUS	19	7
PLAIN	18	3

Tabela 7 Mbiemrat e gjetur më shpesh në bashkërenditje me "beautiful"

Siç vihet re, ndërmjet mbiemrave më të zakonshëm në bashkërenditje dalin jo vetëm ato që lidhen me tërheqjen fizike, bukurinë ("*plain", "hideous"*), por edhe ato me kuptime të tjera. Disa prejt tyre si "*functional", "practical"* dhe *"durable"* nuk njihen si antonime nga fjalorët, (ashtu sikurse në rastin e "*dull"* dhe "*boring"*) por në bazë të rezultateve të studimit sugjerohet që ato të përfshihen këtej e tutje në listën e antonimeve.

Për më shumë, vlen të përmëndetnjë studimshumë interesanti bazuar në korpusiS. Jones dhe M.L. Murphy për sa i përket antonimeve te fëmijët. Qëllimi i këtij studimi ishte përvetësimi i gjuhës dhe antonimeve tek fëmijët. Ky studim përqendrohet në vëzhgimin e gjuhës së fëmijëvë nga dy deri në pesëvjeç në mënyrë të tillë që të kuptohet se kur dhe se si fëmijët përvetësojnë përdorimin e antonimeve në ligjërim të ngjashëm me atë të të rriturve. Edhe në këtë studim, merren si bazë funksionet e antonimisë të përcaktuara nga Jones. Nga kjo qasje ndaj antonimeve rezulton, se përdorimi i antonimeve nga fëmijët edhe pindërit nuk ndryshojnë shumë në lidhje me dy kategoritë tipike, siç janë ato të funksionit ndihmës, dhe të koordinuar. Gjithashtu, nga rezultatet duket qartë se dallimet në përdoriminin e antonimeve në gjuhën e prindërve dhe të fëmijëve dallohen në kategoritë më të vogla siç janë edhe antonimet e mohuara, si edhe kategoria e antonimeve pyetësore. Më poshtë, po japim disa nga rezultatet statistikore të këtij studimi:

Mosha e fëmijës	**Antonimi Ndihmëse**	**Antonimi e koordinuar**	**Antonimi kalimtare**	**Antonimi e mohuar**	**Përdorim tjetër**	**Totali i thënieve/fjalive**
2	22	13	3	13	2	54
3	62	26	9	16	12	125
4	28	15	13	0	6	62
Total	112	54	25	29	21	241

Tabela 8 Shpërndarja e antonimeve në gjuhën e fëmijëve

Mosha e fëmijës	**Antonimi Ndihmëse**	**Antonimi e koordinuar**	**Antonimi kalimtare**	**Antonimi e mohuar**	**Përdorim tjetër**	**Totali i thënieve/fjalive**	**Mosha e fëmijës**
2	24	9	4	6	1	5	49
3	25	13	12	9	4	8	71
4	6	4	6	2	3	0	21
Total	55	26	22	17	8	13	141

Tabela 9 Shpërndarja e antonimeve në gjuhën e të rriturve duke iu drejtuar fëmijëve

Në një tjetër studim mbi antoniminë, siç është edhe ai i Sh.Delisë, theksi vihettek perceptimi vizual i antonimeve tek nxënësit e vegjël parashkollor dhe të arsimit fillor. Deliaj thekson, se "*me qëllim që të përfeksionojmë përceptimin tonë vizual për antonimet,na duhet që të krijojmë një përfytyrim mendor të tyre*".[831]

Në këtë studim jepen disa shembuj se si mund të arrihet përfytyrimi mendor:

a) po të shikojmë fjalën " hairy" në një skedë, në përfytyrimin tonë mendor do të shfaqen dy fjalët e çiftit antonimik HAIRY dhe BOLD.

b) skeda e dytë ka fjalën "thin" dhe ne përfytyrojmë mendërisht fjalët e çftit antonimik THIN dhe FAT.

c) më pas, themi "strong" dhe përftojmë dy përbërës STRONG dhe WEEK.

[831] Sh. Delija (2008) Çështje të Antonimisë të Gjuhës Angleze Vështruar në Përasje me Gjuhën Shqipe, Dizertacion

Gjatë këtij ushtrimi sugjerohet që të mos japim gjykime dhe shpjegime për fjalët, por t'i lejojmë nxënësit tuaj të mendojnë vetë që të gjejnë gjegjëset e tyre.

d) po të japim togfjalëshin "*green light*" kur i referohemi dritave të trafikut, atëherë përfytyrimi mendor do të jetë për GREEN LIGHT, AMBER apo YELLOW dhe RED LIGHT.

Përfytyrimi mendor, na vjen në formë vertikale, ashtu si i kemi parë në trafik. Nëse do ta shkëpusim fjalën "*light*" nga togfjalëshi, atëherë përfytyrimi mendor sjell menjëherë fjalën "*yellow*" ose "*red*".

e) po të kemi togun "*30- year old man*" atëherë përfytyrimi do të jetë BABY apo OLD MAN.

f)

Këto lloj ushtrimesh mund të vazhdojnë pambarimisht edhe në nivele më të larta të mësimit të gjuhës së huaj, por duke rritur shkallën e vështirësisë.

Pas analizave të mësipërme, dhe familjarizimit me tipat kryesorë të studimeve në fushën e antonimisë, në vazhdim, do të analizojmë çështje që lidhen me studimet tona praktike.

5.2. Studimet tona të antonimeve përmes korpusit dhe eksperimenteve gjuhësore

5.2.1. Parashtesat e gjuhës angleze dhe shqipe në fjalorët një dhe dygjuhësh

Në këtë pjesë praktike të punimittonëmbi çështjet e antonimeve e gjuhës shqipe dhe asaj angleze, jemi përqendruar në mbledhjen e informacionit shifror të shpesësisë apo frekuencës, me të cilën parashtesat fjalëfomuese antonime dalin në fjalorët një dhe dygjuhësh.

Objekti

Objekti kryesor është të dallohet frekuenca e secilës parashtesë antonimike në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe të dallojmë cilat janë parashtesat më të shpeshta në secilën gjuhë.

Metodologjia

Ne përdorëm metodën e vjeljes së të dhënave nga korpusi i fjalorëve një dhe dygjuhësh të gjuhës angleze dhe shqipe. Numërimi u bë për çdo parashtesë duke u përqendruar në tre aspekte statistikore:

-numri total i fjalëve me një parashtesë të caktuar

- numri total i mbiemrave për atë parashtesë

- numri total i foljeve për atë parashtesë

- numri total i parashtesave antonimike fjalëformuese për çdo korpus, fjalor

- krahasime dhe analiza.

Përzgjedhja e korpusit

Përzgjedhja e korpusit u bë duke caktuar katër fjalorë të ndryshëm një dhe dygjuhësh, siç janë:Fjalori Shqip-Shqip i vitit 2006 me 30.700 fjalë,Fjalori Shqip-Anglisht i Pavli Qeskut me45.500 fjalë, FjaloriAnglisht-Shqip i Ilo Stefanllarit (1986) me 30.000 fjalë, si edhe Fjalori Anglisht-Anglisht *Oxford Dictionary* me171,476 fjalë.

Rezultatet

Rezultatet e arritura do të paraqiten në tabelat përmbledhëse, si më poshtë:

Parashtesa **në Fjalorin Shqip-Anglisht**	**Frekuenca e mbiemrave**	**Frekuenca e foljeve**
a-	4	-
anti-	13	-
ç-	53	57
de-	12	4
dis-	1	1
dez-	2	1
i-	2	-
ir-	1	-
jo-	31	-
kundër-	17	11
mos-	5	-
nën-	7	3
pa-	407	-
sh-	157	189
z-	3	6
zh-	46	58

Tabela 10 Frekuenca në fjalorin shqip -anglisht[832]

[832] Fjalor Shqip-Anglisht, Pavli Qesku, 45.000 fjalë, EDFA 2002



Grafiku 1



Grafiku 2



Grafiku 3

Nga puna me fjalorin e mësipërm u vu re se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa "**pa-**", me 407 njësi mbiemërore, e cila pasohet nga parashtesa "**sh-**" me 157 njësi mbiemërore dhe 189 njësi foljore. Në vazhdimësi të renditjes vërejmë parashtesën "**ç-**" me 53 njësi mbiemërore dhe 58 njësi foljore. Pothuajse po aq të shpeshtë janë edhe njësitë mbiemërore antonimike të formuara me parashtesën "**zh-**", të cilat rezultojnë me një total prej 46 njësish dhe ato foljore dalin me një total prej 58 njësish. Edhe parashtesa "**jo-**", ka një total të konsiderueshëm prej 31 mbiemrash, por nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë "**a-**", "**dis-**", "**dez-**", "**i-**" dhe "**ir-**", të cilat gjenden në sasi minimale,që variojnë nga 0-4 njësi.

Për më shumë, nga grafiku 3 vërejmë se raporti i përgjithshëm ndërmjet foljeve dhe mbiemrave nëfjalorin Shqip-Anglisht është e diferencuar. Është mëse e dukshme se mbiemrat qendrojnë në një sasi të konsiderueshme më lart sesa foljet antonime të formuara me parashtesim në këtë fjalor. Pra, themi se parashtesimi antonimik është më prodhimtar, për klasën e mbiemrave sesa për atë të foljeve, në fjalorin dygjuhësh Shqip-Anglisht.

Parashtesa **në Fjalorin Shqip-Shqip**	**Frekuenca e mbiemrave**	**Frekuenca e foljeve**
a-	4	-
anti-	13	-
ç-	58	60
de-	14	6
dis-	1	1
dez-	2	1
i-	2	-
ir-	1	-
jo-	34	-
kundër-	20	13
mos-	6	-
nën-	8	3
pa-	414	-
sh-	223	271
z-	3	7
Zh	58	69

Tabela 11 Frekuenca në Fjalorin Shqip-Shqip[833]

[833] Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë (2006) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë



Grafiku 4



Grafiku 5



Grafiku 6

Nga puna me fjalorin e mësipërm u vu re, se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa ***"pa-"*** me 414 njësi mbiemërore, e cila pasohet nga parashtesa ***"sh-"*** me 162 njësi mbiemërore dhe 197 njësi foljore. Në vazhdimsi të renditjes, vërejmë parashtesën "**ç-**" me 58 njësi mbiemërore dhe 60 njësi foljore. Pothuajse po aq të shpeshtë janë edhe njësitë mbiemërore antonimike të formuara me parashtesën ***"zh-",*** të cilat rezultojnë me një total prej 51 njësish.Antonimet foljore me parashtesën ***"zh-",*** dalin me një total prej 69 njësish. Edhe parashtesa "**jo-**" ka një total të konsiderueshëm prej 34 mbiemrash por nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë ***"a-", "dis-", "dez-", "i-"*** dhe ***"ir-"*** të cilat gjenden në sasi minimale, që variojnënga 0-4 njësi.

Nga grafiku 6, edhe këtu njësoj si në grafikun 3, vërejmë se raporti i përgjithshëm ndërmjet foljeve dhe mbiemrave nëfjalorin Shqip-Shqip është i ndryshëm. Është mëse e dukshme, se mbiemrat qendrojnë në një sasi të konsiderueshme më lart sesa foljet antonime të formuara me parashtesim në këtë fjalor. Pra, themi se parashtesimi antonimik është më prodhimtar për klasën e mbiemrave, sesa për atë të foljeve në fjalorin njëgjuhësh Shqip-Shqip.

Më poshtë, po paraqesim një listë të zgjeruar, por jo të plotë, të disa prej antonimeve mbiemërore dhe foljore shqipe, vjelur gjatë kërkimit:

afetár,-e mb.
analfabét,-e mb.
antiajrór,-e mb.
antidemokratík,-e mb.
antifashíst,-e mb
antifetár,-e mb. kundërfetar
antifeudál,-e mb.
antihistorík,-e mb.
antikombëtár,-e mb.
antikontrabánd, mb.
antikushtetúes,-e mb.
antiligjór,-e mb
antipopullór,-e mb.
antishkencór,-e mb.
antishoqërór,-e mb
apolitík,-e mb.
asimetrík,-e mb.
çakord/ój kal.
çanës/ój kal.
çarmat/ój kal.
çarmatós kal.

çarmatosur(i, e) mb
çatdhes/ój kal.,
çatdhesúar (i, e)
çeduk/ój kal.
çedukúar (i, e) mb.
çekuilibr/ój kal.
çekuilibróhem vetv.
çekuilibrúar (i, e) mb.
çembrioniz/ój kal
çembrionizúar (i, e) mb.
çéndur (i, e) mb.
çënjt kal.
çhundorëz/óhet
çhundorëzúar
çideologjiz/ój kal.
çintegr/ój kal.
çintegrúar (i, e) mb.
çinteres/óhem vetv
çinteresúar (i, e) mb.
çlëvozhg/ój kal
çlëvozhgúar (i, e) mb.
çlídhur (i, e) mb.
çlir/ój kal.,
çlirúar (i, e) mb.
çlódh kal.
çlódhur
çlyrës/ój kal.
çlyrós kal.,
çlyrósj/e,-a f. çlyrësim
çmagnetiz/ój
çmagnetizúar (i, e) mb.
çmagjéps kal.
çmagjépsur (i, e) mb.
çmall kal.,
çmat (çmas) kal.,
çmaterializ/óhet vetv.
çmaterializúar (i, e) mb.
çmbledh kal
çmbështjéllë (i, e) mb.
çmbledh kal.,
çmblédhur (i, e) mb.
çmbreh kal.,
çmbush kal.,
çmbúshur (i, e) mb.
çmërzít (çmërzís) kal.,
çmës/óhem vetv
çmësúar (i, e) mb.
çmësýshur (i, e) mb.
çmilitariz/ój kal.
çmilitarizúar (i, e) mb.
çminúar (i, e) mb.
çmiqës/ój kal.,
çmobiliz/ój kal
çmobilizúar (i, e) mb
çmobilizúes,-e mb.
çmont/ój kal.,
çmontúar (i, e) mb.
çmorrít (çmorrís) kal.
çmpi/j ka
çmpírë (i, e) mb.
çmpreh kal.,
çmpréhur (i, e) mb
çnatyr/ój kal
çnatyrúar (i, e) mb.
çmundúar (i, e) mb.
çnder/ój kal
çndéruar (i, e) mb.
çndérsh/ërm (i), -me (e) mb.
çndot kal
çndótur (i, e) mb.
çndrýshkur (i, e) mb.
çngul kal.,
çngúlur (i, e) mb.
çngjit kal.,
çngjyr/ój kal
çngjyrós kal.,
çngjyrósur (i, e) mb.
çnjerëz/ój kal.,
çnjerëzúar (i, e) mb.
çnjoh kal.,
çnjóhur (i, e) mb.
çoksid/ój kal.,
çoksidúar (i, e) mb.
çoksidúes,-e mb
çorganiz/ój kal
çorganizúar (i, e) mb.
çorganizúes,-e mb.,
çorient/ój kal., -óva
çorientúar (i, e) mb.
çorientúes,-e mb.
çoroditur (i, e) mb.
çorodítës,-e mb
çradhít (çradhís) kal.
çregjistr/ój kal.,
çrras kal.,
çrrásur (i, e) mb.
çrregull/ój
çrregullúar (i, e) mb.
çrrégullt (i, e) mb.
çrregullúes,-e mb.

çrreth/ój kal.
çrrënjós kal.
çrrotullój kal.,
çrrudh kal.,
decentralizúes,-e mb.
deduktív,-e mb
deform/ój kal.,
deformúar (i, e) mb.
deformúes,-e mb.
degaz/ój kal.,
degazúar (i, e) mb.
degazúes,-e mb.,
degrad/ój kal.
dekompozúar (i, e) mb.
dekuraj/ój kal.,
dekurajúar (i, e) mb.
dekurajúes,-e mb.
deliberatív,-e mb.
demask/ój kal
demaskúes,-e mb.
demaskúar (i, e) mb.
demaskúes,-e mb
demoraliz/ój kal., -óva,
demoralizúar (i, e) mb.
demoralizúes,-e mb.
destabiliz/ój kal.
destabilizúar (i, e) mb.
destabilizúes,-e mb.
dezinfekt/ój kal.
dezinfektúar (i, e) mb.
dezinfektúes,-e mb.
disimil/ój kal.
disimilúar
ilegál,-e mb.,
imorál,-e mb.,
irracionál,-e mb.
irredentíst,-i m. sh. -ë(t),
irredentíz/ëm,-mi
joalkoolík,-e mb.
joantagoníst,-e mb.
jodemokratík,-e mb.
jodetyrúes,-e mb.
jodialektík,-e mb.
joekonomík,-e mb.
jofetár,-e mb.
jofrutór,-e mb.
jofrymór,-e mb.
johelmúes,-e mb.
johigjieník,-e mb.
johistorík,-e mb.
johundór,-e mb.
jokalimtáre mb.
jokapitalíst,-e mb.
jokërbishtór,-e mb.
jokombëtár,-e mb.
jokryesór,-e mb.
jolargpámës,-e mb.
jolëndór,-e mb.
jomikprítës,-e mb.
jomiqësór,-e mb.
jonormál,-e mb.
jonjerëzór,-e mb.
joorganík,-e$_{I}$ mb.
joorganík,-e$_{II}$ mb.
jopaqësór,-e mb.
joparimór,-e mb.
jopartiák,-e mb.
jopërçúes,-e mb.
jopërparimtár,-e
jopjellór,-e mb.
joprodhimtár,-e mb.
joprodhúes,-e mb.
joreál,-e mb.
jorealíst,-e mb.
joserióz,-e mb.
joshkencór,-e
joshoqërór,-e mb.
joshqúes,-e mb.
joshterúes,-e mb.
jotokësór,-e mb.
jovendimtár,-e mb.
jovetór,-e mb. gjuh.
jozyrtár,-e mb.
kundërajrór,-e mb
kundërfetár,-e mb.
kundërgod/ás
kundërgodítës,-e mb
kundërkimík,-e mb.
kundërligjór,-e mb
kundërmësýmës,-e mb.
kundërnjerëzór,-e mb.
kundërpesh/ój kal
kundërpërgjí gj/em vetv
kundërrevolucionár,-i m.
kundërsulm/ój kal.,
kundërshtetërór,-e mb.
kundërsht/ój kal.,
kundërshtúesh/ëm (i), -me (e) mb.
kúndërt (i, e) mb.
kundërthënës,-e mb.

kundërvepr/ój jokal., -óva,
kundërveprúes,-e mb.,
kundër/vë kal.
kundërvíhem vetv.
kundërzbul/ój kal.,
kundërshtúes,-e mb.,
kundërshtór,-e mb.
kundërshtár,-i m.
kundërlígjsh/ëm (i), -me (e) mb
kundërmësý/j kal.,
kundërm/ój jokal. dhe kal.,
kundërmúes,-e mb
moskokëçárës,-e mb.
mosmëharró mb.
mosmëprék (mosprék) mb.
mosmirënjóhës,-e mb
mosveprúes,-e mb. ospërfíllës,-e mb
mospërfíllës,-e mb.
nënçm/ój kal
nënçmúes,-e mb
nëndetár,-e mb.
nëntokësór,-e mb
nënújës,-e mb.
nënujór,-e mb.
nënújsh/ëm (i), -me (e)
nënvleftës/ój kal.,
nënvleftësúar (i, e) mb. i nënvlerësuar.
nënvleftësues,-e mb.
nënvlerës/ój kal
paafrúar (i, e) mb
paáftë (i, e) mb
paájër (i, e) mb
paánë (i, e) mb.
paangazhúar (i, e) mb
paánsh/ëm (i), -me (e) mb
paapelúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paárdhur (i, e) mb
paarmatósur (i, e) mb.
paarsimúar (i, e) mb.
paarsýesh/ëm (i), -me (e) mb.
paarrírë (i, e) mb
paarrítsh/ëm (i), -me (e) mb
paarrítur (i, e) mb.
paasfaltúar (i, e) mb
paasgjësúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paasimilúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paatdhé (i, e) mb.
pababá (i, e) mb.
pabanúar (i, e) mb
pabanúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pabarabártë (i, e) mb.,
pabésë (i, e) mb.
pabesím (i, e) mb
pabesúesh/ëm (i), -me (e) mb
pabërë (i, e) mb..
pabinár (i, e) mb.
pabíndur (i, e) mb
pabíndsh/ëm (i), -me (e) mb
pabísht (i, e) mb.
pabotúar (i, e) mb.
pabotúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pabrédhur (i, e) mb
pabréngë (i, e) mb.
pabrúmë (i, e) mb
pabrumósur (i, e) mb.
pabújë (i, e) mb
pabújsh/ëm (i), -me (e) mb.
pabúkë (i, e) mb.
pabúksh/ëm (i), -me (e) mb. 1
pabúkur (i, e) mb.
pabulmét (i, e) mb.
pabulmétsh/ëm (i), -me (e) mb.
pabúrrë (i, e) mb
paburrërí (i, e) paburrní (i, e)] mb.
pacák (i, e) mb.
pacaktúar (i, e) mb.
pacén (i, e) mb
pacenúar (i, e) mb.
pacípë (i, e) mb.
pacivilizúar (i, e) mb.
paçélur (i, e) mb.
paçmúar (i, e) mb.
paçmúesh/ëm (i), -me (e) mb.
padálë (i, e) mb
padeklarúar (i, e) mb..
padénjë (i, e) mb.
padérë (i, e) mb
padëgjúar (i, e) mb.
padëm (i, e) mb
padëmsh/ëm (i), -me (e) mb..
padëmtúar (i, e) mb.
padëshirúesh/ëm (i), -me (e) mb.
padëshmúar (i, e) mb.
padíje (i, e) mb. i
padíjsh/ëm (i), -me (e) mb
padisiplinúar (i, e) mb.
padiskutúesh/ëm (i), -me (e) mb
padjallëzí (i, e)
padjallëzúar (i, e) mb.
padobí (i, e) mb

padórë (i, e) mb.
padórës (i, e) mb.,
padrédhur (i, e) mb.
padréjtë (i, e) mb.
padrúajtur (i, e) mb
padúk (i, e) mb.
padúksh/ëm (i), -me (e) mb.
padurím (i, e) mb.
padurúar (i, e) mb.
padyshímtë (i, e) mb
padhémbshur (i, e) mb.
padhëmbë (i, e) mb.
padhjámë (i, e) mb.
padhunúesh/ëm(i), -me (e) mb
paedukátë (i, e) mb.
paedukúar (i, e) mb.
paeféktsh/ëm (i), -me (e) mb
paekuilibrúar (i, e) mb
paelektrifikúar (i, e)
paémër (i, e) mb.,
paépsh/ëm (i), -me (e) mb.
paépur (i, e) mb.
paérë (i, e) Imb.
paérë (i, e) II mb.
paerrësúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pafáj (i, e) mb
pafamílje (i, e) mb.
pafárë (i, e) mb.
pafát (i, e) mb
pafavórsh/ëm (i), -me (e) mb
pafillúar (i, e) mb.
pafísëm (i), -me (e) mb
pafjálë (i, e) mb.
pafjétur (i, e) mb..
pafré (i, e) mb.
pafrenúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pafríksh/ëm (i), -me (e) mb.
pafrút (i, e) mb.
pafrýmë (i, e) mb.
pafrýt (i, e) mb.
pafrýtsh/ëm (i), -me (e) mb.
paftëzúar (i, e) mb
paftúar (i, e) mb.
pafúnd (i, e) mb.
pafúndm/ë (i), -e (e) mb.
pafuqí (i, e) mb. I
pafytýrë (i, e) mb. i pacipë
pagatítur (i, e) mb.
pagójë (i, e) mb.
pagrát (i, e) mb
pagrátsh/ëm (i), -me (e) mb.
pagrúa (i) mb.
pagjásë (i, e) mb.
pagjéthe (i, e) mb.
pagjësh/ëm (i), -me (e) mb.,
pagjínd (i, e) mb
pagjiní (i, e) mb.
pagjúajtur (i, e) mb..
pagjúhë (i, e) mb.
pagjúmë (i, e) mb.
pagjunjëzúar (i, e) mb
pagjunjëzúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pagjykím (i, e) mb.
pagjykúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pahaír (i, e) mb.
pahálë (i, e) mb.
paharrúar (i, e) mb.
paharrúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pahekurósur (i, e) mb.
pahetúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paidentifikúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paimagjinúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pajambájtës,-e mb.,
pajétë (i, e) mb.
pajustifikúesh/ëm (i), -me (e) mb
pakálbur (i, e) mb. jo i kalbur.
pakalítur (i, e) mb.
pakalúes,-e mb.
pakalúesh/ëm (i), -me (e) mb
pakallajísur (i, e) mb.
pakállur (i, e) mb.
pakapërcýesh/ëm (i), -me (e)
pakápsh/ëm (i), -me (e) mb.,
pakaraktér (i, e) mb
paketúes,-e mb.
pakënáqur (i, e) mb.,
pakëpútur (i, e) mb.
• pakësúar (i, e) mb.
pakëshillúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakóhsh/ëm (i), -me (e) mb.
pakúar (i, e) mb.
pakókë (i, e) mb
pakompromís (i, e) mb..
pakonceptúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakondicionúar (i, e) mb.
pakontrollúar (i, e) mb.
pakontrollúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakórë (i, e) mb
pakorrigjúar (i, e) mb.
pakorrigjúesh/ëm (i), -me (e) mb

pakórrur (i, e) mb.
pakrahasím (i, e) mb
pakrahasúesh/ëm (i), -me (e) mb..
pakréhur (i, e) mb.
pakrijúesh/ëm (i), -me (e) mb. libr
pakrípë (i, e) mb
pakrípur (i, e) mb.
pakristalizúar (i, e) mb.
pakritikúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakrýe (i, e) mb.
pakrýer (i, e) mb.
pakrýe (i, e) mb. .
pakrýer (i, e) mb..
pakthýer (i, e) mb.
pakthýesh/ëm (i), -me (e) mb
pakualifikúar (i, e) mb.
pakufí (i, e) mb
pakufish/ëm (i), -me (e) mb.
pakufizúar (i, e) mb
pakufizúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakujdés (i, e) mb.
pakujdéssh/ëm (i), -me (e) mb.
pakujtúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakultúrë (i, e) mb
pakulturúar (i, e) mb.
pakundërshtúesh/ëm (i), -me (e) mb
pamohúesh/ëm (i), -me (e) mb
pakundshóq (i), -e (e) mb
pakuptím (i, e) mb.
pakuptímsh/ëm (i), -me (e) mb..
pakuptúesh/ëm (i), -me (e) mb.
pakurdísur (i, e) mb
pakuréshtje (i, e) mb.
pakurórë (i, e) mb
pakursyer (i, e) mb.
pakushtëzúar (i, e) mb.
pakushtúesh/ëm (i), -me (e) mb.
paláço,-ja m.
palakmí (i, e) mb
palakúar (i, e) mb.
palakúesh/ëm (i), -me (e) mb.
palandýrë (i, e) mb. s
palapét/ë,-a f.
palárë (i, e) mb.
palavdí (i, e) mb
palavdísh/ëm (i), me (e) mb.
palavúar (i, e) mb.
palavós,-e mb.,
palejúesh/ëm (i), -me (e) mb
palegalizúar (i, e) mb.
palésh (i, e) m
pamjekúesh/ëm (i), -me (e) mb
etj.

Parashtesa **në Fjalorin Anglisht-Shqip**	**Frekuenca e mbiemrave**	**Frekuenca e foljeve**
a-/an-	8	-
anti-	20	-
contra-	1	1
counter-	8	10
de-	16	49
dis-	47	66
il-	7	-
im-	41	6
in-	153	3
ir-	21	1
non-	25	-
un-	247	26
under-	7	5

Tabela 12 Frekuenca në Fjalorin Anglish-Shqip[834]

[834] Fjalori Anglisht-Shqip, me 35.000 fjalë,i autorit Ilo Stefanllari, botuar për herë të shtatë në vitin 1997



Grafiku 7



Grafiku 8



Grafiku 9

Nga puna me fjalorin e mësipërm u vu re, se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa ***"un-",*** me 247 njësi mbiemërore dhe 26 foljore, e cila pasohet nga parashtesa ***"in-",*** me 153 njësi mbiemërore dhe 3 njësi foljore. Në vazhdimsi të renditjes, vërejmë parashtesën ***"dis-",*** me 47 njësi mbiemërore dhe 66 njësi foljore. Pothuajse po aq të shpeshtë, janë edhe njësitë mbiemërore antonimike të formuara me parashtesën ***"im-"*** të cilat rezultojnë me një total prej 41 njësish dhe ato foljore dalin me një total prej 6 njësish. Edhe parashtesa ***"non-"***, ka një total të konsiderueshëm prej 25 mbiemrash. Është për t'u përmendur fakti, se nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Gjithashtu, edhe parashtesat e tipit ***"ir-"*** "**anti**-" dhe ***"de-"*** janë me një numër jo fare të vogël dhe me totale të ngjashme. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë ***"under-", "il-", "counter-", "a/an-"*** dhe ***"contra-",*** të cilat gjenden në sasi minimale,që varion nga 8-0 njësi.

Nga grafiku 9, njësoj si në grafikun 3 dhe 6, vërejmë se raporti i përgjithshëm ndërmjet foljeve dhe mbiemrave nëfjalorin Anglisht - Anglisht është i diferencuar. Është mëse e dukshme, se mbiemrat qendrojnë në një sasi të konsiderueshme, më lart sesa foljet antonime të formuara me parashtesim në këtë fjalor. Pra, themi se parashtesimi antonimik është më prodhimtar për klasën e mbiemrave sesa për atë të foljeve, në fjalorin njëgjuhësh Anglisht - Anglisht.

Parashtesa **në Fjalorin Anglisht-Anglisht**	**Frekuenca e mbiemrave**	**Frekuenca e foljeve**
a-/an-	8	-
anti-	22	-
contra-	1	1
counter-	8	10
de-	17	52
dis-	48	73
il-	7	-
im-	49	9
in-	156	3
ir-	21	1
non-	25	-
un-	381	39
under-	22	18

Tabela 13 Frekuenca në fjalorin Anglish-Anglisht[835]

[835] Fjalori Anglisht-Anglisht, "Cambridge Advance Learner's Dictionary" Third Edition, 2009



Grafiku 10



Grafiku 11



Grafiku 12

Nga puna me fjalorin e mësipërm u vu re se parashtesa më prodhimtare me kuptim antonimik është pikërisht parashtesa "**un-**", me 381 njësi mbiemërore dhe 39 foljore, e cila pasohet nga parashtesa "**in-**", me 156 njësi mbiemërore dhe 3 njësi foljore. Në vazhdimësi të renditjes dallojmë, parashtesën "**im-**" dhe "**dis-**", përkatësisht me 49 dhe 48 njësi mbiemërore dhe 9 dhe 73 njësi foljore. Edhe parashtesa "**non-**", ka një total të konsiderueshëm prej 25 mbiemrash. Vlen për tu përmendur se nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Edhe parashtesat e tipit "**ir-**" "**anti-**" dhe "**de-**" janë me një numër jo fare të vogël dhe me numër të ngjashëm. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë "**il-**" dhe "**a/an-**", të cilat gjenden në sasi minimale, që varion nga 8 në 0 njësi.

Nga grafiku 12 vërejmë se raporti i përgjithshëm ndërmjet foljeve dhe mbiemrave në fjalorin Anglisht - Shqip është i diferencuar. Është mëse e dukshme, se mbiemrat qendrojnë në një sasi të konsiderueshme më lart, sesa foljet antonime të formuara me parashtesim në këtë fjalor. Pra, themi se parashtesimi antonimik është më prodhimtar për klasën e mbiemrave, sesa për atë të foljeve në fjalorin dygjuhësh Anglisht - Shqip.

Më poshtë, po paraqesim një listë të përmbledhur të disa antonimeve mbiemërore dhe foljore tëmbledhura nga puna me fjalorët:

aseptic (septic) adj.
asexual (sexual) adj.
askew (skew) adj.
asymmetric (symmetric) adj.
debauched (bauched) adj.
debug (bug) verb
decamp (camp) verb
decentralize (centralize) verb
decode (encode) verb
declassify (classify) verb
decommission (commission) verb
decompress (compress) verb
decontrol (control) verb
decontaminate (contaminate) verb
decrease (increase) verb
decriminalize (criminalize) verb
deforest (forest) verb
defrost (frost) verb
dehumanize (humanize) verb
dehydrate (hydrate) verb
delimit (limit) verb
demilitarize (militarize) verb
demobilize (mobilize) verb
disadvantaged (advantaged) adj.
disafforest = deforest

disagreeable (agreeable) adj.
disagree (agree) verb
disallow (allow) verb
disappear (appear) verb
disapproving (approving) adj.
disbelieve (believe) verb
disconnect (connect) verb
dishonor (honor) verb
illegal (legal) adj.
illegible (legible) adj.
illegitimate (legitimate) adj.
illiberal (liberal) adj.
illiterate (literate) adj.
illogical (logical) adj.
immature (mature) adj.
immaterial (material) adj.
immeasurable (measurable) adj.
immobile (mobile) adj.
immobilize (mobilize) adj.
immoral (moral) adj.
immodest (modest) adj.
immoderate (moderate) adj.
impartial (partial) adj.
inaccessible (accessible) adj.
inaccurate (accurate) adj.
inactive (active) adj.
inadequate (adequate) adj.
inadmissible (admissible) adj.
inalienable (alienable) adj.
inapplicable (applicable) adj.
inappropriate (appropriate) adj.
inapt (apt) adj.
inattentive (attentive) adj.
incomparable (comparable) adj.
incomplete (complete) adj.
irrational (rational) adj.
irreconcilable (reconcilable) adj.
irrecoverable (recoverable) adj.
irreducible (reducible) adj.
irrefutable (refutable) adj.
irregular (regular) adj.
irrelevant (relevant) adj.
irreligious (religious) adj.
irremediable (remediable) adj.
irreplaceable (replaceable) adj.
irresistible (resistible) adj.
non-addictive (addictive) adj.
non-alcoholic (alcoholic)
non-aligned (aligned) adj.
non-bio (bio) adj.
non-combatant (combatant) adj.
non-conformist (conformist) adj.
non-contributory (contributory) adj.
non-dairy (dairy) adj.
non-flammable (flammable) adj.
non-profit (profit) adj.
non-returnable (returnable) adj.
non-smoking (smoking) adj.
non-verbal (verbal) adj.
non-white (white) adj.
underachieve (achieve) verb
undercharge (overcharge) verb
undercook (overcook) verb
underdeveloped (developed) adj.
underdone (overdone) verb
underdressed (overdressed) adj.
underestimate (overestimate) verb
underpay (overpay) verb
underpass (overpass) verb
underrate (overrate) verb
unabated (abated) adj.
unable (able) adj.
unacceptable (acceptable) adj.
unaccompanied (accompanied) adj.
unaccustomed (accustomed) adj.
unadulterated (adulterated) adj.
etj.

5.2.2 Studimi eksperimental përmes vjeljes së informacionit

Në vazhdim, do të trajtojmë rezultatet e vjela nga një tjetër studim praktik, i cili ka një natyrë jo të ngjashme me studimin e mësipërm. Këtu kemi të bëjmë me një studim të natyrës së intervistimit përmes pyetësorëve, të tipit "stimul/përgjigje".

Pyetësorët janë ndërtuar, jo me pyetje direkte dhe nuk presin përgjigjen daj pyetjeve, si në rastet klasike të një studimi të kësaj natyre. Konkretisht, ato përmbajnë 11 (njëmbëdhjetë) fjalë stimul dhe kërkohet që studentët e përzgjedhur nga Bachelor, Gjuhë Angleze, pranë Fakultetit të Edukimit, UAMD, të japin gjymtyrën antonime për çdo fjalë

stimul. Në fazën e fundit, rezultatet krahasohen edhe me çiftet antonimike, të cilat rezultojnënë fjalorine antonimeve *Webster's Dictionary*(online). Më poshtë, do të japim disa të dhëna të këtij studimi praktik.

Qëllimet e studimit janë:

- të vjelim antonimet e mbiemrave të përzgjedhur si korpus studimi nga studentët e programit Bachelor, Gjuhë Angleze, pranë Universitetit "A.Moisiu" Durrës
- të evidentojmë cilët janë mbiemrat, antonimet e të cilëve janë rrënjosur më mirë tek këto folës të gjuhës angleze (si gjuhë e huaj)
- të vëzhgohen antonimet e këtyre mbiemrave në korpusin e antonimeve të gjuhës angleze, përmes vjeljes nga fjalori i antonimeve të gjuhës angleze
- të krahasohen të dhënat e përgjigjeve të studentëve me ato të korpusit të fjalorit të antonimeve
- të dallojmë veçori që përbëjnë interes te rezultatet e studimit
- të evidentohen detyrat e mundëshme për mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze.

Instrumenti matës

Matja do të kryhet përmes përzgjedhjes së një grup prej 11 mbiemrash të gjuhës angleze të cilat u përdorën si fjalë stimul për të vjelur gjegjëse e tyre antonime. Përzgjedhja e mbiemrave u bë në bazë të studimit të Paradis dhe Willners,[836] të cilët i grupuan mbiemrat në bazë të frekuencës së tyre në gjuhën angleze, nga më të shpeshtët deri tek më të rrallët (në shkallë zbritëse). Përzgjodhëm instrument e studimit të mësipërm pasi është një instrument i testuar më parë, dhe si rrjedhojë rrit besueshmërinë dhe vlefshmërinë e studimit tonë.

Pyetësorët janë ndërtuar, jo me pyetje direkte dhe nuk presin përgjigje daj pyetjeve, si në rastet klasike të një studimi të kësaj natyre. Konkretisht, ato përmbajnë 11 fjalë stimul dhe kërkohet që studentët e përzgjedhur, të japin gjymtyrën antonime për çdo fjalë stimul. Në fazën e fundit, rezultatet krahasohen edhe me çiftet antonimike, të cilët janë marrënga fjalori i antonimeve *Webster's Dictionary*(online). Më poshtë, do të japim disa të dhëna të këtij studimi praktik.

Procedura e matjes

Matja do të kryhetpërmes përzgjedhjes së një grup prej 11 mbiemrash të gjuhës angleze të cilët u përdorën si fjalë stimul për të vjelur gjegjëse e tyre antonime. Anketimi u krye me studentët e gjuhës angleze të programit të ciklit të parë të studimeve (Bachelor), Gjuhë Angleze, pranë Fakultetit të Edukimit, departamenti i gjuhës angleze,

[836]C. Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress

UAMD.[837] Në këtë mënyrë u anketuan 100 studentë, të cilët kishin përpara tyre një listë mbiemrash të gjuhës angleze.

Kampioni i studimit

Të anketuarit që kanë shërbyer për zgjedhjen e kampionit të këtij studimi kanë qenë studentët e ciklit të parëtë studimeve (Bachelor),në degën Gjuhë Angleze, Fakulteti i Edukimit, UAMD është pikërisht mësimnxënia e tyre ndër vite që i kualifikon ato si kampionë studimi në këtë anketim.

Nga grupi i studentëve, me anë të teknikës së përzgjedhjes së kampionit me metodën probabilitare, u zgjodhen në mënyrë rastësore studentët, të cilët shërbyen si kampion studimi. Në këtë mënyrë është përzgjedhur një kampion, i cili i përfaqëson në mënyrë sa më të plotë të gjitha karakteristikat e masës së studentëve, duke plotësuar të gjitha kushtet e një kampioni përfaqsues. Kemi përzgjedhur këtë lloj teknike kampionimi për të rritur besueshmërinë, njëkohësisht namundësonte përgjithsimin e rezultateve të nxjerra nga studimi.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Mbiemrat e përzgjedhur pasi u formatuan brenda fletave të anketimit iu shpërndanë studentëve të cilët patën një minutazh prej 60 minutash për të menduar dhe shkruan fjalën antonime të secilit mbiemër në bazë të intuitës së tyre, e cila bazohet edhe tek procesi i përvetësimit të gjuhës angleze. Pasi u mblodhën anketimet e plotësuara me përgjigjet, u studiuan fjalët antonime gjegjëse për cdo mbiemër tek të 100 studentët e anketuar. Më pas, u hartua një tabelë përmbledhëse e cila përmban fjalët stimul si edhe përgjigjen antonimike, e cila mund të variojë nga 1 (një) deri në disa antonime të mundëshme të dhëna nga studentët.

Metodologjia

U përdor metoda e vjeljes së fjalëve nga njohuritë dhe instikti i studentëve, si edhe ajo e vjeles përmes një korpusi të antonimeve në fjalor. Kjo procedurë organizohet si më poshtë:

- u identifikuan dhe përzgjodhën mbiemrat për studim
- u hartuan tabela studimore
- u mblodhën të dhënat
- u analizuan të dhënat
- u hartuan tabela bashkë me rezultatet e fjaleve antonime mbiemërore nga fjalori
- u krahasuan rezultatet e tabelës së parë me tabelën e dytë
- u interpretuan rezulatet
- u nxorrën përfundimet
- u dhanë rekomandimet.

Përzgjedhja e korpusit

Përzgjedhja e grupit të antonimeve u bë në bazë të studimit të Paradis dhe Willners[838]. Prej këtij studimi ne kemi përzgjedhur 11 (njëmbëdhjetë) mbiemrat e parë të

[837] Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

[838] C. Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress

listës së tyre, të gjatë prej 200 mbiemrash, në bazë të kriterit të lidhjes sëngushtë të kundërvënies.[839]

Hartimi i tabelës

Tabela e mëposhtme u hartua dhe u shpërnda për studentët:

Nr.	FJALA STIMUL	PËRGJIGJA
1	BAD	
2	BEAUTIFUL	
3	CLEAN	
4	HEAVY	
5	HOT	
6	POOR	
7	WEAK	
8	YOUNG	
9	SLOW	
10	EXCITING	
11	CALM	

Tabela 14 Tabela me fjalët stimul drejtuar studentëve

[839] Shënim: nga çiftet më të lidhura ngushtë tek ato më të zbehta.

Mbledhja e informacionit dhe hartimi i tabelës

Nr.	**FJALA STIMUL**	**PËRGJIGJA**
1	**BAD**	GOOD, 100 %
2	**BEAUTIFUL**	UGLY, 100 %
3	**CLEAN**	DIRTY, 100 %
4	**HEAVY**	LIGHT, 100 %
5	**HOT**	COLD, 100 %
6	**POOR**	RICH 90 % WEALTHY 10 %
7	**WEAK**	STRONG 88 % POWERFUL 12%
8	**YOUNG**	OLD, 87% ADULT 11 % GROWN-UP,2 %
9	**SLOW**	FAST 82% QUICK, 10% RAPID, 8%
10	**EXCITING**	BORING 46% DULL 41 % UNEXCITING 6%

		CALM 5% SAD 2%
11	**CALM**	STRESSED 40% ANXIOUS 37% AGITATED 20% ANGRY 28 % HECTIC 12% ANNOYED 6% EXCITED 5%

Tabela 15 Të dhënat e mbledhura nga plotësimi i tabelës nga studentët, pas mbledhjes së informacionit

Rezultate dhe analiza

Nga tabela e mësipërme vërejmë, se jo të gjithë studentët dhanë të njëjtën përgjigje për fjalët stimul mbiemërore. Vetëm për disa mbiemra si "*bad" (i keq), "beautiful" (e bukur), "clean" (e pastër), "heavy" (e rëndë), "hot" (e nxehtë), "poor" (e varfër), "weak" (i dobët/i pafuqishëm),"young" (e re), "slow" (i ngadaltë)*, të gjithë studentët (100%) dhanë të njëjtën përgjigje, përkatësisht *"good" (e mirë), "ugly" (e shëmtuar), "dirty"(e pisët), "light" (e lehtë),"cold" (ftohtë), "rich" (i pasur), "strong" (i fuqishëm), "old" (e vjetër), "fast" (i shpejtë).* Kjo provon edhe lidhjen e fortë të këtyre çifteve antonimike në gjuhën angleze.

Ndërkohë, në shkallë zbritëse rradhiten në tabelën e mësipërme fjalët stimul "me lidhje më të dobët", kjo për shkak se studentë të ndryshëm kanë dhënë përgjigje të ndryshme për të njëtën fjalë stimul. Është interesant fakti, se në fund të tabelës gjejmë mbiemra si "*large"(i madh), "rapid"(i shpejtë), "small" (i vogël), "ugly" (i shëmtuar), "exciting"(emocionues), "thick"(i trashë), "strong" (i fuqishëm), "wide", "calm" (i qetë),* të cilët ndryshojnë me nga tre deri në trembëdhjetë fjalë përgjigje të ndryshme. Kjo pasi studentët kanë një intuitë të ndryshme te këto fjalë, ose për shkak se ato kanë një përdorim të kufizuar të asaj fjale vetëm në një kontekst të caktuar dhe është pikërisht ajo nuancë kuptimore kontekstuale e cila përcakton fjalën përgjigje për të tillë mbiemra.

Krahasimi i rezultateve

Më pas studimi u zgjerua në qasjen krahasimore të rezultateve të arritura nga anketimi i studentëve duke ndërtuar të njëjtën tabelë me të njëjtat fjalë stimul, ku

antonimet gjegjëse nuk u volën nga studentët e masterit të gjuhës angleze, por nga *Merriam-Webster Dictionary.*[840]

Nr.	MBIEMRI	ANTONIMET NË FJALOR
1	**BAD**	good, acceptable, adequate, all right, decent, fine, ok (*or* okay), passable, respectable, satisfactory, standard, tolerable
2	**BEAUTIFUL**	grotesque, hideous, homely, ill-favored, plain, ugly, unaesthetic, unattractive, unbeautiful, uncomely, uncute, unhandsome, unlovely, unpleasing, unpretty, unsightly
3	**CLEAN**	besmirched, dirty, filthy, foul, grubby, smirched, soiled, spotted, stained, sullied, unclean, uncleaned
4	**HEAVY**	airy, ethereal, feathery, fluffy, gossamer, gossamery, flimsy, insubstantial, slight, lightweight, undersized (*also* undersize), underweight, ultralight, ultralightweight light, weightless
5	**HOT**	algid, arctic, bitter, bone-chilling, cold, freezing, frigid, frozen, glacial, ice-cold, iced, icy
6	**POOR**	affluent, deep-pocketed, fat, fat-cat, flush, moneyed (*also* monied), opulent, rich, silk-stocking, wealthy, well-heeled,

[840] Webster's Dictionary (Updated Third New International, Online Version Downloaded)

		well-off, well-to-do
7	**WEAK**	mighty, powerful, rugged, stalwart, stout, strong
8	**YOUNG**	adult, grown-up, mature, matured
9	**SLOW**	barreling, bolting, breakneck, breathless, brisk, careering, dizzy, fast, fleet, flying, hasty, hurrying, lightning, meteoric, quick, racing, rapid, rocketing, running, rushing, scooting, scudding, scurrying, snappy, speeding, speedy, swift, warp-speed, whirling, whirlwind, whisking, zipping
10	**EXCITING**	unexciting
11	**CALM**	agitated, angry, inclement, restless, rough, stormy, tempestuous, turbulent, unquiet, unsettled

Tabela 16 Të dhënat e mbledhura nga puna me fjalorin[841]

Interpretim i rezulateve, përfundime dhe propozime për hulumtime të mëtejëshme

Dallimi mes përgjigjeve të dhëna nga studentët e programit Bachelor, Gjuhë Angleze, pranë UAMD dhe antonimeve të vjela nga korpusi i antonimeve në fjalor është jo i vogël. Kështu, dallojmë se për mbiemra të tillë si "*bad"*studentët kanë dhënë vetëm "*good", "fine", "okay"*, si gjegjëse antonime, ndërkohë që korpusi ofron dymbëdhjetë antonime për të. Pra, duket qartë se në tabelën e dytë gama e antonimeve për çdo fjalëështë disa herë më e lartë, se në tabelën e parë të rezultateve të studentëve. Kjo tregon se njohuritë e studentëve për të tillë mbiemra janë të kufizuara në përdorimet më të përgjithëshme të fjalëve dhe rreth kuptimeve të para dhe të dyta të çdo mbimeri në studim.

Le të analizojmë disa çështje me interes, të cilat dalin nga ky studim. Përbën interes fakti, se studentët tanë nuk janë të familjarizuar mjaftueshëm me ndajshtesimin e gjuhës angleze në formimin e antonimeve si në shembujt *"uncute", "unattractive","unbeautiful", "unpretty", "uncleaned", "weightless", "restless", "unlovely", "unquiet",* etj. Këto fjalë antonime të formuara me ndajshtesim nuk gjenden në fjalorin e studentëve tanë. Ky fakt, rrit vetëdijen tonë si mësues në kujdesin që duhet

[841]Webster's Dictionary (Updated Third New International, Online Version Downloaded)

treguar me të tilla forma fjalëformimi, të cilat duhet të kultivohen më shumë brenda në klasë.

Studimi i dytë, nxjerr rezultate të pritura, por njëkohësisht shërben edhe si tregues i punës që duhet të bëhet nga mësuesit e gjuhës angleze në përvetësimin e antonimeve në klasë për të zgjeruar njohuritë e studentëve për përdorimin e fjalëve. Gjithashtu, ajo shërben si një tabelë praktike e përmbledhëse për tu përdorur si mjet didaktik gjatë orës së mësimit të gjuhës së huaj. Kuptohet, se nuk mjafton që këto antonime të mësohen përmendsh por është e nevojëshme një punë e detajuar praktike me to duke i përdorur në fjali, në ndërtime tregimesh me gojë, lojra tëndryshme, me qëllim përvëtësimin e fjalorit në klasë.

Vërejmë edhe disa gabime në mënyrën se disa student e kanë perceptuar antoniminë. Kështu, dallojmë se për mbiemrin "*exciting*" (*emocionues*) është dhënë në një përqindje fare të vogël (5%) antonimi "*calm*", i cili nuk përbën çift antonimesh. Besojmë, se është e lidhur edhe me rezultatin e mëposhtëm në tabelë, ku vërejmë se për mbiemrin "calm" 5% është përgjigjur me "*excited*" (*i emocionuar*), ku mund të themi se qendron si antonimi për faktin se mbiemrat prejpjesorë (*past participle*/*pjesorja e shkuar* me "*-ed"*) në gjuhën angleze tregojnë ndjenja dhe gjendje emocionale. Nga ana tjetër mbiemrat me të njëjtën rrënjë, por me mbaresën e pjesores së tashme (*present participle*), "-ing", përshkruajnë se si duke diçka apo dikush (*exciting, emocionues*).

Për më shumënë lidhje me gabimet, për të njëjtin mbiemër "*exciting*" është dhënë me një përqindje fare të ulët (2%) mbiemri "*sad*" (*i trishtuar*). Edhe këtu vlen për tu përmendur argumenti i mësipërm në lidhje me mbiemrat prejpjesorë. Kështu, "*sad*" mund të ishte antonim i zbehtë me "*excited*", por jo me "*exciting*".

Gjithashtu, nga tabela e mësipërme vërejmë se për fjalët stimul mbiemërore "*exciting*" dhe "*calm*", të cilat përbëjnë mbiemra, që tregojnë opinion dhe jo fakt, përgjigjet e studentëve janëmë të shumta në numër, duke e ndarëpërqindjen në disa gjegjëse antonime për secilën prej këtyre fjalëve stimul.

Mbiemri "*young*" (*i ri*), vërejmë se studentët kanë dhënë përgjigjen "*old*" (*i vjetër*) me përqindje më të lartë (87%). Duke e krahasuar me tabelën e të dhënave të mbledhura nga fjalori Webster's Dictionary Online, vërejmë se për mbiemrin "*young*" kemi shumë mundësi të tjera të çiftimit, si p.sh.,*"young/adult" (i ri/i rritur), "young/grown-up" (i ri/i rritur), "young/mature" (i ri/i rritur),* etj. Ndërkohë, për mbiemrin "*old*" gjegjësja antonime më e mirë do të ishtë "*new*".

Për disa mbiemra si *"bad", "beautiful", "clean", "heavy", "hot"* jepet vetëm një përgjigje. Kjo tregon se studentët janë të prirur t'i shohin të tilla çifte, si *"beautiful/ugly", "heavy/light"*, etj., si tepër kanonike e nuk japin alternative të tjera. Ndërkohë, për të tjera fjalë stimul jepen variante të ndryshme. Kjo mund të jetë tregues i zvogëlimit të forcës antonimike në këto çifte, si*"exciting/boring", "exciting/unexciting", "exciting/boring",* etj.

Në lidhje me propozimet e mëtejëshme, mendojmë se është me rëndësi fillimi i një studimi të detajuar, për sa i përket bashkërenditjes së çifteve të standartizuara të gjuhës shqipe.

Studimi eksperimental i Paradis, Willners, Murphy dhe Jones për antonimet në gjuhën angleze provoi ekzistencën e një vazhdimësie të lidhjes antonimike ndërmjet

fjalëve. Për më shumë, ato theksuan, se ”*edhe pse antonimet tradicionale janë të pakta, një pjesë e mirë e tyre gjenden shpesh në kontekste apo zhanre të caktuara*”.[842] Studimi ynë tregon dhe mbështet hipotezën e Paradis, Willners, Murphy dhe Jones, se ekzistojnë dy tipe të dallueshme antonimesh: kanonike dhe jokanonike.

Si përfundim, nga të tilla studime tekstuale mund të themi, se çiftet antonimike qendrojnë në nivele të ndryshme leksiko-semantike, dhe midis tyre dallohet një bërthamë antonimesh të çiftuara fort në gjuhë dhe mendim.

5.3 Përvetësimi i gjuhës dhe antonimet

Në procesin e përvetësimin të gjuhës, janë disa faktorë që ndikojnë në mënyrën se si fëmija “përparon” drejt zotërimit dhe përdorimit të mirë të gjuhës në mënyrë të pavarur. Janë bërë hulumtime të shumta për të arritur të kuptohet, se kur fëmijët mesojnë rreth antonimisë. Kagan beson se: “*vlerësimi i të kundërtave kuptohet shumë herët dhe shumë thjesht përmes instruksionit të kujdesshëm*”.[843] Të tjerë hulumtues mendojnë se antonimia mësohet në moshë më të vonë. Ka edhe nga ato të cilët supozojnë se antonimia është e mësuar dhe jo e përvetësuar (e fituar). Kjo tregon se ka qasje të ndryshme ndaj pyetjes si fitohet antonimia.

Disa nga metodat që janë përdorur për të përcaktuar njohuritë e fëmijëve për antoniminë janë asosacione të lira të fjalëve, përgjigjet ndaj pyetjes: *What is the opposite of X?* (Cila është e kundërta e X-it) apo dhe metodat e përdorimit të antonimeve në kornizat e duhura ligjërimore.

Kreezer dhe Dallenbach treguan se shumica e fëmijëve janë në gjendje të kuptojnë kundërnënien metalinguistike vetëm pas moshës 5-vjeçare. Ata realizuan studimin përmes lojës: *What is the opposite of X ?,* nga e cila rezultoi se 90 % e fëmijëve e mësuan këtë lojë në moshën 7-vjecare.[844]

Murphy vë në dyshim një moshë kaq të vonë nga studimet e bëra në ditët e sotme. Vërehet një ulje e moshës së fëmijëve, të cilët e mësojnë kundërvënien në një moshë më të herët.[845] Me zhvillimin e shoqërisë, fëmijët në ditët e sotme në vendet e industrializuara janë më të ekspozuar ndaj nocionit të kundërvënies përmes librave, këngëve, televizionit, kompjuterit si në shtëpi edhe në çerdhe apo kopshte. Kështu që, që në vitin e parë fëmijët ndihmohen nga të rriturit që të flasin dhe është vënë re se përdoren antonime të tipit: “*hot/cold”, “up/down” , “sit/stand” , “wet/dry”, “big/little”,* etj.[846]

Studimet e Clark në lidhje me përvetësimin semantik të antonimeve mbiemërore te fëmijët vënë në dukje se mbiemrat dimensional mendohet të mësohen sipas rendit të vështirësisë semantike. Kështu, fëmijët fillimisht përvetsojnë fjalën e përgjithshme si

[842] S. Jones,C. Paradis,M. L. Murphy, C. Willners (2007) Googling for ‘Opposites’: A Web-Based Study of Antonym Canonicity

[843] Cituar nga S. Jones , M. L.Murphy (2003) Antonymy in Childhood: A Corpus-Based Approach to Acquisition

[844] George, Kreezer, and Karl M. Dallenbach (1929) Learning the Relation Of Opposition. American Journal of Philosophy, f. 432-41.

[845] S. M. Ervin (1963) Correlates of Associative Frequency.Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior, f. 422-431.

[846] S. Jones , M. L. Murphy (2003) Antonymy in Childhood: A Corpus-Based Approach to Acquisition, University of Central Lancashire, Sussex, UK, f.370.

"*big"* dhe më pas kuptimet më specifike, si p.sh., *"wide"* ose *"narrow"*.[847] Evans[848] argumenton, se polariteti përvetësohet përpara dimensionit. Kjo mbështet edhe në hulumtimet e Brewer dhe Stone.[849]

Teoritë e sotme mbështeten më shumë te pragmatika.[850] Këto qasje theksojnë faktin se fëmijët e supozojnë se çdo fjalë e re, që ata mësojnë, ka një kuptim të ndryshëm që ata dinë. Gjithashtu, fëmijët priren drejt polaritetit edhe pse ato nuk e kanë akoma idenë se çdo të thotë dimensioni i një çifti. Sipas Josefsson, fëmijët janë në gjendje të dallojnë sinjalet ligjërimore të cilat shoqërojnë bashkrënditjen e antonimeve përmes modeleve prozodike, të cilat theksojnë natyrën kundërvënëse të çiftit antonimik.[851]Ai zbuloi, se antonimet që bashkrënditen theksohen përmes theksit.

Willners thekson rëndësinë e prozodisë si një sinjal edhe më të rëndësishëm sesa frekuenca apo zëvendësueshmëria për të dalluar çiftet antonime. Sipas Murphy, fëmijët e kanë konceptin e teorisë së *marrëdhënies së kundërshtisë* që në moshë të herët, e cila mund të përdoret si një mjet për përcaktimin e kuptimeve të fjalëve, të cilat kundërvihen në ligjërim ashtu sikurse mund të përdoret si një mjet në përcaktimin e antonimisë se fjalëve që ata tashmë dinë.[852]

Ervin[853] propozoi idenë se nëse dy fjalë janë të zëvendësueshme në të njëtin kontekst semantik dhe sintaksor atëherë marrëdhëniet paradigmatike, sidomos antonimia lind përmes këtyre fjalëve. Charls dhe Miller[854] argumentojnë, se çiftet antonime mësohen për vetë faktin, se të dyja gjymtyrët e një çifti antonimik bashkrënditen në kontekste fjalish në një shkallë më të lartë seç pritet. Justeson dhe Katz[855] janë të mendimit, se antonimet kuptohen kur njësitë leksikore bashkrënditen brenda mjediseve të ngjashme në të njëtën fjali, siç janë, p.sh: strukturat e lidhura me lidhëza.

Murphy[856] e studion bashkrënditjen e antonimeve përmes 3 hulumtimeve të ditareve të fëmijëve nga mosha 2 deri në 5 vjecar. U vu re se edhe pse në moshë të

[847] H. H. Clark (1970) Word Associations and Linguistic Theories, cituar nga J. Lyons (ed.) New Horizons in Linguistics, f. 271–86. Baltimore: Penguin

[848] M. J. Evans (1984) Complementarity, Antonymy, and Semantic Development: A Method and Some Data, f.142-62.

[849] G. Kreezer, and K.l M. Dallenbach (1929) Learning the Relation of Opposition. American Journal of Philosophy, f. 432-41.

[850] H. H. Clark (1970) Word Associations and Linguistic Theories cituar nga J. Lyons (ed.) New Horizons in Linguistics, f.271–86. Baltimore: Penguin.

[851] G. Josefsson, (2003) The Acquisition of Swedish Grammar , Christer Platzack, Gisela Håkansson Amsterdam ; Philadelphia : J. Benjamins Pub., f.184.

[852] M.L. Murphy (2006) Antonyms as Lexical Constructions: Why Paradigmatic Construction Isn't An Oxymoron' in D. Schönefeld (ed.) Constructions All Over: Case Studies and Theoretical Implications, f.211.

[853] Cituar nga M.L. Murphy (2006) Antonyms as Lexical Constructions: Why Paradigmatic Construction Isn't An Oxymoron' Constructions All Over: Case Studies and Theoretical Implications, f.211.

[854] W.G. Charles, G.A. Miller (1989) Contexts of Antonymous Adjectives, Applied Psycholinguistics 10, f. 357–75.

[855] J. S. Justeson, Slava M. Katz (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts. Computational Linguistics, f.1-19.

[856] S. Jones , M. L.Murphy (2003) Antonymy in Childhood: A Corpus-Based Approach to Acquisition, University of Central Lancashire, Sussex, UK

herëshme, fëmijët i përdorin antonimet në mënyrë krijuese, lozonjare dhe të kujdesshme.[857]

Përvetësimi i gjuhës në këtë punim do të jetëi lidhur ngushtë me përvetësimin e gjuhës së huaj, konkretisht, atë të gjuhës angleze. Përvetësimi nënkupton jo vetëm të mësuarit e fjalorit, por edhe të lidhjeve gramatikore, të cilat mundësojnë një komunikim të strukturuar. Gramatika dhe strukturat sintaksore janë mëse të rëndësishme, por, është kuptimi ai që përcillet fillimisht nga fjalët. Sa më shumë fjalë të dinë nxënësit, aq më mirë kuptohen ata në situata komunikative duke përdorur gjuhën angleze.

Në lidhje me përvetësimin e fjalorit, mendohet se nxënësit duhet ta ndeshin një fjalë nga 14-16 herë në mënyrë të tillë që ta përvetësojnë atë.[858] Shpesh ndeshemi me pyetjen sesa fjalë duhet të zotërojmë nga një gjuhë për të qenë në gjendje të komunikojmë me lehtësi. Nëse do t'i referohemi numrit të fjalëve në fjalor do të dukej e pamundur që të arrijmë përvetësimin e njësive leksikore të fjalorit të gjuhës angleze. Në të vërtetë, një folësi jo vendas nuk do t'i duhet të mësojë e zotërojë të gjitha fjalët e një fjalori. Është interesant fakti, se edhe njëfolës mesatar vendaspërdor vetëm rrethpesë mijëfjalënëgjuhën e përditshme.

Aftësia e nxënësit në përdorimin e gjuhës angleze varet kryesisht nga pasuria e fjalorit të tij në gjuhën angleze. Përmes fjalorit të zgjeruar, ata janë në gjendje të lexojnë, flasin, dëgjojnë, shkruajnë, etj, në gjuhën angleze, pra, të komunikojnë në këtë gjuhë.

Që të njohësh një fjalë do të thotë të:[859]

1. të jesh në gjendje ta përkufizosh atë
2. të dish se si ta përdorësh atë
3. të njohësh të gjitha kuptimet e saj
4. të jesh në gjendje ta gërmëzosh dhe analizosh atë nga ana morfologjike.

Nga ana tjetër, nxënësit shpesh ndeshen dhe mësojnë fjalë, të cilat kanë një përdorim shumë të veçantë e të lidhur ngushtë me një fushë të caktuar, si për shembull "*abdicate*" (*heq dorë*), "*frugal*" (*i kursyer*), "*wary*" (*i kujdesshëm*), "*tactful*" (*i sjellshëm*), etj. Kryesisht, mos përdorimi i shpeshtë i këtyre fjalëve lidhet me faktin se ka sinonime të tyre, të cilat përdoren shumë më shpesh, si p.sh., "*tactful-polite", "wary-careful"*,etj. Janë pikërisht fjalët sinonime të mësipërme të cilat gjenden më shpesh në ligjërim nga folësit e gjuhës angleze, si gjuhë e huaj. Si pasojë, themi se atyre nuk do t'iu duhet të përdorin çdo fjalë që ata mësojnë.

Përzgjedhjase çfarë duht tëmësojnë, lidhet me frekuencën dhe dobinë, prandaj është e nevojshme të njihen nevojat e veçanta të nxënësve. Pasi të kemi përzgjedhur se çfarë t'ua mësojmë, hapat e ardhshëm të rëndësishme janë të konsiderojmë se çfarë

[857]S. Jones , M. L.Murphy (2003) Antonymy in Childhood: A Corpus-Based Approach to Acquisition, University of Central Lancashire, Sussex, UK, f.372.
[858] A.W. Frisby (1957) Teaching English, The English Language Book Society and Longmans Green and Co., f. 98.
[859] A.W. Frisby (1957) Teaching English, The English Language Book Society and Longmans Green and Co., f. 98.

nxënësit duhet të dinë në lidhje me botën reale, dhe se si ju mund t'jua mësojmë atyre fjalorin.

Për ta përvetësuar sa më mirë fjalorin, nxënësit duhet të ndjekin disa hapa[860]:

- evidentojnë apo dallojnë një fjalë të re me ndihmën e mësuesit
- e njohin një fjalë të re me ndihmën e mësuesit
- më pas, ta dallojnë atë vetë
- në fund, ata duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe përdorin vetë fjalë e re.

Mes shumë prej faktorëve që ndikojnë në përvetësimin e gjuhës së huaj, dallojmë edhe antonimet, të cilat shërbejnë si një mjet jo vetëm për të pasuruar fjalorin, por edhe për të shpjeguar kuptimin e fjalëve të panjohura. Interes paraqet fakti se antonimet mbahen mendqë në fëmijërinë e herëshme. Është dokumenatuar se femijët që në moshë të herëshme kanë tendencën të përceptojnë konceptin e kundërshtisë, duke i mësuar antonimet në çifte me lehtë sesa një e nga një.[861]

Kagan vëren, se fëmija menjëherë pasi mëson fjalën "*lart*", mëson dhe atë "*poshtë*", apo fill pas fjalës "*mirë*", zhvillohet kuptimi i fjalës "*keq*". [862]Kjo mund të ketë lidhje me atë që Lyons e quan "tendenca për dikotomi". E njëjta logjikë mund të përdoret edhe për përvetësimin e gjuhës së huaj ("*bad/good*"). Megjithatë, mund të jetë thjesht një strategji e të mësuarit e përdorur nga fëmijët si pjesë e një mekanizmi të përgjithshëm në përvetësimin e gjuhës. Nga praktika, duket se të mësosh fjalët brenda një familjeje me kuptim të ngjashëm është më e thjeshtë. Megjithatë, çiftet e fjalëve, të cilat përvetësohen më thjeshtë nga fëmijët janë padyshim antonimet.

Në studimet e zhvilluara në fushën e përvetësimit të gjuhës së dytë,do të citojmë disa nga ata autorë, të cilët i përfshijnë marrëdhëniet leksiko-semantike, dhe veçanërisht antoniminë, si një element të rëndësishëm në procesin e përvetësimit të gjuhës.

5.3.1 Strategjitë kyçe për përvetësimin e fjalorit

Nation[863] rendit ato që nxënësit duhet të dinë në lidhje me një fjalë, para se të mund të themi, se ata e kanë mësuar atë. Këto përfshijnë:

- kuptimin e fjalës
- formëm e saj të folur e të shkruar
- pjesët përbërëse të fjalës (p.sh., parashtesa, prapashtesa, rrënja)
- sjelljen gramatikore (p.sh., klasa e saj , modelet gramatikore tipike, etj)
- lidhjet semantike me fjalë të tjera (antonimet, sinonimet, etj.)
- shoqërimin me fjalë të tjera
- regjistrin e përdorimit
- konotacionet që ajo ka
- frekuencën e saj, etj.

[860] A.W. Frisby (1957) Teaching English, The English Language Book Society and Longmans Green and Co., f.98.
[861] J. Kagan (1984)The Nature of the Child. New York: Basic Books, f.187.
[862] J. Kagan (1984)The Nature of the Child. New York: Basic Books, f.187.
[863] I. S. P. Nation (2001) Learning Vocabulary in Another Language, Cambridge: Cambridge University Press

Linda Taylor [864] shprehet, se për të mësuar fjalorin nevojitet informacion i shumëllojshëm duke përfshirë:

1. njohuri në lidhje me frekuencën e përdorimit të fjalës,
2. njohur në lidhje me stilin, regjistin dhe dialektet e përdorimit të fjalëve,
3. njohuri në lidhje me bashkërenditjen e fjalëve në fjali, strukturave, me të cilat ato shoqërohen në lidhjet sintagmatike,
4. njohuri në fushën e morfologjisë,
5. njohuri në fushën e semantikës (kuptimi denotativ dhe konotativ),
6. njohuri për poliseminë e një fjale,
7. përkthimin e fjalës.

Në lidhje me semantikën, ajo shton, se përdorimi i antonimeve për përvetësimn e fjalorit ka një rol të veçantë në këtë pikë. Duhet bërë kujdes në dhënien e gjymtyrës antonime të përshtatëshme për kontekstin specifik, p.sh., "*slim-slander*" (në një kontekst pozitiv), "*emaciated-skinny*" (në një kontekst keqësues), "*thin*" (në një kontekst neutral). Përzgjedhja e duhur e njërës prej gjymtyrëve të mësipërme për të formuar çift antonimik me "*fat*", "*overweight*", etj. ndikon në mënyrën se si nxënësi e përvetëson këtë pjesë të fjalorit dhe se si ai do e përdor atë në të ardhmen.[865]

Sipas N. K. Mehta, për përvetësimin e fjalorit nevojiten:[866]

- përkufizimet (përkufizimi preferohet të bëhet në gjuhën angleze, nëse kjo është gjuha e synuar në klasë. Këshillohet që të punohet me fjalorin në klasë, jo me përkufizime të thjeshtëzuara nga mësuesi.)
- përcaktimi i kontekstit të përdorimit. (kjo realizohet që në fillim të orës mësimore, kur prezantojmë një mësim të ri.)
- antonimet (duke i prezantuar nxënësit me çifte antonimesh që ta ndihmojë të kuptohen nuancat kuptimore të fjalëve. Nëse nxënësi kupton dhe njeh njërën gjymtyrë, atëherë, ai është në gjendje ta njohë edhe gjymtyrën tjetër)
- sinonimet (kur prezantohet një fjalë e re, pasi japim përkufizimin, mund të shtojmë edhe sinonimet e lidhura me këtë fjalë, të cilat qartësojnë edhe nuancat e ndryshme kuptimore mes fjalëve sinonime.)
- dramatizimi (dramatizimi apo loja me role. Mund të përdoren pjesë drame, dialogje, këngë, komanda me foljet antonime ("*close your books*" dhe "*open your books*")
- foto dhe vizatime (këto janë mjete didaktike, që mund të përdoren me moshat e vogla, të cilët mësojnë por edhe zbaviten njëkohësisht**.)**

Robert Lado në lidhje me atë çfarë një nxënës mund të ketë nevojë të dijë për një njësi leksikore, dallon si më poshtë:[867]

- çfarë do të thotë (kuptimi)

[864] L. Taylor (1992) Vocabulary in Action; English Language Teaching; International English Language Teaching

[865] R.M.L.Campillo Teaching and Learning Vocabulary, An Introduction for English Learners, f.43-44.

[866] N. K. Mehta(2004) Vocabulary Teaching: Effective Methodologies, Institute of Chartered Accountants of India

[867] R. Lado (1964) Language Teaching: A Scientific Approach, McGraw Hill: New York, f.121.

- forma (nëse ajo është një folje/emër/mbiemër, etj.)

- si shqiptohet (kjo mund të jetë veçanërisht problematike për nxënësit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj, sepse shpesh nuk ka asnjë lidhje të qartë në mes fjalës së shkruar, shqiptimit dhe theksit.)

- si është e shkruar (kjo është po aq e vështirë në gjuhën angleze, për arsyet e përmendura më lart.)

- modelet e paparashikueshme gramatikore (për shembull, "*a man- some men*", "*një burrë-disa burra*", shumësi i parregullt)

- ngjyrimin (*"bachelor", "beqare",* është një fjalë neutrale/pozitive ndërsa"*maidenish*", "*lëneshë,* jep një imazh më negativ.)

- situatat kur fjala është ose nuk është përdorur (a është *zyrtare/neutrale/jozyrtare*? përdoret kryesisht në ligjërimin e folur apo me shkrim? është e vjetëruar?)

- lidhjet semantike (për shembull, sinonime, antonime, etj.)

- lidhjet e fjalës me fjalë të tjera (*collocations*)

- çfarë ndajshtesash (parashtesa dhe prapashtesa) mund të tregojnë për kuptimin.

Sipas J. McCarten përvetësimi i fjalorit kalon në disa faza, dhe njihen mënyra të dobishme për t'i mësuar fjalët e reja:[868]

- fillimisht shpjegojmë kuptimin e fjalëve të reja

- në fazën e pas shpjegimit të fjalëve të reja, duhet që nxënësit të familjarizohen me këto fjalë duke arritur qëllimin tonë: nxënësi të njohë fjalët. Në këtë fazë mund të organizojmë një sërë ushtrimesh në ndihmë të këtij procesi, si p.sh., lidhja e fjalëve antonime me shigjeta (formohen çiftet antonime), fjalëkryqe, etj.

- për të kaluar në fazën e përdorimit të fjalëve të reja në mënyrë të pavarur, nxënësëve u kërkohet të përshkruajnë diçka që lidhet me fjalët e reja të një mësimi të caktuar. Një tjetër praktikë është edhe "shtrydhja e mendjes" (*brainstorming*), përmes së cilës nxënësit gjenerojnë fjalë të lidhura me një temë të caktuar. Gjithashtu, ndërtimi i fjalive duke përdorur fjalët e reja të mësimit është një mënyrë e efektshme në këtë proces.

- përcaktimi i kontekstit të përdorimit të fjalëve i ndihmon nxënësit të formojnë sa më shumë fjalë si p.sh., kur fjasim për motin, nxënësit përqendrohen tek kjo fushë për të prodhuar fjalë.

[868] J. McCarten (2007) Teaching Vocabulary, Cambridge University Press, New York, f.247

- lloji i mjetit që përdorim për të lehtësuar mësimdhënien dhe përvetësimin e fjalorit të ri ndryshon në varësi të moshës, nivelit, etj. Mund të përdorim edhe muzikën, këngët, prallëzat, etj. janë më të përshtatëshme për një moshë të vogël. Nga ana tjetër, përshkrimet e detajuara, "shtrydhja e mendjes" apo ndërtimi i fjalive, kërkojnë përfshirjen e një moshe më të rritur.

Nëse do të ndalemi tek prezantimi i mbiemrave, McCarten shton, se "*të kundërtat janë mënyra më e mirë për t'i prezantuar fjalët e reja*".[869] Kështu, për shembull, nëse nxënësit e njohin kuptimin e "*big*" dhe ndeshen me small "*small*", është shumë më e thjeshtë për të shpjeguar faktin se ato janë të kundërta në kuptim, dhe nxënësit e përvetësojnë më mirë atë, (në mënyrë të ngjashme edhe me "*long*" dhe "*short*", etj.)

Në lidhje me mbiemrat mund të shtojmë se është e kështillueshme që ato të ilustrohen me figura, objekte nga realiteti (p.sh. "*soft*" dhe "*rough*", do të kërkonin shumë kohë për tu shpjeguar. Nëse marrim një send "të butë" dhe një send "të ashpër" kjo do të ishte edhe më e lehtë). Për të tjerë mbiemra, më të ndërlikuar për tu shpjeguar, si p.sh., "*stunning*", "*gorgeous*", "*spectacular*", "*huge*", apo "*immense",*etj. Mund të sjellim postera apo foto të një vendi me këto cilësi s p.sh. *Luvri, Piamidat e Egjiptit, Kulla Eifel, Statuja e Lirisë*, etj. Kur bëhet fjalë për prezantimin e nocioneve abstrakte, është e vështirë që të përdorim anën pamore. Kështu, nëse do na duhej të shpjegojmë dallimin mes "*early*" dhe "*late*", mund të japim një shembull nga jeta e përditshme, si p.sh. nëse arrini në klasë përpara sesa të vijnë të tjerët, jeni "herët" (*early*), nëse vini pas të tjerëve, jeni "*vonë*" (*late*). Në përgjithësi, duke iu referuar edhe punës sonë praktike me metodat bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze, ushtrimi më i mirë me mbiemrat dhe ndajfoljet është përshkrimi i një figure, ngjarjeje, personazhi, etj.

Gjithashtu, edhe grupimi i fjalëve ndihmon në përvetësimin e fjalorit. Studimet tregojnë, se fjalët mbahen mend në trurin e njeriut, jo si një listë në fjalor, por si një sistem i organizuar. Carter dhe MC Carty[870] kanë dhënë një kontribut të veçantë në studimin e grupimit dhe lidhjeve të fjalëve.Ne do të përqendrohemi te grupimi sipas kriterit semantik, ai i lidhjeve përmes fushës semantike. Në këtë drejtim, Gairns dhe Redman listojnë këto mundësi grupimi:[871]

1. përmes temave p.sh, frutat, kafshët, etj.,
2. përmes njësive leksikore me kuptim të ngjashëm, sinonimet,
3. përmes njësive leksikore që formojnë çifte antonimesh,
4. përmes derivatevetë fjalëve, etj.

Miller dhe Fellbaum vërejnë se "*kur jepet vetëm një term nga çifti antonimik foljor, studentët e gjuhës së huaj kërkojnë t'i mësohet dhe termi tjetër*".[872] Kjo është e vërtetuar dhe nga vetë përvoja jonë në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Për shembull, nëse nxënësit apo studentët prezantohen me foljen "*agree*", ata presin që mësuesi t'u jap edhe foljen "*disagree*". Duke i'u referuar edhe njëherë përvetësimit të gjuhës tek fëmijët, kem vënë re se fëmijët kur i mësojmë një komandë foljore si "*hyp*",

[869] J. McCarten (2007) Teaching Vocabulary, Cambridge University Press, New York, f.247
[870] Carter, McCarty (1991) Vocabulary and Language Teaching, London, Longman, f.18-38.
[871] R. Gairns, S. Redman (1989) Workingwith Words, A Guide to Teaching and Learning Vocabulary, Cambridge , C.U.P
[872] G. A. Miller, C.Fellbaum (1991) Semantic Networks of English. Cognition, f. 197-229.

presin që t'ju prezantohet dhe nocioni i kundër, përmes fjalës "*zbrit*" (në mënyrë të ngjashme edhe foljet "*eja/shko*", "*hape/mbylle*" etj.).

Le të përqendrohemi te përvetësimi i gjuhës angleze, si gjuhë e dytë. Fillimisht, mund të themi se janë disa studiues të kësaj fushe e njohin antoniminë si një nga faktorët kyç të këtij procesi. Për shembull: kur prezantojmë kuptimin e fjalës "*humbas*" ("*lose*") njëkohësisht e shoqërojmë atë me termin e çiftit antonimik foljor përkatës "*fitoj*" ("*win*"). Egan pohon, se "*ne e ndiejmë se është mirë të dimë antonimin e saktë të një fjale, jo vetëm që ai të na japë kuptimin e detajuar të fjalës së cilës ai i kundërvihet, por edhe të kuptimit të vet*".[873]

Nga sa më sipër, duket qartë, se antonimia është një forcë tërheqëse në përvetësimin e gjuhës, në procesin e përvetesimit të gjuhës mëmë dhe më tej, në përvetësimin e gjuhëve të huaja e të dyta. Kështu, antonimia përbën një mjet të fuqishëm, si për studentin e gjuhës së dytë edhe për mësuesin, qëllimi i të cilit është të mundësojë përvetësimin e kësaj gjuhe në mënyrën më efikase të mundëshme, duke e bërë antoniminë një mekanizëm thelbësor në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës së huaj.

5.3.2 Roli i mësuesit në përvetësimin e fjalorit

Roli i mësuesit në hapat e mësipërm është shumë i rëndësishëm. Jo vetëm duhet që mësuesi t'i drejtoj nxënësit drejt këtyre fazave, duke i ndihmuar ata të dallojnë dhe kuptojnë fjalët e reja, por mësuesit gjithashtu kanë detyrë edhe dhënien e ushtrimeve të nevojshme për të praktikuar fjalorin. Shpesh, mësuesit japin një numër të caktuar fjalësh të reja, duke i kërkuar nxënësëve t'i mësojnë përmendësh, por nuk japin ushtrime ku ato përdoren.

Më poshtë, do të rendisim disa këshilla për mësuesit e gjuhës angleze, si gjuhë e dytë:

- mund t'i japim nxënësve disa fjalë nga fjalori dhe t'i kërkojmë atyre të gjejnë kuptimin, shqiptimin. Më pas, kërkojuni atyre, që të shkruajnë një fjali me çdo fjalë të re. Më pas, ata mund të mësojnë me njëri-tjetrin në grupe.
- mund t'i kërkojmë nxënësve të klasifikojnë një grup fjalësh në kategori të ndryshme. Për shembull, një listë të fjalëve, të mbiemrave me kuptim pozitiv e kuptim negativ.
- mund t'i kërkojmë nxënësve të gjejnë fjalët e reja nga leximi i teksteve dhe detyrat e shtëpisë, dhe t'ua mësojnë ato edhe nxënësve të tjerë në klasë.
- mund t'i këshillojmë rishikimin e fjalorit në shtëpi.
- mund t'i nxisim nxënësit drejt autonomisë duke i kërkuar atyre të lexojnë, të shikojnë filma, të dëgjojnë këngë, etj.
- mund të përdorim ngjyra të ndryshme për të dhënë përkufizimin e fjalëve të reja në tabelë.
- mund t'i këshillojmë nxënësit të blejnë një fjalor të mirë dhe të përdorin kohën në klasë për të nxjerrë kuptimin e fjalëve të reja, që ndeshen gjatë ushtrimeve në klasë.
- duhet t'i mësojmë nxënësit tanë të njohin e dallojnë pjesët e ndryshme të ligjeratës (emrat, mbiemrat, etj si edhe shkurtimet e tyre "v", "n", "adj,",etj.)

[873]Cituar nga V. Muehleisen (1997) Antonymy and Semantic Range in English. Unpublished PhD Dissertation, Northwestern University. f.4.

- duhet t'i mësojmë nxënësit tanë të njohin e dallojnë simbolet e transkiptimit të shqiptimit.
- gjithmonë duhet të mbajmë një fjalor të mirë në rast se një nxënës pyet në lidhje me një fjalë që ne nuk e njohim.
- duhet të japim shembuj shtesë të përdorimit të fjalës në klasë si edhe kërkojuni të ushtrojnë fjalorin e ri përmes detyrave të shtëpisë.

Në përfundim, duke u mbështetur në praktikë, mund të themi se dallohen shumë mënyra për të arritur te kuptimi i një njësie leksikore. Disa nga mënyrat më të zakonshme janë:

• ilustrimi (kjo është shumë e dobishme për të kuptuar fjalët e reja në mënyrë pamore, por, jo të gjitha fjalët mund të ilustrohen pasi ka edhe fjalë që shënojnë një koncept abstrakt që nuk ilustrohet lehtë.)

• imitimi (veçanërisht për foljet e veprimit dhe kjo përbën argëtim për nxënësit.)

• sinonimet, antonimet (duke përdorur fjalët që një nxënës i di paraprakisht, i ndihmojmë të kuptojnë antonimin e asaj fjale, i cili në vetvete është një fjalë e re.)

• përkufizimi (sigurohuni që ai është i qartë përmes një fjalori para mësimit, dhe mos harroni të bëni pyetje përtë kontrolluar, nëse ata e kanë kuptuar si duhet.)

• përkthimi (nëse mësuesi e zotëron gjuhën amëtare të nxënësve, atëherë ajo është e shpejtë dhe efikase,edhe pse jo çdo fjalë ka një përkthim të drejtpërdrejtë.)

• konteksti (mendoni për një kontekst të qartë.)

PËRFUNDIME

Në këtë punim u trajtuan në mënyrë të detajuar çështje që lidhen me antoniminë në gjuhën shqipe dhe angleze. Fillimisht u përqendruam në çështje të përgjithëshme që lidhen me terminologjinë dhe fushën e studimit. Më pas, u thelluam drejt objektit të studimit duke u ndalur tek antonimia në mënyrë të veçantë. Vlen për t'u përmendur trajtimi i çështjes që lidhet me qasjen paradigmatike dhe sintagmatike ndaj antonimeve në të dyja gjuhët. Kategorizimi në të dyja gjuhët, atë angleze dhe shqipe, u analizua në mënyrë të detajuar duke përballur qasje të autorëve të ndryshëm, studiues në këtë fushë. Me interes rezultuan të jenë edhe kategorizimet moderne, të cilat vijnë si rezultat i studimeve me natyrë metagjuhësore, psikolinguistike, eksperimentale, etj.

Në vijim, trajtuam lidhjen e antonimisë me poliseminë, duke u ndalur në gërshetimin e këtyre marrëdhënieve leksiko-semantike. Në kalimin nga njëri kapitull te tjetri, thellohemi gjithnjë e më shumë në çështjet e antonimisë, duke u përqendruar tek antonimia mbiemërore dhe foljore e gjuhës shqipe dhe angleze. Herë-herë jemi munduar të bëjmë ndonjë përqasje në lidhje me dallimet dhe të përbashkëtat e antonimeve në të dyja gjuhët, edhe pse përgjithësisht dallohet një qasje e ngjashme në të dyja gjuhët, kryesisht në drejtimin semantik. Për sa i përket kategorizimit dhe veçorive strukturore, vërejmë se zgjerohet mundësia e qasjes krahasimore. Në vazhdimësi, në kreun e fundit, trajtuam edhe disa çështje të lidhura me studimet praktike, kryesisht nga studiues të huaj, por jo vetëm.

Një pjesë e rëndësishme për t'u përmendur është edhe analiza e studimeve tona rreth antonimisë. Theksojmë se këto dy studime, me natyrë tërësisht të ndryshme, dëshmojnë një përpjekje tonën për të hulumtuar në këtë drejtim, edhe pse studime të tilla janë të pamjaftueshme e kërkojnë të zgjerohen në të ardhmen. Më poshtë do të përmbledhim disa nga përfundimet e dala gjatë punimit sipas kapitujve përkatës.

Në kreun e parë, u ndalëm në disa probleme që lidhen me fushën e leksikologjisë dhe semantikës. Leksikologjia është një degë e gjuhësisë e cila studion leksikun e gjuhës. Theksuam se nuk duhet ngatërruar termi leksikografi dhe leksikologji si edhe rolin i antonimve në këto dy drejtime. Për më shumë, trajtuam çështje të tilla si, detyrat kryesore të leksikologjisë, qasjen sikronike, diakronike, objektin e leksikologjisë, etj. Gjithashtu, në kreun e parë pamë diçka në lidhje me strukturën e artikullit për çdo fjalë, ku gjetëm edhe antoniminë si pjesë përbërëse të kësaj strukture. Në këtë mënyrë, dalluam edhe rolin e antonimeve në fjalor duke theksuar se fjalorët në përgjithësi, si edhe fjalorët e nxënësve në mënyrë të veçantë, përbëjnë një mjet të rëndësishëm në procesin e përvetësimit të gjuhës së huaj. Qëllimi kryesor i një fjalori për nxënësit e gjuhës me një korpus të gjerë është t'u paraqesë atyre informacion të dobishëm, i cili do t'i ndihmojë të ndërtojnë lidhjet midis fjalëve dhe kuptimeve në mënyrë të ngjashme me folësit vendas. Theksuam kështu rëndësinë e rigrupimit të fjalëve në fjalor mbi bazën e antonimisë dhe sinonimisë, duke u mbështetur në faktin se në mikrostrukturën e fjalorit gjendet informacion në lidhje me kategorinë gramatikore, përkufizimin, shembujt, njësinë leksikografike, shqiptimin, theksin, sinoniminë dhe antoniminë.

Fjala dhe nocioni zënë një vend të konsiderueshëm në kreun e parë duke u përqendruar në përgjigjen e pyetjes "Çfarë kuptojmë me termin *fjalë* në leksikologji?". Trajtuam qasje të ndryshme ndaj përkufizimit të fjalës: duke iu referuar paraqitjes apo formës së saj, mendimit që ajo shpreh, apo kriterit formal. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis "*fjalës leksikore*" dhe "*fjalës gramatikore*". U ndalëm tek *fjala*, pasi objekti

i studimit tonë janë pikërisht fjalët e mëvetësishme, apo leksikore, të cilat u përkasin dy kategorive gramatikore më kryesore, mbiemrat dhe foljet antonime në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Leksema do të jetë në qendër të studimit tonë, pasi ajo përbën një emërues të përbashkët në inventarin e formave të paradigmës, e cila e dallon fjalën nga sintagma dhe fjalia. Për më shumë, në lidhje me fjalën, u thelluam me fjalët transparente përballë fjalëve opake: në gjuhën shqipe fjala "*mendjelehtë"*është transparente, ndërsa në gjuhën angleze ajo del si opake,"*frivolous"*. Kjo dëshmon se fjala mund të përbëhet nga disa pjesë të kuptimit dhe se këto ndarje në "copëza kuptimore" kanë natyrë arbitrare. Gjithsesi, nuk është e lehtë të përcaktohen këto elemente semantike brenda fjalës.

Fjalët *fonoestetike*, karakteristikat fonologjike të të cilave paraqesin kuptime të caktuara, paraqesin interes të veçantë, si për shembull: fjalët që në gjuhën angleze fillojnë me "*sl*-" përdoren me kuptim *rrëshqitës dhe* në kuptim *keqësues*. Gjithsesi, dolëm në përfundimin se *këto karakteristika fonologjike nuk mund të jenë gjithëpërfshirëse, pra ka edhe përjashtime që tregojnë se sl- para një fjale nuk ka asnjë nga kuptimet e mësipërme.*

Nga sa më sipër, nocioni i termit "fjalë" përbën një çështje komplekse në studimin e gjuhës në rrafshin semantik, një studim i cili kërkon të njihen parimet e mësipërme për të dalluar tiparet e veçanta të termit "*fjalë"*. Pra, fjala nuk është thjesht një njësi semantike natyrale (si njësi e izoluar brenda hapësirave veçuese nga fjalët e tjera), pasi do të ishte shumë e thjeshtë ta ngushtojmë nocionin *fjalë* deri në këto kufizime. Si përfundim, mund të përmbledhim karakteristikat e fjalëve. Nga shqyrtimi i literaturës përmblidhen katër karakteristika të rëndësishme në përkufizimin e termit "fjalë":

1. Fjala është një njësi e pandashme.

2. Fjala mund të përbëhet nga një ose më shumë morfema (kur përbëhën nga një ose më shumë morfema quhen fjalë të thjeshta), ndërsa kur fjalët përbëhen nga më shumë se një morfemë ato mund të jenë të përbëra dhe komplekse.

3. Fjala gjendet në strukturën e frazës dhe, nëse do t'i qasemi hierarkisë strukturore, do të thoshim se morfemat përdoren për të ndërtuar fjalë, fjalët për të ndërtuar fraza, frazat për të ndërtuar "sifjali"[874] *(clauses) dhe sifjalitë për të ndërtuar periudhë.*

4. Fjala i përket një klase të caktuar apo një pjese të ligjëratës.

Në vijimësi u ndalëm në çështje që lidhen me semantikën, historikun dhe terminologjinë e semantikës, përkufizimin , qasjet e ndryshme ndaj semantikës: (filozofike dhe gjuhësore), llojet e ndryshme të semantikës, etj. Lidhja dhe marrëdhëniet kuptimore janë në qendër të këtij punimi, dhe vërtetuam se fjalët në një gjuhe të caktuar lidhen në mënyra të ndryshme, të cilat kanë natyrë jo vetëm gramatikore, por kryesisht natyrë semantike, siç janë edhe sinonimet, antonimet, etj.

Përpos çështjeve që lidhen me fjalën, në kreun e pare, gjithashtu, i dhamë përgjigje pyetjes: "*Ç'është kuptimi i fjalës?"*. Semantika ka të bëjë me mënyrën se si e lidhim gjuhën me eksperiencën tonë dhe si e tillë referenca është një aspekt i rëndësishëm i semantikës. Nga ana tjetër, edhe marrëdhëniet e nuancave kuptimore kanë një rol të rëndësishëm në studimin e gjuhës në përgjithësi, por edhe të antonimisë në veçanti. **S**i përfundim, mund të themi se një teori e kuptimit është e plotë atëherë kur përfshin si

[874]Shënim: terminologji e re e përdorur nga M. Çeliku (2012) Sintaksë e Gjuhës Shqipe, Tiranë

nuancën kuptimore, pra aspektin brendagjuhësor, ashtu edhe *referencën,* apo marrëdhënien e gjuhës me botën.

Në vijim, semantika, antonimet dhe strukturalizmi u trajtuan në mënyrë të përgjithësuar në kreun e parë. Versionet më të njohura janë teoria e shenjës së De Saussure dhe trekëndeshi i Ogden dhe Richards. Sipas kësaj qasjeje, "*gjuha perceptohet si një sistem autonom i marrëdhënieve paradigmatike dhe sintagmatike ndërmjet fjalëve*". Në këtë qasje dallojmë kontributin e themeluesit të strukturalizmit, De Saussure, të pasuar nga gjuhëtarë me kontribut kryesor në studimin e antonimisë, si Firth, Lyons, Cruse, Lehrer, Sinclair, Halliday, etj. Përmes qasjes strukturaliste kuptojmë konceptin si një *sistem ku elementet kanë lidhje paradigmatike midis tyre* (e cila është lidhje tipike e antonimeve në gjuhë).

Nga ana tjetër, pamë diçka në lidhje me gjenerativistët, me përfaqësues kryesor Chomsky. Ata nuk ishin të interesuar të dallonin kuptimin, vlerën apo përmbajtjen e fjalës dhe u përqendruan te *fraza*, dhe jo te *fjala*. Në këtë mënyrë ata e ndajnë shprehjen gjuhësore nga përmbajtja. Chomsky dallon shumë nga De Saussure për sa i përket sistemit të gjuhës apo kompetencës, por dallimi teorik është i njëjtë. Të dy merren kryesisht me përjashtimin e asaj që është thjesht individuale, apo aksidentale (të folurit apo performanca) dhe ngulmojnë tek studimi i mirëfilltë i gjuhës, apo kompetencës së saj. Si për Saussure dhe për Chomsky, gjuha apo kompetenca është një lloj sistemi i idealizuar, pa ndonjë bazë njohëse të qartë, prandaj dhe preferohet të flitet në terma të përgjithshme.

Në punimin tonë kundërvënia kuptimore është thelbi i analizave studimore. Kuptimi leksikor është në qendër të marrëdhënieve leksiko-semantike dhe ne jemi përqendruar në të. Tipologjia e kuptimeve u trajtua me përparësi, duke u ndalur në kuptimet dytësore dhe kuptimet kryesore, kuptimin bazë dhe kuptimin e prejardhur, kuptimin e drejtpërdrejtë dhe kuptimin e figurshëm, kuptimin neutral dhe kuptimin shprehës, kuptimet e pavarura nga konteksti dhe kuptimet kontekstore, kuptimet denotative dhe kuptimet konotative, kuptimin e ngushtuar dhe kuptimin e zgjeruar, etj. Të gjitha fjalët kanë kuptim leksikor, por shkalla e qartësisë së këtij kuptimi është e ndryshme.

Në lidhje me ngjyrimin emocional mund të themi se të gjitha gjuhët kanë një vlerë të caktuar emocionale e cila është tregues i qendrimit të folësit ndaj asaj që ai thotë. Në kapitujt e mëposhtëm, do të zgjerojmë lidhjen e ngjyrimit emocional me antoniminë, duke u ndalur edhe tek katëgoria e antonimeve stilistike.

Tipet e marrëdhënieve kuptimore, gjithashtu, paten një rëndësi të veçantë në këtë kre. Marrëdhëniet semantike në nivelin e fjalës përfshijnë sinoniminë, antoniminë, homoniminë, poliseminë, metoniminë, etj. Dy nga marrëdhëniet më të dukshme janë ato të "*ngjashmërisë*" dhe të "*kundërshtisë*", të cilat njihen ndryshe si *sinonimi* dhe *antonimi*. Marrëdhënie të tjera përfshijnë *homoniminë* dhe *metoniminë,* të cilat përbëjnë marrëdhënie hierarkike midis fjalëve, ku një fjalë me një kuptim të përgjithshëm përfshin kuptimin e fjalëve të tjera me kuptim më specifik.

Në vijim trajtuam fushën konceptore, leksikore dhe semantike**.** Sistemet dhe nënsistemet e koncepteve në botën e dukurive diskrete apo jodiskrete quhen *fusha konceptore*. e fjalëve që mbulojnë fushën konceptore formon një *fushe leksikore*. Kuptimet e një fjale që dalin nga lidhjet e saj në sintagma përbëjnë fushën semantike të asaj fjale. Një fushë semantike përmban fjalë që i përkasin një fushe të përcaktuar të

kuptimit (psh. *bimët, arsimi, ngjyrat* etj). Karakterit sistematik të gjuhë.Kuptimet e një fjale që dalin nga lidhjet e saj në sintagma përbëjnë *fushën semantike* të asaj fjale, kështu që struktura kuptimore e fjalëve studiohet sipas boshtit paradigmatik dhe sipas boshtit sintagmatik. antonimia është studiuar vetem përmes boshtit paradigmatik, duke zëvendësuar fjalët në një thënie, por më pas u zgjerua studimi edhe në boshtin sintagmatik, ku vërehen kombinimet e fjalëve antonime, pra studiuesit e ndryshëm nuk janë dakord me ndarjen sipas boshtit paradigmatik të studimit të sinonimisë, antonimisë dhe hiponimisë dhe sipas boshtit sintagmatik të studimit të polisemisë dhe homonimisë, pasi tashmë gjuhësia e ka zgjeruar studimin e antonimisë, duke përfshirë edhe boshtin sintagmatik.

Çështje tjetër në këtë kre është edhe analiza e përbërësve kuptimor duke u ndalur tek "*tiparet dalluese*", "*elementet dalluese*", "*semat*", etj. Vështirësia qendron tek numri i "*tipareve shënuese*", i cili mund të jetë shumë i madh dhe e vështirëson analizën. Të analizosh përbërësit kuptimorë tek emrat antonimë është më e thjeshtë, ndërsa te kategoritë e tjera nuk është aq e lehtë, pasi ato nuk kanë tipare fizike universale. Në përgjithësi, përbërësit kuptimorë në analizë trajtohen në formën e "*kundërvënies binare*", të ngjashme me natyrën e antonimeve plotësuese. antonimet ndihmojnë edhe në shpjegimin semantik të përbërësve kuptimorë të fjalëve në fjalorë. Në kontekstin e përbërësve kuptimorë, antonimet ndajnë pothuajse të gjitha *tiparet semantike* përveç njërit. Tipari të cilin ato nuk e ndajnë ndodhet në njërën nga gjymtyrët e çiftit dhe mungon në gjymtyrën tjetër. Si përfundim, mund të themi se kjo analizë ka vlerat e saj në analizën e marrëdhënieve semantike, por nuk mund të aplikohet njësoj për të gjitha dhe paraqet probleme praktike.

Në përfundim të kapitullit, por me rëndësi të veçantë janë edhe lidhjet paradigmatike dhe sintagmatike. Natyra e lidhjeve paradigmatike dhe sintagmatike me interes të veçantë. Lidhjet sintagmatike dhe paradigmatike dallohen në të gjitha rrafshet e gjuhës dhe funksionojnë në formën e një tërësie rregullash, të cilat përbëjnë sintagmatikën dhe paradigmatikën e një rrafshi të caktuar.Përbërësit e sintagmës krijojnë lidhje kundërshtie, ndërsa ato të paradigmës krijojnë lidhje kundërvënieje me njëra-tjetrën. Raportet sintagmatike janë lineare, të tipit " *dhe …dhe* ", ndërkohë që vetëm njëra nga gjymtyrët e paradigmës përdoret në ligjërim dhe kjo lidhje njihet si lidhja "*ose…ose*". Lidhjet paradigmatike në mënyrë tradicionale janë cilësuar si mënyra e vetme e studimit të antonimeve në gjuhë. Antonimia konsiderohet një marrëdhënie kuptimore me *natyrë paradigmatike,* për arsye se ka të bëjë me një zgjedhje midis fjalëve, apo zëvendësimin e një fjale me një tjetër në një kontekst të caktuar. Kështu struktura kuptimore e fjalëve duhet analizuar sipas dy rrafsheve:

- sipas boshtit paradigmatik, nëpërmjet të cilit zbulohen lidhjet e zëvendësimit midis fjalëve në një thënie.

- sipas boshtit sintagmatik, që lejon të shtrihen kombinimet e mundshme të kuptimeve të fjalës".

Lidhjet e antonimeve brenda kontekstit dhe bashkrenditja e çiftit antonik, lidhja e rrafshit sintagmatik me frazeologjinë si një nga proceset e zhvillimit të studimeve të lidhjeve kuptimore, lidhjet me bashkërenditje, të cilat përfshijnë disa nëntipe, etj.

Si përfundim, themi se analiza semantike e çifeve antonime dhe përcaktimi i tyre brenda një kategorie apo një tjetre, është i lidhur ngushtë me qasjen ndaj analizës në rrafshin paradigmatik dhe sintagmatik.

Në kreun e dytë, u ndalëm në antonimet në gjuhën shqipe dhe angleze duke trajtuar çështje që lidhen me historikun, terminologjinë, përkufizimin dhe burimet e antonimisë në gjuhën shqipe dhe angleze. Përkufizimi i antonimeve u bë sipas kritereve të ndryshme, ku dalluam dy mënyra kryesore tradicionale përkufizimi të antonimisë: së pari, ai që përfshin *kriterin semantik,* dhe, së dyti, ai që përfshin *kriterin leksikor*. Për më shumë, me zhvillimet e fundit në fushën e gjuhësisë, dallojmë edhe kriterin e *konfigurimit të përmbajtjes,* si një tjetër kriter të rëndësishëm në përcaktimin e antonimeve. Kategorizimi sipas kriterit të konfigurimit rezulton si qasje e re, sipas të cilës antonimet përkufizohen si "*kundërvënie binare në gjuhë dhe në mendim"*. Në këtë qasje, antonimia është përkufizuar sipas dy këndvështrimeve kryesore: përmes konfigurimit apo skemës dhe përmes përmbajtjes. Në lidhje me përkufizimin, themi se antonimia duhet të përkufizohet sipas kritereve leksikore, ashtu edhe atyre semantike, pasi ajo është një fenoment i lidhur me fjalët dhe jo me konceptet. Si përfundim**,** ne jemi të mendimit se, përkufizimi i antonimisë duhet t'u përmbahet të dyja këndvështrimeve, atij leksikor dhe atij semantik. Antonimet duhet të kenë kundërvënie kuptimore, por ato gjithashtu duhet të kenë edhe një marrëdhënie të fuqishme dhe të mirëpërcaktuar me njëra-tjetrën. Ato çifte fjalësh, të cilat u përmbahen të dyja këtyre kritereve, njihen si "*prototipe ose kanonike*" ndërkohë që ato tipe fjalësh të cilat, i përmbahen vetëm kriterit leksikor, njihen si "*jokanonike ose periferike*" nga Cruse dhe Murphy.

dalluam tri tipe kryesore antonimesh në bazë të kriterit semantik në gjuhën angleze:

- Antonime *plotësuese ose kontradiktor*e, të cilat janë çifte fjalësh, me të cilat një gjymtyrë ka një tipar semantik të caktuar, të cilin gjymtyra tjetër nuk e ka. p.sh., "*male/female"* (mashkullor/femërore), "*married/unmarried"* (i martuar/i pamartuar), "*complete/incomplete"* (i plotë/i paplotë), "*alive/dead*" (i gjallë/i vdekur), "*present/absent"* (i pranishëm/i muguar), "*awake/asleep"* (i zgjuar/i përgjumur), etj.

- *Antonimet marrëdhëniore* janë çifte fjalësh, në të cilat prania e një tipari semantik të caktuar në një nga gjymtyrët nënkupton praninë e një tjetër tipari semantik në gjymtyrën tjetër.p.sh., "*buy/sell"* (blej/shes), "*stop/go"* (ndal/iki), etj., si edhe disa mbiemra në formë krahasore të tipit "*taller/shorter"* (më gjatë/më shkurtër),"*cheaper/more expensive"*(më e lirë/më e shtrenjtë), etj.

- *Antonimet e shkallëzuara* janë ato çifte fjalësh, të cilat kundërvihen në lidhje me masën e zotërimit të një tipari semantik të caktuar.p.sh: "*hot/cold*" (i nxehtë/i ftohtë), "*big/small*" (i madh/i vogël), "*tall/short*" (i gjatë/i shkurtër), "*good/bad*" (i mirë/i keq), "strong/weak" (i fortë/i dobët), "*beautiful/ugly*" (e bukur/e shëmtuar), "*happy/sad*" (i lumtur/i trishtuar), "*fast/slow*" (i shpejtë/i ngadaltë), etj.

Në lidhje me burimet e antonimisë, dalluam prejardhjën si burimi kryesor. *Nevoja për të kundërta të leksikalizuara është në rënie për shkak të prodhueshmërisësë mjeteve morfologjike negative apo mohimit përmes frazave.*leksikalizohen nëse kundërvënia ka

rëndësi kulturore.(*mail/email/snail-mail*). Burim tjetër antonimesh janë kategoritë shoqërore (ka të bëjë me orientimin racor dhe seksual p.sh.,"*homoseksual*" më pas u shut në fjalor edhe*"homosexual"*). Burim tjetër i ndryshimeve semantike kemi edhe brenda marrëdhënieve semantike ekzistuese(me zgjerim kuptimi të çiftit p.sh., "*hot/cold" (i nxehtë/i ftohtë*).Pra, antonimet kanonike lëvizin drejt një fushe tjetër semantike përmes zhvendosjes metaforike, e cila i bën të dy gjymtyrët të përshtatshëm në dy fusha të ndryshme: A dhe B (jo gjithmonë mundet që gjymtyrët antonime të ndjekin njëra–tjetrën në zhvendosjen antonimike, p.sh. "tall tale" nuk përdoret në kundërënie me "short tale"). Enantiodromia, gjithashtu, trajtohet si burim, e cila njihet si *procesi përmes të cilit diçka kthehet në të kundërtën e vetes.* P.sh.,përdorimi i mbiemrit "*bad"(i keq)* në zhargon me kuptimin "*good" (i mirë)*

Problematikat rreth natyrës së kundërvënies zënë një vend të rëndësishëm në kreun e dytë, pasi, në studimet e shumta të antonimisë si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, vërejmë se ka vatër debatesh gjuhësore në lidhje me atë çka përbën antonim, në dallim me papajtueshmërinë, mohimin, shkallëzimin, etj. Më poshtë po listojmë disa nga rezultatet e lidhura me këto çështje:

- fjalët e papajtueshme nuk kanë asnjë përbërës kuptimor të përbashkët, ndryshe nga ato antonime të cilat lidhen mes tyre përmes elementëve të përbashkët. sistemii ngjyrave, të cilat ndajnë të njëjtën fushë, por kanë vlerat e tyre, të cilat nga marrëdhënia e kundërvënies rezultojnë të jenë të papajtueshme për disa studiues. Disa të tjerë i shohin ato si antonime përmes intensitetit që ka çdo ngjyrë në raport me të tjerat. Ngjyrat vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh të hapura për nga natyra e tyre semantike.

- përfshirja ose jo në kundërvënie antonimike e pjesëzave mohuese ose jo, bashkë me parashtesat negative si mjete fjalëformuese. duhet bërë dallimi midis mohimit të mbartur në kundërvënie dhe mohimit përmes formave gramatikore, siç janë pjesëzat mohuese.si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe, ato nuk formojnë çifte antonimesh, pasi janë të palidhura morfologjikisht me parashtesat negative.përdorimin e pjesëzave mohuese kemi të bëjmë me një mohim sintaksor.është e rëndësishme që fjala antonimike me kuptim kundërvënës fillimisht të pohojë veten, pastaj të mohojë tjetrën. Pra, pjesëzat nuk e përmbushin këtë kriter.Si përfundim, mund të përmbledhim mendimin tonë, se antonimet nuk janë një mohim i thjeshtë i tipareve semantike të një fjale tjetër, pasi ato e plotësojnë njëra-tjetrën duke u kundërvënë. Themi, se antonimet qendrojnë në një unitet të mohimit dhe pohimit nga këndvështrimi kundërvënës. Gjymtyrët e çiftit antonimik, si rezultat janë të dallueshme, të ngjashme ashtu sikurse kanë dhe një përbërës që i kundërvë me njëra-tjetrën.

- mund të themi se kundërvënia ndërmjet gjymtyrëve të çiftit antonimik nuk është e lehtë të përcaktohet, pasi kërkon që të studiohen mirë përbërësit e kuptimit të këtyre gjymtyrëve. Në varësi të qendrimit subjektiv të folësit, ndonjëherë kemi edhe kalim të një çifti antonimesh nga njëri tip i kundërvënies në një tip tjetër. Megjithatë, nuk flitet për kufij të prerë në gjuhësi. Shkallëzimi është me interes në studim, pasi ndihmon të analizojmë kuptimet dhe raportin e çifteve antonimike tek kundërvënia e pjesshme, ndërkohë që antonimia e plotë shihet te kuptimi kryesor. Fakti që ekziston një mundësi shkallëzimi për antonimet e pashkallëzuara, nuk do

të thotë se nuk ekziston një dallim i qartë midis antonimeve të shkallëzuara dhe të pashkallëzuara në sistemin gjuhësor.

- rezulton se kundërvënia del, jo vetëm përmes tipareve semantike, por edhe atyre pragmatike, ku konteksti dallon se cila nuancë kuptimore është e përshtatshme. Si rezultat, themi se kundërvënia në një kontekst neutral është më e kufizuar dhe shpeshherë më e preferuar për të përcaktuar antonimet kanonike, ndërkohë që marrja parasysh e kontekstit e vështirëson, por edhe e qartëson, më shumë kundërvënien.

Në vijim, u trajtuan edhe marrëdhënia e antonimisë me sinoniminë dhe poliseminë, si dukuri leksiko-semantike, tek mbiemrat dhe foljet, në gjuhën angleze dhe shqipe. Këtu theksojmë rëndësinë e pragmatikës për të bërë dallimin mes marrëdhënieve të ndryshme semantike si antonimia, sinonimia, hiponimia etj. Sinonimia dhe polisemia janë të rëndësishme për studimin e antonimeve, pasi *në bazë të kuptimeve të kundërta të fjalëve polisemike dhe të afërsisë që ato kanë me fjalë të tjera, krijohen disa tipe a modele lidhjesh ndërmjet vargjeve sinonimike e antonimike.* Për më shumë, njohja e strukturës polisemantike të fjalëve do të ishte me shumë rëndësi për studimin e marrëdhënieve të antonimisë që vendosen midis njësive sinonimike. Fjalët polisemantike mund të vendosin marrëdhënie sinonime në një ose disa prej kuptimeve të tyre, por jo në të gjitha.

Në lidhje me marrëdhënien e antonimisë me poliseminë, si dukuri leksiko-semantike tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe, theksojmë se në kuptime të ndryshme, një fjalë mund të ketë antonime të ndryshme, p.sh., mbiemri "*short" (e shkurtër),* kur përdoret për të treguar gjatësinë e një historie, "*short story" (histori e shkurtër),* ka si antonim mbiemrin "*long" (e gjatë),* por kur mbiemri "*short"*përdoret për të treguar gjatësinë e një njeriu, "*short man" (burrë i shkurtër*), merr si antonim "*tall"*(i gjatë), "*tall man*" (*burrë i gjatë*). Ndërkohë, në shprehjet e ngurtësuara apo frazeologjike, kur përdoret fjala *short,* ajo ka kuptim tjetër dhe si pasojë edhe antonimi është i ndryshëm, si p.sh., "*be short with somebody/ be civil with somebody*" (të jesh i pasjellshëm, arrogant me dikë/të jesh i sjellshëm me dikë). Nga shembujt e mësipërm kuptojmë, se mbiemri, në varësi të emrit që përcakton, merr nuanca të ndryshme kuptimore, dhe si rezultat edhe antonime të ndryshme.*shpesh njëri kuptim i një fjale hyn në lidhje antonimike me një fjalë të caktuar, ndërsa një kuptim tjetër i kësaj fjale formon antonim me një fjalë tjetë*rpsh.: "*i fortë/i butë","i fortë / i dobët"*, etj.

Antonimet e formuara nga polisemia kanë kundërvënie të pjesshme, sepse kundërvihen kuptimet e dyta.vërejmë se disa fjalë me përbërje fonetike të njëjtë kanë kuptime të ndryshme në kundërshti me parimin themelor të antonimisë, e cila ekziston në fjalë me përbërje fonetike të ndryshme,njihet ndryshe si enantiosemi p.sh., folja "*godit*" ka kuptimin "*ndërtoj", "rregulloj"* por ka edhe kuptimin "*qëlloj", "i bie"*.polisemia mund të krijojë probleme në përcaktimin e pikës së mesme neutrale, e cila lejon shkallëzimin e disa tipeve të antonimisë. Interes përbën edhe fakti se shumë "*nga modelet e polisemisë janë të zakonshme në shumë gjuhë*". Kështu, p.sh., çifti mbiemëror "*big/little" (i madh/i vogël)* përdoret në kuptimin *old/young (i vjetër /i ri)* si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Për sa i përket marrëdhënies së antonimisë me sinoniminë, si dukuri leksiko-semantike, tek mbiemrat dhe foljet në gjuhën angleze dhe shqipe, vërejmë se gjymtyrët antonime mund të hyjnë në kundërvënie edhe me sinonimet e tyre, dhe kjo realizohet në mënyrë paralele ose të ndërthurur. Antonimia është parë edhe si e kundërta e sinonimisë

me argumentin se, nëse dy fjalë janë antonime ato ndryshojnë në kuptim dhe formojnë dy pjesë plotësuese të ndryshme. Megjithatë, ky këndvështrim nuk qendron për arsyet që i kemi argumentuar më lart kur trjatuam antoniminë përballë mohimit, etj. Për sa i përket raportit me sinoniminë, mund të themi, se pothuaj çdo fjalë mund të ketë një apo më shumë sinonime, por shumë pak fjalë kanë antonime. Si rezultat, themi se kundërvënia në raport me ngjashmërinë (sinonimin) nuk është aq e përhapur, por ashtu si edhe sinonimia, ka një rol të rëndësishëm në ristrukturimin e fjalorit të gjuhës.

Antonimia stilistike si edhe sinonimia stilistike luajnë një rol të rëndësishëm në theksimin e idesë, e cila përcillet te lexuesit dhe dëgjuesit. Me interes është edhe fakti se të gjitha antonimet kanë sinonime të cilat i rezistojnë antonimisë. Kështu, pavarësisht se "*miserable*" dhe "*ecstatic*" i përkasin të njëjtës fushë semantike, asaj të lumturisë, këto fjalë nuk e kanë fuqinë antonimike të kundërvënies "*happy*" dhe "*sad*". Rëndësia që kanë antonimet gjatë dallimit të sinonimeve. Vërejmë se edhe fjalët antonime të përbëra e të përngjitura mund të hyjnë në marrëdhënie sinonimie me njëra-tjetrën. P.sh., kompozita "*fjalëpakë"* mund të hyjë në marrëdhënie sinonime me *fjalëkursyer*, kurse "*fjalëshumë"* mund të hyjë në marrëdhënie sinonimie me "*fjalëmadh"* ose "*fjalëgjatë"*. Për më shumë, përmblodhëm disa lloje antonimesh sinonimike:

- Një fjalë monosemantike, që ka si antonim dy ose më shumë sinonime
- Antonime sinonimike, ku gjymtyrët kanë një numër jo të barabartë sinonimesh, të cilat hyjnë në kundërvënie.
- Antonime të degëzuara, jo paralele me kahje të ndryshme.

Pamë përmbledhurazi karakteristikat dhe tiparete përbashkëta të antonimeve mbiemërore dhe foljore. Pamë se antonimia është përcaktuar si një marrëdhënie *binare, simetrike, jorefleksive* dhe *jokalimtare*. Dolëm në përfundimin se disa çifte janë "*antonime më të gjetura*" se disa të tjera. Këtu dallohen njësitë leksikore, të cilat lidhen ngushtë me një gjymtyrë partnere në gjuhë të cilët njihen si "*qenësisht binare*" në segmentin kuptimor. Tipar tjetër me rëndësi është edhe ai i *shënimit*. Në lidhje me tiparin binar u përqendruam në përcaktimin e kushteve të binaritetit, katër tipet e binaritetit, etj. Si rezultat, dolëm në përfundimin se *të kundërtat janë binare në thelb, pra janë binare për shkak të një domosdoshmërie logjike.* Tipari i gjymtyrës së shënuar është një burim kryesor i asimetrisë ndërmjet gjymtyrëve të çiftit antonim. Ky tipar i antonimeve del qartë, pikërisht brenda mbiemrave të shkallëzuar, të cilët kanë një shpërndarje asimetrike brenda çiftit. Përmes analizës së shembujve dolëm në përfundimin se gjymtyrët e pashënuara përdoren në mënyrë neutrale. Gjithashtu, përmblodhëm edhe mënyrat më të zakonta, në të cilat ndodh neutralizimi për mbiemrat antonimime. Si rezultat, përmes qasjes krahasimore, u theksua edhe fakti se shënimi përbën një raport universal në të gjitha gjuhët.

Bazuar në provat e shoqërimit të fjalës, rezulton se marrëdhënie të caktuara antonimike mund të ruhen në mendjen tonë sipas drejtimeve të ndryshme që ato kanë. Ndërkohë që shpërndarja asimetrike e gjymtyrëve të çiftit tregon edhe natyrën e tyre semantike asimetrike. Megjithatë, pamë, se jo të gjithë mbiemrat janë asimetrikë. Në lidhje me bindjen e bazuar tek tradita se fjalët në një marrëdhënie paradigmatike duhet të jenë të zëvendësueshme nga njëra-tjetra në të gjitha kontekstet, e hedh poshtë shembulli i mëposhtëm:

How *big* is your house?
(Sa e madhe është shtëpia jote?)

(këtu *big* nuk mund të zëvendësohet me *small*)

Kreu i tretë, përqendrohet kryesisht te tipologjia e përgjithshme në gjuhën shqipe dhe angleze. Pamë se si antonimet tradicionale qendrojnë përballë kategorive të reja. Vërejmë se duke qenë, se përkufizimi i shumicës së studiuesve të semantikës ka natyrë logjike, ata kanë dalluar shumë nënkategori të kundërtash, si pasojë e kësaj natyre logjike të të menduarit. Por, jo të gjitha të kundërtat hyjnë në marrëdhënie logjike të njëjta, e si pasojë edhe kategorizimi është i larmishëm. Në shumëllojshmërinë e kategorizimit dallojmë antonimet *klasike kanonike* me bazë logjike dhe, nga ana tjetër, ato të cilat shihen si *kategori të reja* në qasjet metalinguistike ndaj antonimeve. Dalluam dy grupe kryesore studiuesish: ata tradicionalë, dhe, nga ana tjetër, ata të cilët e zgjerojnë studimin e tyre përtej teorisë dhe logjikës, duke përfshirë edhe koncepte të reja, siç janë korpusi dhe studimi i tij, konfigurimi i përmbajtjes, eksperimentet inovative, përdorimi i antonimeve në gjuhë, konteksti, bashkërenditja, etj. Për sa i përket studimeve në gjuhën shqipe kemi vërejtur, se fakti që nuk janë të shumtë emrat e studiuesve, të cilët kanë hulumtuar në këtë drejtim të gjuhësisë shqipe ka sjellë edhe një mungesë debati të fortë për çështje që lidhen me kategorizimin apo përdorimin e antonimeve në gjuhën shqipe. Është vënë re, se ka pasur një proces reflektimi e hulumtiminë lidhje me atë që kuptohet me fjalën antonim, por zakonisht këto reflektime janë bërë nga vetë studiuesit, e jo në vatrën e debatit gjuhësor.

Në këtë kapitull kemi parë se si paraqitet tipologjia e përgjithshme e antonimeve në gjuhën shqipe dhe angleze. Kemi përballur antonimet tradicionale me kategoritë e reja. Fillimisht, trajtuam çështje që lidhen me tipologjinë tradicionale semantike dhe strukturore në gjuhën angleze. Më tej, paraqitëm një klasifikim të përgjithshëm tradicional të antonimeve në gjuhën shqipe duke u ndalur te katër parametrat kryesorë në përcaktimin e antonimisë në gjuhën shqipe:

- *parametri i parë është mohimi*
- *parametri i dytëështë boshti i përbashkët semantik, i cili lidh a bashkon fjalët ose dy gjymtyrët e një çifti antonimik me njëra–tjetrën*
- *parametri i tretë është mundësia e krahasimit midis gjymtyrëve antonimik nga kuptimi.*
- *parametri i katërt,shkalla e caktuar e kundërvënies së kuptimit.*

Siç e pamë më lart, klasifikimi i antonimeve sipas kriterit semantik është më i ndërlikuar në krahasim me atë strukturor, pasi ai mbështetet në strukturën kuptimore të tyre, në karakterin e kuptimeve leksikore të kundërta dhe në tipin e tyre, në përbërësit e kundërt kuptimplotë, që marrin pjesë për kundërvënien e fjalëve nga kuptimi dhe në shkallen e antonimisë a të kundërvënies.

Klasifimikimin kuptimor e pamë në disa këndvështime:

- duke u mbështetur *në strukturën kuptimore*
- duke u bazuar në *tipin e kuptimeve*, fjalët antonime mund të kundërvihen në kuptimet *parësore (themelore), të prejardhura, të figurshme.*
- duke u mbështetur në karakterin ose në *shkallën e kundërvënies së kuptimeve,* nga ana semantike, fjalët antonime shqipe mund të jenë *të mirëfilltaose jo të mirëfillta*.

Për më shumë, dalluam:

A) antonime kontradiktore, sipas koncepteve kontradiktore që ato shprehin;

B) antonime të *kundërta (i madh/ i vogël, i keq/ i mirë etj*), sipas koncepteve të kundërta që ata shprehin;

C) antonime reciproke, që shënojnë koncepte me ligje të ndërsjella.

Më pas, u ndalëm në klasifikimin e antonimeve të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze sipas kriterit strukturor, ku dallojmë:

1. *Fjalë antonime me rrënjë të ndryshme, me skemë strukturore*
2. *Fjalë antonime me parashtesa, të cilat mund të marrin pjesë:*
   c) *si gjymtyrë të çiftit antonimik në njërin prej krahëve të tij*
   d) *si gjymtyrë në të dy krahët e çiftit antonimik,*
3. *Fjalë antonime të përbëra ose të përngjitura,*
4. *Antonimet togfjalëshe frazeologjike ose jofrazeologjike*

Gjithashtu, trajtuam edhe klasifikimin gramatikor në shqip dhe anglisht në mënyrë të përgjithëshme. Nga ana leksiko-semantike, antonimet shqipe janë më shumë fjalë kuptimplote e shënuese, kurse nga ana kategoriale, gramatikore, ato janë mbiemra, folje, emra, ndajfolje, përemra dhe pak parafjalë, pjesëza e pasthirrma. Në kundërvënie me perceptimim se përgjithësisht antonimia është një marrëdhënie midis fjalëveqë i përkasin të njëjtës pjesë të ligjëratës, qendron argument, se për aq kohë sa antonimia është një marrëdhënie semantike, ajo mund të qendrojë edhe midis fjalëve në pjesë të ndryshme të ligjëratës, si p.sh, midis një foljeje dhe një emri, midis një foljeje dhe një mbiemri, etj.

Më tej, cekëm disi edhe kategoritë e reja të antonimeve ku dalluam se kategoritë klasike janë parë sipas këndvështrimit logjik dhe teorik. Antonimet mund të kategorizohen edhe në bazë të kriterit të korpusit, me qëllim për të evidentuar atë çka antonimet bëjnë në një fushë të caktuar dhe jo thjesht për të përshkruar atë çka antonimet janë në vetvete. Interes të veçantë paraqet tipologjia e antonimisë, sipas qasjes metagjuhësore me bazë korpusin.Në këto kategorizime të reja dallojmë:

- kategorizmi në bazë të funksionit në bashkërenditje: *antonimet ndihmëse,antonimet krahasuese, antonimet e koordinuara, antonimet e dallueshme, antonimet ekstreme, antonimet idiomatike., antonimet e mohuara,antonimet kalimtare.*
- kategorizimi sipas interpretimit të konfigurimit dhe përmbajtjes së kuptimit
  - *kategorizimi i antonimisë përmes konfigurimit apo skemës*
  - *kategorizimi përmes strukturave përmbajtësore të kuptimit*

Më pas, u përqendruam tek disa kategori të tjera, siç janë edhe:

- *Antonimet ndërkulturore* ku dallohen dy grupe gjuhësh:

- *gjuhë me vetëdije të qartë të antonimeve*
- *gjuhë me vetëdije të nënkuptuar të antonimeve*

- *Antonimet stilistike,*të cilat na çuan në përfundimin se janë faktorët shoqërorë ato që

kushtëzojnë këtë tip antonimesh. Antonimet stilistike janë të lidhura ngushtë me sinoniminë dhe stilistikën dhe krijohen midis gjymtyrësh sinonimike, ku njëra prej tyre përdoret në kuptim negative, për shkak të interpretimit me ngjyrim emocional, stilistikor. Në letërsi stili i autorit ka lirshmëri të mjaftueshme për të formuar çifte antonimike stilistikore, të cilat pasqyrojnë botën e brendshme, ndjenjat e forta përmes antitezave. Në shqipe, kemi ngjyrim emocional keqësues edhe me fjalë të huazuara nga turqishtja. Si mjete stilistikore shërbejnë në mënyë të përmbledhur, arkaizmat, orientalizmat, ndajshtesa keqësuese,frazeologjia dhe togjet e qendrueshme, antiteza dhe oksomoroni, etj.

- *Antonimet kontekstuale,*kanë të bëjnë me kundërvënie brenda një konteksti të

caktuar, jashtë të cilit kjo kundërvënie nuk duhet të ekzistonte. Brenda kontekstit, antonimia kalon deri në shkallë sinonimie me njërën prej gjymtyrëve. Gjithashtu, pamë disa tipe antonimesh kontekstuale foljore, të cilat janë me interes të veçantë për nga natyra e tyre semantike dhe strukturore.

Në kreun e katërt, thellohemi më shumë drejt tipologjisë së antonimeve të shprehura me mbiemër dhe folje në gjuhën angleze dhe shqipe. Në gjuhën shqipe, kontribut në këtë kategorizim kanë dhënë studiues si |J. Thomai, M. Samara, I. Goci, R. Memushaj etj., të cilët edhe pse me terminologji të ndryshme, kanë përshkruar disa qasje teorike ndaj natyrës së kundërvënies dhe tipologjisë së antonimisë mbiemërore. Kështu, përmbledhurazi, kujtojmë edhe një herë çka thamë më lart, duke theksuar se Samara njeh kuptime të mirëfillta, të cilat i ndan në antonime të mirëfillta skajore dhe jo të mirëfillta skajore. Në lidhje me antonimet e mirëfillta, ai trajton çështje të kundërvënies trefishe, enantioseminë, si edhe kundërvënien stilistikore. Ndërkohë që në lidhje me mbiemrat antonimë jo të mirëfilltë ai trajton antonimet e shkallëzuara, antonimet e rastit si edhe ato kontekstuale. Samara fut konceptin e teorisë në fushën semantike gjatë analizës semantike në kontekstin e gjuhës shqipe, ku thekson edhe rolin e kontekstit në kundërvënie. Gjtihashtu, Samara flet edhe për forcën antonimizuese të disa mbiemrave. J. Thomai përdor një tjetër kriter për të dalluar antonimet e plota (të cilat nuk varen nga konteksti) dhe antonime kontekstuale (nuk janë antonime në kuptimet themelore, por në kontekste të caktuara dalin si antonime). R. Memushaj flet për antonime të pashkallëzueshme dhe antonime të shkallëzueshme. I. Goci përdor termin antonimi e plotë dhe e pjesshme. Gjithashtu ai analizon edhe mbiemrat e shijes dhe ngjyrës. Sipas I. Gocit, antonimia mbiemërore "mund të jetë elementare ose e abstraktuar.

Në bazë të llojit të kuptimit të kundërvënë dallojmë:

1. Kundërvënie kuptimesh parësore

2. Kundërvënie kuptimesh dytësore (të prejardhura)

3. Kundërvënie kuptimesh të figurshme.

Tipologjia e antonimeve të shprehura me mbiemër në gjuhën angleze parë semantikisht paraqitet e larmishme në lidhje me kriteret e përdorura si edhe me terminologjinë. Kështu, *Saeed* dallon tipe antonimesh mbiemërore: si *antonime të thjeshta, antonimet e shkallëzuara,* si edhe *motrat taksonomike* janë ato fjalë të cilat janë

në të njëjtin nivel në një taksonomi të caktuar si p.sh. ngjyrat: *red, orange, yelloë, black , ëhite, green* etj

Në përgjithësi, antonimet mbiemërore në gjuhën angleze dalin si të shkallëzuara dhe plotësuese (në gjuhën shqipe Memushaj ka një kategorizim të ngjashëm). Cruse gjithashtu trajton tiparin binar të antonimeve mbiemërore të shkallëzuara. *Rastet komplekse* të diferencimit midis mbiemrave të shkallëzuar dhe plotësues përbëjnë një tjetër çështje interesante në ato çka analizuam më lart.

Në vijim, trajtuam çështje që lidhen me tipologjia e antonimeve të shprehura me folje në gjuhën angleze dhe shqipe parë semantikisht. Në lidhje me foljet e gjuhës angleze, përbën interes fakti se disa disa autorë si Lyons, Cruse në analizën e foljeve nuk shohin antonimi, por kundërvënie në kuptim më të përgjithësuar, pasi ata e shohin antoniminë të lidhur ngushtë me shkallëzimin (i cili në përgjithësi është tipar i mbiemrave). Ne do ti referohemi termit *antonim* në kuptim gjithëpërfshirës të kundërvënënies pasi në studim foljet dhe mbiemrat do i trajtojmë si pjesë të ligjeratës me aftësi për të krijuar lidhje kuptimore antonimike. Në një këndvështrim përgjithësues dallojmë këto dy tipe antonimesh foljore:

- *Antonime plotësuese* janë fjalë të cilat karakterizohen nga një kundërvënie binare e vetme, që mund të ketë vetëm dy gjymtyrë, ku mohimi i njërës prej gjymtyrëve në kundërvënie nënkupton pohimin e gjymtyrës tjetër, si p.sh., *remember/forget (kujtoj/harroj).*

- *Antonime të anasjellta* janë fjalë të cilat shënojnë të njëjtin referent të parë në këndvështrime të ndryshme.

Për më shumë, dalluam edhe treshen antonimike foljore "*të lindësh/ të jetosh/ të vdesësh*" që njihet si "*plotësuese të anasjellta*".

Si përfundim, duhet thënë se nuk ekziston një ndarje absolute mes kategorive të antonimeve, pasi, shpeshherë, vërejmë se disa çifte antonimesh mund të kalojnë nga njëra kategori tek tjetra, si raset kur mbiemrat plotësues "*married/single*", "*male/female*", "*dead/alive*" etj., mund të kalojnë në kategorinë e antonimeve të shkallëzuara në një kontekst të caktuar. Kështu, dikush mund të jetë në një gjendje të tipit "*more dead than alive*" ("*më shumë i vdekur sesa i gjallë*").

Për më shumë, disa antonime të shkallëzueshme paraqesin karakteristika të atyre plotësuese, si në rastet kur disa ciftç të shkallëzueshme përmes formave gramatikore të krahasimit (*more/less/-er*), por që mohimi i njërit gjymtyrë na sjell në mendje gjymtyrën tjetër, pra nuk ka një gjymtyrë të tretë të ndërmjetme. Shembull: "*open/shut*" (*i hapur/i mbyllur*), nëse dera thuhet se nuk është "*open*", atëherë ajo është "shut". Ky tipar dikotomie tek mbiemrat e shkallëzuar vërehet edhe në çifte të tipit "*honest/dishonest*", "*obedient/disobedient*" etj. Palmer të tillë mbiemra i sheh si "*antonime të shkallëzuara të qarta*" e jo si "*antonime me shkallëzim të nënkuptuar*".

Gjithashtu, dalluam disa mbiemra, të cilët edhe pse janë të shkallëzuar, nuk mund të përdoren me treguesit gramatikorë të formës krahasore (more/less) si për shembull çifti "*brilliant/stupid*", të cilët edhe pse klasifikohen tek mbiemrat e shkallëzuar, kanë vlerë absolute në kuptimin që qendrojnë në skajet fundore të boshtit.

Më pas, u ndalëm në tipologjinë e antonimeve të shprehura me folje dhe mbiemër në gjuhën angleze dhe shqipe parë strukturalisht. *Prejardhja parashtesore* është burimi kryesor I antonimeve si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze. Nga ana strukturore ai dallon dy nëntipe:

a, Skema P+T <-> T, e cila kanë kundërvënie më të dobët në krahasim me grupin e dytë.

b. skema P+T<->P1+T, e cila karakterizohet nga një kundërvënie e mirëfilltë, në skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta .

Vërejmë se parashtesa nuk e ndërron kategorinë leksiko-gramnatikore të fjalës me të cilën bashkohet, por, i jep asaj një kuptim të ri plotësues. Parashtesat mund të jenë të parme (“*sh-” , “zh-” , “ç-”, “stër-” , “shpër-*”, etj., në gjuhën shqipe, dhe *“un”, “in”, “dis”,“il”, “im”, “ir”,* etj. në gjuhën angleze) ose të formuara prej fjalësh të tjera, si p.sh. parafjalore (*mbi- , nën- , pa- , ndër-* etj. në gjuhën shqipe, “counter-”, “under-”, “inter-” etj.).

Për sa i përket *prapashtesave*, në gjuhën shqipe ato formojnë mbiemrat me nuancë keqësuese, sharëse, përbuzëse, etj. Këtu dallojmë prapashtesa të tilla si: *–ak, -ac, -uc, -acuk-, -aq, -uq , -hash, -ec,* p.sh. “*burrë/burracak*”. Theksojmë se ato nuk formojnë antonime në gjuhën shqipe. Në gjuhën angleze, dallojmë prapashtesën “*-less*”, e cila formon antonimi, duke ju kundërvënë mbiemrave me prapashtesën “-ful” si në shembujt “*careless/careful*”, “*useless/useful*”, etj. Por, ka edhe raste të tjera kur kundërvënia me “*-ful*” nuk kërkon domosdoshmërisht prapashtesën “*-less*”, si p.sh., “*successful/unsuccessful*” (nuk ka një formë të tipit *successless**).

Më tej u ndalëm te antonimet me togfjalësha të qendrueshëm, duke theksuar se ato e kanë fituar kuptimin gjatë përdorimit shumëvjeçar në gjuhë, dhe formojnë kundërvënie jo të mirëfillta, meqenëse kanë marrë kuptime figurative të cilat e kanë dobësuar fuqinë e shkallës kundërvënëse ndërmjet tyre.

Në kreun e pestë, korpusi i antonimeve dhe studimet eksperimentale të antonimeve, shërbejnë si një hyrje për te studimet tona. U ndalëm tek disa nga studimet më të rëndësishme të antonimeve përmes korpusit dhe eksperimenteve gjuhësore në gjuhën angleze, duke analizuar qëllimin, metodologjinë, rezultatet, etj.

Përmblodhëm tre treguesit kryesorë për përcaktimin e antonimeve “*më të gjetura*”. Janë pikërisht këto tre tregues të cilët janë përdorur në përgjithësi tradicionalisht për të dalluar antonimet “*e mira*” nga ato “m*ë pak të mira*”:

- qartësia e dimenstioneve në të cilat bazohen antonimet.
- dimesioni duhet të jetë me natyrë denotative dhe jo konotative.
- treguesi i tretë lidhet me pozicionin që zë kuptmi i fjalës në dimension.

Në vitet e fundit, vëmendja është përqendruar tek studimet me në qendër kontekstin, përdoruesin e gjuhës, korpuset konkrete e praktike të gjuhës, etj., përmes metodave moderne eksperimentale. Studime të tilla ofrojnë një qasje tjetër me të qartë të antonimeve dhe përdorimit dhe natyrës së tyre në gjuhë. Dallojmë Murphy me *Marrëdhënia përmes Kontrastit (RC/Relation by Contrast);* Paradis dhe Willners me metodën e tyre metagjuhësore të konfigurimit dhe përmbajtjes,e cila njihet si *dikotomia antonimike* e një strukture kuptimore; Jones, Paradis, Murphy dhe Willners me

eksperimentet përmes testeve psikologjike me natyrë metagjuhësore; etj. Gjatë studimeve mbi antonimet kanonike janë përdorur disa metoda, si p.sh., testet e shoqërimit të fjalëve, testet e gjykimit, apo eksperimentet e vjeljes (mbledhjes) së fjalëve, etj. Studimet në lidhje me antonimet kanonike nuk janë bazuar vetëm në korpuset gjuhësore por edhe në veprimtaritë metalinguistike duke shfrytëzuar intuitën e dëgjuesit.

Por, modelet e mësipërme të eksperimenteve metalinguistike nuk arrijnë të vlerësojnë se si gjuha përdoret por vetëm atë që informantët reflektojnë përsa i përket kuptimeve të fjalëve të dhëna dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre . Nga ana tjetër studimet me bazë korpusi vlerësojnë antonimet në përdorimin natyral të gjuhës dhe shumica e tyre janë bazuar tek bashkërënditja si një tregues kyç për antonimet kanonike.Studimi i Jones, Paradis, Murphy dhe Willners është një qasje e kombinimit të dy metodave të mësipërme duke shmangur disa problem që lidhen me to.

Në përfundim, themi, se mënyrat se si njerëzit e përdorin dhe ndërveprojnë me antoimet tregojnë se ndërkohë që kundërvënia është e dukshme nga ana psikologjike, disa marrëdhënie semantike si ato kundërshtuese dhe plotësuese nuk dallohen qartë nga përdoruesit e gjuhës. Kjo është e dukshme edhe në eksperimentet psikolinguistike si edhe në përdorimin e gjuhës ku kategoritë e antonimeve janë të papërshtatëshme me funksionet e tyre në ligjërim.

Në studimet tona të antonimeve përmes korpusit u përqendruam tek parashtesat që formojnë antonime në gjuhën angleze dhe shqipe, në fjalorët një dhe dygjuhësh. Fillimisht përcaktuam objektin, metodologjinë, përzgjedhjen e korpusit, rezultatet, etj. Për sa i përket fjalorit Shqip-Anglisht (Pavli Qesku, 45.000 fjalë, EDFA 2002) u vu re se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa "**pa-**", që formon mbiemra, e cila pasohet nga parashtesa "**sh-**", që formon mbiemra dhe folje. Në vazhdimsi të renditjes vërejmë parashtesën "**ç-**" e cila gjithashtu formon mbiemra dhe folje. Pothuajse po aq të shpeshtë janë edhe njësitë mbiemërore dhe foljore antonimike të formuara me parashtesën "**zh-**". Edhe parashtesa "**jo-**" ka një total të konsiderueshëm mbiemrash, por, nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Ndërkohë, parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë "**a-**", "**dis-**", "**dez-**", "**i-**" dhe "**ir-**" të cilat gjenden në sasi minimale.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, (2006, Akademia e Shkencave e Shqipërisë), u vu re, se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa ***"pa-"***, e cila formon njësi mbiemërore. Ajo pasohet nga parashtesa ***"sh-"***, e cila formon mbiemra dhe folje. Në vazhdimsi të renditjes, vërejmë parashtesën "**ç-**", e cila formon mbiemra dhe folje. Pothuajse po aq të shpeshtë janë edhe njësitë mbiemërore antonimike të formuara me parashtesën ***"zh-"***. Më pas rradhiten antonimet foljore me parashtesën ***"zh-"***. Edhe parashtesa "**jo-**" ka një total të konsiderueshëm por nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë ***"a-", "dis-", "dez-", "i-"*** dhe ***"ir-"*** të cilat gjenden në sasi minimale.

Në Fjalorin Anglisht-Shqip (Ilo stefanllari), u vu re se parashtesa më prodhimtare me kuptim të kundërt është pikërisht parashtesa ***"un-"***, e cila pasohet nga parashtesa ***"in-"***. Në vazhdimsi të renditjes vërejmë parashtesën ***"dis-"***, e cila formon folje dhe mbiemra. Pothuajse po aq të shpeshtë janë edhe njësitë mbiemërore dhe foljore antonimike të formuara me parashtesën ***"im-"***. Edhe parashtesa ***"non-"*** ka një total të konsiderueshëm. Është për tu përmendur fakti se nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Gjithashtu edhe

parashtesat e tipit ***"ir-"*** "**anti**-" dhe ***"de-"*** janë me një numër jo fare të vogël. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë ***"under-", "il-", "counter-", "a/an-"*** dhe ***"contra-"*** të cilat gjenden në sasi minimale.

Në fjalorin Anglisht-Anglisht, (Cambridge Advance Learner's Dictionary, 2009) u vu re se parashtesat më prodhimtare me kuptim antonimik janë pikërisht parashtesa "**un-**" dhe parashtesa **"in-"**. Në vazhdimsi të renditjes dallojmë parashtesën "**im**-" dhe "**dis**-", e cila formon folje dhe mbiemra. Edhe parashtesa "**non**-" ka një total të konsiderueshëm mbiemrash. Vlen për tu përmendur se nuk gjenden folje me këtë parashtesë. Gjithashtu, edhe parashtesat e tipit "**ir**-" "**anti**-" dhe "**de**-" janë me një numër jo fare të vogël. Parashtesat më pak prodhimtare në këtë fjalor janë "**il**-" dhe "**a/an**-", të cilat gjenden në sasi minimale.

Për sa i përket studimit të dytë eksperimental, përmes vjeljes së informacionit, përcaktuam qëllimet e studimit, instrumentin matës, procedurën e matjes, dhe kampionin e studimit. Më pas u morrëm me mbledhjen dhe analizën e të dhënave, metodologjinë, përzgjedhjen e korpusit, hartimin e tabelës, mbledhjen e informacionit dhe hartimin e tabelës së të dhënave, rezultatet dhe analizën, krahasimin e rezultateve, interpretim e rezulateve, përfundimet dhe propozimet për hulumtime të mëtejëshme.

Si përfundim, vërejmë se dallimi mes përgjigjeve të dhëna nga studentët e programit Bachelor, Gjuhë Angleze, pranë UAMD dhe antonimeve të vjela nga korpusi i antonimeve në fjalor është jo i vogël. Kështu, dallojmë se për mbiemra të tillë si "*bad"*studentët kanë dhënë vetëm "*good, "fine", "okay"*, si gjegjëse antonime ndërkohë që korpusi ofron dymbëdhjetë antonime për të. Pra, duket qartë se në tabelën e dytë gama e antonimeve për çdo fjalëështë disa herë më e lartë se në tabelën e parë të rezultateve të studentëve. Kjo tregon se njohuritë e studentëve për të tillë mbiemra në gjuhën shqipe janë të kufizuara në përdorimet më të përgjithëshme të fjalëve dhe rreth kuptimeve të para dhe të dyta të çdo mbimeri në studim.

Studimi i dytë nxjerr rezultate të pritura por njëkohësisht shërben edhe si tregues i punës që duhet të bëhet nga mësuesit e gjuhës angleze në përvetësiin e antonimeve në klasë për të zgjeruar njohuritë e studentëve për përdorimin e fjalëve. Vërejmë edhe disa gabime në mënyrën se disa studentët e kanë perceptuar antoniminë.

Në lidhje me propozimet e mëtejëshme, mendojmë se është me rëndësi fillimi i një studimi të detajuar për sa i përket bashkërenditjes së çifteve të standartizuara të gjuhës shqipe. Ky studim do të ketë të ngjashmëri me natyrës e studimit tëS. Jones,C. Paradis,M. L.Murphy, C. Willners (2007) "Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity". në këtë mënyrë, lindin detyra të reja për të ardhmen e studimeve moderne në lidhje me marrëdhëniet leksiko-semantikore siç është edhe antonima.

Në vazhdim, në procesin e përvetësimin të gjuhës janë disa faktorë që ndikojnë në mënyrën se si fëmija "përparon" drejt zotërimit dhe përdorimit të mirë të gjuhës në mënyrë të pavarur. Janë bërë hulumtime të shumta për të arritur të kuptohet, se kur fëmijët mesojnë rreth antonimisë.Të tjerë hulumtues mendojnë se antonimia mësohet në moshë më të vonë. Ka edhe nga ato të cilët supozojnë, se antonimia është e mësuar dhe jo e përvetësuar (e fituar). Kjo tregon se ka qasje të ndryshme ndaj pyetjes si fitohet antonimia. Teoritë e sotme mbështeten më shumë te pragmatika. Këto qasje theksojnë faktin, se fëmijët e supozojnë se çdo fjalë e re që ata mësojnë ka një kuptim të ndryshëm që ato dinë. Gjithashtu, fëmijët priren drejt polaritetit, edhe pse ato nuk e kanë akoma idenë, se çdo të thotë dimensioni i një çifti. Për më shumë, u theksua edhe rëndësia e

prozodisë si një sinjal edhe më i rëndësishëm sesa frekuenca apo zëvëndësueshmëria për të dalluar çiftet antonime.

Si përfundim, mund të themi se nëse e studiojmë përvetsimin e gjuhës përmes përdorimit të antonimisë në ligjerim nga fëmijët në mënyrë të ngjashme me të rriturit atëherë mund të themi se ndodh në një moshë shumë të herët. Ndërsa përdorimi i antonimeve përmes eksperimenteve metalinguistike, si p.sh: testeve të asosacionit të lirë të fjalëve apo lojrave të ndryshme me pyetje përgjigje, mësohet në një moshë më të vonë. Në përgjithësi këto studime tregojnë se fëmijët njësoj si të rriturit kanë tendencë drejt binaritetit dhe kundërshtisë të papajtueshme. Kjo rezulton në studimet me natyrë paradigmatike. Gjithashtu, është vënë re se fëmijët preferojnë të përgjigjen në zëvendësimin e fjalëve përmes një antonimi dhe jo sinonimi.

Strategjitë kyçe për përvetësimin e fjalorit përbëjnë një tjetër çështje me interes. U përqendruam tek ato që nxënësit duhet të dinë në lidhje me një fjalë para se të mund të themi se ata e kanë mësuar atë. Për të mësuar fjalorin nevojitet informacion i shumëllojshëm ku përmendet edhe roli i semantikës dhe i lidhjeve semantike të fjalëve siç është ajo e antonimisë. Si rezultat, vërejmë se përvetësimi i fjalorit kalon në disa faza, dhe se *të kundërtat janë mënyra më e mirë për ti prezantuar fjalët e reja*.

U ndalëm tek prezantimi i mbiemrave dhe përvetësimi i tyre përmes antonimisë. Është e kështillueshme që ato të ilustrohen me figura, objekte nga realiteti, edhe pse jo gjithmonë është e mundur për shkak të natyrës abstrakte të disa prej mbiemrave.Në përgjithësi, duke i'u referuar edhe punës tonë praktike me metodat më bashkkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze, ushtrimi më e mirë me mbiemrat dhe ndajfoljetështë përshkrimi i një figure, ngjarjeje, personazhi, etj.

Gjithashtu, edhe grupimi i fjalëve ndihmonnë përvetësimin e fjalorit. Studimet tregojnë se fjalët memorizohen në trurin e njeriut jo si një listë në fjalor, por si një sistem i organizuar. Ne do të përqendrohemi tek grupimi sipas kriterit semantik, ai i lidhjeve përmes fushës semantike ku dallojmë lidhjet përmes njësive leksikore që formojnë çifte antonimesh.

Vë vijim, theksuam, se roli i mësuesit në përvetësimin e fjalorit është shumë i rëndësishëm. Jo vetëm duhet që mësuesi ti drejtoj nxënësit drejt këtyre fazave, duke i ndihmuar ata të dallojnë dhe kuptojnë fjalët e reja, por mësuesit gjithashtu kanë si detyrë edhe dhënien e ushtrimeve të nevojëshme për të praktikuar fjalorin. Shpesh, mësuesit japin një numër të caktuar fjalësh të reja, duke i kërkuar nxënësëve ti mësojnë përmendësh, por nuk japin ushtrime ku ato të përdoren. Në përfundim, dhamë disa këshilla për mësuesit e gjuhës angleze si gjuhë e dytë.

Nga sa më sipër cituam, duket qartë se antonimia është një forcë tërheqëse në përvetësimin e gjuhës që nga femijëria, në procesin e përvetesimit të gjuhës mëmë dhe më tej, në përvetësimin e gjuhëve të huaja e të dyta. Kështu, antonimia përbën një mjet të fuqishëm si për studentin e gjuhës së dytë edhe për mësuesin, qellimi i të cilit është të mundësoj përvetësimin e kësaj gjuhe në mënyrën më efikase të mundëshme, duke e bërë antoniminë një mekanizëm thelbësor në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës së huaj.

BIBLIOGRAFIA

1. C. Baygh, T. A. Camble (1978) The History of English Language , Londër, f. 12-13.
2. A.Dhrimo (1972) Formimi i Mbiemrave në Gjuhën e Sotme Shqipe, Studime Filogjike 3, f. 46-52.
3. A.Kostallari, Mbi Disa Veçori të Strukturës Semantike të Kompozitave Pronësore të Shqipes, Studime Filologjike.
4. A.Kostallari, Parimet Themelore për Hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe", Studime Filologjike.
5. A.Lehrer (1985) Markedness and Antonymy. Linguistics, f. 397-429.
6. A.Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity, f. 498-508.
7. A.Lehrer (2002) Paradigmatic Relations of Exclusion and Opposition I: Gradable Antonymy and Complementarity. In Cruse, D.A., F. Hundsnurcher, M. Job and P.R. Lutzeier, eds. Handbook of Lexicology. Berlin: de Gruyter, f. 498-508.
8. A.Lehrer, K. Lehrer (1982) Antonymy. Linguistics and Philosophy5, Paradigmatic Relations, f. 483–501.
9. A.W.Frisby (1957) Teaching English, The English Language Book Society and Longmans Green and Co., f. 98.
10. A.W.Read (1948) An Account of the Word Semantics: World Volume 4, f. 78.
11. B. Russell (2007) Inquiry into Meaning and TR., Routlege, f. 11-98.
12. C. Fellbaum (1995) Co-occurrence and Antonymy.International Journal of Lexicography, f. 281–303.
13. C.K.Odgen, I. A. Richards (1946) The Meaning of Meaning, New York, Harcourt, Brace &Co., f. 186.
14. C. K..Ogden (1967)
15. Opposition: a Linguistic and Psychological Analysis. Bloomington: Indiana University Press, f. 57-146.
16. C. K..Ogden, I. A. Richards (1923) The Meaning of Meaning University of Cambridge, f. 147.
17. C.Paradis (2004) Where Does Metonymy Stop? Senses, Facets and Active Zones. Metaphor and Symbol, f. 245 -264.
18. C.Paradis (2010) Good, Better and Superb Antonyms: A Conceptual Construal Approach.the Annual of Texts by Foreign Guest Professors, Faculty of Arts, Charles University Prague, f.75.
19. C.Paradis, C. Willners (2006) Antonymy and Negation: The Boundedness Hypothesis
20. C.Paradis, C. Willners (2006) What a Corpus-Based Dictionary Tells us About Antonyms. In E. Corino, C. Marello C. Ornesti, eds., Proceedings XII Euralex International Congress, f. 213-220.
21. C.Paradis, C. Willners (2011) Antonymy from Convention to Meaning-Making, Lund University, Review of Cognitive Linguistics, f. 367–391.
22. C.Paradis, C. Willners, (Forthcoming) 'Antonyms in Dictionary Entries: Methodological Aspects', Studia Linguistica, f. 55-277.
23. C.Paradis, C. Willners, M.L. Murphy, S. Jones, (Forthcoming) 'Good vs. Bad Antonyms: How to Tell the Difference', f. 93.
24. C.Paradis, C. Willners, S. Löhndorf , M.L. Murphy (2006) 'Quantifying Aspects of Antonym Canonicity in English And Swedish: Textual and Experimental', Quantitative Investigations in Theoretical Linguistics 2, f. 31.

25. C.Willners (2001) Antonyms in Context. A Corpus-based Semantic Analysis of Swedish Descriptive Adjective.Sweden: Dept. of Linguistics, Lund University, f. 174.
26. Carter, Mc.Carty (1991) Vocabulary and Language Teaching, London, Longman, f.18-38.
27. Ch.Bally (1951) Traite De Stilistue Francise, vol.I, II, Geneva-Paris, f. 42
28. D.A. Cruse (1986) Lexical semantics.Cambridge: Cambridge University Press, f. 63-203.
29. D.A.Cruse (1986) Lexical Semantics, Cambridge: Cambridge University Press, f. 94-262.
30. D.A.Cruse (2000) Meaning in Language, Oxford: Oxford University Press, f. 95-105.
31. D.A.Cruse, P. Togia (1995) Towards a Cognitive Model of Antonymy. Lexicology, f. 108-109.
32. D.Bolinger (1967) Adjectives in English: Attribution and Predication. Lingua, f. 18.
33. D.Gross, K..J.Miller (1990). 'Adjectives in WordNet', International Journal of Lexicography 3, f. 265–77.
34. D.Gross,U.Fischer &G. A.Miller (1989) The Organization of Adjectival Meanings.Journal of Memory and Language, f. 92-106.
35. D.Gross, U.Fischer, G. A.Miller (1988) Antonymy and the Representation of Adjectival Meanings. Cognitive Science Laboratory Report 13, Princeton University, f.178-204.
36. D.Hoxhaj (1994) Makrostruktura dhe Mikrostruktura e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, f.49.
37. D.J.Herrmann, R. J. S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool. (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy and Synonym Comprehension. Zeitschrift fur Psychologie, f. 138.
38. D.J.Herrmann, R.Chaffin. (1986) Comprehension of Semantic Relations as a Function of the Definitions of Relations, Amsterdam: Elsevier, f. 311-9.
39. D.J.Herrmann, R.J.S. Chaffin, G. Conti, D. Peters, P.H. Robbins (1979) Comprehension of Antonymy and the Generality of Categorization Models, f. 145.
40. D.J.Herrmann, R.J.S. Chaffin, M.P. D., R.S. Wool. (1986) The Role of Elements of Relation Definition in Antonymy And Synonym Comprehension. Zeitschrift fur Psychologie, f. 133-53.
41. D.L.Medin, R. L.Goldstone,& Gentner, D.(1993) Psychological Review, f. 254-278.
42. D.McNeill (1997) A Stydy of Word Opposition, Chicago: University of Chicago Press, f.132.
43. D.Raybeck, D. Herrmann (1996) Antonymy and Semantic Relations: The Case for a Linguistic Universal Cross-Cultural Research 30, f. 154-83.
44. Dictionary of Linguistics and Phonetics (1985) f. 18.
45. E.Weiner, Grammar in Early Modern English, Deputy Chief Editor, OED
46. E.V.Clark, H. H.Clark (1979) When Nouns Surface as Verbs, f. 785.
47. F.Agalliu (1972) Pjesorja në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike
48. F.Agalliu, R. Memushaj, M. Reso (1986) Hyrje në Gjuhësi, Tiranë
49. F.C.Fellbaum (1995) Co-occurrence and antonymy. International Journal of Lexicography, f.281-303.

50. F.De Saussure (1959) Course in General Linguistics. (Ed.by C. Bally and A Sechehaye.Trans.by W.Baskin.) New York: Philosophical Society, f. 96-196.
51. F.R Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 156.
52. F.R. Palmer (1981) Semantics, Cambridge University Press, f. 27-156.
53. Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë (2006) Akademia e shkencave e shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë
54. Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë (2006) Akademia e shkencave e shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë
55. Fjalor Shqip-Anglisht, Pavli Qesku, 45.000 fjalë, EDFA 2002
56. Fjalori Anglisht-Anglisht, "Cambridge Advance Learner's Dictionary" Third Edition, 2009
57. Fjalori Anglisht-Shqip me 35.000 fjalë të autorit Ilo stefanllari, botuar për herë të shtatë në vitin 1997
58. G.A.Miller, C.Fellbaum (1991) Semantic Networks of English. Cognition, f. 197-229.
59. G.A.Murphy, &J. M.Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy Inadjectives. Journal of Memory and Language, f. 301–319.
60. G.E.Miller (1990) WordNet: An On-Line Lexical Database. International Journal of Lexicography, f. 235-312.
61. G.Evens (1976) Semantic Structure and Logical Form, f. 199–222.
62. G.Josefsson (2003) The Acquisition of Swedish Grammar , Christer Platzack, Gisela Håkansson Amsterdam ; Philadelphia : J. Benjamins Pub., f. 184.
63. G.Kreezer, and K.l M. Dallenbach (1929) Learning the Relation of Opposition. American Journal of Philosophy, f. 432-41.
64. G.Leech (1974) Language Arts and Disciplines, f. 11-19.
65. G.Leech (1974) Semantics. Middlesex, Penguin, f. 125.
66. G.Leech (1974) Semantics: The Study of Meaning. New York: Penguin Books cituar nga S. Jones, Corpus Approaches to Antonymy,University of Central Lancashire, f.93-157.
67. G.Miller (1992) Lexical & Conceptual Semantics, f. 238.
68. G.Sampson (1974) Semantic Structures by Renate Bartsch; Theo Vennemann: Foundations of Language, Springer, f.287-289.
69. Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, Mënyrat dhe Tipat e Fjalëformimit, f. 58- 348.
70. H.G.Wells (1975) Early Writings in Science and Fiction University: California Press, f. 69.
71. H.H.Clark (1992) Arenas of Language Use. Chicago: University of Chicago Press, f. 172.
72. H.H.Clark (1970) Word Associations And LinguisticTheories, cituar nga J. Lyons (ed.) New Horizons in Linguistics, Baltimore: Penguin, f. 271–86.
73. H.Jackson (1988) Words and their Meaning. Cambridge, Cambridge University Press, f.76.
74. H.Jackson , E. Zeamvela (2007) Words, Meaning And Vocabulary, An Introduction to Modern English Lexicology, Cromwell Press, f.18-119.
75. H.Sweet (1900) A new English grammar, logical and historical Oxford, Clarendon Press, f. 14.
76. I.Goçi (1985) Antonimet e Gjuhës së Sotme Shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, f. 11-113.
77. I.S.P. Nation (2001) Learning Vocabulary in Another Language, Cambridge: Cambridge University Press

78. I.Stefanllari (2011) A Course in English Lexicology, GEER, Tiranë, f. 3.
79. J.Deese (1965) The Structure of Associations in Language and Thought. Baltimore: Johns Hopkins University Press, f. 108.
80. J.Froomkin (1993) The Crisis in Higher Education, f .165.
81. J.I.Saeed (2009) Sematics, Wiley-Blackwell, f. 67
82. J.Kagan (1984) The Nature of the Child. New York: Basic Books, f.187.
83. J.Katz, J. A. Fodor (1964) The Structure of Semantic Theory, North Holland Publishing Co. Smith, MD, f. 480.
84. J.Lyons (1977) Semantics, Cambridge University Press, f .74-286.
85. J.Lyons (1968) Introduction to Theoretical Linguistics,Cambridge University Press, f. 427
86. J.Lyons (1977) Semantics, Vol. 1. Cambridge: Cambridge University Press, f. 178.
87. J.Lyons (1977) Semantics: Volume 2. Cambridge, Cambridge University Press, f. 140-189
88. J.McCarten (2007) Teaching Vocabulary, Cambridge University Press, New York
89. J.R.Firth (1957) Modes of Meaning. Papers in Linguistics 1934–51, Oxford University Press, f. 190-215.
90. J.R.Hurford, B. Heasley, M. B. Smith (1983) Sematics: A Coursebook, f. 25.
91. J.R.Martin (1985) Factual Writng: Exploring and Challenging Social Reality, f. 58.
92. J.S.Justeson, S. M. Katz. (1991) Co-Occurrences of Antonymous Adjectives and their Contexts. Computational Linguistics, f. 138.
93. J.S.Justeson, S. M. Katz (1991) Co-occurrences of Antonymous Adjectives and Theircontexts. Computational Linguistics, f. 1–19.
94. J.S.Justeson, Slava M. Katz (1992) Redefining Antonymy: The Textual Structure of a Semantic Relation. Literary and Linguistic Computing, f. 176-184.
95. J.Sinclair (1987) Looking up. An Account of the COBUILD Project in Lexical Computing and the Development of the Collins COBUILD English Language Dictionary. London: Harper Collins, f. 38.
96. J.Thomai (1964) Probleme të Frazeologjisë së Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike
97. J.Thomai (1974) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Tiranë, f. 30-161.
98. J.Thomai (1981) Tipat Themelor të Derivacionit Semantik të Gjuhës Shqipe, f. 101.
99. J.Thomai (2005) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Tiranë, Dudaj, f. 129.
100. J.Thomai (2009) Prejardhja Kuptimore në Gjuhën Shqipe, EDFA,Tiranë, f.16-216
101. J.Thomai (SF) Vëzhgime mbi Frazeologjizmat e Gjuhës Shqipe, S.F.
102. J.Thomai, (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Tiranë, f. 33-49.
103. J.Thomai, (1981) Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Tiranë, f. 33-49.
104. K.Cipo (1948) Kompozitat Determinative, Studime Filologjike, f. 9-12.
105. L. Bloomfield (1914) Introduction to the Study of Language: The Sentence and the Word, f. 65-69.
106. L.Bloomfield (1933) Language and Linguistics, f. 139-151.
107. L.Bloomfield (1936) Language or Ideas? Language, f. 89-95.
108. L.Danglli (2012) Çështje të Sinonimisë në Gjuhën Angleze dhe Shqipe, Punim Doktorate, f.78.
109. l.Dodbiba, S .Spasse (1955) Gramatika e Gjuhës Shqipe, Tiranë, f. 262-264.
110. L.Lipka (1992) An Outline of English Lexicology: Lexical Structure, Word Semantics, and Word Formation,.DE GRUYTER f.145-146.

111. L.Murphy, J. M. Andrew (1993) The Conceptual Basis of Antonymy and Synonymy in Adjectives. Journal of Memory and Language, f. 301-19.
112. L.Taylor (1992) Vocabulary in Action; English Language Teaching; International English Language Teaching
113. L.Wittgenstein (2009) G E M Anscombe; P M S Hacker; Joachim Schulte,Chichester, West Sussex, U.K., f. 145.
114. Lanternfish ESL (2009) www.bogglesworldesl.com
115. Longman Dictionary of Applied Linguistics, Richards, Platt, Weber (1985) f. 14.
116. M.A.K.Halliday (1994) An Introduction to Functional Grammar. London: Edward Arnold, f. 85.
117. M.A.K.Halliday, W. Teubert, C. Yallop, A. Cermakova (2004) Lexicology and Corpus Linguistics. An Introduction University of Oslo, Norway, f. 202-207.
118. M.Bierwisch (1971) Modern Linguistics: Its Development, Methods, and Problems, f.26/87.
119. M.Breal (1900) Semantics, Studies on the Science of Meaning, f. 63.
120. M.Çeliku (1969) Çështjet të Normës Morfologjike në Letërsinë Artistike pas Çlirimit, S.F., f. 20.
121. M.Çeliku (2012) Sintaksë e Gjuhës Shqipe, Tiranë , f. 232.
122. M.L.Murphy (2003) Semantic Relations and the Lexicon, Antonymy, Synonymy and other Paradigms, Camridge University Press, f. 197-213.
123. M.L.Murphy (2006) Antonyms as Lexical Constructions: Why Paradigmatic Construction Isn't An Oxymoron' in D. Schönefeld (ed.) Constructions All Over: Case Studies and Theoretical Implications, f. 211.
124. M.Samara (1965) Vëzhgime mbi Antonimet me Parashtesa në Gjuhën Shqipe, Studime Filogjike, f. 157-161.
125. M.Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.60.
126. M.Samara (1968) Mbi Antonimet me Togfjalësha të Qendrueshëm në Gjuhën Shqipe, Studime Fillogjike, f.58-64.
127. M.Samara (1972) Mbi Karakterin Antonimik të Kuptimeve të Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime mbi Leksikun, II, Tiranë, f. 144-146.
128. M.Samara (1980) Vëzhgime Rreth Antonime të Fjalëve të Përbëra dhe të Përngjitura të Gjuhës Shqipe, Studime Filologjike, f. 122-124.
129. M.Samara (1985) Çështje të Antonimisë në Gjuhën Shqipe, f.34 -191.
130. M.Samara (1993) Rreth Sintagmatikës së Fjalëve në Gjuhën Shqipe, Studime Filologjike
131. M.Samara (2008) Rreth Leksikut Politik e Shoqëror në Gjuhën Shqipe, Antonimia, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 101-176.
132. M.J.Evans (1984) Complementarity, Antonymy, and Semantic Development: A Method and Some Data, f.142-62.
133. N.Chomsky (1957) Syntactic Structures the Hague/Paris: Mouton.
134. N.Chomsky (1969) Topics in the Theory of Generative Grammar, Cambridge University Press
135. N.K.Mehta (2004) Vocabulary Teaching: Effective Methodologies, Institute of Chartered Accountants of India.
136. P.Handke (1995) Die Stunde Da Wir Nichts Voneinander Wußten. Ein Schauspiel, Suhrkamp, f.174.
137. R.Carter (1987) Vocabulary. London, Allen & Unwin, f.98-103.
138. R.Gairns, S. Redman (1989) Working with Words, A Guide to Teaching and Learning Vocabulary, Cambridge , C.U.P.

139. R.Lado (1964) Language Teaching: A Scientific Approach, McGraw Hill: New York, f. 121.
140. R.M.Kempson (1977) Semantic Theory, Cambridge University Press, f. 12-126.
141. R. M. L.Campillo (2004) Teaching and Learning Vocabulary, An Introduction for English Learners, f.43-44.
142. R.Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.129
143. R.Memushaj (2006) Hyrje në Gjuhësi, Botimet Toena, f.49-172.
144. R.Varley (1991) Referene, Sense and Antonymy in the Assessment of Lexical Semantic Abilities in Aphasia. Aphasiology, f. 168.
145. R.S.Ginsburg (1979) A Course in the Modern English Lexicology, f. 147-148.
146. R.S.Ginsburg (1979) Functioning of Compound Antonyms in Modern English / A Course in Modern English Lexicology.
147. Roget's Thesaurus/ Roget, P.Mark (1962) [1852], Dutch, Robert A., O.B.E., ed., The Original Roget's Thesaurus of English Words and Phrases (Americanized ed.), New York: Longmans, Green & Co./Dell Publishing Co., Inc.
148. S.Jones (2002) Antonymy, A Corpus-Based Perspective, Routledge: London, f. 94-128.
149. S.Jones (2003) Corpus Approaches to Antonymy, University of Central Lancashire Artikull, f. 297-310.
150. S.Jones , M. L.Murphy (2003) Antonymy in Childhood: A Corpus-Based Approach to Acquisition, University of Central Lancashire, Sussex, UK, f. 372.
151. S.Jones,C. Paradis, M. L.Murphy, C. Willners (2007) Googling for 'Opposites': A Web-Based Study of Antonym Canonicity, f .131.
152. S.M.Ervin (1963) Correlates of Associative Frequency.Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior, f. 422-431.
153. S.Ullmann (1962) Semantics: An introduction to the Science of Meaning, f. 74-128.
154. Sh.Delija (2008) Çështje të Antonimisë të Gjuhës Angleze Vështruar në Përasje me Gjuhën Shqipe, Dizertacion
155. T.Givon (2002) Bio-Linguistics, Amsterdam: John Benjamins, f. 95.
156. V.Fromkin, Richard Rodman (1998) An introduction to Language, Longman Publishers, f. 83-85.
157. V.Mathesius (1975) A Functional Analysis of Present Day English on a General Linguistic Basis, f. 18.
158. V.Muehleisen (1997) Antonymy and Semantic Range in English, (Ph.D dissertation), University of Illinois. f.113
159. W.Alston (1964) Philosophy of Language, London:Routledge, f. 10, 134-136.
160. W.Croft, D.A.Cruse (2004) Cognitive Linguistics, Cambridge University Press, f. 69.
161. W.Croft, D.A.Cruse (2004) Journal of Pragmatics, f. 54.
162. W.G.Charles, M.A.Reed, &D.Derryberry (1994) Conceptual and Associative, Processing in Antonymy and Synonymy. Applied Psycholinguistic, f. 329–354.
163. W.G.Charles, M.A.Reed, D. Derryberry (1994) Conceptual and Associative Processing in Antonymy and Synonymy. Applied Psycholinguistics, f. 54.
164. W.G.Charles, G.A. Miller (1989) Contexts of Antonymous Adjectives, Applied Psycholinguistics 10, f. 357–75.
165. Webster's Dictionary (Updated Third New International, Online Version Downloaded)
166. Xh.Lloshi (1966) Shënime për Fjalën dhe Togfjalëshin, Studime Filologjike
167. Xh.Lloshi (1997) Gjuha, Stili dhe Redaktimi në Shtyp, f. 17.

168. Xh.Lloshi (2012) Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, f. 13.